



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

DOKTORATË

LIDHJA

**KRYEFJALË – KALLËZUES – KUNDRINOR
NË GJUHËN SHQIPE DHE GJUHËN ANGLEZE**

Punoi:

Msc. Rilind MAHMUDI

Udhëheqës shkencor:

Prof. dr. Vilma TAFANI

2021

Doktoratë

Përgatitur nga: Rilind Mahmudi

Për marrjen e gradës shkencore “DOKTOR”

Profili: Gjuhësi/Sintaksë

*LIDHJA KRYEFJALË-KALLËZUES-KUNDRINOR NË GJUHËN SHQIPE DHE GJUHËN
ANGLEZE*

Udhëheqës shkencor: **Prof. dr. Vilma Tafani**

Mbrohet më, dt. ____ . ____ . 2021 para jurisë:

1. _____ (Kryetar)
2. _____ (Oponent)
3. _____ (Oponent)
4. _____ (Anëtar)
5. _____ (Anëtar)

Falënderime

Do të doja të shpreh falënderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më kanë nxitur dhe mbështetur të realizoj këtë disertacion.

Falënderimet e mia më të sinqerta shkojnë për udhëheqësen shkencore, Prof. dr. Vilma Tafani, e cila në vazhdimësi më ka nxitur dhe mbështetur në përfundimin e këtij disertacioni.

Mirënjohje për kolegët, miqtë dhe të gjithë dashamirët të cilët më kanë mbështetur në të gjitha mënyrat e mundshme për përfundimin e suksesshëm të disertacionit.

Mbi të gjitha, falënderoj familjen time të ngushtë, bashkëshorten dhe dy fëmijët, Jonidën dhe Jonin, prindërit dhe vëllanë tim për mbështetjen e pazezervë dhe nxitjen e vazhdueshme për të realizuar me sukses këtë studim.

Ky disertacion u kushtohet fëmijëve të mi të cilët janë motivi im kryesor në jetë.

Abstrakt

Sintaksa është një fushë në zhvillim e sipër dhe pasurohet me studime të reja. Sintaksa e gjuhës shqipe është plotësuar vazhdimisht me studime të cilat lidhen me përkufizimin e termave më të rëndësishëm sintaksorë, përbërësit dhe strukturën e fjalisë si edhe rendin e fjalëve. Duke qenë se disa çështje në gjuhën angleze ka kohë që janë përkufizuar, si p.sh. termi *frazë (phrase)* ose *fjali e varur (dependent clause)*, në gjuhën shqipe ekzistojnë qëndrime të ndryshme lidhur me përdorimin e termave *togfjalësh, sintagmë, frazë, përbërës sintaksor* dhe së fundi *sifjali*. Zgjidhja për këto qëndrime mund të vijë duke parë të përbashkëtat dhe dallimet që ka shqipja me gjuhët e tjera, e në veçanti me anglishten si gjuha më e studiuar në këtë aspekt.

Ky studim ka për qëllim analizën hap pas hapi të çështjeve sintaksore që lidhen me temën kryesore ‘*Lidhja kryefjalë – kallëzues – kundrinor në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze*’. Analiza e secilës gjymtyrë më vete dhe lidhjes së tyre me njëra-tjetrën, na çon drejt qëllimit final të këtij disertacioni, identifikimit të ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze. Ngjashmëritë dhe dallimet në strukturën e fjalive, rendi i gjymtyrëve në tipa të ndryshëm fjalish, roli i interferencës gjuhësore dhe roli i leksikonit janë çështjet kryesore që trajtohen në këtë disertacion. Këto çështje janë pjesë e studimit në rrafsh teorik, ndërsa analiza e fjalive në veprën letrare të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe ‘*Aventurat e Sherlock Holmsit*’, përbën pjesën kryesore praktike të këtij disertacioni. Pyetësi i analizuar në kreun e pestë të këtij disertacioni, i plotësuar nga studentë dhe mësimdhënës, tregon nivelin e zotërimit të gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe, si dhe ndikimin e interferencës gjuhësore.

Me anë të analizës dhe krahasimit të shembujve në pjesën teorike dhe praktike të këtij disertacioni kemi arritur në përfundime të përshtatshme të cilat tregojnë se ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime në strukturën e fjalive dhe rendin e gjymtyrëve ndërmjet dy gjuhëve të marra në studim.

Fjalët kyçe: sintagmë, sifjali, fjali, gjymtyrë të fjalisë, kryefjalë, kallëzues, kundrinor, rendi i gjymtyrëve, përkthim.

Abstract

Syntax is a constantly evolving field and is enriched with new studies. The syntax of Albanian language is constantly supplemented with studies related to the definition of the most important syntactic terms, sentence constituents and structure, as well as word order. Since some issues in English language have long been defined, e.g., the term *phrase* or *dependent clause*, in Albanian language there are different attitudes regarding the use of the terms *group of words*, *syntagm*, *phrase*, *syntactic constituent* and finally *clause*. The solution to these attitudes can be found by looking at similarities and differences that Albanian language has with other languages, in particular with English as the most studied language in this aspect.

This study aims a step-by-step analysis of syntactic issues related to the main topic ‘*Subject – Predicate – Object Agreement in Albanian and English Language*.’ The analysis of each word separately and their connection with each other leads us to the final goal of this dissertation, to identify similarities and differences between Albanian and English language. Similarities and differences in sentence structure, word order in different sentences, the role of language interference and the role of lexicon are the main issues addressed in this dissertation. These issues are part of the theoretical study, while sentence analysis in the literary work translated from English into Albanian language ‘*The Adventures of Sherlock Holmes*’ is the main practical part of this dissertation. The analyzed questionnaire in the fifth chapter of this dissertation, completed by students and teachers, shows the level of English and Albanian language proficiency, as well as the impact of language interference.

Through analysis and comparison of examples in the theoretical and practical part of this dissertation, we have come to adequate conclusions which show that there are similarities and differences in sentence structure and word order between the two languages addressed in this study.

Key words: syntagm, clause, sentence, parts of sentences, subject, predicate, object, word order, translation.

Deklaratë

Deklaroj me përgjegjësinë time të plotë se ky disertacion është hartuar nga unë dhe për çdo material të përdorur janë ndjekur rregullat e citimit dhe referimit.

Deklaroj se ky punim është origjinal dhe asnjë pjesë e tij nuk është plagjiaturë.

Rilind Mahmudi

Pasqyra e lëndës

Falënderime.....	2
Abstrakt.....	3
Abstract.....	4
Deklaratë.....	5
KREU I	9
HYRJE	9
1.1. Qëllimet dhe synimet e studimit.....	9
1.2. Arsytet pse është ndërmarrë ky studim	11
1.3. Hipotezat	12
1.4. Metodologjia e punës kërkimore.....	13
1.5. Mjetet e realizimit të studimit	14
1.6. Çështje terminologjie dhe konceptesh.....	15
1.7. Struktura e studimit	19
KREU II.....	22
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM TEORIK I GJYMTYRËVE TË FJALISË.....	22
2.1 Hyrje.....	22
2.2. Sintagmat dhe roli i tyre sintaksor në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.....	26
2.3. Vështrim i shkurtër teorik mbi gjymtyrët e fjalisë në gjuhën shqipe	37
2.4. Vështrim i shkurtër teorik mbi gjymtyrët e fjalisë në gjuhën angleze	39
2.5. Kryefjala në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.....	42
2.5.1. Kryefjala në gjuhën shqipe	42
2.5.2. Kryefjala në gjuhën angleze	46
2.6. Kallëzuesi në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze	54
2.6.1. Kallëzuesi në gjuhën shqipe	54
2.6.2. Kallëzuesi në gjuhën angleze	60
2.7. Kundrinori dhe llojet e kundrinorit në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze	64
2.7.1. Kundrinori në gjuhën shqipe	64
2.7.2. Kundrinori në gjuhën angleze.....	67
2.8. Gjymtyrët e tjera në gjuhën shqipe	69
2.9. Gjymtyrët e tjera në gjuhën angleze.....	72

KREU III.....	78
RENDI I GJYMTYRËVE NË FJALITË E THJESHTA NË GJUHËN SHQIPE DHE GJUHËN ANGLEZE	78
3.1. Vështrim i përgjithshëm mbi rendin e fjalëve dhe rolin gramatikor të tij.....	78
3.2. Lidhja kryefjalë-kallëzues-kundrinor në fjalitë e thjeshta.....	86
3.3. Rendi i gjymtyrëve të tjera të dyta	101
3.4. Rendi i fjalëve në fjalitë sipas kumtimit.....	107
3.5. Rendi i fjalëve në fjalitë sipas pranisë apo mungesës së gjymtyrëve.....	111
3.6. Semantika në lidhjen e kryefjalës-kallëzuesit-kundrinorit.....	113
3.7. Roli i leksikonit dhe i përkthimit në strukturën e fjalisë	116
3.8 Shprehjet frazeologjike në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze dhe ndikimi i tyre mbi strukturën e fjalisë	118
KREU IV	120
RENDI I GJYMTYRËVE TË FJALIVE NË VEPRËN ‘AVENTURAT E SHERLOK HOLMSIT’ E PËRKTHYER NGA GJUHA ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE	120
4.1 Hyrje.....	120
4.2. Analizë e fjalive me rendin kryefjalë – kallëzues – kundrinor (i drejtë/i zhdrejtë)	121
4.3. Analizë e fjalive me rendin kryefjalë – kallëzues – gjymtyrë tjetër e dytë (kallëzues emëror, kallëzuesor i kundrinorit, rrethanor)	141
4.4. Analizë e fjalive me një kryepërbërës, dy kryepërbërës ose të paplota	163
KREU V	166
ANALIZË E PYETËSORIT ME FJALI TË PËRKTHYERA NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHËN ANGLEZE DHE ANASJELLTAS	166
5.1 Hyrje.....	166
5.2 Analizë e fjalive me emra përmbledhës dhe përemra të pacaktuar të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas	167
5.3 Analizë e fjalive nga vepra ‘Aventurat e Sherlock Holmsit’ të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.....	176
5.4 Analizë e fjalive nga libri ‘Environmental Biotechnology’ të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.....	183

5.5 Analizë e fjalive nga libri ‘ <i>siRNA Design</i> ’ të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe	191
KREU VI	202
PËRFUNDIME DHE SUGJERIME	202
6.1 Përfundime të përgjithshme	202
6.2 Sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme	207
6.3 Kufizimet e studimit	209
BIBLIOGRAFIA	210
SHTOJCA A	214
FJALITË E ANALIZUARA NGA VEPRA ‘ <i>AVENTURAT E SHERLOK HOLMSIT</i> ’	214
Tabela 1. Fjali me kryefjalë, kallëzues dhe kundrinor në veprën ‘ <i>Aventurat e Sherlock Holmsit</i> ’.	
.....	214
Tabela 2. Fjali me kryefjalë, kallëzues dhe gjymtyrë tjetër të dytë (kallëzues emëror, kallëzuesor i kundrinorit ose rrethanor) në veprën ‘ <i>Aventurat e Sherlock Holmsit</i> ’.	
.....	230
Tabela 3. Fjali me një kryepërbërës, dy kryepërbërës ose fjali të paplota në veprën ‘ <i>Aventurat e Sherlock Holmsit</i> ’	242
SHTOJCA B	244
PYETËSOR ME FJALI TË PËRZGJEDHURA TË PËRKTHYERA NGA GJUHA ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE DHE NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHËN ANGLEZE NGA LIBRAT ‘ <i>AVENTURAT E SHERLOK HOLMSIT</i> ’, ‘ <i>ENVIRONMENTAL BIOTECHNOLOGY</i> ’ DHE ‘ <i>SIRNA DESIGN</i> ’	244
SUMMARY	248

KREU I

HYRJE

1.1. Qëllimet dhe synimet e studimit

Procesi i studimit të çështjeve të ndryshme të sintaksës së gjuhës shqipe dhe të gjuhëve tjera nuk ka përfunduar dhe nuk ka tendencë për të përfunduar ndonjëherë. Ky disertacion bazohet në sintaksë, më saktë, në studimin e rendit të fjalëve në fjali, në veçanti të kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit (të drejtë dhe të zhdrejtë) në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze në fjalitë e thjeshta, duke mos përjashtuar edhe gjymtyrët tjera, pjesët e ligjëratës me të cilat shprehen, si dhe përshtatjen dhe lidhjen mes tyre. Kemi analizuar përbërësit dhe strukturën e fjalive të shkëputura nga tekste të rastit dhe shembuj të dhënë në mënyrë individuale, përmes së cilëve janë bërë analiza dhe krahasime. Pra, për të arritur deri te studimi i rendit të fjalëve, fillimisht janë analizuar gjymtyrët e fjalisë, duke filluar nga ajo se çka mund të jetë kryefjalë, çka mund të jetë kallëzues dhe çka mund të jetë kundrinor, por edhe gjymtyrët e tjera. Kjo analizë, nga njëra anë, është bërë për gjymtyrët e fjalisë në gjuhën shqipe dhe, nga ana tjetër, për gjymtyrët e fjalisë në gjuhën angleze, ku çdo ngjashmëri ose dallim është theksuar në mënyrë të veçantë dhe janë nxjerrë përfundime dhe sugjerime përkatëse.

Nëpërmjet këtij krahasimi, me një shembull të thjeshtë ilustrojmë një dallim të caktuar, për shembull, rendin e mbiemrit. Në gjuhën shqipe mbiemri “*i shpejtë*” (në gjuhën angleze, “*fast*”) në fjalinë “*Është një qen i shpejtë.*” qëndron pas emrit. Ndërsa në fjalinë e njëjtë në gjuhën angleze “*It is a fast dog.*” mund të vërehen menjëherë dy dallime sipërfaqësore. Njëri është se kemi të bëjmë me ndryshimin e vendit të mbiemrit para emrit në gjuhën angleze (*a fast dog*), ndërsa ndryshimi i dytë është se në gjuhën shqipe fjalia fillon me folje (*Është*), ndërsa në gjuhën angleze me kryefjalë (*It*), por që të dyja fjalitë janë fjali dëftore.

Në këtë mënyrë kemi analizuar shembuj të ndryshëm nga tre tekste të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, ku njëra është vepra letrare ‘*Aventurat e Sherlok Holmsit*’ dhe dy

tekste universitare ‘*Environmental Biotechnology*’ dhe ‘*siRNA Design*’, si dhe shembuj të gjetur dhe grumbulluar në mënyrë individuale, për të arritur deri te qëllimi përfundimtar i këtij studimi, nxjerrja në pah e ngjashmërive dhe dallimeve të rendit të fjalëve në fjali në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Këto ngjashmëri dhe dallime mund të rrjedhin nga historia e zhvillimit të gjuhëve, tipologjia e gjuhëve, këtu kemi parasysh faktin se shqipja është gjuhë sintetike, ndërsa anglishtja analitike, nga interferencat gjuhësore (ndikimi i njëres gjuhë në tjetrën), në veçanti kur kemi tekste të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, ose fjali të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe ose anasjelltas. Është studiuar shkurt edhe ndikimi i terminologjisë shkencore, gjegjësisht, nëse mungesa e terminologjisë shkencore ndikon në rendin e fjalëve në fjali gjatë përkthimit.

Studimi i strukturës së fjalisë paraqet një fushë shumë tërheqëse për studiuesit, prandaj edhe ky disertacion motivohet nga ideja e studimit të strukturës së fjalisë në gjuhën shqipe, duke e krahasuar atë me gjuhën angleze. Në këtë disertacion janë analizuar dhe krahasuar llojet e ndryshme të fjalive të thjeshta, duke filluar nga fjalitë dëftore, pyetëse, dëshirore, urdhërore, nxitëse dhe thirrmore. Shembujt që janë dhënë në njëren gjuhë krahasohen me gjuhën tjetër, me qëllim arritjen e përfundimeve dhe sugjerimeve të mbështetura në teori dhe shembuj praktikë. Si rrjedhim, krahasimi i rendit të gjymtyrëve në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze paraqet çështjen themelore të këtij disertacioni që hap rrugën për studime ende më të thelluara dhe zgjerim të mëtejshëm të këtij studimi.

Në këtë studim kemi ngritur këto pyetje për të cilat jemi munduar të nxjerrim përgjigjet përkatëse:

- A është e njëjtë struktura e fjalive të thjeshta në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze?
- A ka dallime sintaksore (të gjymtyrëve) midis gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze?
- A ndryshon rendi i gjymtyrëve (kryefjalë-kallëzues-kundrinor) në tipat e ndryshëm të fjalive të thjeshta apo është i fiksuar në të dyja gjuhët?
- A ndryshon vendi i gjymtyrëve të tjera në fjalitë e përkthyer?
- A ndikon mungesa e terminologjisë shkencore në rendin e gjymtyrëve (kryefjalë-kallëzues-kundrinor)?

Si rrjedhim, më poshtë janë radhitur qëllimet dhe synimet specifike të këtij disertacioni:

- Analizimi i çështjeve sintaksore në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe.

- Analizimi i detajuar i gjymtyrëve të fjalisë kur gjymtyrët përbëhen nga përbërës të ndryshëm.
- Analizimi i rendit dhe pozicionit të gjymtyrëve të fjalisë së thjeshtë në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe.
- Prezantimi i ngjashmërive dhe dallimeve të strukturës së fjalive, me theks të veçantë lidhja e kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit.
- Prezantimi i problemeve sintaksore në rendin e gjymtyrëve të hasura gjatë përkthimit të tekstit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe ose anasjelltas.

1.2. Arsyet pse është ndërmarrë ky studim

Një studim i këtillë krahasues i detajuar nuk është realizuar deri sot, prandaj ky studim përbën një hap modest në fushën e pafundme të studimit krahasues të sintaksës. Gjatë studimit të gjuhës, në veçanti të gjuhës angleze, studentët shqiptarë në nivel universitar hasen me mungesë studimesh krahasuese në aspektin gramatikor, në veçanti për sa i përket aspektit sintaksor, i e kryesisht për lidhjen dhe rendin e kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit. Kjo lidhje në gjuhën shqipe, në gramatikën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë është shpjeguar shkurtimisht ku janë dhënë rregullat themelore të rendit të fjalëve në fjali. Rendi i fjalëve në fjali është studiuar edhe nga gjuhëtarë të tjerë shqiptarë të përmendur në këtë disertacion. Në anën tjetër, në gjuhën angleze kemi një situatë pak më ndryshe, sepse i është kushtuar më shumë rëndësi rendit të fjalëve në fjali. Një shpjegim i shkurtër në gjuhën shqipe, edhe pse i plotë, nuk do t'i mjaftonte një studiuesi të ri i cili dëshiron të studiojë gjerësisht gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Prandaj, ky disertacion mbështetur në teori të qëndrueshme nga gjuhëtarë të ndryshëm të cilët kanë vendosur themelet e sintaksës, do të paraqesë një krahasim të rrafshit sintaksor ndërmjet gjuhës shqipe dhe angleze.

Krahasimi i elementeve të caktuara gramatikore në të dyja gjuhët (angleze dhe shqipe) mund të ndihmojë studiuesit e ardhshëm për të kuptuar rëndësinë dhe vështirësinë e studimit të gjuhëve të huaja. Kjo lidhet drejtpërdrejt edhe me përkthimin nga njëra gjuhë në tjetrën. Përkthyesit duhet të njohin mirë gramatikën, gjegjësisht morfologjinë dhe sintaksën e të dyja gjuhëve në cilat përkthejnë. Duhet theksuar se përkthyesit (profesional e joprofesional) janë ata

të cilët zakonisht bëjnë gabime gjuhësore, për këtë qëllim janë përzgjedhur për analizë tekste të fushave të ndryshme të cilat janë shfrytëzuar për të nxjerrë gabimet e mundshme të ndikuara nga struktura e fjalisë dhe rendi i fjalëve në fjali.

Ideja për ndërmarrjen e këtij studimi rrjedh nga përkthimi i teksteve profesionale (shkencore e teknike) nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, e më saktë nga vështirësitë e përkthimit të fjalive të caktuara, përshtatja e gjymtyrëve në fjali dhe ndikimi i mungesës së terminologjisë së përshtatshme në përpilimin e fjalive kuptimplota. Roli i dygjuhësisë, gjegjësisht përkthimit nga njëra gjuhë në tjetrën, realisht është një faktor mjaft i rëndësishëm kur flitet për strukturën e fjalisë. Por edhe përkthimi letrar mund të krijojë ndryshim të strukturës së fjalisë. Themi kështu sepse përkthimi i fjalive që lidhen me fusha të përgjithshme apo të tjera, mund të mos kërkojë ndonjë stil të veçantë përkthimi, ndërsa përkthimi letrar kërkon një stil krejtësisht tjetër, gjegjësisht stil letrar. Janë shprehjet, mënyra e të shprehurit dhe stili ato që mund të rezultojnë me një strukturë të ndryshuar të fjalisë së përkthyer. Gjithsesi, stili i përkthyesit padyshim që ka ndikim në ruajtjen ose mosruajtjen e strukturës apo rendit të gjymtyrëve të fjalisë gjatë përkthimit. Mbi të gjitha, ruajtja e kuptimit është më e rëndësishme sesa ruajtja e strukturës apo rendit të fjalëve në fjali. Pra, ky studim është ndërmarrë edhe për t'u ardhur në ndihmë përkthyesve të dy gjuhëve.

1.3. Hipotezat

Duke u mbështetur në qëllimin dhe idenë e lartpërmendur, më poshtë janë dhënë edhe hipotezat e përgjithshme të këtij disertacioni:

- Ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime gramatikore - sintaksore midis gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe për sa i përket strukturës së fjalisë së thjeshtë.
- Ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime në rendin dhe lidhjen e kryefjalës-kallëzuesit-kundrinorit në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.
- Ekzistojnë disa dallime në rendin e gjymtyrëve në fjalitë e thjeshta në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.
- Gjuha angleze në raste të caktuara mund të ndikojë në rendin e gjymtyrëve ose në strukturën e fjalisë së përkthyer në gjuhën shqipe.

- Leksikoni, në rast të mungesës së terminologjisë përkatëse, mund të ketë ndikim në lidhjen e kryefjalës, kallëzuesit dhe gjymtyrëve të tjera.

1.4. Metodologjia e punës kërkimore

Metoda e kërkimit shkencor është mënyrë e kërkimit, e planifikuar, përkatësisht mënyra e punës për realizimin e kërkimit, struktura e së cilës është e vërtetuar shkencërisht dhe vlera e saj është e verifikuar¹. Shkurtimisht, metodat janë të rëndësishme për prodhimin e një produkti të besueshëm dhe të verifikuar, të bazuar në fakte të qëndrueshme dhe të sigurt. Se cila metodë përdoret për arritjen e qëllimit, varet nga vetë qëllimi i përcaktuar. Metodatat kërkimore-shkencore janë të domosdoshme për të arritur në përfundime të qëndrueshme. Metoda e kërkimit shkencor është sistem kompleks i rregullave logjike, nëpërmjet të cilave arrihen njohuri shkencore, andaj për këtë arsye është e rëndësishme të kemi njohuri të mjaftueshme për metodën dhe aftësi për zbatimin e saj, gjegjësisht të procedurave të cilat mundësojnë përdorimin e saj në kërkime². Më poshtë janë dhënë metodat kryesore në të cilat është mbështetur ky studim.

Metoda e kërkimit cilësor paraqet pikënisjen për realizimin e disertacionit. Normalisht përdoret në pjesën teorike ku janë dhënë shembuj në mënyrë individuale për të vërtetuar hipotezat e përmendura më lart. Janë analizuar në mënyrë cilësore shembujt e paraqitur në gramatikën e gjuhës shqipe për rendin, gjymtyrët e fjalisë, për tipat e fjalive dhe janë krahasuar me gjuhën angleze për të nxjerrë të përbashkëtat dhe dallimet.

Ndaj, *metoda krahasuese* është thelbësore në këtë disertacion. Me gjuhën angleze në njërin anë dhe me gjuhën shqipe në anën tjetër, në këtë disertacion janë dhënë shembuj që janë përkthyer nga njëra gjuhë në tjetrën dhe janë vendosur përballë njëri-tjetrit. Shembujt përdoren për të krahasuar ngjashmëritë dhe dallimet, të cilat përfundimisht shpjen në përfundime dhe sugjerime. Nëpërmjet kësaj metode kryesore nxjerrim ngjashmëritë dhe dallimet e strukturës së fjalisë dhe rendit të fjalëve në fjalitë e përkthyer. Kjo metodë është vendimtare për vërtetimin ose kundërshtimin e hipotezave të parashtruara.

¹ Azemi, B., dhe Bujari, R. “*Bazat e kërkimit në edukim*”, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 20.

² Po aty, f. 20.

Në këtë disertacion kemi përdorur edhe *metodën eksperimentale*. Përdorimi i fjalive të përzgjedhura nga tekstet profesionale të përkthyer është material i dobishëm për arritjen e rezultateve të sigurt, për të nxjerrë përfundime më të besueshme, veç përfundimeve të nxjerra nga pjesa teorike, dhe për të dhënë sugjerime të mëtejshme. Të intervistuarit janë ballafaquar me fjali ku në disa raste e kanë pasur të vështirë të gjejnë fjalën e duhur. Pyetësi përmban fjali me përbërës të ndryshëm, të cilët prekin shumë çështje sintaksore.

Metoda përshkruese është shumë e rëndësishme për organizimin e punës shkencore në aspektin teorik. Shumë problematika/çështje përkatëse të prezantuara në këtë disertacion mbështeten në metodën përshkruese, ku janë prezantuar teoritë përkatëse. Në këtë disertacion përshkruhen në mënyrë të detajuar tipat e sintagmave, gjymtyrët e fjalisë dhe rregullat për rendin e fjalëve në fjalitë e thjeshta dhe tipat e tjerë të fjalive në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

Metoda deduktive dhe induktive janë përdorur paralelisht në këtë disertacion duke analizuar në vazhdimësi teorikisht çështjet sintaksore në lidhje me rendin e fjalëve dhe duke provuar vërtetimin e tyre në fjalitë e përkthyer. Nga përgjithësimi i çështjeve teorike arrihet të shembujt specifikë, të cilët në raste të caktuara mund të vërtetojnë ose të mos vërtetojnë hipotezat.

1.5. Mjetet e realizimit të studimit

Materiali bazë teorik i përdorur në këtë disertacion, për sa i përket gjuhës angleze, është marrë nga gramatikat e gjuhës angleze, duke filluar nga sintaksa të botuara në kohë të ndryshme deri te ato moderne, të autorëve të ndryshëm (Randolph Quirk, Sidney Greenbaum, Herman Wekker, David Morley dhe të tjerë) dhe të shtëpive të ndryshme botuese si Oxford, Cambridge, Routledge, Blackwell etj. Në anën tjetër, për sa i përket gjuhës shqipe, pjesa teorike mbështetet në Gramatikën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe në tekstet e autorëve, si: Shaban Demiraj, Thoma Dhima, Aleksandër Xhuvani, Mahir Domi, Spiro Floqi, Remzi Përnaska, Menella Totoni, Mehmet Çeliku, Vesel Memedi dhe të tjerë.

Fjalitë të cilat përdoren për ilustrim janë marrë nga burime të ndryshme, por janë dhënë edhe shembuj vetjakë. Për pjesën praktike, shembujt janë marrë nga vepra letrare ‘*Aventurat e Sherlock Holmsit*’ e përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, si dhe dy tekste universitare të

shkencave teknologjike dhe natyrore të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe (*'Environmental Biotechnology'* dhe *'siRNA Design'*).

Shembujt janë dhënë sipas problematikave që janë përmendur në kërkerët përkatës, për të bërë lidhjen me qëllimin dhe hipotezat e disertacionit.

Fillimisht, si material për pjesën e parë praktike, gjegjësisht analizën e rendit të gjymtyrëve dhe të strukturës së fjalive, është marrë vepra *'Aventurat e Sherlock Holmsit'* e përkthyer nga Linda Gashi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe e botuar nga shtëpia botuese Damo, Prishtinë, në vitin 2016. Fjalitë e përkthyera janë dhënë në Shtojcën A me numër rendor dhe atyre u jemi referuar në kreun IV sipas numrit rendor. Për realizimin e pjesës së dytë praktike të këtij disertacioni janë angazhuar 91 studentë universitarë të gjuhës angleze dhe të shkencave sociale me njohje të mirë të gjuhës angleze, të cilët kanë bërë përzgjedhjen e përkthimit të saktë të fjalive të dhëna nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas nga tre tekste të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe (vepra letrare *'Aventurat e Sherlock Holmsit'* dhe dy tekste universitare *'Environmental Biotechnology'* dhe *'siRNA Design'*). Përveç studentëve universitarë, 24 mësimdhënës të gjuhës angleze/profesorë universitarë të shkencave sociale me njohje të mirë të gjuhës angleze kanë bërë përzgjedhjen e rasteve të dhëna në pyetësonin e njëjtë, i cili është dhënë në Shtojcën B. Analiza e përgjigjeve të pyetësonit është dhënë në kreun V.

Shembuj të ndryshëm nga burime të ndryshme, por edhe shembuj vetjakë janë dhënë brenda këtij disertacioni, duke mos u kufizuar në burime të caktuara, me qëllim ilustrimin e ndryshimeve të mundshme strukturore gjatë përkthimit të fjalive nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe mundësinë e ndryshimit të rendit të gjymtyrëve në fjali, në veçanti të tre gjymtyrëve me interes për ne: kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit.

1.6. Çështje terminologjie dhe konceptesh

Studimet sintaksore të gjuhës shqipe fillimin e kanë të hershëm, mirëpo zhvillimi i tyre ka zgjatur një periudhë të gjatë deri në hartimin e një vepre pothuajse të plotë, e cila vazhdimisht referohet nga studiuesit shqiptarë. Problemet kryesore me të cilët është përballur sintaksa e gjuhës shqipe kanë qenë përcaktimet, përkufizimet e klasifikimet e njësive dhe të fakteve

sintaksore³. Në sintaksën e gjuhës shqipe në vazhdimësi bëhet betejë për kodifikim, gjegjësisht përkufizim të njësive dhe të termave sintaksorë. Çështje me interes këtu është përdorimi i termave *togfjalësh*, *sintagmë*, *frazë* dhe *përbërës sintaksor*.

Sintaksa e gjuhës shqipe ka kaluar një rrugë të vështirë për përkufizimin e disa çështjeve mjaft të rëndësishme. Shumë i rëndësishëm për konceptet themelore të gjuhës shqipe është teksti universitar “Sintaksa” i Stefan Priftit ku është trajtuar koncepti i “njësisë sintaktike”, madje edhe i “sintagmës” ku ai atë e sheh si një thes të madh me fjalë të prejardhura e të përbëra, si gjymtyrë potenciale fjalie, fjali njëkryegjymtyrëshe, fjali të zgjeruara ose pjesë të tyre dhe më vonë Spiro Floqi shton edhe një njësi të tretë sintaksore – konceptin e togfjalëshit që nga viti 1968⁴. Në njësi sintaksore të ndërmjetme mes fjalës sintaksore (gjymtyrës) dhe fjalisë futen vetëm njësitë e formuara nga lidhje nënrenditëse të gjymtyrëve të fjalisë, duke përjashtuar nga teoria e togfjalëshit të ashtuquajturat togfjalësha me bashkërenditje për shkak se teoria e fjalisë dhe e gjymtyrëve të saj nuk mund të zbulojë rregullsitë e bashkimit të fjalëve në njësi më të mëdha se gjymtyra e fjalisë⁵. Para gjenerativizmit, sintaksa strukturaliste dhe sintaksa e mbështetur në togfjalësh, nuk arritën të zgjidhin problemet kryesore dhe gjuhësia strukturaliste arriti të segmentonte fjalitë në përbërës të drejtpërdrejtë por që nuk kanë arritur analizë të mirëfilltë sintaksore dhe si rezultat ky problem u tejkalua nga gjuhësia gjenerative e cila gjeti zgjidhje, madje edhe solli risi siç është skema e pemës ku e tërë struktura e fjalisë mund të paraqitet në një pemë të tillë duke nxjerrë në pah rolet sintaksore të fjalëve të fjalisë⁶.

Fraza në gjuhësinë shqiptare llogaritet si një përbërës maksimal sintaksor dhe për herë të parë është përdorur nga M. Domi në vitin 1964, i cili atë e shihte si një tërësi gramatikore, kuptimore dhe intonacionore⁷. Fraza dhe shtjellimi i saj nuk përfundoi me Domin, por vazhdoi edhe me M. Totonin ku fraza është njësi sintaksore ligjërimore me intonacion të mbaruar dhe me kumtim të plotë brenda një konteksti të caktuar dhe llogaritet njësi sintaksore e realizuar⁸. Totoni vazhdon edhe më tej ku fraza mund të jetë e thjeshtë, kur struktura e saj përputhet me strukturën e fjalisë, dhe e përbërë, kur struktura e saj përmban dy a më shumë fjali⁹.

³ Domi, M. “*Vepra I – Studime sintaksore*”, Kristalina KH, Tiranë, 2013, f. 114.

⁴ Memushaj, R., “*Tri koncepte themelore të sintaksës moderne*”, Studime Filologjike, 2008, f. 161.

⁵ Floqi S., “*Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*”, Studime Filologjike 1, f. 76-78.

⁶ Memushaj, R., “*Tri koncepte themelore të sintaksës moderne*”, Studime Filologjike, 2008, f. 162.

⁷ Domi, M., “*Sintaksa (për shkollat pedagogjike)*”, Tiranë, 1964; dhe “Sintaksa e gjuhës shqipe II, “ konspekt-leksione, Tiranë, 1969, f. 1-3.

⁸ Totoni, M., “*Fraza me nënrenditje*”, SHBLU, Tiranë, 2000, f. 9.

⁹ Po aty, f. 9.

Përveç termit të mëhershëm *togfjalësh*, e më vonë *sintagmë* e *frazë*, përdorimi apo më mirë thënë prezantimi i termit të ri *përbërës sintaksor* tenton të zërë vendin kryesor në sintaksën e gjuhës shqipe, duke zëvendësuar plotësisht termin *sintagmë*. Termi ‘*përbërës sintaksor*’ përdoret nga sintaksologu Mehmet Çeliku i cili atë e konsideron si term pothuajse të barasvlershëm me termat *sintagmë*, *frazë* apo *grup fjalësh* që përdoren në gjuhësinë bashkëkohore dhe që shprehin koncepte të njëjta¹⁰. Me rëndësi për ne janë përbërësit sintaksorë, gjegjësisht sintagmat, dhe lidhjet e tyre në fjalinë e thjeshtë dhe në periudhë. Kjo është edhe arsyeja përse u përmend lidhja e përbërësve. Një pjesë e konsiderueshme e analizës sintaksore në këtë disertacion mbështet në pikëpamjen ndërtimore dhe funksionale të kësaj sintakse bashkëkohore.

Për sa i përket konceptit të sintagmës, ashtu siç u përmend edhe më lart, ishte njëjtë Blumfildi ai i cili përdori këtë koncept në sintaksë. Por duke filluar nga Dionis Trakasi e deri në shekullin XX, në sintaksë përdorehin dy njësi, gjymtyra dhe fjalia. Mirëpo gjuhëtarët vazhdimisht vërenin se mungonte diçka dhe ishte po Blumfildi ai i cili e bëri dallimin e grupit të fjalëve si njësi e veçantë përmes metodës së analizës në përbërës të drejtpërdrejtë (ang. Immediate Constituents Analysis)¹¹.

Na duhet edhe një herë të shpjegojmë kronologjinë e përdorimit të termit *sintagmë* në gjuhën shqipe. Gjuhësia gjenerative në gjuhën shqipe luan një rol të pazëvendësueshëm në këtë studim, duke pasur parasysh se gjatë këtij punimi kryefjala apo kundrinori mund të përbëhen nga sintagma të ndryshme, pra, jo çdoherë vetëm nga një emër apo vetëm sintagmë emërore. Kjo më së miri u ilustrua me shembujt e dhënë më lart për atë se çka mund të jetë kryefjalë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Këtu do të ndalemi për një moment. Ne vazhdimisht kemi përmendur termin *sintagmë* dhe qëllimisht është lënë të sqarohet në këtë pikë. Por çka në të vërtetë është sintagma? Gjuhësia shqiptare është zhvilluar dhe zhvillohet vazhdimisht nga gjuhëtarë të përkushtuar të cilët dëshirojnë vazhdimisht të studiojnë arritjet gjuhësore të gjuhëtarëve botërorë dhe dëshirojnë të provojnë nëse teoritë e njëjta do të vlenin edhe për gjuhën shqipe.

Këtu do të japim edhe një herë një kronologji të shkurtër të përdorimit të termit *sintagmë* apo *frazë*. Nëse një gjuhëtar anglez pyetet se çka është fraza, ai sigurisht që do ta ketë të njohur konceptin e frazës i cili e dallon atë nga sifjalia (ang. clause) dhe paqartësitë e terminologjisë

¹⁰ Çeliku, M., “*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 1.

¹¹ Memushaj, R. “*Tri koncepte themelore të sintaksës moderne*”, Studime Filologjike, 2008, f. 164.

janë sqaruar me kohë, por nëse ndonjë student shqiptar do të pyetet se çka është sintagma, atëherë termin e tillë do të mund ta ngatërronte mbase me sifjalinë. Termi *frazë* që mbase në lexim të parë mund të duket si term i ri në gjuhën shqipe, nuk është edhe i tillë. Termi *frazë*¹² për herë të parë është përdorur nga Mahir Domi, ku me *frazë* nënkupton dy ose më shumë fjali të bashkuara me mjete të ndryshme sintaksore.

Kronologjia e përdorimit të termit *sintagmë* nis që me përdorimin e termit *togfjalësh*¹³ i përdorur për herë të parë nga Spiro Floqi i cili ka qenë i ndikuar nga gjuhësia ruse dhe ky term përdoret shumë pak, pastaj me përdorimin e termit *grup fjalësh* i prezantuar për herë të parë nga B. Beci dhe E. Hysa, për të arritur deri te termi *sintagmë* i futur si rezultat i gjuhësisë gjenerative që faktikisht nënkupton termin *frazë* dhe, së fundi, nga Çeliku përdoret termi *përbërës sintaksor*¹⁴. Në vazhdimësi të këtij punimi ne parapëlqejmë që të përdorim termin *sintagmë*, meqenëse është term gjerësisht i përdorur dhe i pranuar dhe në fjalorin teknik të sintaksës bashkëkohore përdoret plotësisht termi *sintagmë*¹⁵.

Nocion i rëndësishëm në këtë disertacion është përdorimi i termit të ri *sifjali* i përdorur nga Çeliku. Sipas tij, pjesët e fjalisë së përbërë që janë quajtur *pjesë, fjali, njësi, bërthamë* etj., nuk mund të konsiderohen fjali, pasi nuk plotësojnë njërin tipar (intonacionin e përfunduar) dhe për këtë arsye quhen *sifjali* (ang. *clause*)¹⁶. Ky term është më se i mirëseardhur në gjuhën shqipe për shkak se thjeshtëson terminologjinë dhe e përaftron terminologjinë e sintaksës së gjuhës shqipe me atë në gjuhën angleze, duke pasur një term ombrellë për fjalitë e varura.

Një koncept domethënës është edhe koncepti i valencës. Nga vetë fjala kur përmendet valenca, çdo njeri që ka pak njohuri të çështjeve gjuhësore atë e lidh me foljen. Koncepti i valencës dallon nga konceptet e gramatikës tradicionale për shkak se rëndësia në fjali bie mbi foljen/predikatin e jo mbi kryefjalën. Valenca e foljeve jo rrallëherë është përmendur në gjuhësinë shqiptare. Valenca e foljeve zë vend shumë të rëndësishëm në rendin e fjalëve në fjali pasi që valenca e foljeve përcakton me sa dhe me çfarë pjese të ligjëratës plotësohet fjalia. Koncepti i valencës për herë të parë është përmendur nga gjuhëtari frëng Tesnier në modelin e njohur si ‘gramatika e varësisë’ (dependency grammar) ku folja është gjymtyra themelore e

¹² Dhima, Th. “Disa veçori të frazës shqipe në këndvështrimin e gjuhësisë së sotme”, Seminari i Albanologjisë, Ohër, 2007.

¹³ Floqi, S. “Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme”, Studime Filologjike, Nr. 1/1968.

¹⁴ Çeliku, M. “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 1.

¹⁵ Dhima, Th. “Gjuha shqipe - Sintaksa”, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 28.

¹⁶ Çeliku, M. “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 50.

fjalisë (fjalja fillon nga folja) dhe gjymtyrët tjera konsiderohen si gjymtyrë të varura (ku kryefjala është në një nivel të njëjtë me kundrinorin)¹⁷. Dihet që gramatika e gjuhës shqipe nuk bazohet në gramatikën e varësisë dhe folja/kallëzuesi dhe kryefjala janë gjymtyrë kryesore të fjalisë, por valenca e foljeve është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të gjymtyrëve në fjali. Tesnier bëri veçimin specifik të foljeve dhe atë: jovalente, monovalente, divalente dhe trivalente. Është interesante se rendi i fjalëve në fjali është përmendur edhe nga Tesnieri, me atë se para foljes qëndron kryefjala, ndërsa pas foljes qëndron kundrinori¹⁸. Kjo lidhet drejtpërdrejt me teorinë e valencës së Tesnierit, por edhe me Çomskin në sintaksën gjenerative ku gjymtyrët e varura (aktantët) i quan komplemente, kurse rrethanorët (cirkostantët) i quan adjunktë (plotës rrethanor/ndihmës) dhe me këto elemente që quhen ‘mbushës të valencave’¹⁹, fillon plotësimi i fjalisë me plotës.

Teoria e roleve tematike dhe teoria e rasës pasuan si module ku e para kishte të bëjë me caktimin e funksioneve semantike të sintagmave emërore, ndërsa e dyta me kushtet që duhet të përmbushë sintagma emërore për të shërbyer si argument i foljes²⁰. Me zhvillimet që pasuan për sa i përket teorisë së rasës, jo domosdoshmërisht kryefjala duhet të jetë në rasën emërore apo kundrina e drejtë në rasën kallëzore, por duhet vetëm që sintagma të gjendet në vendin e duhur për të marrë funksionin përkatës.

1.7. Struktura e studimit

Ky disertacion është ndarë në gjashtë krerë në të cilët trajtohen çështje të veçanta, si dhe dy shtojca. Shtojca A përmban fjalitë e përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe të veprës letrare ‘*Aventurat e Sherlock Holmsit*’ të renditura me numra rendor për referim më të lehtë, të ndara në tre tabela. Në shtojcën B është dhënë pyetësi i cili është plotësuar nga studentë universitarë dhe mësimdhënës të gjuhës angleze/profesorë të shkencave sociale me njohje të mirë të gjuhës angleze.

¹⁷ Tesniere, L. ‘*Elements de syntaxe structurale*’, Paris: Klincksieck, 1959, f. 109.

¹⁸ Memushaj, R. ‘*Tri koncepte themelore të sintaksës moderne*’, Studime Filologjike, 2008.

¹⁹ Bolshakov, I. dhe Gelbukh A. ‘*Computational Linguistics – Models, Resources, Applications*’, CIENCIA DE LA COMPUTACION, 2004, f. 40.

²⁰ Po aty, f. 167.

Në hyrjen e përgjithshme që paraprin studimin, trajtohen pyetjet studimore, arsyet pse është ndërmarrë ky studim, qëllimet e studimit, hipotezat e përgjithshme, metodat e punës shkencore të cilat janë përdorur për të arritur qëllimin e dëshiruar dhe mjetet e përdorur për përmbushjen e këtij studimi.

Kreu i dytë paraqet vështrimin e përgjithshëm teorik, terminologjinë bazë të gjymtyrëve kryesore të fjalisë, si dhe gjymtyrëve të tjera, përshkrimin e çështjeve kryesore teorike që lidhen me gjymtyrët si në gjuhën angleze ashtu edhe në gjuhën shqipe dhe çështjet e caktuara sintaksore në të dyja gjuhët. Në këtë pjesë janë dhënë shembuj të shumtë për të ilustruar funksionet e ndryshme sintaksore që marrin fjalët në fjali, në veçanti ato që luajnë rolin e kryefjalës, kallëzuesit dhe të kundrinorit, por edhe funksione të tjera sintaksore.

Pas analizës së detajuar të gjymtyrëve të fjalisë, në kreun e tretë, që përbën edhe pjesën kryesore të këtij disertacioni, vazhdohet me lidhjen kryefjalë-kallëzues-kundrinor në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Kjo analizë bëhet paralelisht për fjalitë në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, duke i përkthyer shembujt e grumbulluar dhe nxjerrë të përbashkëtat dhe dallimet e strukturës së fjalisë, d.m.th. rendi dhe funksioni i tyre sintaksor. Në këtë krye trajtojmë edhe rolin e semantikës në lidhjen e gjymtyrëve dhe mungesën e terminologjisë që mund të ndikojë në strukturën e fjalisë, gjegjësisht në mundësinë e krijimit të fjalive gramatikore ose jo.

Kreu i katërt është pjesa kryesore e punës praktike, pavarësisht se edhe në kreun e dytë dhe të tretë janë dhënë mjaft shembuj. Në kreun e katërt janë analizuar fjalitë nga vepra letrare ‘*Aventurat e Sherlok Holmsit*’ për dallime strukturore dhe të rendit të gjymtyrëve. Fjalive u jemi referuar me numra rendor siç janë paraqitur në Shtojcën A, me qëllim që të mos mbingarkohet pa nevojë pjesa praktike. Janë vërejtur dallime të caktuara që lidhen drejtpërdrejt me qëllimin e këtij disertacioni.

Kreu i pestë, që njëkohësisht është edhe kreu i parafundit, përmban analizën e pyetësorit të plotësuar nga mësimdhënës dhe studentë universitarë që gjendet në Shtojcën B. Në kreun e pestë janë dhënë fjali ku në raste të caktuara mund të jetë më e vështirë të përcaktohet numri i foljes, fjali me emra përmbledhës, përemra të pacaktuar, kryefjalë homogjene apo kryefjalë e zbrazët. Fjalitë janë përzgjedhur me kujdes, ku në pjesën e parë janë dhënë shembuj të përgjithshëm, ndërsa në tre pjesët e tjera shembuj nga tre tekstet, ‘*Aventurat e Sherlok Holmsit*’ dhe tekstet universitar ‘*Environmenal Biotechnology*’ dhe ‘*siRNA Design*’. Qëllimi i pyetësorit ka qenë përcaktimi nëse të intervistuarit do të përzgjedhin opsionin e dhënë në libër apo një opsion tjetër.

Kreu i gjashtë, që është edhe kreu i fundit, përmban përfundimet dhe sugjerimet e përgjithshme që rrjedhin nga vështirimi teorik dhe analiza e fjalive të shumta, si dhe kufizimet e studimit dhe rekomandimet e përgjithshme për studime më të thella të kësaj problematike.

Në fund të disertacionit është dhënë bibliografia e cila është mjaft e gjerë. Në këtë disertacion janë cituar autorë me shumë ndikim në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Jemi mbështetur në teoritë e autorëve të ndryshëm për të pasur një disertacion të kompletuar.

Në shtojcën A të këtij disertacioni janë dhënë fjalitë e përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe nga vepra letrare '*Aventurat e Sherlock Holmsit*', të cilat janë analizuar për të gjetur ngjashmëri dhe dallime të caktuara strukture/sintaksore, si edhe rendin e gjymtyrëve.

Në shtojcën B është dhënë pyetësi, i cili është plotësuar nga 24 mësimdhënës të gjuhës angleze/profesorë të shkencave sociale me njohje të mirë të gjuhës angleze dhe 91 studentë universitarë me njohje të mirë të gjuhës angleze. Pyetësi përmban fjali të përzgjedhura nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Detyra e pjesëmarrësve në pyetësor ka qenë përzgjedhja e opsioneve të sakta të fjalive, gjegjësisht gjetjen e numrit të saktë të foljes ose përkthimit të saktë. Fjalitë në pamje të parë duken të thjeshta, por gjetja e përgjigjes së saktë është më e komplikuar për shkak se bëhet fjalë për fjali me emra përmbledhës, emra të lëndës, përemra të pacaktuar, kryefjalë të përbërë, kryefjalë të zbrazët dhe shembuj të tjerë.

KREU II

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM TEORIK I GJYMTYRËVE TË FJALISË

2.1 Hyrje

Gjuhët ndryshojnë në vazhdimësi dhe ndryshimet mund të ndodhin për shkak të faktorëve të ndryshëm. Mirëpo kur flasim për rrafshin gramatikor (morfologjik dhe sintaksor), ndryshimet janë më të ngadalta. Gjuha shqipe ka kaluar një rrugë të gjatë studimesh dhe ndryshimesh. Studimi historik i strukturës gramatikore të gjuhës shqipe ka një traditë të hershme, duke filluar nga shekulli XIX me studimin e sistemit gramatikor nga Franz Boppi i cili njëkohësisht përcaktoi karakterin indoeuropian të gjuhës shqipe, me artikujt dhe monografitë e Gustav Meyerit dhe Holger Pedersenit për formimin e emrave, numërorëve, foljeve, pastaj në shekullin XX me Norbert Joklin duke vazhduar kështu deri në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar me gjuhëtarët shqiptarë Eqrem Çabej (studime në fushën e etimologjisë, fonetikës e dialektologjisë historike), Aleksandër Xhuvanin (studime mbi origjinën dhe formimin e ndajfoljeve, pjesores, paskajores dhe parafjalëve), Mahir Domin e Kostaq Cipun deri te Shaban Demiraj i cili ka analizuar tërë sistemin gramatikor të gjuhës shqipe²¹.

Është mjaft interesant të theksohet fakti se struktura gramatikore e gjuhës shqipe është studiuar edhe në kohën e BRSS-së. Agnija V. Desnickaja në studimin e saj nxjerr disa tipare karakteristike të zhvillimit të rrafshit morfologjik të gjuhës shqipe siç janë: krijimi i formave të reja flektive (si rezultat i rivendosjes së temave dhe bashkimit të sintagmave analitike), kalimi i elementeve të temës në mbaresa, kategoritë e foljes të cilat shprehen përmes treguesve të caktuar gramatikorë, homoniminë e trajtave foljore për vetën e parë dhe të dytë (si dhe shpeshherë për vetën e tretë të kohës së tashme të dëftores, folja në gjuhën shqipe në vetën e parë dhe të dytë

²¹ Topalli, K. “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, Qendra e Studimeve Albanologjike – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2011, f. 95-101.

nuk është e obligueshme të përdoret me përemra vetorë (ku folja vazhdon të ketë karakter vetor) dhe se gjuha shqipe nuk ka kategorinë gramatikore të aspektit²² dhe përfundime të tjera.

Kontribut të veçantë për sa i përket sistemit emëror të gjuhës shqipe ka dhënë Shaban Demiraj. Sipas Demiraj, gjinia asnjëse gjatë zhvillimit historik të shqipes ka ardhur duke u çintegruar e duke u tkurrur, por nuk është zhdukur krejtësisht duke u përdorur sidomos tek emrat prejfoljorë asnjëse²³, p.sh., *të kuptuar-i-t, të punar-i-t*. Në tekstin e njëjtë përmendet edhe roli i emrave prejfoljorë (ang. gerund) të cilët mund të luajnë funksion kryefjalor e kundrinor²⁴, si në shembullin më poshtë:

‘Të ngushëlluarit është gjëja më e vështirë për njeriun, ashtu siç është të uruarit puna më e lehtë. Megjithëse edhe këtë radhë i erdhi të përtypur dhe të përcjellur, tyxhari qeshi me një buzëqeshje të lehtë, që e mbajti për vehte ... dhe Suat bej Vërdhoma ndjeu një të sëmbuar të fortë në trup. (Xoxa, II/163; III/166; II/65)’.

Gjuha angleze është pjesë e familjes së madhe indoeuropiane ku bën pjesë edhe gjuha shqipe, por që gjuha angleze bën pjesë në grupin e gjuhëve gjermanike²⁵. Për dallim nga gjuha shqipe, gjuha angleze ka pësuar ndryshim rrënjësor të strukturës së saj. Gjuha angleze ka kaluar disa faza ndryshimi, duke filluar nga anglishtja e vjetër, anglishtja e mesme, anglishtja moderne e hershme, anglishtja moderne e vonshme dhe anglishtja standarde. Nëse krahasojmë ndonjë tekst të shkruar në gjuhën angleze në fund të shekullit XIV, ai është aq i ndryshëm dhe i ndërlikuar saqë do të ishte shumë i vështirë ta kuptojmë. Jo vetëm që fjalitë tingëllojnë ndryshe, por edhe fjalët edhe strukturat janë të ndryshme, p.sh., *sweveninges, lesynges, false ne bene*²⁶, etj. folësit e huaj të gjuhës angleze, por edhe folësit të cilët e kanë gjuhën angleze gjuhë amtare, nuk do të ishin në gjendje t’i kuptojnë. Gjuhët vazhdimisht ndryshojnë dhe nuk ekziston ndonjë gjuhë që nuk ndryshon. Sot anglishtja e vjetër duket si ndonjë gjuhë krejtësisht e huaj në krahasim me anglishten moderne. Shpejtësia e ndryshimeve ndodh për shkak të faktorëve të brendshëm dhe faktorëve të jashtëm. Gjuha angleze ka ndryshuar rrënjësisht që nga anglishtja e vjetër për shkak

²² Kuçi, S. “Studimet mbi strukturën e shqipes në BRSS (Monografi)”, Allco Impex, Prishtinë, 2013, f. 72.

²³ Demiraj, Sh. “Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë, 1972, f. 217.

²⁴ Po aty, f. 239.

²⁵ Baugh, C. A. dhe Cable, Th. “A History of the English Language”, Routledge, f. 29.

²⁶ O’Grady, W., Dobrovolsky, M. dhe Katamba, F. “Contemporary linguistics by Murray W. R.”, Longman, London 1997, f. 249.

të faktorëve të brendshëm, faktorë të cilët u paraqitën në shekullin V si dhe për shkak të zhvillimeve politike dhe shoqërore në periudhën e vjetër dhe të mesme për shkak të pushtimeve të ndryshme²⁷. Kontakti gjuhësor ishte një ndër shkaqet kryesore të ndryshimit të anglishtes së vjetër në atë moderne dhe kjo kryesisht ka ndodhur për shkak të pushtimeve të ndryshme dhe ndikimit të gjuhëve të ndryshme. Si rezultat, morfologjia e gjuhës angleze është një fushë e gjerë për t'u studiuar.

Në gjuhën angleze në vazhdimësi janë paraqitur gramatika të ndryshme, por nga gramatikat më të vjetra ajo e cila ka pasur ndikim afatgjatë në gjuhën angleze është "*A short Introduction to English Grammar*" e peshkopit Robert Lowth²⁸ në vitin 1762 ku ai nxjerrë në pah gabimet dhe jep shembuj si duhet të duket përdorimi i saktë i gjuhës angleze. Në shekullin XX kanë ekzistuar disa shkolla të gramatikës së gjuhës angleze të cilat karakterizoheshin nga një qasje kryesisht përshkruese dhe fokusi kryesor ishte mbi sintaksën, duke theksuar dy gramatika më të rëndësishme, gramatikën historike nga gjuhëtari holandez Hendrik Poutsma "*A Grammar of Late Modern English*" të publikuar në 5 vëllime nga viti 1904 deri në vitin 1929 dhe gramatikën historike "*Modern English Grammar on Historical Principles*" nga viti 1909 deri në vitin 1949 nga gjuhëtari Otto Jespersen²⁹. Në vitet 1972 dhe 1985 u publikuan dy gramatika të mëdha referuese dhe shumë të rëndësishme nga ekipi i gramatikanëve Randolph Kuirk, Sidni Greenbaum, Xhefri Liç dhe Jan Svartvik "*A grammar of Contemporary English*" (1972) dhe "*A Comprehensive Grammar of the English Language*" (1985) të cilat janë kryesisht gramatika sinkronike³⁰ dhe këto gramatika janë ndarë në gramatika të veçanta të cilat përdoren për studentët universitar, tituj në të cilët do të mbështetet më së shumti pjesa teorike në këtë studim për sa i përket gjuhës angleze. Zhvillimi i gramatikave të gjuhës angleze nuk përfundon këtu dhe vazhdimisht publikohen gramatika të cilat tentojnë të marrin primatin e gramatikës së gjuhës angleze.

Çdo gjuhë ka një strukturë të caktuar gramatikore, specifikat e saj morfologjike e sintaksore. Mirëpo duhet kuptuar se sintaksa e një gjuhe ka pasur zhvillim të caktuar, si për gjuhën shqipe, ashtu edhe për gjuhën angleze. Studimi i sintaksës është i hershëm duke filluar në shekulli II nga Apolon Diskoli i cili ka tentuar të ilustrojë format e sakta të gjuhës greke të

²⁷ Hickey, R. "*Studying the History of English*", www.uni-due.de/SHE/, qasur në 04.10.2017.

²⁸ Freeborn, D. "*From Old English to Standard English – A course Book in Language Variation Across Time (Third Edition)*", Macmillan, 1992, f. 186.

²⁹ McArthur, B. Th. "*The Oxford Companion to the English Language*", Oxford University Press, 2005, f. 449.

³⁰ Po aty, f. 450.

epokës e duke vazhduar me natyrën e lidhjeve sintaksore dhe lidhjet në ‘distancë’³¹. Nga vetë fjala lidhje neve na zgjohet interesi duke analizuar mënyrën e lidhjeve të fjalëve në fjali. Apoloni ka dhënë dy shembuj mbi të cilët ka bërë analizën e lidhjes së përbërësve në fjali:

(1)

- a. *Ky burrë më ka goditur.*
- b. **Kjo grua më kanë goditur*³².

Që këtu del në pah elementi i përshtatjes, që është pjesë e lidhjes sintaksore. Duke analizuar shembujt (1/a) dhe (1/b) është shumë e lehtë të shihet se shembulli (1/a) është një fjali e përpiluar mirë, duke respektuar rregullat sintaksore, gjegjësisht përshtatjen në numër, gjë që nuk vlen edhe për shembullin (1/b). Normalisht, përshtatja në numër realizohet mes fjalëve të afërta. Me qëllim që fjalia (1/b) të jetë e saktë, atëherë ne ndryshojmë numrin e foljes:

(2) *Kjo grua më ka goditur.*

Por duhet të rikujtojmë rregullën e artë se çdo rregull ka përjashtim. Prandaj janë dhënë edhe shembujt (3/a) dhe (3/b) për të ilustruar këtë pohim:

(3)

- a. **Ajo gruaja që shoqëronte fëmijët më kanë goditur.*
- b. *Ajo gruaja që shoqëronte fëmijët më ka goditur.*

Menjëherë vërehet se rregulla që vlen për fjalitë (1/a) dhe (2) nuk vlen edhe për fjalitë (3/a) dhe (3/b). Këtu kemi ‘lidhje në distancë’. Pra, lidhjet sintaksore nuk vlejnë vetëm për elementet që ndodhen afër njëri-tjetrit, por edhe për ata që i përkufizojnë. ‘Distanca’ mund të jetë e dukshme, por nuk mund të jetë çfarëdo distance pasi vëmë re se ajo duhet të realizohet edhe mes paraprijësës së një fjalie lidhore dhe foljes së kësaj të fundit, kur pjesa paraprijëse ka funksionin e kryefjalës në fjalinë lidhore³³. Ky lloj i lidhjes (në numër) nuk është lidhja e vetme sintaksore, por ekzistojnë edhe lloje të ndryshme të lidhjes së gjymtyrëve në fjali. Çdo fjali e çfarëdo gjuhe natyrore shfaq edhe shumë tipa të tjerë lidhjes ku shumë prej këtyre lidhjeve janë pranuar nga e ashtuquajtura gramatikë tradicionale³⁴.

³¹ Graffi, G. “Sintaksa – Strukturat e ligjërit”, Dituria, 2003, fq. 20.

³² Shenja ‘*’ në rastet ku gjendet në fillim të shembujve në këtë disertacion përdoret për të treguar se fjalia nuk është gramatikore.

³³ Graffi, G. “Sintaksa – Strukturat e ligjërit”, Dituria, 2003, f. 21.

³⁴ Po aty, f. 23.

2.2. Sintagmat dhe roli i tyre sintaksor në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze

Në bazë të Gramatikës së Akademisë së Shkencave sintagmat njihen me emërtimin togfjalështa dhe të njëjtat në bazë të kategorisë leksiko-gramatikore³⁵ ndahen në:

- togfjalështa emërorë (*liqen i kaltër*)
- togfjalështa foljorë (*lexoj rrjedhshëm*)
- togfjalështa mbiemërorë (*shumë i shpejtë*)
- togfjalështa numërorë (*dy prej djemve*)
- togfjalështa përemërorë (*secili nga ne*)
- togfjalështa ndajfoljorë (*shumë herët*).

Sipas kuptimit leksikor, Çeliku njeh sintagmat (ose siç i quan ai *përbërësit sintaksor*³⁶) vijuese: Përbërës emëror (PE), përbërës foljor (PF), përbërës mbiemëror (PMb), përbërës ndajfoljor (PNd), përbërës përemëror (PPër) dhe përbërës numëror (PNu).

Në vazhdim të këtij disertacioni ne do të pranojmë vetëm sintagmat vijuese: sintagmën emërore (SE), sintagmën mbiemërore (SM), sintagmën foljore (SF), sintagmën ndajfoljore (SN) dhe sintagmën parafjalore (SP) të cilat pranohen nga Dhima³⁷, si dhe të njëjtat korrespondojnë edhe me gramatikat në gjuhën angleze. Në asnjë mënyrë nuk përjashtojmë ekzistencën e përemrave apo të numërorëve, por ata do të jenë pjesë e sintagmës emërore, ashtu siç janë edhe në gramatikat e gjuhës angleze, përfshirë atë të Kuirkut³⁸. Në këtë mënyrë, këtu mbeti pa sqaruar vetëm sintagma parafjalore, e cila është shumë e rëndësishme në gjuhën angleze, por edhe në gjuhën shqipe.

Në anën tjetër, *fraza* apo *sintagma* në gjuhën angleze është term shumë i qartë. Ajo çka bie në sy është se ka raste që në të dyja gjuhët (në gjuhën shqipe dhe angleze) mund të vlejnjë të njëjtat rregulla sintaksore. Vetë kjo ide na shtyn që të analizojmë gjenerativizmin e Noam Çomskit me librin e tij “*Struktura sintaksore*” i cili gjuhën e llogarit si diçka të lindur dhe ajo ka një sistem kategorish universale, të përbashkëta për të gjitha gjuhët e rruzullit, ku këto kategori janë ato fonetike (vokalike, konsonantik, hundor, etj.), leksikore (emër, mbiemër, folje, ndajfolje etj.) dhe sintaksore (sintagmë emërore, sintagmë foljore, sintagmë mbiemërore etj.), ku një pjesë

³⁵ Akademia e Shkencave, “*Gramatika e gjuhës shqipe 2*”, Tiranë, 2002, f. 87.


³⁶ Çeliku, M., “*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 51.

³⁷ Dhima, Th., “*Gjuha shqipe - Sintaksa*”, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 28.


³⁸ Quirk, R. dhe Greenbaum S., “*A University Grammar of English*”, Longman, 1976, f. 59.

e këtyre kategorive realizohen në të gjitha gjuhët, kurse pjesa tjetër parametrizohet në strukturat sipërfaqësore të gjuhëve të ndryshme³⁹. Për të mos u larguar nga qëllimi, këtu e kemi të detyrueshme të përmendim sintaksën gjenerative transformuese të Çomskit. Vetë Çomski ka prezantuar gramatikën e sintagmës dhe transformimet dhe për analizimin e një fjalie sipas tij nevojitet pikëpamja e strukturës së përbërësve të saj, pikëpamja funksionale dhe pikëpamja semantiko-sintaksore që bashkë rezultuan me lindjen e gramatikës së strukturës së sintagmës (phrase structure grammar)⁴⁰. Prej këtui mund të shihet se sintagma ka një strukturë të caktuar të përbërë nga koka dhe elementët përbërës të sintagmës (që mund të jenë jo të domosdoshëm). E gjitha do të ishte shumë e ndërlikuar po të mos ishte krijuar Teoria X-bar⁴¹ që lehtëson shpërndarjen e përbërësve të fjalisë në sintagmat përkatëse, përfshirë kokat dhe shoqëruesit e tyre. Teoria X-bar mund të ilustruhet në mënyrë grafike me diagramin e pemës (tree diagram⁴²) që rezultoi nga gramatika gjenerative. Për ta ilustruar në mënyrë grafike këtë do të japim shembullin vijues:

tepër i lodhur nga leximi



too tired from reading



Në gjuhën angleze ka kohë që është qartësuar lloji i sintagmave (të quajtura fraza – ang. ‘phrases’) nga gramatika e Kuirkut⁴³, por edhe nga një numër i madh i gramatikave të gjuhës angleze. Në gjuhën angleze, siç është përmendur më herët, ekzistojnë këto tipa sintagmash:

- Sintagma emërore (*liqen i kaltër*) → (*blue lake*)

³⁹ Memushaj, R., “Gjuhësia gjenerative”, SHBLU, 2008, f. 78.

⁴⁰ Po aty, f. 108.

⁴¹ Po aty, f. 144.

⁴² Në skemën e pemës mund të shihet përdorimi i termit ‘*specifikues*’ (ang. specifier) i cili qëndron për termin ‘*caktuesor*’. Në skemat në vazhdim, përdorimi i termit ‘*modifikues*’ (ang. modifier) do të qëndrojë për termin ‘*përcaktor*’. Sintagmat mund të kenë më shumë se një modifikues të paravendosur (ang. pre-modifier) ose të prapavendosur (post-modifier).

⁴³ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A Comprehensive Grammar of the English Language”, Longman, 1985, f. 38.

- Sintagma foljore (*lexoj rrjedhshëm*) → (*read fluently*)
- Sintagma mbiemërore (*shumë i shpejtë*) → (*very fast*)
- Sintagma ndajfoljore (*shumë herët*) → (*too early*)
- Sintagma parafjalore (*në shtëpi*) → (*at home*)

- **Sintagma emërore në gjuhën shqipe:** Sintagmat emërore në gjuhën shqipe mund të jenë të tipit: *emër + emër*, *emër + emër i pashquar*, *emër + emër në rasën rrjedhore* (*bukë gruri*, *fushë sporti*), *emër + parafjalë + emër i pashquar* (*person me rëndësi*, *supë pa kripë*, *tesha për fëmijë*), *emër + emër i shquar* (*shtëpia e shokut*, *qeni i fqinjit*), *emër + paskajore* (*aftësia për të mashtruar*, *nevoja për të lëvizur*), *emër + mbiemër* (*kalë i bardhë*, *objekt pesëkatësh*), *emër + numëror* (*pesë studentë*, *dy objekte*) dhe *emër + ndajfolje* (*shtëpia majtas*, *kati lart*)⁴⁴.

Sintagma emërore mund të luajë një numër të madh funksionesh në fjali, si më poshtë:

(4)

- | | |
|---|------------------------------------|
| a. Liqeni i kaltër është i bukur. | (Kryefjalë) |
| b. Beni bleu veturë të shpejtë . | (Kundrinor i drejtë) |
| c. Beni i bleu Bleonës veturë të kuqe. | (Kundrinor i zhdrejtë) |
| d. Kishte doreza dimri . | (Përcaktor brenda kund. të drejtë) |
| e. Rrugës kishte njerëz. | (Rrethanor vendi) |
| f. Një mëngjes prindërit e mi nuk ishin në shtëpi. | (Rrethanor kohe) |
| g. Anija ishte dhjetë metra e gjatë. | (Përcaktor mbiemri në SMb) |
| h. Ajo ishte rruga 'Bill Klinton' . | (Ndajshtim i paveçuar) |
| i. Joni, një djalë i ri i mençur , fitoi garat në shkollë. | (Ndajshtim i veçuar) |
| j. Djali , arriti porosia juaj. | (Thirror) |


- **Sintagma emërore në gjuhën angleze:** Sintagma emërore në gjuhën angleze si kokë të sintagmës mund të ketë një emër, përemër, mbiemër emëror ose numëror. Emrat mund të shoqërohen nga nyjat (*a/an/the*), numërorët (*one, two, ten*), determinantët⁴⁵ (*the, a, some, both, this*), por sintagmat emërore mund të kenë edhe modifikues të paravendosur ose të prapavendosur të cilët japin të dhëna që karakterizojnë kokën në mënyrë më specifike (*the high*

⁴⁴ Akademia e Shkencave, "Gramatika e gjuhës shqipe 2", Tiranë, 2002, f. 87-90.

⁴⁵ Termi 'determinativ' (ang. 'determiner') është përdorur nga Çeliku. (Çeliku M., "Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)", ILAR, Tiranë, 2012, f. 408)

levels of stress)⁴⁶. Një skemë standarde ku përfshihen pjesa më e madhe e shoqëruesve të sintagmës emërore është dhënë më poshtë.

the high levels of stress



Duhet theksuar se sintagma mund të ketë më shumë përcaktorë të paravendosur ose të prapavendosur, ndajshtime etj., varësisht nga informacionet që janë dhënë në sintagmën emërore.

Sintagma emërore në fjali ka një numër të madh funksionesh sintaksore, duke filluar nga kryefjala, kundrinori deri te plotësori që mund të jetë kallëzuesor⁴⁷. Më poshtë do të jepen me shembuj të gjithë funksionet sintaksore të cilat mund t'i luajë sintagma emërore⁴⁸:

(5)

- | | |
|---|-----------------------------|
| a. <i>My early childhood was so unfortunate.</i> | (Kryefjalë) |
| b. <i>Give him the money!</i> | (Kundrinor i drejtë) |
| c. <i>John bought Ana some flowers.</i> | (Kundrinor i zhdrejtë) |
| d. <i>That was a gift!</i> | (Kallëzues emëror) |
| e. <i>I consider this talk a waste of time!</i> | (Kallëzuesor i kundrinorit) |
| f. <i>Can you find the guest bedroom?</i> | (Përcaktor i SE) |
| g. <i>Boy, get out of there!</i> | (Thirror) |
| h. <i>You must walk a long distance.</i> | (Rrethanor) |

Karakteristikë e sintagmës emërore është se mund të jetë modifikues/përcaktor i më shumë pjesëve të ligjëratës, si të mbiemrit, parafjalës, ndajfoljes, një emri tjetër apo mbiemrit⁴⁹, si në shembujt:

(6)

- a. They were **hours earlier**!/We were **late five minutes**. (Mod. i SM)

⁴⁶ Greenbaum, S., "English Grammar", Oxford University Press, 1996, f. 209.

⁴⁷ Quirk, R. dhe Greenbaum, S., "A University Grammar of English", Longman, 1976, f. 59.

⁴⁸ Greenbaum, S., "English Grammar", Oxford University Press, 1996, f. 212.

⁴⁹ Po aty, f. 213.

- b. Tourists arrived **weeks before the start** of the holidays. (Mod. i SP)
- c. They have gone **a level further**. (Mod. i SN)
- d. Rachel bought **a leather jacket**. (Mod. i SE)

- **Sintagma foljore në gjuhën shqipe:** Foljet bashkohen me emra a përemra në rasa të ndryshme me ose pa parafjalë, me ndajfolje, me paskajore, me përcjellore dhe me pjesore. Lloji i foljes përcakton edhe argumentet që pasojnë foljen (kallëzuesin), kështu që nga sintagma foljore varen marrëdhëniet kundrinore, rrethanore, përcaktore⁵⁰ etj, si më lart ku janë shënuar funksionet e sintagmës emërore, por që faktikisht funksioni varet nga lloji dhe valenca e foljeve. Më poshtë janë dhënë disa shembuj ku sintagma foljore funksionon si kallëzues. Sintagmat foljore mund të jenë kryesisht të tipit: *folje + emër/përemër*, *folje + me/pa parafjalë/lokucion parafjalor*, *folje + paskajore*⁵¹ (*U nisa për të arritur në shtëpi. Udhëtoi pa u ndalur.*), *folje + përcjellore* (*Beni lëvizte duke u lëkundur.*) dhe *folje + ndajfolje* (*Iku shpejt. Kur ka ikur?*).

(7)

- a. Djemtë e shkollës **fituan** garat shkollore. (Kryefjalë + kallëzues + kundrinor)
- b. Nxënësi i cili **u vonua të futej** në klasë, **u dënua** ashpër. (Fjali lidhore e nënrenditur si pjesë e kryefjalës + sintagmë foljore si kallëzues)

- **Sintagma foljore në gjuhën angleze:** Sintagma foljore në gjuhën angleze ka si kokë foljen kryesore (ose leksikore). Folja kryesore përpara mund të ketë folje ndihmëse (ndihmëse ose modale). Sintagma foljore në fjali luan rolin e kallëzuesit, ku kallëzuesi mund të jetë i thjeshtë (me një folje) ose i plotësuar me elemente shtesë (folje ndihmëse/modale).

(8)

- a. *The boys and the girls* **play** together this afternoon. (SF e thjeshtë)
- b. *I* **have been playing** football for two hours. (SF me folje ndihmëse)
- c. *The baby* **might cry** after the vaccination. (SF me folje modale)

Rendi i fjalëve ndryshon në fjalitë pyetëse, kështu duke nxjerrë foljen përpara kryefjalës:

(9) *Is it mine?*

⁵⁰ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 90-91.

⁵¹ Po aty, f. 90-100.

Këtu duhet përmendur edhe roli i mënyrës lidhore të foljes dhe në këtë mënyrë humbet lidhja midis kryefjalës dhe foljes së shtjelluar në vetën e tretë njëjës në kohën e tashme⁵².

(10)

- a. *If only he were **told**!* (Folja në mënyrën lidhore)
- b. ***Long live** the Queen!* (Folja në lidhore në sifjalinë kryesore)
- c. *If you don't like wearing a mask, **be** it clean, there is a chance you get the virus.* (Folja në lidhore në fjali të varura rrethanore⁵³)

Sintagmat foljore në gjuhën angleze mund të jenë me folje të shtjelluara si më lart apo të pashtjelluara, si më poshtë:

(11)

- a. *I look forward **to hearing** from you!*
- b. *I am happy **to see** you.*

Sintagmat foljore me lokucione foljore në gjuhën angleze janë shumë të përdorura dhe përbëhen nga folja dhe ndajfolja dhe mund të kenë kundrinor (foljet kalimtare) ose mund të mos kenë kundrinor (foljet jokalimtare)⁵⁴.

(12)

- a. *You must **look after** the baby!* (Folje frazore me kundrinor)
- b. *You need to **shut up**!* (Folje frazore pa kundrinor)

- **Sintagma mbiemërore në gjuhën shqipe:** Sintagmat mbiemërore janë të llojllojshme në gjuhësi pasi që mund të shoqërohen nga pjesë të ndryshme të ligjëratës si: *mbiemër + emër* që paraprihet nga një parafjalë (*i lodhur nga jeta, e bukur si kukull*), *mbiemër + ndajfolje* (*shumë i lumtur, jashtëzakonisht i suksesshëm*) dhe *mbiemër + paskajore*, por që krijohet situata ku kemi *mbiemër + fjali të varur* kundrinore me kallëzues në lidhore (Ata ishin *të aftë* për të fituar. Ishin *të pafuqishëm* që të vazhdonin)⁵⁵.

- **Sintagma mbiemërore në gjuhën angleze:** Sintagma mbiemërore ka kokë mbiemrin dhe mund të ketë edhe elemente të tjerë. Mbiemrat mund të kenë rol sintaksor vetëm kur janë pjesë e sintagmës mbiemërore, por meqenëse është vetë mbiemri ai që përcakton funksionin e sintagmës mbiemërore, ndodh shpesh që mbiemri të përdoret vetë për të ilustruar funksionet që i ka në

⁵² Quirk, R. dhe Greenbaum, S., "A University Grammar of English", Longman, 1976, f. 51.

⁵³ Në këtë tip fjalish mund të shihet përmbyssa e rendit të kryefjalës dhe të kallëzuesit.

⁵⁴ Greenbaum, S., "English Grammar", Oxford University Press, 1996, f. 280.

⁵⁵ Akademia e Shkencave, "Gramatika e gjuhës shqipe 2", Tiranë, 2002, f. 100-102.

fjali⁵⁶. Më poshtë janë dhënë dy funksionet sintaksore kryesore që sintagma mbiemërore mund të ketë në fjali:

(13)

- a. *Your son is **smart**.* (Kallëzuesor)
- b. *He made his daughter **very proud**.* (Kallëzuesor i kundrinorit)

Përdorimi i mbiemrave të emërzuar është shumë interesant dhe i rëndësishëm. Mbiemrat e emërzuar mund të luajnë rolin e kryefjalës në fjali:

(14) ***The rich** can fly to the Moon.* (Mbiemri i emërzuar si kryefjalë)

Por sintagmat mbiemërore mund të jenë edhe kallëzuesor⁵⁷:

(15) ***Flying a plane** is not **easy**.* (Kallëzuesor)

Për më tepër, sintagmat mbiemërore mund të jenë pjesë e sintagmave të tjera, duke i plotësuar ato, si te:

(16)

- a. *Rita Ora is **a famous singer**.* (SM si përcaktor i SE)
- b. *The Bulls don't play **till late**.* (SM si përcaktor i SP)

- **Sintagma numërore**: Gramatika e Akademisë sintagmën numërore e njeh si sintagmë të pavarur, por në gjuhën angleze si dhe nga Dhima kjo sintagmë nuk njihet si sintagmë e pavarur por si sintagmë emërore⁵⁸ sepse nuk është radhitur në tipat e sintagmave që mund të ekzistojnë në gjuhën shqipe. Megjithatë, këtu do të jepen disa shembuj për të pasqyruar qëndrimin e Gramatikës së Akademisë. Në anën tjetër, në gjuhën angleze numërori konsiderohet si pjesë e sintagmës emërore, gjegjësisht thuhet se është sintagmë emërore dhe jo numërore.

(17)

- a. ***Dy vetura** u larguan me shpejtësi.*
- b. *Djali i ri u godit nga **dy objekte**.*

- **Sintagma përemërore**: Edhe për sa i përket sintagmës përemërore, vlen i njëjti qëndrim si për sintagmën numërore. Në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera sintagma përemërore faktikisht llogaritet sintagmë emërore, për vetë faktin se përemri zëvendëson emrin. I njëjti qëndrim është shprehur edhe nga Dhima⁵⁹, por edhe këtu do të japim disa shembuj të sintagmave përemërore të

⁵⁶ Quirk, R. dhe Greenbaum, S., "A University Grammar of English", Longman, 1976, f. 115.

⁵⁷ Në gjuhën angleze përdoret termi 'complement' për kallëzuesorin e kryefjalës (ang. Subject complement).

⁵⁸ Dhima, Th., "Gjuha shqipe - Sintaksa", SHBLU, Tiranë, 2005, f. 28.

⁵⁹ Po aty, f. 28.

pranuara nga Gramatika e Akademisë së Shkencave. Edhe këtu si me sintagmën numërore, në gjuhën angleze përemrat konsiderohen si pjesë e sintagmës emërore, gjegjësisht janë sintagma emërore.

Sintagmat përemërore mund të jenë të tipit: *përemër + përemër me parafralë* (Çdonjëri nga ju mund të flasë. Cili nga ju e goditi makinën?) dhe *përemër + mbiemër* (Ai tha diçka të mençur.)⁶⁰. Përderisa sintagmat përemërore do të llogariten sintagma emërore, atëherë këto mund të luajnë funksione të ndryshme në fjali, si te shembujt e sintagmave emërore ku emri mund të zëvendësohet me përemër. Faktikisht, përemri në rolin e sintagmës emërore, përveç roleve më poshtë, mund të jetë edhe përcaktor:

(18)

- | | |
|--|------------------------|
| a. <i>Ai e shikoi vajzën.</i> | (Kryefjalë) |
| b. <i>Beni e bleu atë.</i> | (Kundrinor i drejtë) |
| c. <i>Qëndrimi i bleu asaj shumë lule.</i> | (Kundrinor i zhdrejtë) |
| d. <i>Hej ti, ik që andej!</i> | (Thirrje) |

- **Sintagmat ndajfoljore në gjuhën shqipe:** Sintagmat ndajfoljore nuk janë aq të pasura si sintagmat e tjera, sepse më së shumti sintagma ndajfoljore si sintagmë në vete mund të ketë një ndajfolje tjetër, ose të jetë pjesë e sintagmës mbiemërore.

(19)

- | | |
|---|-------------------------|
| a. <i>Beni iku shpejt.</i> | (Ndajfolje) |
| b. <i>Lepuri vraponte shumë shpejt.</i> | (Ndajfolje + ndajfolje) |
| c. <i>Jonida është shumë e bukur.</i> | (Ndajfolje + mbiemër) |

Nga shembujt e mësipërm mund të shohim se sintagma çdoherë varet nga funksioni leksikor i kokës si në shembullin e parë dhe të dytë, ndërsa në shembullin e tretë kemi ndajfolje + mbiemër që përbëjnë një sintagmë në rolin e kallëzuesit emëror. Në fillim mund të duket e paqartë se cila fjalë bart kuptimin kryesor, që sipas atij kuptimi merr edhe emërtimin e sintagmës. Në këtë rast, kuptimin kryesor e ka mbiemri 'e bukur', ndërsa ndajfolja shumë shërben si intensifikues dhe këtu kemi një sintagmë mbiemërore, jo ndajfoljore.

- **Sintagma ndajfoljore në gjuhën angleze:** Një sintagmë duhet të ketë kokë një ndajfolje për të qenë sintagmë ndajfoljore. Në nivel të sintagmës, ndajfolja mund të shoqërohet me modifikues të paravendosur ose të prapavendosur.

⁶⁰ Akademia e Shkencave, "Gramatika e gjuhës shqipe 2", Tiranë, 2002, f. 102.

(20)

- a. *He speaks English **well**.* (Sintagmë ndajfoljore)
- b. *My friend eats **very fast**.* (Modifikues + SN)
- c. ***Luckily for them**, they all passed the exams.* (SN + Modifikues)
- d. *This laptop works **really well for its price**.* (M + SN + M)

Nga këta katër shembuj mund të shohim se ndajfolja mund të marrë modifikues përpara dhe pas saj, por që duhet theksuar se modifikuesit ose përcaktorët janë fakultativë. Ndajfoljet mund të modifikojnë mbiemrin, një ndajfolje tjetër, parafjalën, përemrin, determinantin, numërorin dhe sintagmën emërore⁶¹.

Sintagmat ndajfoljore në gjuhën angleze janë shumë të rëndësishme, sepse luajnë disa funksione sintaksore në fjali, përveç atyre në nivel të sintagmës:

(21)

- a. *John could not run **very fast**.* (Rrethanor)
- b. *At least we are **inside**.* (Kallëzuesor i kryefjalës/Subject predicative)
- c. *I will leave the toys **outside**.* (Kallëzuesor i kundrinorit/Object predicative)

- **Sintagmat parafjalore në gjuhën shqipe:** Në gjuhën shqipe, duke iu referuar edhe gramatikave të gjuhës angleze⁶² dhe duke krahasuar shembujt në gjuhën shqipe, sintagmat parafjalore kanë së paku dy përbërës, patjetër një parafjalë dhe një plotësor tjetër. Rendi i fjalëve në sintagmat parafjalore është i ngulitur, ku parafjala qëndron në fillim të sintagmës dhe ka funksion leksikor dhe plotësorët qëndrojnë pas saj. Sintagma parafjalore është shumë e rëndësishme për sa i përket funksionit sintaksor në fjali sepse mund të jetë *adjunkt* ose shtesor⁶³ (ang. adjunct), por që realisht janë rrethanor vendi, kohe ose lloj tjetër rrethanori, kallëzuesor ose përcaktor. Për shembull:

(22)

- a. *Beni shkoi **në shtëpi**.* (Rrethanor vendi)
- b. *Të rinjtë arritën në shtëpi **me kohë**.* (Rrethanor kohe)
- c. *Rezultatet **nga spitali** ishin të mira.* (Përcaktor)

⁶¹ Greenbaum, S., “*English Grammar*”, Oxford University Press, 1996, f. 297.

⁶² Po aty, f. 208.

⁶³ Çeliku, M., “*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*”, ILAR, Tiranë, 2012, f.66. (Shtesor, sipas Çelikut, është një shoqërues jo i domosdoshëm, por në gjuhën angleze gjatë përdorimit të sintagmave parafjalore ndodh që ato të jenë adjunkte/shtesorë, por të domosdoshme, kështu që i bie që të jenë plotësorë (shoqërues të domosdoshëm) në gjuhën shqipe. Si pasojë e këtyre situatave, Çeliku përdor termin *rrethanorë plotësorë* i cili është plotësisht adekuat me këto fjali).

d. *Dielli ishte si në Afrikë.*

(Kallëzuesor)

- **Sintagmat parafjalore në gjuhën angleze:** Sintagma parafjalore përbëhet prej së paku dy përbërësish: një parafjalë dhe një përbërës tjetër/plotësor i parafjalës, i cili zakonisht është sintagmë emërore, pjesore me *-ing* ose sifjali me *wh-*. Përveç këtyre dy përbërësve, sintagma parafjalore mund të modifikohet me ndajfolje intensifikuese⁶⁴.

Në nivel të sintagmës, sintagma parafjalore mund të shoqërohet nga:

- Sintagmë emërore (*for one hour, at home, in the evening*);
- Sifjali me pjesore me *-ing* (*tired of playing games*);
- Ndajfolje (*until then, till now*);
- Mbiemër (*in private, in dark*);
- Sintagmë parafjalore (*from under the table*).

Sintagma parafjalore në nivel të fjalisë luan disa funksione të rëndësishme⁶⁵, si më poshtë:

(23)

- | | |
|--|-------------------------------------|
| a. <i>The students were singing on the plane.</i> | (Rrethanor) |
| b. <i>To my surprise, I passed the exam.</i> | (Rrethanor i veçuar ⁶⁶) |
| c. <i>We count on you.</i> | (Kundrinor me parafjalë) |
| d. <i>I am sorry for his actions.</i> | (Kallëzues emëror) |

Nga shembujt e mësipërm pritët që të kuptohet më lehtë sintaksa, si e gjuhës shqipe, ashtu edhe e gjuhës angleze, pasi që skema e pemës jep një vizualizim shumë të thjeshtë hierarkik, por njëkohësisht edhe gjithëpërfshirës të sintagmave, kokave dhe përbërësve shoqërues të sintagmave. Prej shembujve më lart, si dhe sipas Çomskit dhe teorisë X-bar, mund të shohim se sintagmat janë projektion i kokave të tyre dhe se struktura e sintagmave është e njëjtë për të gjitha gjuhët dhe në gramatikën gjenerative transformuese është përdorur simboli X për të shënuar çdo sintagmë që ka si kokë kategorinë X (që patjetër të jetë kategori leksikore)⁶⁷. Paraqitja grafike realizohet për të gjitha llojet e sintagmave. Të njëjtat rregulla vlejnë edhe gjatë përdorimit të teorisë X-bar, gjegjësisht skemës së pemës kur kemi të bëjmë me fjali. Kjo vërtetohet me fjalinë më poshtë, dhe shembujt janë dhënë qëllimisht për të vërtetuar se skema e pemës ose teoria X-bar funksionon si për gjuhën angleze, ashtu edhe për gjuhën shqipe.


⁶⁴ Greenbaum, S., “*English Grammar*”, Oxford University Press, 1996, f. 300.

⁶⁵ Quirk, R. dhe Greenbaum, S., “*A University Grammar of English*”, Longman, 1976, f. 145-146.


⁶⁶ Në gjuhën angleze përdoret termi *disjunct* që nënkupton rrethanorin e veçuar nga fjalia.

⁶⁷ Memushaj, R., “*Gjuhësia gjenerative*”, SHBLU, Tiranë, 2008, f. 145.

My parents travelled yesterday from Boston.



Prindërit e mi udhëtuan dje nga Bostoni.



Shkurtesat në diagrame qëndrojnë për fjalinë dhe sintagmat vijuese: Fjali (F/Fj.), sintagmë emërore (SE), sintagmë mbiemërore (SM), sintagmë foljore (SF), sintagmë ndajfoljore (SN) dhe sintagmë parafjalore (SP).

2.3. Vështrim i shkurtër teorik mbi gjymtyrët e fjalisë në gjuhën shqipe

Gjuhësia shqiptare vazhdimisht ka pasur studime, pajtime dhe kundërshtime për çështje të caktuara. Njëra ndër çështjet më të debatuar ka qenë klasifikimi i gjymtyrëve të fjalisë. Për gjymtyrët që sot njihen si gjymtyrë kryesore, nuk ka pasur ndonjë debat domethënës dhe pjesa më e madhe e gjuhëtarëve e llogarisin si punë të kryer. Klasifikimi i gjymtyrëve të dyta përbën një çështje më të studiuar dhe debatuar në gjuhësinë shqiptare. Më saktë, kanë qenë pyetjet se çfarë i përcakton, përkufizon e klasifikon gjymtyrët e tjera dhe këto pyetje kanë nxitur mendime të ndryshme. Që në gjysmën e parë të shekullit XIX kanë filluar studimet ku janë vërejtur kryesisht dy drejtime kryesore: 1) i pari mbështetet në raportet e brendshme, në kuptimin, funksionin dhe 2) i dyti në mënyrën e shprehjes gramatikore, dhe të dy drejtimet apo teoritë u paraqitën kur në gjuhësi rol kyç kishte drejtimi logjik-gramatikor dhe si rrjedhim u pranuan gjymtyrët e dyta: *përcaktor*, *kundrinë a objekt*, *rrethanor a plotës rrethane*, por që edhe sot në gjuhësinë moderne si gjymtyrë të dyta njihen njëjtë tri kategori më të mëdha: përcaktorët, kundrinorët (me nënlojet e veta) dhe rrethanorët⁶⁸.

Gjymtyrët janë fjalë (ose togfjalësha) si njësi sintaksore më vete në bazë të funksionit sintaksor, fjalë që kanë kuptim të plotë me trajtat e tyre, fjalë që janë të shoqëruara ose të pashoqëruara me fjalë të tjera shërbyese, apo bashkime fjalësh dhe si të tilla janë njësia më e vogël që analizohet nga sintaksa⁶⁹. Fjala si e tillë duhet të luajë një rol të caktuar në fjali. Çdo fjalë ka funksionin dhe vendin e vet në fjali dhe në këtë mënyrë krijohen raportet dhe funksionet që fjalët luajnë në fjali.

Në gjuhën shqipe është bërë një ndarje e gjymtyrëve të fjalisë në kryesore dhe të dyta. Në fjalitë njëkryegjymtyrëshe kemi të bëjmë vetëm me një kryegjymtyrë të vetme që nuk është as kryefjalë, as kallëzues (p.sh., *Qetësi!*, *Nxehtë. Shkoni!*), ndërsa në fjalitë dykryegjymtyrëshe kryegjymtyrët kryefjala dhe kallëzuesi janë në gjendje të ndërtojnë strukturën minimale të fjalisë së thjeshtë⁷⁰ (p.sh., *Beni lexon. A shkuan fëmijët?*). Në fjalinë e dytë ‘A’ është pjesëz pyetëse e cila përdoret për të parashtruar pyetje.

⁶⁸ Domi, M. “*Veptra I – Studime sintaksore*”, Tiranë, 2013, f. 216

⁶⁹ Po aty, f. 125.

⁷⁰ Çeliku, M. “*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 131.

Meqenëse disertacioni ka për objekt lidhjen kryefjalë-kallëzues-kundrinor, ne këtu përqendrohemi në fjalitë dykryegjymtyrëshe dhe funksionet që gjymtyrët kanë brenda një fjalie si dhe mënyrën se si lidhen dhe renditen ato. Funksionet e tyre janë të rëndësishme sepse përmes tyre sqarohet lidhja e gjymtyrëve në fjali dhe vendi i tyre brenda vetë fjalisë. Për më tepër, duhet sqaruar me më shumë detaje se çfarë është fjalia dykryegjymtyrëshe dhe çfarë lloj gjymtyrësh ekzistojnë.

Ekzistojnë dy tipa fjalish dykryegjymtyrëshe: fjalitë dykryegjymtyrëshe të pazgjeruara, që janë fjali që përbëhen vetëm nga kryefjala dhe kallëzuesi, dhe fjalitë dykryegjymtyrëshe të zgjeruara, që janë fjali që mund të kenë edhe gjymtyrë të tjera plotësuese (ose gjymtyrë të dyta)⁷¹. Pa kryefjalë dhe kallëzues fjalia e pazgjeruar nuk do të kishte kuptim dhe lidhja midis këtyre dy gjymtyrëve gjen shprehjen e vet gramatikore në lidhjen kallëzuese, e cila është e ngjashme me përshtatjen, por jo e njëjtë me të⁷².

Ashtu siç u përmend më lart, në fjali përveç gjymtyrëve kryesore, ose gjymtyrës së vetme kryesore me të cilën mund të dalin, shpesh dalin edhe gjymtyrë të tjera. Gjymtyrët që i plotësojnë gjymtyrët kryesore, i përcaktojnë më tej ato, lidhen me to nga ana kuptimore e strukturore, quhen gjymtyrë të dyta⁷³. Nga ky përkufizim është e thjeshtë të logjikohet përse ekzistojnë gjymtyrët e dyta. Ato thjeshtë përdoren për të plotësuar e pasuruar fjalitë, për të dhënë më shumë informacione rreth fjalisë, apo për ta plotësuar fjalinë me më shumë hollësi. Mund të shprehen me çdo fjalë kuptimplotë, p.sh., emër a përemër, lokucione emërore, përemërore, mbiemërore, ndajfoljore, të shoqëruar ose jo me parafjalë a lokucion parafjalor, me mbiemër a numëror, me ndajfolje, me togfjalëshja leksikorë ose të lirë, me trajtë të pashtjelluar foljore (pjesore, paskajore, përcjellore), me fjalë jokuptimplotë (p.sh., një, lidhëz, parafjalë, pjesëz, pasthirrmë) të emëruar, me trajtë të shtjelluar të foljes, zakonisht të emëruar, me formën e ndërtimeve shkurtesa, ose me njësi apo element të pamëvetësishëm (tingull, shkronjë, rrokje, ndajshtesë, fundore) që konceptohet si diçka e sendëzuar e që emërohet⁷⁴. Në aspektin sintaksor kjo ndarje është shumë më e shkurtër, sepse çdo fjalë duhet të luajë një rol të caktuar sintaksor në fjali. Përcaktimi i funksioneve dhe i kriterëve të klasifikimit të funksioneve të caktuara në gramatikën e gjuhës shqipe është bërë mjaft vonë dhe në vazhdimësi ka pasur mospajtime të ndryshme rreth

⁷¹ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 165.

⁷² Po aty, f. 165.

⁷³ Domi, M., “Vepra I – Studime sintaksore”, Tiranë, 2013, f. 208.

⁷⁴ Po aty, f. 211.

emërtimeve, ndarjeve dhe nëndarjeve të gjymtyrëve të dyta. Në gjuhën shqipe ndarja apo klasifikimi i gjymtyrëve të dyta kryesisht është bërë duke u bazuar në dy drejtime kryesore: a) i pari mbështetet në raportet e brendshme, kuptimin, funksionin, dhe b) i dyti mbështetet në mënyrën e shprehjes gramatikore, ku si rrjedhim u krijua teoria e gjymtyrëve të dyta që përfshinte *përcaktorin, kundrinorin e drejtë/zhdrejtë(objektin) dhe rrethanorin (plotës rrethane)*⁷⁵. Kjo teori u dëshmuar aq e rëndësishme sa edhe sot kemi ndarjen e njëjtë në tri kategori të mëdha të gjymtyrëve të dyta. Thuhet kategori të mëdha pasi që të njëjtat pastaj ndahen në nënkategori të ndryshme, por për ne më e rëndësishme është kategoria e kundrinorit dhe ndarja e tij që është sqaruar më poshtë.

Lista e gjatë e nënlojeve të gjymtyrëve të dyta na bën të mendojmë dhe logjikojmë se edhe për gjymtyrët e dyta ekzistojnë rregulla se si futen në fjali, më saktë, vendin që zënë në fjali. Ato janë të varura nga gjymtyrët kryesore të cilave u referohen dhe në fjali luajnë një funksion të caktuar sintaksor. Futja e tyre në fjali duhet patjetër të respektojë rregullat e caktuara gjuhësore dhe ato rregulla respektohen në atë mënyrë që gjymtyrët e dyta në fjali lidhen me anë të: a) përshtatjes (të plotë ose të pjesshme), b) drejtimit (të drejtpërdrejtë a parafjalor), ose c) bashkimit (të thjeshtë a pranvënies)⁷⁶. Kështu, gjymtyrët e dyta mund të gjenden në të gjithë tipat e fjalive, përfshirë fjalitë njëkryegjymtyrëshe e të paplota (p.sh. *Bukur! Mirë! Më ngadalë!*).

2.4. Vështrim i shkurtër teorik mbi gjymtyrët e fjalisë në gjuhën angleze

Gjuha angleze gjatë historisë së zhvillimit të saj ka pësuar shumë ndryshime si në aspektin morfologjik, sintaksor dhe fonetik. Gramatika e gjuhës angleze është studiuar nga shumë studiues dhe shumë shkolla e shtëpi botuese. Këtu do u referohemi disa gramatikave që kanë të bëjnë me sistemin sintaksor në gjuhën angleze dhe ndarjen e gjymtyrëve në fjali, si të Oksfordit, Longmanit, McMillanit, etj. Gramatikat e gjuhës angleze kanë një unitet të caktuar për sa i përket ndarjes së fjalive dhe ndarjes së gjymtyrëve në fjali dhe me këtë bëhet më i lehtë analizimi i gjymtyrëve dhe rolit të tyre në fjali. Këndvështrimet më poshtë janë marrë nga disa nga

⁷⁵ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 209.

⁷⁶ Po aty, f. 207.

gramatikat më të rëndësishme si të Randolph Quirk⁷⁷, Bas Aarts⁷⁸, Herman Wekker dhe Liliane Haegeman⁷⁹ etj.

Fillimisht, në gjuhën angleze fjalitë janë fjali të thjeshta (simple sentences) dhe fjali të përbëra (multiple sentences). Fjalitë e përbëra ndahen në fjali të përbëra me bashkërenditje (compound sentences) dhe fjali të përbëra me nënrenditje (complex sentences)⁸⁰. Këtu nuk futemi më thellë në ndarjet e fjalive sepse qëllimi ynë është studimi i fjalive të thjeshta, gjymtyrëve të tyre (respektivisht kryefjala, kallëzuesi dhe kundrinori) dhe funksionet e përbërësve në fjali.

Pas ndarjes së fjalive, sipas Greenbaum dhe Nelson, në gjuhën angleze si gjymtyrë apo përbërës të fjalisë (ang. sentence constituents) janë: kryefjala (K) (subject[S]), kallëzuesi (K) (verb/predicate[V/P]), kundrinori i drejtë (KD) (direct object [DO]), kundrinori i zhdrejtë (KZH) (indirect object[IO]), përcaktorët si: përcaktori kallëzuesor i kryefjalës (PKK) (subject complement[SC]), përcaktori kallëzuesor i kundrinorit (PKK) (object complement [OC]) dhe në fund rrethanori (RR) (adverbial[A])⁸¹.

Është shumë interesante se në gjuhën angleze gjymtyrët e lartpërmendura mund të ndahen në *shtatë* struktura/modele themelore fjalish (basic sentence structures/patterns)⁸² dhe çdo fjali duhet patjetër të jetë pjesë e ndonjëres strukturë. Kjo ndarje në shtatë kategori e bën shumë praktike analizën e fjalive dhe përcaktimin e funksioneve sintaksore në fjali.

E njëjta ndarje e gjymtyrëve paraqitet në gramatikën më të rëndësishme të gjuhës angleze, atë të Kuirkut⁸³ dhe në shumë gramatika të tjera dhe ndarja e tyre në gjuhën angleze është bërë si më poshtë:

1. KK (Kryefjalë + Kallëzues [folje jokalimtare]) – SP (Subject + Predicate)

(24) *I speak./ Unë flas.*

⁷⁷ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech G. dhe Svartvik, J. “*A comprehensive grammar of the English language*”, Longman, London & New York, 1985, f. 719-721.

⁷⁸ Aarts, B. “*English syntax and argumentation – Second edition*”, Palgrave Macmillan, London, 2001, f. 8-20.

⁷⁹ Wekker, H. dhe Haegeman, L. “*A modern course in English syntax*”, Routledge, London, 1985, f. 68-86.

⁸⁰ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “*A comprehensive grammar of the English language*”, Longman, London & New York, 1985, f. 719.

⁸¹ Greenbaum, S. dhe Nelson, G. “*An introduction to English grammar – Second Edition*”, Longman, London, 2002, f. 33.

⁸² Po aty, f. 33.

⁸³ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “*A comprehensive grammar of the English language*”, Longman, London & New York, 1985, f. 720.

2. KKKD (Kryefjalë + Kallëzues + Kundrinor i drejtë(KD)) – SPO (Subject + Predicate + Direct Object (DO))

(25) *I have bought a bike./Unë kam blerë një biçikletë.*

3. KKKE (Kryefjalë + Kallëzues + përcaktor kallëzuesor) – SPSC (Subject + Predicate + Subject Complement)

(26) *I feel happy./Unë ndjehem i lumtur.*

4. KKRR (Kryefjalë + Kallëzues + Rrethantor) – SPA (Subject + Predicate + Adverbial)

(27) *I live in a village. / Unë jetoj në fshat.*

5. KKDKZH (Kryefjalë + Kallëzues + Kundrinor i zhdrejtë (KZH) + Kundrinor i drejtë (KD)) – SPOO (Subject + Predicate + Indirect Object (IO) + Direct Object(DO))

(28) *I have brought her a flower. /Unë i kam sjellë asaj një lule.*

Në shembullin e mësipërm kundrinori i zhdrejtë ‘asaj’ është ndarë nga trajta e shkurtër ‘i’ për shkak të lëvizjes së lirë në fjali, por që normalisht të dyja konsiderohen si një gjymtyrë - kundrinor i zhdrejtë.

6. KKDKPKK (Kryefjalë + Kallëzues + Kundrinor i drejtë + Përcaktor kallëzuesor i kundrinorit) – SPOC (Subject + Predicate + Direct Object + Object Complement)

(29) *You have made me happy. / Ti më ke bërë mua të lumtur.*

7. KKDRR (Kryefjalë + Kallëzues + Kundrinor i drejtë + Rrethantor) – SPOA (Subject + Predicate + Direct Object + Adverbial)

(30) *You can park your car in the garage. / Ti mund ta parkosh makinën tënde në garazh.*

Përveç kësaj ndarjeje shumë të rëndësishme, sipas Kuirkut në gjuhën angleze ekziston edhe një ndarje e vogël e ashtuquajtur fjali ekzistenciale e zbrazët (bare existential sentence)⁸⁴, por kjo është një kategori shumë e vogël në krahasim me shtatë kategoritë e lartpërmendura.

(31) *There is no need for this. / Nuk ka nevojë për këtë.*

Në krahasim me gjuhën shqipe, këtu është interesant roli i përcaktorit si një komplement i kryefjalës ose kundrinorit. Pra, njihet vetëm përcaktori kallëzuesor dhe jo përcaktori. Kjo gjë e ka thjeshtësuar tej mase përcaktimin e funksioneve sintaksore sepse nuk njihen përcaktorët si gjymtyrë e mëvetësishme, por si elemente që plotësojnë gjymtyrët e tjerë dhe për ata që mësojnë

⁸⁴ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A comprehensive grammar of the English language”, Longman, London & New York, 1985, f. 721.

gramatikën e gjuhës angleze është shumë më i lehtë identifikimi i tyre sesa për ata që mësojnë gramatikën e gjuhës shqipe.

Nga shembujt e dhënë mund të shihet lehtë se folja duhet patjetër të jetë kalimtare me qëllim që të mund të plotësohet me elementë të tjerë dhe elementët të mund të kenë funksione të caktuara në fjali. Vetëm në kategorinë e parë folja është jokalistare, prandaj edhe nuk është e pasuar nga asnjë element dhe fjalia përbëhet vetëm nga kryefjala dhe kallëzuesi. Mirëpo mund të ndodhë që një folje të jetë jokalistare dhe kalimtare njëkohësisht dhe në rastet e tilla fjalia mund të jetë pjesë e njërës kategori ose tjetrës, si për shembull:

(32)

a. *Ata po hanë.* (KK) / *They are eating.* (SP)

b. *Ata hanë pica.* (KKK) / *They are eating pizza.* (SPO)

Prandaj, jo vetëm që folja luan rol kyç për sa i përket fjalisë së thjeshtë, por ajo luan rol kyç edhe në përcaktimin e strukturave/kategorive të mësipërme të fjalive.

2.5. Kryefjala në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze

2.5.1. Kryefjala në gjuhën shqipe

Kryefjala është pjesë thelbësore e fjalive dykryegjymtyrëshe. Si në çdo gjuhë të botës, është studiuar gjerë e gjatë se çfarë mund të jetë kryefjalë. Në gjuhën shqipe ekziston një listë se me çfarë mund të shprehet kryefjala. Përpara se të fillohet me elementet me të cilët shprehet kryefjala, fillimisht duhet sqaruar se çfarë është, në fakt, kryefjala dhe kjo përbën pjesën më të rëndësishme teorike në këtë studim.

Kryefjala është gjymtyra kryesore emërore a përemërore e fjalisë dykryegjymtyrëshe që hyn në marrëdhënie kallëzuese me kallëzuesin⁸⁵. Nga vetë fjala ‘emërore a përemërore’ është fare e thjeshtë të kuptohet se kryefjala shprehet me një emër ose përemër. Por gjërat bëhen më të komplikuar kur futemi më thellë në atë se me çfarë emrash, përemrash apo pjesësh të tjera të ligjëratës shprehet kryefjala. Kryefjala është në lidhje kallëzuese me foljen apo kallëzuesin

⁸⁵ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 167.

(përbërësin e dytë kryesor të fjalisë) dhe ajo është e pavarur në aspektin gramatikor sepse ajo ia cakton kallëzuesit numrin, vetën apo edhe gjininë, kurse varet në aspektin semantik nga kallëzuesi sepse ai e kërkon atë si plotësor të saj⁸⁶. Është shumë e rëndësishme të përmendet këtu se, në krahasim me gjuhën angleze, në gjuhën shqipe kryefjala e vetës së tretë mund të mungojë dhe ajo nënkuptohet përmes kontekstit dhe në këtë rast fjalia konsiderohet si fjali dykryepërbërëse e paplotë⁸⁷. Shembull i tillë është fjali ku bëhet fjalë për një send: A: *A ishte këtu?*/ *Was it here?* B: *Ishte këtu./It was here.*

Kryefjala⁸⁸ shprehet me emra (konkret/abstrakt, të numërueshëm/panumërueshëm, asnjës, në numrin njëjës/shumës, emra përmbledhës, emra të lëndës, emra në trajtën e shquar/pashquar), përemra, numërorë, mbiemra të emëruar, përemra pronorë të emëruar, togfjalësh dhe sifjali. Më poshtë është dhënë një sqarim i shkurtër për sa i përket emrit dhe funksionit sintaksor, gjegjësisht kur përdoret për të shprehur kryefjalën.

Emri, bashkë me foljen, përbën pjesën më të rëndësishme në këtë studim si në rrafshin morfologjik, ashtu edhe sintaksor. Qëllimi ynë këtu është identifikimi i funksioneve sintaksore që emri mund të luajë në fjali. Emri, përveç se mund të jetë kryefjalë e fjalisë, mund të ketë edhe funksione të tjera, si p.sh.: ‘*Beni dëshiron akullorë*’ – *Beni* (kryefjalë) dhe *akullorë* (kundrinor). Prandaj, për të kuptuar mirë të gjithë rolet që emri ka në fjali, nevojitet njohja e mirë e tij dhe një analizë e shkurtër, por e domosdoshme, e kategorive gramatikore dhe grupeve leksiko-gramatikore të emrit. Në të shumtën e rasteve, kryefjala kur shprehet me një emër (të përveçëm ose të përgjithshëm), emri gjendet në rasën emërore dhe në trajtën e shquar për shkak se përdorimi i emrit në trajtë të pashquar e vështirëson krijimin e strukturave sintaksore, gjegjësisht fjalive me kuptim të plotë⁸⁹. Për shembull: *Joni luan me top. Retë u errësuan. U dëgjuan krisma. Ide të mira u shfaqën në kokën e tij.* Por emri njëjtë mund të jetë edhe në trajtën e pashquar si: *Një ide e mirë është gjithnjë e pranueshme. E kalova një provë në jetë.* Më poshtë është dhënë një përshkrim i shkurtër i kategorive të emrit. Për sa i përket gjinisë, emrat në gjuhën shqipe në përgjithësi janë ose të gjinisë mashkullore, ose të gjinisë femërore, ndërsa vetëm një numër shumë i vogël emrash janë të gjinisë asnjës, pra duke mos përfshirë asnjë emër.

⁸⁶ Çeliku M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksor)”, Ilar, 2012, f. 137.

⁸⁷ Po aty, f. 137.

⁸⁸ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 167-172.

⁸⁹ Po aty, f. 167.

Për sa i përket kryefjalës është shumë e rëndësishme të përmenden *emrat përmbledhës*⁹⁰. Emrat përmbledhës zënë vend shumë të rëndësishëm në këtë studim, pasi që emrat përmbledhës mund të jenë edhe emra që përdoren në njëjës (p.sh., *djemuria*, *vëllazëria*), por edhe në shumës, por që ka një dallim midis shumësisë dhe bashkësisë (emra që tregojnë masë: *mbeturina*, *makarona*, *të mbjellat*, *perimet*, *të hollat*; emra që tregojnë sende të përbërë prej dy ose më shumë pjesësh: *pantallona-t*, *pranga-t*, *ski-të*; emra që tregojnë një shumicë qeniesh-frymorësh/njerëzish: *dhen-të*, *shqerrë-at*, *dy vetë*, *tre vetë*; emra abstrakt: *të palara-t*, *ethe-t*; disa emra të përveçëm ose të përgjithshëm që tregojnë vende: *Alpe-t*, *vise-t*, *lugje-t*. Por duhet pasur parasysh se emrat që përdoren në shumës dallojnë për nga aspekti morfologjik nga emrat që dalin vetëm në njëjës dhe nga emrat përmbledhës.

Karakteristikë tjetër shumë e rëndësishme është edhe ajo se emrat përmbledhës, me përdorimin e tyre, shfaqin lidhjet e tyre të dyfishta si me njëjësin, ashtu edhe me shumësin, çka duket në formën e foljes – kallëzuesit, e cila vihet herë në njëjës, herë në shumës si me emrin ‘*rinia*’⁹¹, si te shembujt:

(33)

- a. ***Rinia është forcë e pandalshme e vendit.*** (Emër përmbledhës + folje njëjës)
- b. ***U nisën rinia dhe shkuan në mal.*** (Emër përmbledhës + folje shumës)

Përpara se të kalohet te emrat e lëndës apo materies, duhet theksuar edhe diçka në lidhje me emrat përmbledhës, veçanërisht nëse marrim shembullin *rinia*. Duhet pasur parasysh se emri *rinia* mund të ketë dy kuptime:

(34)

- a. *Rinia e jetës së tij shkoi keq fare.* (Shumësi e pazbërthyeshme - tërësi)
- b. *Rinia e fshatit ishin aty.* (Shumësi e zbërthyeshme - individë)

Në fjalinë e parë më lart flasim për jetën e një personi dhe aty ajo merret si tërësi dhe absolutisht përshtatet me rregullën se emrat përmbledhës përdoren në numrin njëjës. Mirëpo te fjalja e dytë dhe e tretë sërish konfirmohet situata se ndonjë emër përmbledhës herë mund të përdoret në njëjës, herë në shumës (duke iu referuar nocionit të shumësisë së zbërthyeshme dhe të pazbërthyeshme) dhe kjo vërtetohet edhe me shembuj të tjerë kur analizohet lidhja e kryefjalës dhe kallëzuesit në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe.

⁹⁰ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 104-105.

⁹¹ Po aty, f. 86.

E gjithë analiza për sa i përket emrit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kryefjalën, pasi kryefjala jo çdoherë është një fjalë e vetme, por edhe një emër me elemente shoqëruese të cilët bashkë përbëjnë një sintagmë dhe e gjitha konsiderohet kryefjalë. Çeliku ka bërë një përmbledhje se me çfarë shprehet kryefjala, por duhet theksuar se në dallim nga Gramatika e Akademisë, Çeliku sintagmat i quan përbërës sintaksorë. Sipas tij, kryefjala shprehet me: 1) emër të shquar (njëjës/shumës, i përgjithshëm/i përveçëm, konkret/abstrakt etj. dhe të gjitha pjesët e tjera të ligjëratës të emëruara), 2) emër të pashquar i paraprirë nga nyja joshquese *një*, 3) emër të pashquar (njëjës a shumës pa nyja joshquese), 4) emër të shquar të farefisnisë të paraprirë nga pronorë të shkurtuar në rolin e caktuesorëve të pronësisë, 5) emra të pashquar të farefisnisë të paraprirë nga përemra pronorë në funksion të caktuesorëve pronorë, 6) përemra-emra (përemra të përdorur si emra) vetor, dëftor, pyetës, të pacaktuar, lidhor, 7) numërorë të përdorur si të emëruar ku i paraprin caktuesori ‘*të*’⁹².

Duhet pasur parasysh se kryefjala jo çdoherë mund të shprehet vetëm nga një fjalë, e kjo vlen si për gjuhën shqipe ashtu edhe për gjuhën angleze, Çeliku përmend disa përbërës me të cilët mund të shprehet kryefjala: 1) përbërës emërorë të thjeshtë të zgjeruar (përemra-mbiemra dëftorë + emra të pashquar, p.sh. *ky person*; emra të shquar + përemra-mbiemra pronorë, p.sh. *djali i tij*; përemra-mbiemra të pacaktuar + emra të pashquar, p.sh. *shumë persona*; përemra-mbiemra pyetës + emra të pashquar, p.sh. *cili person*; numërorë + emra të pashquar, p.sh. *tre shokë*; emra për shumësi sendesh + emra në rrjedhore në shumës, p.sh. *një sërë idesh*; përemra-emra të pacaktuar, p.sh. *lloj-lloj, njëfarë*; përemër-mbiemër pyetës + emra në rrjedhore, p.sh. *lloj-lloj kafshësh*; mbiemra të emëruar + emër i pashquar, p.sh. *e zeza nënë*; emra të shquar + emra të përveçëm njerëzish, p.sh. *zoti Bekim, mbretëresha Teuta*; emër + parafjala *me/lokucioni bashkë me* + emër në kallëzore, p.sh. *Joni me Jonidën* dhe këtu duhet vënë re se folja detyrimisht vendoset në shumës dhe me emërtime të përbëra nga dy a më shumë fjalë, p.sh. *Universiteti i Elbasanit*; 2) përbërës përemëror të shprehur me përemër + parafjala *nga/prej* + emër a përemër, p.sh. *shumë prej tyre, disa nga personat*, 3) përbërës numëror të shprehur me numëror + parafjala *nga/prej* + emër a përemër, p.sh. *dy nga shtetet, pesë nga lëndët*; 4) përbërës sifjali e që mund jetë e varur dhe si e tillë mund të quhet sifjali kryefjalore. Sifjalia mund të jetë përbërës i

⁹² Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksor)”, Ilar, 2012, f. 138-143.

varur i një përbërësi emëror kokë⁹³. Shembujt me përbërës sifjali janë të shumtë dhe të shumëllojshëm, p.sh. *Dihet që Toka rrotullohet rreth Diellit*.

2.5.2. Kryefjala në gjuhën angleze

Për dallim nga gjuha shqipe, struktura e gjuhës angleze e bën më të thjeshtë identifikimin e kryefjalës dhe gjetjen e pjesëve të ligjëratës me të cilat shprehet kryefjala. Rol kyç për këtë pohim ka kategorizimi i fjalive, i përmendur më herët, nga Kuirku. Sipas tij, ndarja e fjalisë së thjeshtë (identifikimi i kryefjalës dhe kallëzuesit) lidhet me pohimin se kryefjala llogaritet më shumë si një kategori logjike sesa strukturore e gramatikore – meqë kryefjala shpesh përshkruhet si përbërësi i cili shënon temën e fjalisë, apo ajo për të ‘cilën’ është fjalia⁹⁴. Ngjashëm, kryefjala në gjuhën angleze diskutohet edhe nga Huddleston, sipas të cilit, termi kryefjalë përkufizon ‘temën’ e fjalisë (ajo për çfarë është fjalia) dhe kryefjala vihet përpara kallëzuesit (i cili përmban ‘komentin’ ose atë çfarë thuhet për temën)⁹⁵. Prandaj, gjatë analizës së fjalive të thjeshta në gjuhën angleze kryefjala pritet të jetë në fillim të fjalisë dhe rrallëherë ndodh që të ketë rend të përmbysur, e kur ndodh një gjë e tillë zakonisht bëhet për shkak të stilit.

Kryefjala në gjuhën angleze, ashtu si në gjuhën shqipe, mund të shprehet me një fjalë a me më shumë fjalë. Kryefjala kryesisht tregon tërësi, send, person, kafshë, etj. dhe ka funksion emëror. Në gjuhën angleze kryefjala është emër, sintagmë emërore, përemër ose sifjali⁹⁶. Në aspektin sintaksor, kryefjala mund të ketë dy ose më shumë sintagma emërore, sasiore, numërore dhe emra përmbledhës. Më poshtë janë dhënë disa shembuj të kryefjalës së shprehur me emër dhe përemër, por vend shumë të rëndësishëm zë edhe sifjalia dhe llojet e sifjalisë me të cilët shprehet kryefjala, si sifjali me *that*, *wh-*, gjerund dhe infinitiv⁹⁷. P.sh.:

(35)

a. *Ana is sick./Ana është e sëmurë.*

⁹³ Çeliku, M., “*Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksor)*”, Ilar, 2012, f. 143.

⁹⁴ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “*A comprehensive grammar of the English language*”, Longman, London & New York, 1985, f. 79.

⁹⁵ Huddleston, R. ‘*Introduction to the Grammar of English*’, Cambridge University Press, 1984, f. 58.

⁹⁶ Morley, G. D. ‘*Syntax in Functional Grammar – An Introduction to Lexicogrammar in systemic linguistics*’, Continuum, 2000, f. 91.

⁹⁷ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “*A comprehensive grammar of the English language*”, Longman, London & New York, 1985, f. 724-726.

- b. *He left./Ai iku.*
- c. *The youngest pupil in the classroom left school./Nxënësi më i ri në klasë e la shkollën.*
- d. *The government were divided./Qeveria ishte e ndarë.* (Kryefjalë me emër përmbledhës)
- e. *That his idea was wonderful was obvious./Ishte e dukshme që ideja e tij ishte e mrekullueshme.* (Kryefjalë e shprehur me sifjali – me formë të shtjelluar [përemër lidhor])
- f. *What I need is a rest./Çfarë më nevojitet, është pushimi.* (Kryefjalë e shprehur me sifjali – [përemër lidhor])
- g. *To tell the truth takes a lot of courage./Të thuash të vërtetën duhet shumë guxim.* (Kryefjalë e shprehur me paskajore/infinitiv)
- h. *Being a president is a great honor./Është nder i madh të jesh president.* (Kryefjalë e shprehur me gjerund/gerund)

Më lart mund të vërehet se për të pasur një fjali kuptimplotë në gjuhën angleze duhet patjetër të kemi kryefjalë dhe kallëzues, por jo edhe në gjuhën shqipe. Por duhet vënë re se ka një ndryshim gjatë përkthimit të fjalive nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, e këtu mund të vërehet se kryefjala jo çdoherë është në fillim të fjalisë, ashtu si në gjuhën angleze. Kjo sqarohet me atë se rendi i fjalëve në gjuhën angleze është i fiksuar, ndërsa në gjuhën shqipe është i lirë dhe me këtë nuk paraqitet problem për vendosjen e kryefjalës në fillim apo në fund të fjalisë dhe kryefjala vendoset aty ku tingëllon më mirë dhe në mënyrë më natyrore. Kjo liri e lëvizjes së gjymtyrëve vjen për shkak të mbaresave vetore dhe sistemit rasor. Si dallim tjetër më lart mund të shihet numri i foljes në shembullin me emrin përmbledhës dhe për këtë rol kryesor luan kryefjala. Kryefjala e shprehur me emër përmbledhës (*The government/Qeveria, the youth/rinia, the elderly/the old – të moshuarit* etj.) është shumë e rëndësishme pasi në varësi të emrit përmbledhës kallëzuesi mund të jetë në njëjës ose në shumës dhe ky nuk është shembulli i vetëm i përmendur në këtë studim.

Kryefjala në gjuhën angleze jo çdoherë gjendet në fillim të fjalisë. Në raste të tilla bëhet fjalë për përmbysje të rendit të fjalëve në fjali dhe rastet e tilla janë më të rrallë dhe të pazakontë.

(36)

- a. *Three teachers came into the classroom./Tre mësues u futën në klasë.*

- b. *Into the classroom came **three teachers**./Në klasë u futën **tre mësues**.*

Siç u tha më lart, përmbysja e rendit të fjalëve në fjali në gjuhën angleze ndonjëherë bëhet për të arritur stil më të lartë të shkruarit (sidomos në vepra letrare) apo të folurit, e kjo mund të shihet në shembullin më poshtë:

(37)

- a. ***I** have never seen such a beauty./**Unë** nuk kam pa asnjëherë bukuri të tillë.*
b. *Never have **I** seen such a beauty./Asnjëherë nuk kam pa **unë** bukuri të tillë.*

Në shembullin e dytë më lart, një njohës i gjuhës angleze e kupton menjëherë se kryefjala dhe kallëzuesi kanë ndryshuar vendet dhe se fjalia ka një stil të veçantë me të cilin fitohet një efekt special. Lëvizje të kryefjalës kemi edhe në fjalitë pyetëse ku kryefjala dhe kallëzuesi ndryshojnë vendet e tyre, si në shembullin:

(38) ***This** is Ben. => Is **this** Ben?/**Ky** është Beni. => A është **ky** Beni?*

Një lloj tjetër fjalish interesante për sa i përket kryefjalës, në gjuhën angleze, janë fjalitë urdhërore dhe pyetëse. Në fjalitë urdhërore kryefjala mund të jetë e fshehur, si në gjuhën angleze ashtu edhe në gjuhën shqipe, ndërsa në fjalitë pyetëse identifikimi i kryefjalës është më i lehtë, p.sh.:

(39)

- a. *Listen to the music./Dëgjo muzikën.*
b. *Will **he** return tomorrow?/A do të kthehet **ai** nesër?*

Gjetja e kryefjalës në fjalinë a) është e lehtë për shkak se bëhet fjalë për fjali urdhërore dhe kryefjala ‘You/Ti’ nënkuptohet. Ndërsa në fjalinë pyetëse, përemri ‘he/ai’ është pa asnjë dyshim kryefjala e fjalisë. Folja ndihmëse ‘will’ del përpara kryefjalës dhe kjo lëvizje është e domosdoshme.

Me shumë interes për sa i përket kryefjalës në gjuhën angleze janë fjalët ‘there’ dhe ‘it’. Përderisa në gjuhën angleze ‘there’ është kryefjala e fjalisë, në gjuhën shqipe kryefjala mund të mos shprehet. Përemri ‘it’ përdoret për situatat kur kemi të bëjmë me një përdorim joreferencial ose të zbrazët në aspektin semantik për shprehje të cilat lidhen me kohën, motin apo distancën dhe kjo në anglisht quhet ‘empty/prop subject’⁹⁸ ‘dummy subject’⁹⁹ apo kryefjalë e shprehur me

⁹⁸ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A comprehensive grammar of the English language”, Longman, 1985, f. 348.

fjalë ekspletive¹⁰⁰ ose siç do ta përdorim ne në këtë disertacion ‘*kryefjalë e zbrazët*’, term i cili përputhet me ‘*empty subject*’ të Kuirkut e që shprehet me përemrat ‘*there*’ ‘*here*’ ose ‘*it*’. Ka pasur mendime të ndryshme nga linguistët rreth asaj se a mund të llogaritet ‘*there*’ si kryefjalë e fjalisë ose jo. Sipas Jespersen, ‘*there*’ mund të sillet si kryefjalë e fjalisë dhe quhet ‘*kryefjalë më pak e theksuar*’ ose ‘*kryefjalë ekzistenciale*’¹⁰¹. Edhe pse këto nocione sugjerojnë se ai e konsideronte fjalën ‘*there*’ si kryefjalë ‘*reale*’, ai kishte dyshimet e tij nëse duhej të aplikohet ky nocion në konstruktin ekzistencial të kryefjalës. Përveç Jespersenit, për rolin e fjalës ‘*there*’ si kryefjalë në gjuhën angleze mendime kanë dhënë edhe Huddleston dhe Kuirk. Kur flitet për përcaktimin e kryefjalës, që të dy janë të mendimit se duhet të merret parasysh aspekti sintaksor në vend të atij semantik dhe se fjala ‘*there*’ është kryefjalë e fjalive ekzistenciale për shkak se përfshin pjesën kryesore të kodimit të kryefjalëve tipike në gjuhën angleze¹⁰². Pra, fjala ‘*there*’ sillet si kryefjalë për sa i përket pozicionit, inversionit, pyetjeve të tipit ‘*apo jo*’ (‘*She went, didn’t she?/Ajo iku, apo jo?*’) dhe foljeve këpujore (ang. *copular verbs* ose *linking verbs*) ‘*seem*’ dhe ‘*appear*’ dhe pjesa që gjendet përpara foljes ‘*be/jam*’ merr rolin e kryefjalës jo vetëm për shkak se është kandidati i vetëm për përcaktimin e rolit kryesor semantik, por edhe për shkak se mund të kontrollojë lidhjen kryefjalë-kallëzues¹⁰³. Si e tillë, fjala ‘*there*’ edhe nga ne në gjuhën angleze konsiderohet kryefjalë e fjalisë. P.sh.:

(40)

- a. ***There*** is hope./Ka shpresë.
- b. ***There*** are too many nice places./Ka shumë vende të mira.

Në fjalitë me këtë lloj kryefjale, numri i foljes nuk përcaktohet nga kryefjala por nga emri që ka pranë. Ky është njëri nga dallimet më të theksuara kur përkthehen fjalitë e këtij tipi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Dy shembujt e dhënë më poshtë në gjuhën shqipe, kur lexohen nuk tingëllojnë mirë. Prandaj, me kësaj lloj fjalish ndonjëherë nevojitet të bëhet përshtatje e përkthimit duke shkruar fjali si ‘*Një burrë dhe dy gra gjenden në rrugë.*’. Por kjo përshtatje shihet se ndikon drejtpërdrejt në rendin e gjymtyrëve të fjalisë, si dhe në funksionin e tyre.

⁹⁹ Downing, A. dhe Locke, Ph. ‘*English Grammar – A University Course Second Edition*’, Routledge, 2006, f. 44.

¹⁰⁰ Memushaj, R. ‘*Gjuhësia gjenerative*’, SHBLU, 2008, f. 170.

¹⁰¹ Jespersen, O. ‘*Analytic Syntax*’, University of Chicago Press, 1984, f. 130.

¹⁰² Huddleston, R. ‘*Introduction to the Grammar of English*’, Cambridge University Press, 1984, f. 68-72.

¹⁰³ Hannay, M. ‘*English Existentials in Functional Grammar*’, Walter De Gruyter Incorporated, 1985, f. 14-15.

Derisa jemi të përqendruar te këto dy shembuj, linguistët Hannay dhe Vester¹⁰⁴ japin dy shembuj të tjerë interesantë paralel për sa i përket numrit të kallëzuesit:

(41)

- a. *A man and two women are in the street./Një burrë dhe dy gra janë në rrugë.*
- b. *Two women and a man are in the street./Dy gra dhe një burrë janë në rrugë.*

Ajo çfarë mund të vërehet është se kemi dy dallime shumë të interesante në krahasim me dy shembujt paraprak me fjalën ‘there’. Si fillim, bëhet identifikimi i lehtë i kryefjalës dhe nuk ekziston dyshimi nëse kemi kryefjalë të plotë ose të zbrazët¹⁰⁵. Këtu bëhet fjalë për kryefjalë të plotë, ashtu siç është theksuar te shembujt. Dallimi i dytë është se kallëzuesi/folja në të dy rastet është në numrin shumës, për dallim nga shembujt me fjalën ‘there’ ku folja në njërin rast është në njëjës dhe në tjetrin në shumës. Për më tepër, duhet të analizojmë edhe shembujt vijues:

(42)

- a. *There was a man and a woman in the street./Ishte një burrë dhe një grua në rrugë.*
- b. *A man and a woman were in the street./Një burrë dhe një grua ishin në rrugë.*

Këtu përsëri na del një dallim tjetër kur përmenden dy emra në njëjës. Përderisa në fjalinë e parë (me kryefjalën ‘there’) kallëzuesi është në njëjës, fjalia e njëjtë por pa kryefjalën ‘there’ kallëzuesin e ka në shumës. Këtë e sqarojnë edhe Huddleston dhe Kuirk të cilët thonë se rregullat normale të lidhjes kryefjalë-kallëzues nuk vlejnë për konstruktionet me kryefjalën ‘there’, sepse folja në numrin njëjës shpesh përdoret edhe atëherë kur pjesa që vjen pas foljes ‘be/jam’ është shumës¹⁰⁶. Për ta përmbledhur këtë pjesë, Kuirk thekson se fjala ‘there’ në fjali ekzistenciale dallon nga fjala ‘there’ si ndajfolje në fillim të fjalisë me atë se i mungon theksi, nuk bart asnjë kuptim lokativ të ndajfoljes ‘there’ dhe se sillet në shumë raste si kryefjalë e sifjalisë¹⁰⁷, e që me

¹⁰⁴ Hannay, M. dhe Vester, E. ‘Working with Functional Grammar: Descriptive and Computational Applications’, Foris Publications, 1990, f. 75.

¹⁰⁵ Kryefjalë e plotë është kryefjala e shprehur me emër, ndërsa kryefjala e shprehur me ‘there’ ose ‘it’ është e zbrazët në aspektin semantik.

¹⁰⁶ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A comprehensive grammar of the English language”, Longman, 1985, f. 1405-1408.

¹⁰⁷ Po aty, f. 1405.

këtë kuptohet se ndryshon nga tipat themelore të fjalive të thjeshta në gjuhën angleze. Kuirk këtë e ilustron me tre shembuj:

(43)

- a. **There** are some people in the room./Ka disa njerëz në dhomë.
- b. Is **there** any more food? A ka më ushqim?
- c. There's nothing wrong, is **there**?/Gjithçka në rregull, apo jo?
- d. I don't want **there to be any misunderstanding**./Unë nuk dua të këtë mosmarrëveshje.
- e. He was disappointed at **there being so little to do**./Ai ishte zhgënjyer se nuk kishte shumë gjëra për të bërë.

Në shembullin e parë, fjala 'there' si kryefjalë nuk ndikon në numrin e foljes (numri varet nga emri që vjen pas foljes). Në shembullin e dytë dhe të tretë shërben si kryefjalë e pyetjeve 'po-jo' dhe të tipit 'apo jo' dhe në shembullin e tretë shërben si kryefjalë në sifjalitë me infinitiv dhe gerund¹⁰⁸.

Përderisa jemi ende te 'there', Kuirk ka dhënë dy shembuj mjaft interesant ku prania a mungesa e fjalës 'there' ndikon në atë se cila është kryefjala¹⁰⁹.

(44)

- a. In the garden {was} a **sundial**./Në oborr ishte **një orë dielli**.
- b. In the garden **there** was a sundial./Në oborr kishte **një orë dielli**.

Tani këtu kemi një situatë shumë interesante. Përderisa në gjuhën angleze në rastin e parë kryefjalë është fjala 'sundial/orë dielli', në rastin e dytë shtimi i fjalës 'there' bën që vetë ajo fjalë të jetë kryefjalë. Në gjuhën shqipe funksioni përcaktohet nga folja. Me foljen *jam* kryefjalë është *një orë dielli*, ndërsa me foljen *kam* nuk është kryefjalë por kundrinor i drejtë. Fjalja e dytë më lart është fjali njëkryegjymtyrëshe pavetore.

Kryefjala në gjuhën angleze mund të shprehet edhe me përemrin 'it/ai-ajo'. Por këtu bëhet fjalë për një lloj tjetër situatë e jo për situatë kur përemri 'it' zakonisht përdoret për të emëruar send apo kafshë. P.sh.:

(45)

- a. **It** is three o'clock./Ora është tre.

¹⁰⁸ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. "A comprehensive grammar of the English language", Longman, 1985, f. 1405.

¹⁰⁹ Po aty, f. 1410.

- b. *It is snowing./Po bie borë.*
- c. *It is 100 meters away./Është 100 metra larg.*

Ajo çfarë mund të vërehet është problemi i gjendjes së kryefjalës së barasvlershme në gjuhën shqipe. Më saktë, në rastin e parë fjala ‘*ora*’ zë vendin e kryefjalës, por që nuk reflekton realitetin me kryefjalën në gjuhën angleze sepse në realitet ora nuk është kryefjala e fjalisë. Në rastin e dytë dhe të tretë në gjuhën angleze kemi kryefjalë, ndërsa në gjuhën shqipe kemi fjali pa kryefjalë. E gjithë kjo ndodh për shkak të strukturës së gjuhës angleze dhe shqipe, ose më thjeshtë, gjuha angleze ka krijuar një kryefjalë të zbrazët për të mbuluar vendin e kryefjalës dhe për të plotësuar kushtin që fjalia dëftore duhet patjetër të ketë kryefjalë.

Lista se me çfarë shprehet kryefjala në gjuhën angleze nuk përfundon këtu. Megjithëse pjesa e përmendur më lart përfshin shumicën e rasteve me të cilat shprehet kryefjala, në gjuhën angleze ndodh rrallëherë që kryefjala të shprehet edhe me sintagmë parafjalore ose sintagmë ndajfolore¹¹⁰. Shembuj të tillë të rrallë, në veçanti shembuj me sintagmë ndajfoljore, janë:

(46)

- a. ***Under the bed** is the place where monsters hide./Poshtë krevatit është vendi ku fshihen përbindëshat.*
- b. ***By plane** costs less than by bus./Me aeroplan kushton më pak sesa me autobus.*
- c. ***Just here** would be the ideal place./Mu këtu do ishte vendi ideal.*

Në gjuhën angleze rol shumë të rëndësishëm për caktimin e kryefjalës luan edhe theksi se kush apo çfarë e bart kuptimin kryesor. Thuhet kështu pasi në rast se do të ndryshonte vendi i fjalëve në fjali dhe nëse do të riorganizohej fjalia e parë atëherë mund të fitonim kryefjalë tjetër (***The place where the monsters hide** is under the bed./Vendi ku fshihen përbindëshat është poshtë krevatit.*). Prandaj, këtu ndihmon edhe pohimi se vendi i fjalëve në fjali ka rend të fiksuar në gjuhën angleze dhe kjo na ndihmon në gjetjen e kryefjalës, si p.sh. ‘*Men eat fish./Burrat hanë peshk., Fish eat men./Peshqit hanë burra.*’. Ky shembull është shembull tipik me të cilin shihet se funksioni sintaksor në gjuhën angleze varet nga pozita e gjymtyrëve.

¹¹⁰ Aarts, B. “Oxford Modern English Grammar”, Oxford University Press, 2011, f. 97.

Një tip tjetër kryefjale në gjuhën angleze është edhe kryefjala e zbrazët e zhvendosur (extraposed subject¹¹¹). Bëhet fjalë për fjali e cila fillon me përemrin ‘it’ dhe kjo situatë paraqitet atëherë kur kryefjala është e gjatë dhe më e vështirë dhe është më mirë të zhvendoset në fund të fjalisë në pajtim me parimet informuese dhe stilitstike dhe kryefjala e tillë shpesh paraqitet si komplement apo në gjuhën shqipe kallëzuesor i emrit ose mbiemër në strukturën kryefjalë-kallëzues-komplement¹¹². Foljet që zakonisht përdoret në këtë tip fjalish janë ‘be/jam’ dhe foljet këpujore ‘seem, appear/duket’. Por ajo çfarë është më e rëndësishme me këtë lloj fjalish është se në gjuhën angleze fjalia ka kryefjalë (kryefjala normale dhe kryefjala e zhvendosur¹¹³).

(47)

- a. *It is easy to pass the exam.* => *To pass the exam is easy.* / Është lehtë të kalosh provimin. / Të kalosh provimin është lehtë.
- b. *It seems that you were wrong.* => **That you were wrong seems.* / Duket që ishe gabim. Që ishe gabim, duket.

Përderisa zhvendosja e kryefjalës normale është e lehtë të realizohet kur përdoret folja ‘be/jam’, situata komplikohet në rastin e dytë me foljet këpujore pasi që nuk mund të formohet fjali gramatikore në gjuhën angleze. Në gjuhën angleze një zhvendosje e tillë jo që është reale, por edhe e domosdoshme pasi fjalia pa kryefjalë të zhvendosur nuk është fjali e saktë në aspektin sintaksor. Në gjuhën shqipe nuk lëviz kryefjala, por ajo shprehet me sifjali të varur. Dallimi këtu është se në gjuhën angleze pas analizës sintaksore kemi dy kryefjalë (*it+to pass the exam; it+that you were wrong*), për dallim nga gjuha shqipe ku kemi një kryefjalë të shprehur me sifjali kryefjalore.

¹¹¹ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A comprehensive grammar of the English language”, Longman, 1985, f. 1391.

¹¹² Downing, A. dhe Locke, Ph. ‘English Grammar – A University Course Second Edition’, Routledge, 2006, f. 47.

¹¹³ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A comprehensive grammar of the English language”, Longman, 1985, f. 1391.

2.6. Kallëzuesi në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze

2.6.1. Kallëzuesi në gjuhën shqipe

Krahas kryefjalës, kallëzuesi zë vendin kryesor në fjali. Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore dhe si i tillë luan rol kryesor në fjali dhe me kryefjalën kanë lidhje të pandashme. Kallëzuesi është gjymtyra kryesore foljore e fjalisë dykryegjymtyrëshe që hyn në marrëdhënie e në lidhje kallëzuesore me kryefjalën dhe shprehet me folje, me foljen *jam*, të shoqëruar nga një emër, mbiemër, përemër a me numëror, ose edhe me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës¹¹⁴. Në gramatikën e Akademisë së Shkencave kallëzuesi është tri llojesh: 1) kallëzues foljor (i shprehur me folje dhe tregon veprim a gjendje që i referohet kryefjalës), 2) kallëzues emëror (i shprehur me foljen *jam* dhe me një emër, mbiemër, përemër a numëror dhe tregon një karakteristikë që i referohet kryefjalës) dhe 3) kallëzues i shprehur me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës (pjesëza, pasthirrma ose onomatope dhe jep idenë e një veprimi ose bën vlerësimin subjektiv-emocional të kryefjalës)¹¹⁵. Sqarim të njëjtë jep edhe Çeliku sipas të cilit kallëzuesi është përbërësi foljor i fjalisë dykryepërbërëse që hyn në marrëdhënie kallëzuesore me kryefjalën dhe që shprehet me shprehje të shtjelluar; është gjithnjë në lidhje me kryefjalën me të cilën bashkëpërshtatet në vetë e numër; sipas natyrës semantike të foljes, kërkon në fjali të plotësohet semantikisht, përveç kryefjalës, edhe nga përbërës të tjerë të domosdoshëm, si: kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë, kundrinor me parafjalë, kallëzuesor dhe rrethanorë; në fjalitë dëftore qëndron zakonisht pas kryefjalës; shpesh përputhet me remën e thënies dhe me predikatin logjik¹¹⁶. Nga vetë përkufizimi i dhënë është e qartë se kallëzuesi shprehet me folje, por edhe me pjesë të tjera të ligjëratës kur është kallëzues emëror dhe me pjesëza e pasthirrma.. Çeliku vazhdon më tutje me një ndarje të përmblendhur të llojeve të kallëzuesit: 1) kallëzues foljorë të thjeshtë, 2) kallëzues foljorë të përbërë dhe 3) kallëzues emëror¹¹⁷.

¹¹⁴ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 173.

¹¹⁵ Po aty, f. 173.

¹¹⁶ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 26.

¹¹⁷ Po aty, f. 146.

(48)

- a. Ne **ikëm**./We **left**. (kallëzues foljor i thjeshtë)
- b. Nxënësi **mbaroi së lexuari** librin./The student **finished reading** the book.
(kallëzues foljor i përbërë)
- c. Qielli **është i shndritshëm**./*The sky **is bright**. (kallëzues emëror)

Kallëzuesit foljorë të thjeshtë shprehen me folje të shtjelluar ose shprehje foljore që tregojnë mënyrën, vetën, numrin, kohën dhe aspektin dhe mund të shprehen me të gjitha mënyrat e foljes dhe me të gjitha format kohore dhe diatezore të saj, të thjeshta apo të përbëra¹¹⁸. Këtu shembujt janë të pafund, meqenëse mundësitë janë të gjëra për shkak të kohëve, diatezave dhe mënyrave të foljeve. P.sh.: Ai **ishte** në Tiranë./He **was** in Tirana. Joni **flet** edhe anglisht./Jon also **speaks** English.

Kallëzuesit foljorë të thjeshtë të ndërlkuar, të cilët në gramatikat tradicionale konsiderohen si një kallëzues, paraqesin një nënndarje më vete. Sipas Çelikut, bëhet fjalë për përsëritje të së njëjtës folje apo me bashkim të dy foljeve sinonimike a antonimike dhe elementet e këtyre përbërësve lidhen zakonisht me bashkërenditje apo me lidhëza¹¹⁹. P.sh.: Ai **qau e qau**./He **cried and cried**.

Kallëzuesit foljorë të përbërë shprehen me dy folje nga të cilat e para është një folje modale ose aspektore dhe e dyta një folje leksikore dhe ky lloj kallëzuesi mund të jetë kallëzues foljor i përbërë aspektor dhe kallëzues foljor i përbërë modal¹²⁰. P.sh.: Lojtarët **filluan të merrnin** çmimet./The players **started to receive** the prizes. Ai **mund të vdiste**./He **could die**.

Kallëzuesit emërorë zënë vend shumë të rëndësishëm sepse, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze, janë shumë të rëndësishëm, por me një dallim shumë domethënës. Në gjuhën shqipe flitet për kallëzues emëror, ndërsa në gjuhën angleze bëhet fjalë për plotësor apo komplement i kryefjalës (ang. subject complement). P.sh. Dita **ishte e ftohtë**./It **was cold**. Gramatikat në gjuhën angleze e kanë futur në përdorim termin *complement (plotësor)* dhe në këtë rast fjala *cold* llogaritet si plotësor, e që në krahasim me gjuhën shqipe është pothuajse e njëjta gjë. Themi kështu se në të dyja gjuhët folja këpujore e kryen rolin e saj dhe krijohet lidhja në formë ure e kryefjalës dhe kallëzuesorit/plotësorit (komplementit). Kallëzuesi emëror përbëhet nga dy pjesë: folje këpujë + mbiemër a emër, përemër, numëror, ndajfolje, folje

¹¹⁸ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 146.

¹¹⁹ Po aty, f. 150.

¹²⁰ Po aty, f. 153.

(paskajore), shprehje frazeologjike a sifjali dhe zakonisht tregojnë cilësi dhe gjendje të kryefjalës a të kundrinorit dhe pjesa e dytë (plotësori i foljes këpujë) funksionon si plotësor i foljeve, e për dallim nga kundrinorët ata marrin pjesë në ngjizjen semantike të kryepërbërësit kallëzues, ndërsa kundrinorët e konkretizojnë semantikën e foljes në një thënie të caktuar duke kufizuar kuptimin e gjerë të foljes¹²¹. Folja *jam* është folja e parë që secilit i bie në mend kur flitet për foljet këpujore, por edhe folje të tjera mund të quhen folje këpujore, si foljet *bëhem*, *dukem*, *quhem*, *emërohem* etj. P.sh.: *Fëmijët janë të mençur./The children are smart.. Ajo quhet Jonida./She is called Jonida. Nxënësit duken të lodhur./The students seem tired.* Por, këtu është shumë e rëndësishme të jepet një krahasim shumë domethënës:

(49)

- a. *Ai është president./He is president.* (plotësor/përcaktor kallëzuesor i kryefjalës = kallëzues emëror)
- b. *Ata e bënë atë president./They made him president.* (kundrinor + plotësor/përcaktor kallëzuesor i kundrinorit = *kallëzues emëror në gjuhën shqipe ose plotësor/përcaktor kallëzuesor në gjuhën angleze)

Për sa i përket shembullit të parë më lart, në gjuhën shqipe fjala *president* llogaritet pa asnjë dyshim si kallëzues emëror, por në gjuhën angleze ekziston termi *komplement i kryefjalës* (ang. subject complement) i cili në fakt paraqet të njëjtën gjë si në gjuhën angleze dhe gjatë analizës sintaksore bëhet ndarja e njëjtë e gjymtyrëve në të dyja gjuhët. Në shembullin e dytë kemi një situatë më ndryshe për shkak të qëndrimeve të ndryshme të gjuhëtarëve në gjuhën shqipe. Fjala *president* në gjuhën angleze është plotësor i kundrinorit, jo i kryefjalës, prandaj i njëjti është përcaktor kallëzuesor. Në gjuhën shqipe, sipas Gramatikës së Akademisë, fjala e njëjtë është përcaktor kallëzuesor (i kundrinorit), ndërsa sipas Çelikut vetëm kallëzues emëror pasi ai nuk e njeh përcaktorin kallëzuesor. Çeliku të dy rastet më lart i konsideron kallëzues emëror për shkak se përbëhen nga folje këpujë + plotësor dhe nuk bën ndarjen e njëjtë siç bëhet në gjuhën angleze duke qenë se në gjuhën angleze del qartë plotësori i kryefjalës dhe plotësori i kundrinorit. Term tjetër i përmendur nga Çeliku është sifjali kallëzuesor¹²² (ang. [subject] complement clause) ku në gjuhën shqipe ajo njihet si plotësor i foljes këpujore:

¹²¹ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 155-156.

¹²² Po aty, f. 156.

(50) *Çështja është se ke humbur./The point is that you have lost.* (jam + sifjali kallëzuesore)

Kallëzuesit e shprehur pa përbërës sintaksorë vetëm me një pjesëz pohuese a mohuese ose një pasthirrmë mund të gjenden në dialogë, pyetje, fjali dyshe dhe sifjali të periudhave me bashkërenditje¹²³. Ky lloj kallëzuesi nuk është edhe aq i rrallë në gjuhën shqipe, p.sh.: *Kush do largohet? Unë jo./Who will leave? Not me.*

Folja/kallëzuesi me kryefjalën përshtaten **në vetë dhe numër** (folja ose folja këpujë merr vetën dhe numrin e kryefjalës kur ajo shprehet me përemër vetor), folja ose folja këpujë vihet në vetën e tretë dhe përshtatet në numër kur kryefjala shprehet me një emër a përemër dëftor, emrat përmbledhës e marrin foljen në njëjës, por edhe në shumës, folja vihet në shumës me kryefjalë homogjene dhe në **gjini** (kallëzuesori, i shprehur me mbiemër a emër, merr gjininë e kryefjalës)¹²⁴. Këtu shkurtimisht u përmend në pika të shkurtra përshtatja e kryefjalës me kallëzuesin, por në kreun vijues përshtatja analizohet me më shumë detaje.

Edhe pse kategorizimi i foljeve sipas kohëve dhe mënyrave është i rëndësishëm, këtu për hir të hapësirës nuk do të futemi në shumë detaje. Por është shumë e rëndësishme që këtu të përmendim valencën e foljes dhe diatezën si elemente shumë të rëndësishëm për këtë studim.

Valenca e foljeve – Në gjuhën shqipe, në bazë të valencave (numrit të argumenteve të ndryshme që shoqërojnë një folje) ekzistojnë katër klasa foljesh: zerovalente, njëvalente, dyvalente dhe trevalente¹²⁵. Nga vetë termat e përmendur lehtë nënkuptohet numri i argumenteve që shoqërojnë një folje. Pra, foljet zerovalente nuk shoqërohen me asnjë argument, foljet njëvalente me një argument (emër ose grup emëror) e kryefjala e pjesës së nënrenditur del para për arsye kumtuese, foljet dyvalente me dy argumente (emra, përemra, grupe emërore, sifjali ose kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë) dhe foljet trevalente me tre argumente (emër, grup emëror, frazë, sifjali)¹²⁶. Shembujt vijues janë dhënë për ta pasur më të qartë këtë ndarje:

0 valente: *Flet./Talks.*

I valente: *Ai ecën./He walks.*

II valente: *Joni sheh lojën./Jon watches the game.*

III valente: *Jonida i dha një dhuratë vëllait./Jonida gave her brother a gift.*

¹²³ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 160.

¹²⁴ Po aty, f. 160-161.

¹²⁵ Dhima, Th. ‘Gjuha shqipe – Sintaksa’, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 19.

¹²⁶ Po aty, f. 20.

Klasat e foljeve zerovalente, njëvalente, dyvalente dhe trevalente ngjajnë me foljet që në gramatikën e gjuhës shqipe quhen pavetore, jokalimtare dhe kalimtare. Kjo vlen pjesërisht pasi që kriteret e klasifikimit janë të ndryshme dhe klasifikimi tradicional i foljeve nuk përputhet me klasifikimin sipas valencës. Në gramatikën tradicionale nuk ekziston një klasë që korrespondon me foljet trevalente, të cilat në përgjithësi lidhen me kalimtare¹²⁷. Prandaj, klasifikimi sipas valencës është unik dhe formal sintaksor.

Foljet trevalente kanë rëndësi të veçantë për sa i përket fjalisë së thjeshtë (dëftore), ku edhe përqendrimi kryesor është në fjalinë dëftore, për shkak se në fjali kemi kundrinor të drejtë dhe kundrinor të zhdrejtë dhe kundrinori është drejtpërdrejt i lidhur me rendin e fjalëve në fjali. Në shembujt e dhënë më lart mund të shihet se një dallim i vogël në përkthim paraqitet vetëm me foljen trevalente. Rendi i fiksuar i fjalëve në fjali në gjuhën angleze kërkon që kundrinori i zhdrejtë të qëndrojë përpara atij të drejtë (në fjalitë ku ka dy kundrinorë), ndërsa në gjuhën shqipe fjalët *një dhuratë* dhe *vëllaut* mund të ndryshojnë vendet pa asnjë problem. Ndërsa nëse një gjë e tillë do të bëhej në gjuhën angleze, atëherë do të duhej të shtohet parafjala *to* dhe fjalia do të merrte formën: *Jonida gave a gift to her brother*. Ky është një dallim mjaft domethënës kur krahasohet gjuha shqipe me gjuhën angleze, por njëkohësisht është edhe dallim sipërfaqësor i cili nuk krijon vështirësi të tjera në përkthimin e fjalisë.

Diateza e foljeve – Diateza e foljeve, përveç valencës, zë vend shumë të rëndësishëm për sa i përket kallëzuesit për shkak të ndryshimit të vendit të gjymtyrëve në fjali gjatë transformimit të fjalive nga diateza veprorë në diatezën pësore. Me anë të kategorisë gramatikore të diatezës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe kryefjalës dhe diatezë kanë ato folje që kanë mundësi të përdoren në diatezën veprorë dhe joveprorë¹²⁸. Në gjuhën shqipe ekzistojnë katër lloje të diatezës: 1) diateza veprorë, 2) diateza pësore, 3) diateza vetvetore dhe 4) diateza mesore. P.sh.:

(51)

- a. *Unë fillova punën./I started work.* (diateza veprorë)
- b. *Biçikleta është blerë nga Joni./The bike was bought by Jon.* (diateza pësore)

¹²⁷ Dhima, Th. 'Gjuha shqipe – Sintaksa', SHBLU, Tiranë, 2005, f. 20.

¹²⁸ Akademia e Shkencave, "Gramatika e gjuhës shqipe 1", Tiranë, 2002, f. 270.

c. *Aparati i kafes ishte prishur./The coffee machine was ruined.*(diateza vetvetore/pësore)

d. *Ai u përpoq të ecë./He tried to walk.* (diateza mesore/veprore)

Në ndryshim nga gjuha shqipe, që sipas shembujve të dhënë, njeh katër diateza, në gjuhën angleze njihen vetëm diateza vepore dhe pësore. Në gjuhën angleze mbetet i diskutueshëm pranimi i diatezës vetvetore sepse modeli “folje kalimtare + përemër vetvetor” dallon nga modeli i formës analitike dhe ky model nuk formon paradigmë, sepse nuk prezanton asgjë ndryshe nga diateza vepore si në aspektin strukturor ashtu edhe atë semantik¹²⁹. Diateza lidhet me mënyrën e shprehjes së veprimit nga folja, d.m.th. kush e kryen veprimin dhe mbi kë bie veprimi dhe nuk përcaktohet nga gjymtyrët.

Dallimi shumë i rëndësishëm na paraqitet me diatezën mesore, diatezë e cila në gjuhën angleze nuk ekziston dhe kjo është sqaruar më poshtë kur flasim për kallëzuesin në gjuhën angleze. Duke qenë se në shembullin më lart (51/d) foljen e kemi në diatezën mesore, në përkthimin në gjuhën angleze folja është në diatezën vepore dhe *to walk* në këtë rast është kundrinor. Por në raste të tjera një fjali në diatezën mesore mund të krijojë edhe situatë tjetër. P.sh.: *Ai u tremb./He got scared*. Në këtë rast, në gjuhën shqipe kemi folje në diatezën mesore, ndërsa në gjuhën angleze kemi diatezë pësore me foljen *get*. Diateza pësore me *get* në gjuhën angleze del kryesisht në përdorimin joformal të gjuhës dhe ka shpeshtësi më të kufizuar sesa folja *be/jam*¹³⁰. Këto dallime janë mjaft të rëndësishme kur fjalitë përkthehen nga njëra gjuhë në tjetrën.

Duhet theksuar se për të pasur diatezë pësore, folja duhet të jetë folje kalimtare sepse përndryshe nuk do mund të ndryshonim foljen nga diateza vepore në pësore, apo mesore dhe vetvetore (në gjuhën shqipe). Është e rëndësishme të dihet roli që gjymtyrët marrin pas transformimit të fjalisë nga diateza vepore në pësore.

(52)

a. *Joni ka blerë biçikletë./Biçikleta është blerë nga Joni.* (diateza vepore)

b. *Jon has bought a bike./A bike has been bought by Jon.* (diateza pësore)

Si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze mund të shohim se arrihet transformimi i njëjtë dhe gjymtyrët ndryshojnë vendet në mënyrë të njëjtë. Rolet sintaksore ndryshojnë si në

¹²⁹ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 1”, Tiranë, 2002, f. 127.

¹³⁰ Eastwood, J. ‘Oxford Guide to English Grammar’, Oxford University Press, 1994, f. 136.

gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze, kryefjala bëhet kundrinor dhe kundrinori bëhet kryefjalë.

2.6.2. Kallëzuesi në gjuhën angleze

Pas kryefjalës, kallëzuesi është gjymtyra më e rëndësishme në gjuhën angleze. Është shumë e rëndësishme të theksohet se në gjuhën angleze në të gjithë modelet themelore të fjalive të thjeshta fjalia përbëhet nga kryefjala dhe kallëzuesi. Si i tillë, kallëzuesi me kryefjalën kanë lidhje të pandarë dhe ai drejtpërdrejt ndikohet nga kryefjala. Kallëzuesi në gjuhën angleze gjithmonë shprehet me folje¹³¹ (kalimtare ose jokalimtare) apo frazë foljore dhe folja mund të jetë folje leksikore ose kombinim me folje ndihmëse dhe leksikore. Folja/kallëzuesi është elementi më ‘qendror’ dhe ajo mund të qëndrojë pa element plotësues përveç kryefjalës, ose mund të plotësohet me një ose dy kundrinorë, plotësorë dhe/ose rrethanor i cili është elementi më periferik (mund të lëvizë/ndryshojë vendin në fjali)¹³². Përveç kësaj, folja/kallëzuesi është gjymtyrë domosdoshme, nuk mund të vendoset në pozitë tjetër të fjalisë dhe ndihmon për të përcaktuar numrin e elementëve të tjerë¹³³. Për më tepër, në krahasim me kryefjalën, e cila mund edhe të mungojë në fjalinë urdhërore, kallëzuesi është i domosdoshëm dhe pa kallëzues nuk mund të kemi fjali urdhërore.

Në gjuhën angleze kallëzuesi mund të shprehë tre kuptime gramatikore: 1) veprim (me folje kalimtare (*buy, break*), jokalimtare (*rain, walk*) ose këpujore [ang. linking verb]) (*be, become, appear*) sipas modeleve: a) *kallëzues-folje kalimtare-frazë foljore e dytë*, b) *kallëzues-folje jokalimtare-plotësor* dhe c) *kallëzues-folje këpujore-plotësor*; 2) përshkrim sipas modelit *kallëzues-folje këpujore-plotësor*; 3) identifikim sipas modelit *kallëzues-folje këpujore-plotësor*¹³⁴.

¹³¹ Van Gelderen, E. ‘*An Introduction to the Grammar of English – Revised Edition*’, 2010, John Benjamins Publishing Company, f. 66.

¹³² Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “*A comprehensive grammar of the English language*”, Longman, London & New York, 1985, f. 50.

¹³³ Po aty, f. 50.

¹³⁴ O’Dwyer, B. T. ‘*Modern English Structures – Form, Function and Position (Second Edition)*’, Broadview Press, 2006, f. 159-160.

Kategoritë gramatikore të foljes janë një fushë e gjerë për ta diskutuar, por këtu përmenden disa nga më të rëndësishmet dhe që lidhen drejtpërdrejt me interesin tonë. Folja në gjuhën angleze ka kategoritë gramatikore vijuese: kohën, aspektin, mënyrën, diatezën, vetën, dhe numrin¹³⁵. Koha dhe aspekti nuk janë aq të rëndësishme për ne aq sa janë mënyra, diateza, veta, numri, kalueshmëria dhe valenca e foljeve. Themi kështu se të gjitha këto elemente që u përmenden ndikojnë në lidhjen e kryefjalës dhe kallëzuesit, ose kallëzuesit dhe kundrinorit.

Mënyra e foljeve – Në gjuhën angleze folja ka dy mënyra dhe atë: dëftore dhe lidhore; në gjuhën angleze moderne mënyra lidhore përdoret vetëm në raste speciale dhe si nënklasë e mënyrës lidhore ka mbetur vetëm mënyra urdhërore¹³⁶ dhe si rezultat tani ekziston mënyra dëftore dhe urdhërore, por pa e përjashtuar edhe atë lidhore. Mënyra urdhërore funksionon njësoj si në gjuhën shqipe pasi në të dyja gjuhët mund të mos shprehet kryefjala dhe fjalia fillon vetëm me foljen.

(53)

- a. *I work./Unë punoj.* (mënyra dëftore)
- b. *It is essential that he is released./Është thelbësore që ai të lëshohet.*
(mënyra lidhore)
- c. *Go there!/Shko atje!* (mënyra urdhërore)

Kur folja është në mënyrën lidhore, atëherë ndodh që të kemi mospërputhje të numrit të kryefjalës dhe të kallëzuesit, si në fjalinë:

(54) *I wish I were at the spot./Dëshiroj të isha në vend.*

Diateza e foljeve – Qëllimi i diatezës si në gjuhën angleze, ashtu edhe në çdo gjuhë tjetër, është për të treguar nëse kryerësi i veprimit është ndikuar nga veprimi ose e ka pësuar veprimin. Prandaj, në gjuhën angleze njihen vetëm dy lloj diatezash, në krahasim me gjuhën shqipe ku ekzistonin katër lloj diatezash. Gjuha angleze njih diatezën veprorë dhe pësorë, por në raste të rralla përmendet edhe diateza vetvetore¹³⁷ (ang. *middle voice* ose ndonjëherë e quajtur *reflexive voice* – edhe pse *middle voice* në përkthim shkon me *diatezë mesore*, në gjuhën angleze nuk flitet për mesore, por flitet për vetvetore, siç është ilustruar më poshtë te shembujt). Problemi i diatezës vetvetore është ende i diskutueshëm, pasi modeli ‘folje kalimtare + përemër vetvetor’

¹³⁵ Iriskulov, A. T. ‘*Theoretical Grammar of English*’, Tashkent, 2006, f.29.

¹³⁶ Brinton, L. J. ‘*The Structure of Modern English – A Linguistic Introduction*’, John Benjamins Publishing Company, 2000, f. 116.

¹³⁷ Po aty, f. 117.

dallon nga modeli i formës analitike, karakteristikë e formave të kohëve të foljes ose diatezës pësore dhe kështu nuk është çdoherë e mundur të bëhet dallimi i qartë midis konstruksioneve vetvetore dhe kombinimeve të lira të fjalëve¹³⁸ dhe kjo paraqet problem për gjuhëtarët që të diateza vetvetore të llogaritet si diatezë e pranuar gjerësisht.

Diateza pësore në gjuhën angleze bëhet me foljen *be/jam* + *pjesoren/past participle*, kurse forma e foljes në atë vetvetore nuk merr ndonjë formë ndryshe si në gjuhën angleze ashtu edhe në gjuhën shqipe.

(55)

- a. *I left home./Unë ika nga shtëpia.* (veprore)
- b. *The bike was stolen (by Ben)./Biçikleta ishte vjedhur (nga Beni).* (pësore)
- c. *Jack hurt himself./Xheku lëndoi veten.* (vetvetore)

Për të pasur diatezë pësore, fjalia patjetër duhet të përbëhet nga folje kalimtare (e përshkruar më poshtë). Ajo çfarë ndodh gjatë transformimit të fjalisë nga diateza vepore në diatezën pësore është ndryshimi i roleve sintaksore të kryefjalës dhe kundrinorit. Në fjalitë e thjeshta transformimi nga diateza vepore në diatezën pësore bën që kryefjala të bëhet agjent, ndërsa kundrinori të bëhet kryefjalë¹³⁹. Madje, në fjalitë ku ka dy kundrinorë, mund të ndodhë që të dy kundrinorët në fjali të veçanta të luajnë rolin e kryefjalës. P.sh.:

(56)

- a. *The boy saw the crash. Djali pa aksidentin.* (Kryefjalë-kallëzues-kundrinor)
- b. *The crash was seen by the boy. Aksidenti u pa nga djali.* (Kryefjalë-kallëzues_{pësore}-agjent)
- c. *She gave me this gift./Ajo ma dha mua këtë dhuratë.* (Kryefjalë-kallëzues-kundrinor i zhdrejtë-kundrinor i drejtë)
- d. *I was given this gift by her./Mua më ishte dhënë kjo dhuratë nga ajo.* (Kryefjalë-kallëzues_{pësore}-kundrinor i drejtë-agjent)
- e. *This gift was given (to) me by her./Kjo dhuratë mua më ishte dhënë nga ajo.* (Kryefjalë-kallëzues_{pësore}-kundrinor i zhdrejtë-agjent)

¹³⁸ Alexeyeva, I. 'Theoretical English Grammar Course', NK Publishers, 2007, f. 127.

¹³⁹ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. "A comprehensive grammar of the English language", Longman, 1985, f. 57-58.

Vlen të theksohet se trajtat e shkurtra *ma* dhe *më* në gjuhën shqipe nuk konsiderohen kundrinorë, por thjeshtë janë caktuesorë të foljes, siç është sqaruar më poshtë.

Valenca dhe kalueshmëria e foljeve – Në gjuhësi ka ekzistuar dhe ende vazhdon përcaktimi i limitit të termit valencë dhe kalueshmëri e foljes. Valenca e foljeve dhe prejardhja e termit valencë është përmendur më lart dhe e njëjta vlen edhe për gjuhën angleze, por ajo çfarë është me rëndësi të përmendet këtu është krahasimi i valencës dhe kalueshmërisë. Problemi qëndron në atë se si njëri term, ashtu edhe termi tjetër ndërhyjnë në punën e njëri-tjetrit. Themi kështu se valenca e foljes përcakton numrin e argumenteve me të cilët plotësohet fjalia, por edhe kalueshmëria e foljes faktikisht tregon gjënë e njëjtë. Në dy dekadat e fundit, sipas Hopper dhe Thompson, kalueshmëria ka kaluar në një kategori më të rëndësishme duke bashkëvepruar me shumë faktorë funksionalë të cilët veten e manifestojnë si ‘alternime kalueshmërie (ang. transitivity alternations)¹⁴⁰’ por më në fund të dy nocionet janë të përafërt, por jo të njëjtë. Në gjuhën shqipe përdoren termat folje kalimtare dhe jokalistare.

Në gjuhën angleze ekzistojnë katër lloj valencash njëjtë duke u bazuar te Tesnier, njëjtë si në gjuhën shqipe, por këtu rëndësi të madhe ka më shumë kalueshmëria e foljeve sesa valenca e tyre për shkak se janë terma të përafërt dhe ndërhyjnë në fushën e njëri-tjetrit. Për sa i përket kalueshmërisë së foljeve, në gjuhën angleze ekzistojnë folje kalimtare dhe jokalistare¹⁴¹. Dallimi i tyre është i lehtë pasi foljet kalimtare kërkojnë kundrinor për të plotësuar kuptimin e fjalisë dhe një folje kalimtare pa kundrinor nuk do të ishte e plotë. Foljet jokalistare nuk kanë nevojë të plotësohen me argument tjetër dhe në fjali mund të qëndrojnë vetëm me kryefjalën.

(57)

- a. *I cut my finger./Unë preva gishtin tim.* (folje kalimtare)
- b. *She fainted./I ra të fikët.* (folje jokalistare)

Është mjaft e rëndësishme të thuhet se për të pasur diatezë pësore folja duhet patjetër të jetë kalimtare. Me folje jokalistare nuk mund të përftohet diatezë pësore sepseveprimi nuk bie në argument. Karakteristikë tjetër e foljeve është se e njëjta folje mund të jetë edhe kalimtare, edhe jokalistare, varësisht nga kuptimi i fjalisë. P.sh.:

¹⁴⁰ Kulikov, L., Malchukov, A. dhe De Swart, P. ‘Case, Valency and Transitivity’, John Benjamins Publishing Company, 2006, f. 7.

¹⁴¹ Altenberg, E. P. dhe Vago, R. M. ‘English Grammar: Understanding the Basics’, Cambridge University Press, 2010, f. 35.

(58)

- a. *I stopped the car. //Unë e ndala makinën.* (kalimtare)
- b. *The car stopped./ Makina ndaloi.* (jokalimtare)

Ajo çfarë mund të shihet nga përkthimi i shembujve të mësipërm është se nuk kemi ndonjë dallim në strukturën e fjalisë në të dy gjuhët kur kemi fjali të thjeshta. Dallime ekzistojnë në kategoritë gramatikore të foljeve të gjuhës shqipe dhe angleze, në veçanti të mënyra dhe diateza të foljeve. Në gjuhën shqipe nuk kemi diskutuar për mënyrat e foljes për shkak të numrit më të madh të tyre, përkatësisht gjashtë mënyrave, ndërsa në gjuhën angleze siç u përmend më lart ekzistojnë tre mënyra të foljes. Diateza mesore paraqet dallimin tjetër për sa u përket kategorive gramatikore të foljeve në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Kjo tregon se në raste të caktuara dallimet e kategorive gramatikore mund të kenë ndikim edhe në strukturën e fjalisë.

2.7. Kundrinori dhe llojet e kundrinorit në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze

2.7.1. Kundrinori në gjuhën shqipe

Elementi i tretë themelor me interes për këtë studim pas kryefjalës dhe kallëzuesit (si gjymtyrë kryesore) është kundrinori (ang. object) – gjymtyrë e dytë e cila plotëson fjalinë e thjeshtë. Kundrinori është gjymtyrë e fjalisë që vihet në marrëdhënie kundrinore dhe që lidhet me lidhje nënrenditëse drejtimi me gjymtyrën prej së cilës varet, por edhe mund të mos e tregojë objektin e veprimit¹⁴². Në gjuhën shqipe njihet kundrinori i drejtë (ang. direct object) dhe kundrinori i zhdrejtë (ang. indirect object), ku: a) kundrinori është i drejtë kur nga kundrinor i ndërtimeve veprore mund të kthehet në kryefjalë të ndërtimeve joveprore dhe b) kundrinori është i zhdrejtë kur ky kthim nuk mund të bëhet dhe ky tip kundrinori del në dy forma (pa parafjalë dhe me parafjalë)¹⁴³.

Çeliku ka bërë një përmbledhje të përbërësve sintaksorë me të cilët mund të shprehet kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë:

¹⁴² Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 251

¹⁴³ Po aty, f. 251

Kundrinori i drejtë – shprehet me emër a përemër në rasën kallëzore pa parafjalë dhe tregon objektin e veprimit që ndikohet direkt nga veprimi i foljes, shprehet me rasën kallëzore pa parafjalë dhe varet drejtpërdrejt nga përbërësi foljor i shprehur me folje veprorë kalimtare. Kundrinori i drejtë mund të shprehet me: a) emër të shquar, b) emër të pashquar, c) përemër-emër dhe ç) përbërës emëror të thjeshtë të zgjeruar¹⁴⁴.

(59) *Ata pushtuan qytetin./They conquered the city.*

Kundrinori i zhdrejtë – ka përdorim të gjerë dhe të larmishëm si në kuptim ashtu edhe në formë.

(60) *Familjes i sollën kufomën./The corpse was brought to the family.*

Kundrinori i zhdrejtë ndahet në:

1) **Kundrinor i zhdrejtë i rasës dhanore (pa parafjalë)** shpesh shënon person dhe shprehet me: a) emra të shquar a të pashquar, b) emër-përemër dhe c) përbërës emëror i thjeshtë i zgjeruar¹⁴⁵;

(61) *Nxënësja i dha dhuratë mësueses./The student gave the teacher a gift.*

2) **Kundrinor i zhdrejtë me parafjalë** përbëhen nga një parafjalë dhe nga një përbërës emëror a përemëror në rasë emërore, kallëzore, dhanore a rrjedhore dhe shprehet me përbërës të thjeshtë, të thjeshtë të zgjeruar dhe të zbërthyesëm¹⁴⁶.

(62) *Uji përbëhet nga hidrogjeni dhe oksigjeni./Water consists of hydrogen and oxygen.*

Fjali me dy kundrinorë (të drejtë dhe të zhdrejtë):

(63) *Unë Jonit i bleva biçikletë./I bought Jon a bike.*

Në rastin me fjalinë ku kemi kundrinor të zhdrejtë, rendi i lirë i fjalëve në fjali lejon që fjala *familjes* të qëndrojë në fillim të fjalisë, ndërsa një gjë e tillë nuk është e mundur në gjuhën angleze dhe ky paraqet një dallim të rëndësishëm për sa i përket pozicionit të kundrinorit të zhdrejtë në fjali. Në shembullin e fundit na del në pah trajta e shkurtër ‘i’ si pjesë e pandashme e kundrinorit të zhdrejtë. Rendi i lirë i fjalëve në fjali lejon që fjala *Jonit* të lëvizë dhe mund të jetë edhe pas foljes (*Unë i bleva Jonit biçikletë*) dhe të ketë formë të ngjashme si në gjuhën angleze. Kjo është shumë e rëndësishme për ta përcaktuar pasi ndikon në rendin e fjalëve në fjali dhe analizën sintaksore kur kemi të njëjtnë fjali të përkthyer në njërën apo gjuhën tjetër. Përderisa

¹⁴⁴ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 162-166.

¹⁴⁵ Po aty, f. 167-168.

¹⁴⁶ Po aty, f. 171.

kundrinori i zhdrejtë në gjuhën shqipe mund të lëvizë pa ndonjë vështirësi, në gjuhën angleze ai mund të lëvizë vetëm para ose pas kundrinorit të drejtë, por një lëvizje e tillë ndryshon strukturën e fjalisë pasi që shton ose largon një parafjalë, si p.sh. *I bought **Jon** a bike./I bought a bike **to Jon***. Dallim tjetër është se në rastet kur kemi kundrinor të zhdrejtë me dhe pa parafjalë në gjuhën shqipe (*mësueses/the teacher; nga hidrogjeni dhe oksigjeni/of hydrogen and oxygen*), në fjalitë në gjuhën angleze kemi modelin kryefjalë-kallëzues-kundrinor sipas modeleve themelore të fjalive të thjeshta në gjuhën angleze dhe nuk bëhet dallimi nëse flitet për kundrinor të drejtë apo të zhdrejtë, por sipas Konrad thjeshtë konsiderohet si kundrinor i drejtë sepse në gjuhën angleze fjalia nuk mund të ketë kundrinor të zhdrejtë pa pasur kundrinor të drejtë¹⁴⁷. Por ky pohim kundërshtohet nga Quirk i cili pohon se fjalia në gjuhën angleze mund të përbëhet nga kryefjala, kallëzuesi dhe rrallë herë edhe nga kundrinori i zhdrejtë¹⁴⁸ si në shembullin më poshtë ku në gjuhën shqipe është kundrinor i drejtë, ndërsa në gjuhën angleze kundrinor i zhdrejtë:

(64) *Ti mund të më dërgosh **mua**./You can send **me***. (kundrinor i drejtë/zhdrejtë)

Trajtat e shkurtra në gjuhën shqipe janë sa të rëndësishme, po aq problematike gjatë analizës së fjalive dhe caktimit të rolit sintaksor. Përdorimi i tyre është i gjerë dhe më lart u tha se luajnë rolin e caktuesorit të foljes. Trajatat e shkurtra nuk janë kundrinor, nuk rimarrin kundrinorin në fjali, por janë formante gramatikore të domosdoshme, të ngjashëm me mbaresat e foljeve, me nyjat jo shquese të emrave dhe përfshihen në kategorinë e caktuesorëve. Trajatat e shkurtra të përemrave vetorë, duke shënjuar kalimtarësinë e foljes, shprehin kuptimin aktual të foljes dhe luajnë rol për formësimin semantik të foljes dhe për përdorimin konkret¹⁴⁹. Trajta e shkurtër: 1) shënjohe para foljeve që plotësohen nga një kundrinor i zhdrejtë i rasës dhanore pa parafjalë (p.sh.: *Atij **i** pëlqeu ushqimi.*), 2) shënjohe para foljeve kur ato plotësohen nga një kundrinor i drejtë (p.sh.: *Vajzat Jonin **e** pëlqejnë.*), 3) është e domosdoshme në fjalitë njëkryepërbërëse pavetore (p.sh.: ***Më** hahet. **Më** pihet*), 4) është e domosdoshme para foljeve kalimtare ku veprimi i foljes bie mbi një kundrinor përemër të vetave të ndryshme (*Dje **më** thirri komisari.*), 5) është mjet gramatikor i domosdoshëm në tekste ku i referohet një kundrinori të thënë në sifjalinë e parë dhe që normalisht nuk rimerret më (*Vrasësi **i** ndoqi viktimat e pas një kohe **i** kapi.*), 6) nuk është e domosdoshme para foljeve që plotësohen nga kundrinorë të drejtë

¹⁴⁷ Konrad, D. C. dhe Adelman, P. B. ‘*The Grammar Handbook*’, Good Year Books by Pearson Learning, 2000, f. 43.

¹⁴⁸ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “*A Comprehensive Grammar of the English Language*”, Longman, 1985, f. 727.

¹⁴⁹ Çeliku, M., “*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 169.

(*Banorët e Iliridës e humbën pavarësinë e tyre. Banorët e Iliridës meritojnë pavarësinë.*) dhe 7) shprehin edhe kuptim përgjithësues dhe caktuesori të i jep foljes një kuptim përgjithësues (*Spilleja të ofron qetësi.*)¹⁵⁰.

Në gjuhën shqipe, larmishmëria e gjerë e kundrinorit, në veçanti e atij të zhdrejtë, si dhe rendi i lirë i fjalëve në fjali, lejojnë krijimin e shumë kombinimeve të fjalive të thjeshta dhe ndryshimin e vendit të fjalëve në fjali.

2.7.2. Kundrinori në gjuhën angleze

Ashtu si në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën angleze njihen kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë dhe ai shprehet me emër, përemër, frazë emërore ose sifjali¹⁵¹. Nga vetë fakti që si i drejti, ashtu edhe i zhdrejti, quhen thjeshtë kundrinor na bën të mendojmë se kanë diçka të përbashkët. Në gjuhën angleze kundrinori qëndron pas kryefjalës dhe kallëzuesit. Për shkak të rendit të fiksuar në gjuhën angleze, kundrinori është i kufizuar dhe nuk mund të lëvizë në fjali. Përfundim është situata kur kemi dy kundrinorë, atë të zhdrejtë dhe të drejtë, dhe këta dy kundrinorë mund të zënë vetëm vendin e njërit-tjetrit por me shtim të një parafjale.

Në vazhdim duke u mbështetur në gramatikat më relevante të gjuhës angleze, po paraqesim disa nga çështjet gramatikore lidhur me kundrinorin. Për sa i përket kundrinorit, Quirk përmend disa karakteristika të tij¹⁵²:

1) Forma – kundrinori mund të shprehet me frazë emërore ose sifjali. Por ekzistojnë kufizime për sa i përket sifjalisë në rastet kur kemi kundrinor të zhdrejtë dhe ai mund të shprehet vetëm me sifjali lidhore.

2) Pozicioni – kundrinori normalisht qëndron pas kryefjalës dhe kallëzuesit dhe në rastet e foljeve trevalente, kur kemi dy kundrinorë (të drejtë dhe të zhdrejtë), i zhdrejti qëndron para të drejtës. P.sh.:

(65)

a. *I gave **her the ring**./Unë ia dhashë **asaj unazën**.* (KZH-KD)

¹⁵⁰ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 169-171.

¹⁵¹ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A Comprehensive Grammar of the English Language”, Longman, 1985, f. 724.

¹⁵² Po aty, f. 726-728.

- b. *I gave **the ring to her***¹⁵³./Unë ia dhashë **unazën asaj**. (KD-parafjalë-KZH)

3) Funkzioni sintaksor – funksioni sintaksor i kundrinorit (të zhdrejtë) kërkon rasën kallëzore të përemrave. P.sh. përemri *them* në rasën kallëzore në fjalitë:

(66)

- a. *I want **them***./Unë i dua **ato**. (KD)
b. *I gave **them water***./Unë u dhashë **atyre ujë**. (KZH-KD)

a) Nëse kundrinori lidhet me kryefjalën, ai zakonisht shprehet me përemër vetvetor, i cili përshtatet me kryefjalën në vetë, numër dhe gjini. Përshtatja e ngjashme nevojitet edhe për gjinoren emfatike (*their own/e(të) tyre*) brenda kundrinorit. P.sh.:

(67)

- a. *She likes **herself***./Ajo pëlqen **veten**. (Kundrinor me përemër vetvetor)
b. *They saved **their own business***./Ata shpëtuan **biznesin e tyre**. (Kundrinor në rasën gjinore)

Në të dy shembujt nuk ekziston ndonjë dallim gjatë përkthimit të fjalive nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

b) Kundrinori në fjali veprorë bëhet kryefjalë e fjalisë përkatëse në fjali pësorë. Në rastet kur kemi fjali me dy kundrinorë, shpesh është e mundur që si kundrinori i drejtë ashtu edhe ai i zhdrejtë të bëhet kryefjalë e fjalisë në diatezën pësorë. Kushtet për të pasur fjali në diatezën pësorë janë përmendur më lart te kalueshmëria e foljeve. P.sh.:

(68)

- a. *I crashed **the car***./**The car** was crashed (by me). (Diatezë veprorë>pësorë)
b. *Unë e prisha **makinë***./**Makina** ishte prishur (nga unë). (Diatezë veprorë>pësorë)

c) Kundrinori i zhdrejtë zakonisht përbëhet edhe nga një parafjalë/frazë parafjalore në rastet kur del pas kundrinorit të drejtë. Kjo u ilustrua me shembullin e mësipërm për sa i përket pozicionit të kundrinorit.

4) Karakteristikat semantike

a) Kundrinori i drejtë zakonisht i referohet një sendi i cili ndikohet nga veprimi i theksuar në fjali. P.sh.:

- (69) *Ai prishi **festën***./He ruined **the party**. (kundrinor i drejtë)

¹⁵³ Rastet e kështilla në gjuhën angleze njihen si ‘prepositional object’ ose ‘kundrinor me parafjalë’.

b) Kundrinori i zhdrejtë zakonisht u referohet qenieve të gjalla mbi të cilët bie veprimi.
P.sh.:

(70) *I bought **my mother** some flowers./Unë i bleva **nënës time** ca lule.* (kundrinor i zhd.)

Edhe pse normalisht rendi i fjalëve në fjali në gjuhën angleze është i fiksuar, ndodh rrallë që të kemi lëvizje të kundrinorit në fjali¹⁵⁴. Bëhet fjalë, më saktë, për kundrinorin e drejtë, dhe shembujt më poshtë tregojnë rolin e *it/atë* në përcaktimin e kundrinorit:

Kundrinor i drejtë i zhvendosur në krahasim me atë jo të zhvendosur:

(71)

- a. *He thought **it** like something right and necessary **to help the poor**.*
- b. *He thought **to help the poor** like something right and necessary.*
- c. **Ai e mendoj **atë** si diçka të mirë dhe të domosdoshme **të ndihmosh të varfërit**.*
- d. **Ai mendoj **të ndihmosh të varfërit** si diçka të drejtë dhe të domosdoshme.*

Fjalitë e përkthyer në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa parafrzim (fjalitë c dhe d) nga gjuha angleze në gjuhën shqipe e humbin kuptimin dhe ruajtja dhe përcjellja e kuptimit bëhet vetëm me anë të përkthimit me përshtatje. Për më tepër, fjalia (c) është jogramatikore dhe e papranueshme, ndërsa fjalia (d) është e pranueshme, por jonormative.

2.8. Gjymtyrët e tjera në gjuhën shqipe

Klasifikimi i gjymtyrëve të dyta në gjuhën shqipe ka nisur mjaft vonë në krahasim me gramatikat e gjuhës angleze. Kjo është edhe njëra nga arsytet për ekzistencën e këndvështrimeve dhe dallimeve në klasifikimin e tyre. Sipas Gramatikës së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, teoria e gjymtyrëve, përfshirë gjymtyrët e dyta, është mënyra më e pranueshme e analizës së përbërësve të fjalisë pasi zbërthimi i fjalisë në gjymtyrë ka rëndësi për raportet sintaksore që vendosen në kuadrin e fjalisë dhe lidhjeve midis elementeve të mendimit të

¹⁵⁴ O'Dwyer, B. T. 'Modern English Structures – Form, Function and Position (Second Edition)', Broadview Press, 2006, f. 173.

shprehur prej saj¹⁵⁵. Në gjuhën shqipe janë tri kategori kryesore të gjymtyrëve të dyta: 1) Përcaktorët, 2) Kundrinori (i drejtë dhe i zhdrejtë) dhe 3) Rrethanorët¹⁵⁶. Kundrinori (i drejtë dhe i zhdrejtë), si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe, është diskutuar më lart, ndërsa më poshtë shkurtimisht është sqaruar përdorimi i përcaktorëve dhe rrethanorëve në fjali.

Përcaktorët (ang. modifiers) – shprehin raporte të një tipari a veçorie me bartësin e tij a të saj nëpërmjet një mbiemri, emri ose fjale tjetër emërore të lidhura me përshtatje të plotë apo të pjesshme (në numër, gjini dhe rasë), me drejtim, me ose pa parafjalë, ose edhe me bashkim të thjeshtë. Përcaktorët mund të jenë edhe disa trajta foljore të pashtjelluara ose ndajfolje¹⁵⁷.

(72) *Ditët e fundit të jetës së tij ishin të rënda./His last days of his life were hard.*

Ndërsa në gjuhën shqipe përcaktori njihet si gjymtyrë e dytë, në gjuhën angleze nuk njihet si gjymtyrë e fjalisë. Në fakt, përcaktori në gjuhën angleze analizohet në nivelin e dytë të analizës së fjalive me anë të pemës sintaksore ku analizohen të gjithë përbërësit sintaksorë. Në llojet apo modelet e fjalive të thjeshta në gjuhën angleze, përcaktori nuk konsiderohet si gjymtyrë, por si pjesë përbërëse e një fraze e cila e plotëson kokën e asaj fraze, e ajo frazë bashkë me përcaktorin shpreh një rol të caktuar sintaksor si kryefjalë apo kundrinor. Derisa në gjuhën shqipe kemi *ditët – kryefjalë, e fundit, të jetës së tij – përcaktor*, në gjuhën angleze kemi *his last days of his life – kryefjalë* si një përbërës apo gjymtyrë e ku përcaktori është pjesë e sintagmës emërore. Ndajfoljet ndodh të krijojnë probleme gjatë përcaktimit të funksioneve sintaksore. Për ta pasur më të qartë, në shembullin e mëposhtëm është dhënë fjala e njëjtë në dy fjali të ndryshme – *atje/there*:

(73)

a. *Atë vajzën atje e njoh shumë mirë./I know very well that girl there.*

(përcaktor)

b. *Ajo është ulur atje./She is sitting there.* (rrethanor)

Fjala *atje/there* në shembullin e parë është përcaktor në të dy gjuhët, por duhet bërë analizë pse është përcaktor në këtë rast. Shkaku është se qëndron pas emrit dhe në gjuhën angleze duhet imagjinuar situata sikur fjalia të ishte: *I know very well that girl sitting there*. Në këtë rast, dallimi i përcaktorit në gjuhën angleze do të ishte edhe më i lehtë pasi që veçse janë diskutuar llojet e kryefjalëve ose kundrinorëve të shprehur me sifjali. Ndërsa në rastin e dytë nuk mund të

¹⁵⁵ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 211.

¹⁵⁶ Po aty, f. 213.

¹⁵⁷ Po aty, f. 213.

flitet për përcaktor, por flitet për rrethanor pasi që *atje/there* tregon një rrethanë-vend dhe nuk mund të konsiderohet përcaktor.

Rrethanorët – janë gjymtyrë të dyta me një përdorim shumë të gjerë në gjuhën shqipe pasi tregojnë raporte të ndryshme rrethanore, vend, kohë, shkak, qëllim etj. të cilët mund të shprehen me ndajfolje, lokucione ndajfoljore, emër ose fjalë emërore, trajtë foljore të pashtjelluar ose togfjalësh, të lidhur me drejtim, me ose pa parafjalë, ose me bashkim, kryesisht me një folje ose me mbiemër¹⁵⁸. Kryesisht ndajfolja ose lokucionet ndajfoljore janë ato me të cilat kryesisht shprehet rrethanori. P.sh.:

(74)

- a. Ai vaproi **shpejt**./He ran **quickly**. (rrethanor mënyre)
- b. Vajza u zhduk **në errësirë**./The girl went missing **in the dark**. (rr. vendi)
- c. **Asnjëherë** nuk do ta tradhëtoja vendin tim. I would **never** betray my country. (rr. kohe)
- d. Ajo nuk mundej të flejë **për shkak të lumturisë së saj**./She couldn't sleep **because of her happiness**. (rr. shkak)
- e. Ai shkoi atje **për të studiuar**./He went there **to study**. (rr. qëllimi)
- f. Na duhen **më shumë**./We need **more**. (rr. sasi)
- g. **Në rast paniku**, shtypni butonin!/In **case of panic**, push the button! (rr. kushti)
- h. Kompjuteri punonte **me gjithë problemet e tij**./The computer was working **with all his problems**. (rr. lejimi)

Siç mund të shihet nga shembujt e dhënë më lart, rrethanori është i shumëllojshëm në gjuhën shqipe dhe për këtë arsye gjen përdorim shumë të gjerë. Kjo ndodh për shkak të llojeve të ndryshme të rrethanorit, lëvizjes së tij në fjali për shkak të rendit të lirë të fjalëve dhe për shkak se rrethanori shprehet me ndajfolje, lokucione ndajfoljore, emra me dhe pa parafjalë dhe forma të pashtjelluara të foljeve dhe mënyra më e lehtë për t'i gjetur është duke përdorur pyetjet *ku, kur, pse, përse, si, sa*, etj. Në traditën e vonshme të gramatikës së gjuhës shqipe si rrethanorë nuk njihen përbërësit që shprehin mjetin, instrumentin dhe agentin dhe të njëjtët konsiderohen si

¹⁵⁸ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 214.

kundrinor¹⁵⁹. Gjithsesi, lista e gjatë e llojeve të rrethanorëve e bën fjalinë të jetë e pasur me rrethanorë të llojeve të ndryshëm.

2.9. Gjymtyrët e tjera në gjuhën angleze

Gramatika e gjuhës angleze ka bërë një ndarje të qartë dhe të lehtë për identifikimin e gjymtyrëve të tjera. Si Quirk, ashtu edhe gjuhëtarë të tjerë, kanë bërë kategorizimin dhe ndarjen e gjymtyrëve të tjera. Përveç kryefjalës, kallëzuesit, kundrinorit (të drejtë dhe të zhdrejtë), në gjuhën angleze ekzistojnë edhe dy lloj gjymtyrësh tjera:

Plotësori ose komplementi (ang. complement) - Plotësori në gjuhën angleze është dy llojesh: 1) Plotësori i kryefjalës (ang. subject complement) ose i njohur edhe si përcaktori kallëzuesor i kryefjalës ose gjerësisht i njohur në gjuhën shqipe si kallëzuesi emëror dhe 2) Plotësori i kundrinorit (ang. object complement) ose i njohur edhe si përcaktori kallëzuesor i kundrinorit ose kallëzuesori i kundrinorit.

Rrethanori (ang. adverbial) i cili mund të lidhet me kryefjalën (ang. subject related adverbial) ose me kundrinorin (ang. object related adverbial)¹⁶⁰.

Në gjuhën shqipe ka një ndarësi të gjuhëtarëve për sa u përket termave specifikes, përcaktor, argument e komplement, por që shpesh të gjithë këto terma përdoren në vend të njëri-tjetrit dhe në këtë mënyrë krijohet paqartësi në lidhje me përdorimin e duhur të këtyre termave. Këtu e tutje do të përdoren termat *kallëzues emëror* për *subject complement* dhe *kallëzuesor i kundrinorit* për *object complement*.

Nga shembujt të cilët janë dhënë më poshtë shihet qartë lidhja e kryefjalës me plotësinë përmes foljes këpujore. Pra, për të pasur një kallëzues emëror duhet që fjalia të përbëhet nga një folje këpujore.

Plotësori në gjuhën angleze është mirë i definuar dhe nuk ka çështje madhore të diskutueshme të cilat do të ndikojnë në përcaktimin e roleve sintaksore në fjali. Më poshtë janë dhënë disa karakteristika themelore të plotësorit:

¹⁵⁹ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 176.

¹⁶⁰ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A Comprehensive Grammar of the English Language”, Longman, 1985, f. 720.

1) Forma – normalisht shprehet me emër (sintagmë emërore), mbiemër (sintagmë mbiemërore), por mund të shprehet edhe me sifjali. (*He is the guy./Ai është personi. They were late./Ata ishin vonë.*)

2) Pozita – kallëzuesi emëror normalisht qëndron pas kryefjalës dhe foljes, ndërsa kallëzuesori i kundrinorit qëndron pas kundrinorit të drejtë. (*Jonida was **tired**./Jonida ishte e lodhur./They elected Jon **president of the class**./Ata e zgjodhën Jonin **kryetar të klasës**.*)

3) Funksionet sintaksore – a) Nëse shprehet me sintagmë emërore, kallëzuesi emëror zakonisht përshtatet në numër me kryefjalën (*It is an unusual gift./Është një dhuratë e pazakonshme.*), ndërsa kallëzuesori i kundrinorit me kundrinorin e drejtë (*The committee elect her a leader./Komiteti e zgjodhi atë lider.*); b) Nëse është përemër vetvetor, kallëzuesi emëror përshtatet në numër, vetë dhe gjini (aty ku mundet) me kryefjalën (p.sh.: *He is not himself today./Ai nuk është vetja sot.*); c) Ndryshe nga kundrinori, plotësori nuk mund të bëhet kryefjalë e konstruksionit në diatezën pësore. Nuk mund të krijohet fjali në diatezën pësore për fjalitë e llojit kryefjalë-kallëzues-plotësor (komplement), ndërsa me fjalitë e llojit kryefjalë-kallëzues-kundrinor-plotësor (komplement) si kryefjalë e konstruksionit në diatezën pësore mund të bëhet kundrinori i drejtë.

4) Karakteristikat semantike – Plotësori zakonisht identifikon ose karakterizon referentin e elementit të sifjalisë për të cilin është lidhur¹⁶¹. P.sh.: *The situation was alarming./Situata ishte alarmuese.*

Nga vetë ndarja e këtillë e plotësorit, në momentin kur përmendet kallëzuesi emëror kuptohet se ai tregon lidhshmëri me kryefjalën dhe se folja këpujore shërben si urë lidhëse, ndërsa kallëzuesori i kundrinorit dukshëm tregon lidhshmëri me kundrinorin. P.sh.:

(75)

- a. *Jonida is **happy**./Jonida është e lumtur.* (kallëzues emëror)
- b. *They consider **Obama a president**./Ata e konsiderojnë **Obamën president**.*
(kundrinor + kallëzuesor i kundrinorit)

Pra, në shembullin e parë fjala *e lumtur* kuptohet që vlen për kryefjalën *Jonida*. Përveç kësaj, folja është folje këpujore dhe këto dy elemente na japin ide të qartë se flitet për kallëzues emëror. Në shembullin e dytë fjala *president* dukshëm nuk lidhet me kryefjalën *they*, por lidhet

¹⁶¹ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A Comprehensive Grammar of the English Language”, Longman, 1985, f. 729.

me kundrinorin *Obama* dhe si i tillë konsiderohet kallëzuesor i kundrinorit. Të dy shembujt e dhënë lehtë identifikohen në modelin e fjalive të thjeshta, fjalia e parë si fjali e modelit kryefjalë-kallëzues-kallëzues emëror dhe fjalia e dytë si fjali e modelit kryefjalë-kallëzues-kundrinor-kallëzuesor i kundrinorit.

Kallëzuesi emëror i shprehur me sifjali mund të realizohet nga shumë lloj sifjalish: sifjali me *that*, sifjali lidhore, sifjali me *wh*- dhe sifjali me *yes-no*¹⁶².

(76)

- a. *The idea is **that the robbers are imprisoned**.*/Ideja është **se hajdutët u burgosën**. (kallëzues emëror i shprehur me sifjali)
- b. *I enjoyed **what you said yesterday**.*/Më pëlqeu **çfarë the dje**. (me sifjali kundrinore)
- c. *My problem is **how to do it**.*/Problemi im është **si ta bëj atë**. (me sifjali me *wh-how*)
- d. *The issue is **whether he lies or not**.*/Problemi është **nëse ai gënjen ose jo**. (me sifjali pyetëse)

Kallëzuesori i kundrinorit mund të shprehet me pjesore, si p.sh.:

(77) *I keep the money **hidden in my house**.*/Unë i ruaj paratë **të fshehura në shtëpinë time**. (kallëzuesor i kundrinorit i shprehur me pjesore)

Shembulli i mësipërm është krejtësisht në rregull pasi ky shembull është i natyrës së njëjtë si fjalia e përbërë nga kryefjala-kallëzuesi-kundrinori-kallëzuesori i kundrinorit, si p.sh.:

(78) *I keep the money **safe**.*/Unë i ruaj paratë **të sigurta**.

Një rol sintaksor i cili nuk është përmendur në funksionet sintaksore më lart në gjuhën angleze është *object of preposition*¹⁶³ e që në gjuhën shqipe është i barasvlershëm me kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë. Në fakt, edhe në gjuhën angleze flitet njëjtë për kundrinorin e zhdrejtë dhe bëhet një ndarje të tij si në gjuhën shqipe për shkak se në vete përmban parafjalë. P.sh.:

(79)

- a. *I can't take it **from you**.*/Nuk mund ta marr **nga ti**. (i shprehur me përemër)

¹⁶² Wekker, H. 'Topics in English Linguistics 22', Mouton de Gruyter, 1997, f. 265.

¹⁶³ O'Dwyer, B. T. 'Modern English Structures – Form, Function and Position (Second Edition)', Broadview Press, 2006, f. 175.

- b. *You need to give time **to your boss**.*/Duhet t'i japësh kohë **shëfit tënd**. (me sint. emërore)

Nga shembujt e mësipërm mund të shohim se kundrinori i zhdrejtë me parafjalë në gjuhën angleze mund të shprehet me emra, sintagma emërore dhe përemra dhe shembuj të tillë janë të shumtë në gjuhën angleze.

Rrethanori në gjuhën angleze është një pjesë përbërëse apo gjymtyrë e dytë e fjalisë me një karakteristikë të rëndësishme. Rrethanori mund të lëvizë në fjali lirshëm, për dallim nga gjymtyrët e tjera që kryesisht janë të fiksuara në fjali. Rrethanorin në gjuhën angleze mund ta gjejmë në fillim, në mes dhe në fund të fjalisë. Karakteristikat themelore të rrethanorit sipas Quirk¹⁶⁴ janë:

1) Forma – Rrethanori zakonisht përbëhet nga një ndajfolje, sintagmë ndajfoljore, sintagmë parafjalore, sintagmë emërore ose sifjali rrethanore.

(80)

- a. *Jonida smiled **happily**.*/Jonida qeshi **gëzueshëm**. (me ndajfolje)
- b. *The girls sang **surprisingly well**.*/Vajzat kënduan **çuditërisht mirë**. (me sintagmë ndajfoljore)
- c. *The robbers hid **under the bridge**.*/Hajdutët u fshehën **poshtë urës**. (me sintagmë parafjalore)
- d. *My brother arrived **this morning**.*/Vëllai im arriti **këtë mëngjes**. (me sintagmë emërore)
- e. *We continued the game **until the sun set**.*/Ne e vazhduam lojën **derisa perëndoi dielli**. (me sifjali)

2) Pozita – Rrethanori është gjymtyra e cila më së shumti mund të lëvizë në fjali në gjuhën angleze. Normalisht qëndron pas kryefjalës dhe foljes, por mund të gjendet edhe në fillim, në mes dhe në fund të fjalisë. Rrethanori mund të jetë i kufizuar për t'u përdorur në pozicione të caktuara në varësi të llojit të rrethanorit sepse ekzistojnë rregulla gramatikore për rendin e rrethanorit në fjali.

(81)

- a. ***Suddenly***, *Ben felt sick*,/Papritmas, Beni u ndje keq. (në fillim)

¹⁶⁴ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. "A Comprehensive Grammar of the English Language", Longman, 1985, f. 729.

- b. *Your students are **always** late./Studentët e tu çdoherë vonohen.* (në mes)
- c. *My sister visits me **occasionally**./Motra ime më viziton herë pas here.* (në fund)

3) Funksioni sintaksor – Rrethanori është i obligueshëm në modelet e fjalisë të tipit kryefjalë-kallëzues-rrethanor (SVA) dhe në disa fjali me rend kryefjalë-kallëzues-kundrinor-rrethanor (SVOA) dhe si i tillë konsiderohet plotësor, ndërsa në tipat e tjerë të fjalive rrethanori është fakultativ ose shtesor.

(82)

- a. *My friend acts **funny**./Shoku im sillet **në mënyrë qesharake**.* (plotësor)
- b. *My mother put the plate **on the table**./Nëna ime e vendosi pjatën **në tavolinë**.* (plotësor)
- c. *He left (**last week**)./Ai iku (**javën e kaluar**).* (shtesor)

4) Karakteristikat semantike – Ashtu si në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën angleze rrethanori u referohet rrethanave të situatave të ndryshme, komenton formën ose përmbajtjen e sifjalisë së varur ose siguron lidhjen midis sifjalive.

(83)

- a. *The dog bit my friend **on the leg**./Qeni e kafshoi shokun tim **në këmbë**.*
- b. ***Obviously**, no one won./Padyshim, askush nuk fitoi.*

Karakteristikë tjetër për sa u përket rrethanorëve është se ata kanë lidhshmëri me foljet kalimtare dhe jokalistare. Rrethanorët si plotësorë paraqiten në fjali me folje jokalistare dhe kalimtare¹⁶⁵. Në fjalitë me folje jokalistare rrethanorët mund të shprehen me sintagma parafjalore ose ndajfoljore, si p.sh.:

(84)

- a. *The turtle may live **in this area**./Breshka mund të jetojë **në këtë zonë**.*
- b. *Her students reacted **angrily**./Studentët e saj reaguan **me zemërim**.*

Gjatë analizës së fjalive duhet pasur kujdes që të mos ngatërrohet rastësisht funksioni sintaksor i sintagmës parafjalore si në fjalinë më poshtë:

(85) *They stayed **with her for three hours**./Ata qëndruan **me atë për tre orë**.*

Folja ‘*stayed*’ është folje kalimtare dhe në gjuhën angleze foljet kalimtare marrin kundrinor. Në këtë rast, përveç kundrinorit ‘*with her*’ kemi edhe rrethanorin ‘*for three hours*’.

¹⁶⁵ Wekker, H. dhe Haegeman, L. “A modern course in English syntax”, Routledge, London, 1985, f. 74.

Funksionet sintaksore përputhen në të dy gjuhët. Folja jokalmtare normalisht nuk merr kundrinor, prandaj mund të plotësohet vetëm me rrethanor, si p.sh.:

(86) *The boys remained **there**./Djemtë mbetën **aty**.*

Në këtë rast është shumë e lehtë të identifikohet rrethanori *there/aty* i cili është plotësor (i domosdoshëm) pasi që specifikon lokacionin e aktivitetit.

Një tjetër specifikë e rrethanorëve është kur ata përdoren në fjali me folje këpujore. Menjëherë kur përmendet folja këpujore në gjuhën angleze na bën të mendojmë se pas asaj vjen kallëzuesi emëror. Por jo çdoherë folja këpujore *jam/be* në gjuhën angleze konsiderohet si folje këpujore. P.sh.:

(87) *Jon is **in Elbasan**./Joni është **në Elbasan**.*

Në fjalinë e mësipërme folja *is/është* nuk konsiderohet folje këpujore pasi nuk i përcakton një karakteristikë kryefjalës, por ajo specifikon vendin ose kohën e të qenët në një vend të caktuar. Prandaj, *in Elbasan/në Elbasan* është rrethanor vendi.

Në anën tjetër, rrethanorët mund të paraqiten në fjali edhe me folje kalimtare, në diatezën veprorë por edhe pësorë¹⁶⁶, si p.sh.:

(88)

- a. *Jonida put the car **in the garage**./Jonida futi makinën **në garazh**.*
- b. *The car was put **in the garage**./Makina ishte futur **në garazh**.*

Semantika e foljes është faktori i cili ndikon në plotësimin e saj. Pjesa që vjen pas foljes në këtë rast konsiderohet pjesë e domosdoshme pasi që fjalia pa ‘*in the garage/në garazh*’ nuk do të ishte e plotë dhe kjo pjesë plotësohet këtu nga rrethanori i vendit.

¹⁶⁶ Wekker, H. dhe Haegeman, L. “A modern course in English syntax”, Routledge, London, 1985, f. 77.

KREU III

RENDI I GJYMTYRËVE NË FJALITË E THJESHTA NË GJUHËN SHQIPE DHE GJUHËN ANGLEZE

3.1. Vështrim i përgjithshëm mbi rendin e fjalëve dhe rolin gramatikor të tij

Lidhja e gjymtyrëve në gjuhë është shumë e rëndësishme për krijimin e fjalive të sakta në aspektin gramatikor – sintaksor dhe semantik. Duke u nisur nga fakti se disa herë kemi përmendur se rendi i fjalëve në gjuhën shqipe është i lirë, ndërsa në gjuhën angleze i fiksuar, ndodh që jo çdo herë ky të jetë një pohim universal dhe mund të mos vlejë në të gjitha rastet. Gramatika e një gjuhe ka rregulla të caktuara e të përshkruara qartë. E njëjta vlen edhe për rendin e fjalëve në fjali që mbështetet në teori dhe rregulla përkatëse.

Në gjuhën shqipe kontribut shumë të rëndësishëm kanë dhënë disa gjuhëtarë si Spiro Floqi, Kostaq Cipo, Mahir, Shaban Demiraj, Remzi Përnaska, Thoma Rrushi, Menella Totoni, Mehmet Çeliku etj. Kontributi i tyre ka rezultuar me një punë të përmbledhur kur flitet për rendin e fjalëve në fjali pasi janë përkufizuar rregullat dhe kushtet që duhen plotësuar, si dhe përjashtimet në raste të caktuara. Në gjuhën angleze ekzistojnë teori të ndryshme të rendit të fjalëve në fjali të zhvilluara nga gjuhëtarë të ndryshëm si Blumfeld, Graffi, Çomski, Quirk, Greenbaum, Leech, Svartvik, Song etj., si tipologjia linguistike, gramatika gjenerative (teoria e lidhjes, teoria e parimeve dhe parametrave, programi minimalist), teoria e optimalitetit, si dhe teori të bazuara në analizë të përbërësve si teoria e hershme dhe e rishikuar e përbërësve të drejtpërdrejtë, teoria e varësisë¹⁶⁷ etj.

Në gjuhën shqipe rendi i fjalëve në fjali dhe teoritë me rendin e fjalëve në fjali kanë filluar të studiohen shumë vonë nga gjuhëtarët shqiptarë. Në fakt, për herë të parë vendi i kryefjalës është përmendur nga Ilia Dilo Sheperi në ‘Gramatikën dhe sindaksën e gjuhës shqipe’ në vitin

¹⁶⁷ Song, J. J. ‘Word Order’, Cambridge University Press, 2012, f. 3.

1927, pastaj i kallëzuesit në fjalitë e varura kohore nga Kostaq Cipo në ‘Sintaksën’ e tij në vitin 1952 dhe Mahir Domi në librin ‘Sintaksa për shkollat e mesme’ të vitit 1954¹⁶⁸. Ajo që vlen të theksohet këtu është se ekziston një artikull më i hershëm që ka të bëjë me rendin e fjalëve në fjali. Bëhet fjalë për artikullin ‘Një rregullë e shqipes mbi rendin e fjalëve’ të gjuhëtarit gjerman Klaus Hebler i cili ka nxjerrë rregullat më tipike të rendit të fjalëve në fjali dhe që e konsideron si të pamjaftueshëm shqyrtimin e rendit të gjymtyrëve duke u bazuar vetëm në dy gjymtyrët kryesore dhe çështja e pozicionit të kallëzuesit ndaj gjymtyrëve të tjera është vendimtare për vlerësimin e rendit të fjalëve¹⁶⁹. Ajo çfarë është vërejtur te artikulli i Heblerit është se ai është përqendruar vetëm në rendin e kryefjalës dhe kallëzuesit, mjetin e lidhjes, por nuk ka marrë parasysh edhe rendin e gjymtyrëve të tjera dhe rolin e kallëzuesit në lidhjen e fjalëve në fjali.

Floqi pohon se rendi i fjalëve në gjuhë nuk mund të studiohet pa marrë parasysh fenomenin gjuhësor shoqërues të domosdoshëm në çdo fragment ligjërimor, pra intonacionin në pjesët që lidhen me theksat frazorë, dhe struktura formale gramatikore zë vend primar përballë anës objektive të semantikës dhe rendi i fjalëve bashkë me intonacionin shërbejnë për të treguar raportin e një gjymtyre ndaj një gjymtyre tjetër në një fjali ose fjali të tërë; kjo tregon peshën kumtuesore që ka fjala ose togfjalëshi në një njësi të caktuar kumtuesore, fjalie ose periudhe¹⁷⁰.

Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve është përmendur edhe nga Thoma Rushi. Sipas tij, rendi i fjalëve në gjuhën shqipe mund të luajë edhe rol gramatikor (sintaksor) ku përcaktohet funksioni sintaksor i gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë dhe ai këtu përmend edhe rendin e ngulitur të fjalëve në raste të caktuara, por që rendi i gjymtyrëve në fjalitë dëftore është i lirë, kjo duhet konsideruar si diçka relative¹⁷¹. Rushi vazhdon edhe më tutje duke e ndarë rendin e fjalëve në dy grupe ku: 1) rendi i fjalëve shërben për përcaktimin e funksioneve të dy gjymtyrëve që shprehen me forma të njëjta gramatikore e që mund të kryejnë dy funksione dhe me ndihmën e rendit të fjalëve mund të dallohet kryefjala nga kundrina e drejtë dhe nga gjymtyra emërore e kallëzuesit dhe 2) rendi i fjalëve mund të shërbejë për të dalluar funksionin e një gjymtyre që mund të kryejë dy funksione që mund të varet nga dy gjymtyrë e që mund të jenë një gjymtyrë emërore dhe një gjymtyrë foljore dhe me rendin e fjalëve mund të dallohet përcaktori me përshtatje nga gjymtyra emërore e kallëzuesit, përcaktori me përshtatje nga përcaktori

¹⁶⁸ Floqi, S. ‘Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme’, Studime Filologjike – Nr.2, 1969, f. 125.

¹⁶⁹ Haebler, C. ‘Eine albanische Wortstellungsregel’, Münchener Studien zur Sprachwissenschaft, 1957, Heft 11, f. 49-61.

¹⁷⁰ Floqi, S. ‘Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme’, Studime Filologjike – Nr.2, 1969, f. 141.

¹⁷¹ Rushi, Th. ‘Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe’, Studime Filologjike – Nr. 4, 1984, f. 47.

kallëzuesor, përcaktori i veçuar nga përcaktori kallëzuesor, përcaktori pa përshtatje nga kundrinori me parafjalë dhe përcaktori pa përshtatje nga rrethanori¹⁷². Gjithë funksioni i rendit të fjalëve në fjali në këtë rast shihet si diçka e lidhur me intonacionin dhe theksin logjik.

Rendi i gjymtyrëve i lidhur me perspektivën funksionale (gjymtyrëzimin aktual) është teoria e radhës e përmendur nga Remzi Përnaska kur flitet për gjymtyrëzimin aktual të thënies. Ai flet për: 1) rend të drejtë të tipave: *kryefjalë + kallëzues foljor ose emëror, kallëzues + kundrinor, kallëzues + rrethanor* dhe rend të zhdrejtë si *kallëzues foljor a emëror + kryefjalë*, 2) theksin logjik si faktor në shqyrtimin e gjymtyrëzimit aktual, 3) përcaktimin e mjeteve gjuhësore (leksikore e gramatikore) për zbërthimin e thënies dhe 4) gjetjen e remës, rendit të gjymtyrëve të fjalisë, intonacionin, emrat (të gjitha llojet), mbiemrat, përemrat e pacaktuar, pjesëzat, disa ndërtime sintaksore të specializuara, trajtat¹⁷³ etj.

Mahir Domi konsiderohet si një nga emrat më të rëndësishëm kur flitet për sintaksën e shqipes, raportet sintaksore dhe mjetet e shprehjes së mjeteve sintaksore. Sipas Domit, ekzistojnë dy kategori të mëdha raportesh: 1) raportet e barazisë (pavarësisë) ku njësitë e vëna në lidhje midis tyre qëndrojnë në të njëjtin plan pa u varur nga njëra-tjetra – të pranishëm në fjali midis gjymtyrëve të një lloji, gjymtyrëve homogjene, midis fjalive të një periudhe me bashkërenditje, disa llojeve të fjalive jolidhëzore, fjalive kryesore të bashkuara me lidhëza bashkërenditëse ose pa lidhëza dhe fjalive të varura të një lloji, periudhën e përzier dhe 2) raportet e varësisë ku njësitë e bashkuara qëndrojnë në plane të ndryshme a të varura prej njëra-tjetrës – të pranishëm midis gjymtyrëve të dyta dhe atyre të plotësuar prej tyre, qofshin kryesore ose të dyta, në periudhë me nënrenditje midis një fjalie kryesore dhe të varur prej saj dhe midis dy a më shumë fjalish të pavarura të mëvetësishme ose periudhash që formojnë thënie të lidhur¹⁷⁴.

Raportet sintaksore janë themeli i këtij disertacioni, prandaj edhe e zënë vendin kryesor gjatë analizës së rendit të fjalëve. Analiza e rendit të fjalëve në fjali bëhet duke u mbështetur në raportet sintaksore të një gjuhe të caktuar. Në gjuhën shqipe për shprehjen e raporteve sintaksore përdoren këto mjete: 1) morfologjike (trajtat e fjalëve ose eptimi apo fleksioni), 2) sintaksore (fjalët ndihmëse a shërbyese si lidhëzat dhe parafjalët, bashkimi nëpërmjet tyre, bashkimi i

¹⁷² Rushi, Th. 'Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe', Studime Filologjike – Nr. 4, 1984, f. 47-54.

¹⁷³ Përnaska, R. 'Një rast i veçantë i rendit të gjymtyrëve në fjalinë e përbërë në gjuhën shqipe', Studime Filologjike – Nr. 1, 1979, f. 158.

¹⁷⁴ Domi, M. 'Vepra I – Studime sintaksore', Kristalina KH, Tiranë, 2013, f. 130.

thjeshtë, topika dhe rendi) dhe 3) fonetike (intonacioni me pauzat)¹⁷⁵. Përdorimi i përbashkët i këtyre mjeteve bën që fjalët të lidhen në fjali dhe të kenë kuptim të plotë gramatikor-sintaksor dhe semantik.

Një karakteristikë e veçantë që e dallon gjuhën shqipe nga anglishtja, është se gjuha shqipe, si një gjuhë eptuese (flektive), ka një sistem të pasur trajtash morfologjike të cilat shërbejnë për krijimin e strukturave të shumta sintaksore; ka edhe lakim, edhe zgjedhim si një pasuri tjetër që mbizotëron gramatikën e gjuhës shqipe dhe këta e bëjnë gjuhën shqipe të ketë karakterin e një gjuhe sintetike¹⁷⁶. Edhe fjalët e ndryshme ndihmëse, parafjalët dhe lidhëzat shërbejnë për të shprehur raportet sintaksore dhe krijimin e fjalive të ndryshme.

Si Mahir Domi, edhe Thoma Dhima ka përmendur se ekzistojnë një sërë mjesh me anë të të cilëve shprehen lidhjet e fjalëve në sintagma dhe në fjali: 1) trajtat e fjalëve ose eptimi (fleksioni) si mjete morfologjike, 2) fjalët shërbyese, 3) rendi i fjalëve si mjet sintaksor dhe 4) intonacioni¹⁷⁷. Për ne me interes të veçantë janë fjalët shërbyese, rendi i fjalëve dhe intonacioni pasi na nevojiten për të analizuar lidhjen e kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit. Nëpërmjet tyre për ne bëhet më e lehtë analiza e fjalëve dhe gjetja e funksioneve sintaksore të tyre në fjali.

Pra, raportet gramatikore të gjuhës shqipe janë sintetike dhe analitike, kurse të gjuhës angleze janë kryesisht analitike. Sipas Nuhiut, gjuha shqipe a) është gjuhë flektive prandaj ka rend fjalësh relativisht të lirë, b) ka morfema të varura flektive të cilat vetvetiu përcaktojnë funksionin e tyre në raste të caktuara, c) funksioni gramatikor është i shënuar në fjalët shqipe, ç) rendi i fjalëve është në masë të madhe çështje stili, ndërsa në gjuhën angleze funksioni i fjalëve shënohet dhe identifikohet kryesisht nga konteksti dhe rendi i fjalëve zakonisht është mënyra e vetme për të dalluar funksionet e ndryshme të fjalëve në fjali¹⁷⁸. Për të përgjithësuar këtë ilustrim jepet një shembull i thjeshtë por shumë domethënës:

(89)

- a. *Jonida e këshilloi Jonin./Jonida advised Jon. (d. veprorë)*
- b. *Joni ishte këshilluar nga Jonida./Jon was advised by Jonida. (d. pësorë)*
- c. *Jonida Jonin e këshilloi./*Jonida Jon advised.*
- d. *Jonin e këshilloi Jonida./*Jon advised Jonida.*

¹⁷⁵ Domi, M. 'Vepra I – Studime sintaksore', Kristalina KH, Tiranë, 2013, f. 131.

¹⁷⁶ Po aty, f. 132.

¹⁷⁷ Dhima, T. 'Gjuha shqipe - Sintaksa', SHBLU, Tiranë, 2008, f. 40.

¹⁷⁸ Nuhiu, V. 'Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe', ASHAK, Prishtinë, 2013, f. 283.

- e. *Jonin Jonida e këshilloi./ *Jon Jonida advised.*
- f. *E këshilloi Jonida Jonin./ *Advised Jonida Jon.*
- g. *E këshilloi Jonin Jonida./ *Advised Jon Jonida.*

Nga shembujt e mësipërm mund të shihet se në gjuhën angleze vetëm dy shembujt e parë janë të saktë në aspektin gramatikor dhe semantik, ai në diatezën veprorë dhe pësorë. Për më tepër, kemi edhe një fjali gramatikisht të saktë në të dy gjuhët në aspektin gramatikor, por jo edhe në aspektin semantik në gjuhën angleze pasi që ndryshohet kryefjala dhe kundrinori në këtë rast. Pra:

(90)

- a. *Jonida e këshilloi Jonin./ Jonida advised Jon.*
- b. *Jonin e këshilloi Jonida./ *Jon advised Jonida.*

Në dy shembujt e mësipërm, fjalitë në gjuhën shqipe janë të barasvlershme për shkak të mbaresave rasore dhe kanë kuptim të njëjtë edhe pse kemi lëvizje të gjymtyrëve. Në fjalinë e parë në gjuhën angleze gjithçka është në rregull, por në fjalinë e dytë '*Jon advised Jonida.*' kemi rast ku fjalia është e saktë në aspektin gramatikor por jo edhe aspektin semantik pasi kemi krejtësisht ndryshim të funksioneve sintaksore kryefjalë-kundrinor. Themi kështu sepse fjalia e tillë përkthehet '*Joni këshilloi Jonidën.*' dhe nuk është e njëjtë me fjalinë e parë gjë që tregon se kryefjala dhe kundrinori kanë ndryshuar vendet dhe kanë marrë në mënyrë jo të drejtë funksionin e njëri-tjetrit. Ndryshimi i rendit të fjalëve në gjuhën angleze ndikon drejtpërdrejt në funksionin sintaksor të tyre.

Por përderisa deri këtu është përmendur vetëm rendi i fjalëve në fjali, shkurtimisht duhet diskutuar edhe rendi i fjalive dhe organizimi i sintagmës. Rendi i fjalive në gjuhën shqipe mund të jetë i ngulitur dhe i lirë, ku: 1) rendi i ngulur kushtëzohet nga struktura ose semantika e frazës në tërësi ose nga semantika e përbërësve kryesorë të saj (kryesisht e kuptimit të foljes së fjalisë kryesore) dhe njihet rendi i ngulur i fjalive në frazat me bashkërenditje, frazat asindetike dhe disa lloje frazash me nënrenditje, disa nënlojeve të fjalive kryefjalore, fjali kundrinore, fjali kallëzuesore, rrjedhimore, habitore, shkakore etj. dhe 2) rendi i lirë lidhet me vendin që zë fjalia e nënrenditur ndaj kryesores (me rend të drejtë dhe të anasjelltë) dhe ky rend kushtëzohet nga gjymtyrëzimi aktual i frazës (me rend neutral dhe afektiv)¹⁷⁹. Përveç se në fjali të thjeshta, rendi i fjalëve mund të ndryshojë edhe në grupin e frazave me nënrenditje. Totoni me termin frazë

¹⁷⁹ Totoni, M. '*Fraza me nënrenditje*', SHBLU, 2000, f. 34.

nënkupton fjalinë e përbërë. Si rrjedhim, rendi mund të jetë: 1) i përcaktuar nga struktura e frazës ku futen frazat ku fjalia e nënrenditur me rend të ngulur është e lidhur me një fjalë mbështetëse, fjalia e nënrenditur qëndron pas kryesores nëse gjendet pas kallëzuesit të fjalisë kryesore, qëndron në mes të kryesores nëse fjala mbështetëse ndodhet para kallëzuesit të kryesores dhe fjalia e nënrenditur i nënshtrohet gjymtyrëzimit aktual të frazës në lidhje me fjalën mbështetëse, dhe 2) i papërcaktuar nga struktura e frazës ku kemi rend të lirë dhe fjalia e nënrenditur mund të ketë dy ose tri pozicione të mundshme (në fillim, në mes apo në fund) dhe ky rend i lirë kushtëzohet nga gjymtyrëzimi aktual i frazës dhe vendi përcaktohet nga konteksti dhe nga ngarkesa kumtuese. Përveç kësaj, në gjymtyrëzimin aktual të frazës luan rol edhe intonacioni dhe konteksti, ndërsa në tipa të ndryshëm edhe mjete të tjera si rendi i fjalëve, përemri i patheksuar i vetës së tretë të kallëzores njëjës, lidhëzat *që* dhe *se*, disa pjesëza përforcuese dhe korrelatët që rimarrin fjalinë kryesore me të nënrenditurën¹⁸⁰.

Ekzistojnë disa rregulla për sa i përket rendit të gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura: 1) Rendi i fjalëve në fjalinë e nënrenditur është i drejtë përveç në fjalitë kryefjalore, në kundrinoret e në qëllimoret që lidhen me *të* dhe kushtoret që lidhen me *po*, *në*, *të*, kallëzuesi vihet në krye sepse këto elemente lidhëzore janë pjesë përbërëse e formave foljore, 2) Rendi i fjalëve në fjalitë e nënrenditura i nënshtrohet disa rregullave ku a) për rendin e fjalëve në fjalitë e nënrenditura duhet parë pozicioni i gjymtyrëve kryesore dhe të dyta, b) rendi i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura kushtëzohet nga arsyet strukturore (në fjalitë përcaktore), arsyet e peshës kumtuese të një gjymtyre a grup gjymtyrësh dhe nga nuancat e reja kuptimore që i mbishtohen kuptimit themelor dhe c) rendi i kryefjalës dhe kallëzuesit në fjalitë lidhëzore nuk varet nga pozicioni i mjetit lidhës, 3) Rendi i gjymtyrëve në fjalinë e nënrenditur është i lirë ose i ngulitur kryesisht për kallëzuesin, ndërsa për gjymtyrët e tjera rendi përcaktohet nga pesha kumtuese ku sa më larg foljes, aq më e madhe është pesha kumtuese e tyre, 4) Rendi është i lirë në raste të tjera i kushtëzuar nga gjymtyrëzimi aktual i fjalisë, 5) Lidhëzat asemantike dhe semantike që nuk kanë prejardhje nga ndajfoljet nuk ndikojnë në rendin e gjymtyrëve të fjalisë i cili është i lirë si në një fjali frazore dhe 6) Rendi i gjymtyrëve të fjalisë së nënrenditur në fjalitë që bashkohen me përemra a ndajfolje mund të jetë i lirë ose i ngulitur¹⁸¹. Nga e gjithë kjo mund të kuptojmë se përveç rregullave gramatikore, rëndësi të madhe në rendin e lirë të fjalëve ka pesha kumtuese

¹⁸⁰ Totoni, M. 'Fraza me nënrenditje', SHBLU, 2000, f. 35-37.

¹⁸¹ Po aty, f. 38-43.

dhe ajo mund të ndikojë në lëvizjen e gjymtyrëve. E njëjta gjë nuk mund të vlejë për gjuhën angleze.

Në gjuhën angleze janë zhvilluar disa teori për sa u përket përbërësve të fjalisë dhe rendit të tyre kur bëhen pjesë e fjalisë. Edhe pse rendi i fjalëve në fjali dhe studimi i tyre është studiuar shumë herët, këtu është e rëndësishme të përmenden Henry Weil, P. W. Schmidt, Joseph Greenberg dhe Lehman. Weil bën diferencimin e progresit sintaksor dhe progresit të ideve ku progresi sintaksor në njërën anë përmban rendin specifik të njësive sintaksore në një gjuhë sipas rendit ‘qenia që bën veprimin, veprimi, qenia mbi të cilin bie veprimi, qenia që preket nga veprimi sipas mënyrës, kohës, vendit të veprimit, etj.’, ndërsa progresi i ideve në anën tjetër fillon me atë që njihet dhe lëviz drejt të panjohurës¹⁸². Prej këtu rrjedh ideja se rendi i fjalëve në fjali nuk mbështetet vetëm në sintaksë, por edhe në pragmatikë dhe përmend edhe termat *konstrukt i fiksuar* dhe *konstrukt i lirë*¹⁸³, terma shumë të rëndësishëm për këtë disertacion pasi që ideja e gjithë disertacionit mbështetet në rendin e fjalëve në fjali, gjegjësisht nëse rendi është i lirë apo i fiksuar. Për dallim nga Weil, P. W. Schmidt ka qenë më ambicioz duke prezantuar një hierarki të parametrave¹⁸⁴ që ndikojnë drejtpërdrejt në rendin e fjalëve të fjalisë. Me një fjalë, Schmidt ka plotësuar idetë e Weil, por edhe ka theksuar se parametrat e tij mund të mos vlejë për të gjitha gjuhët.

Greenberg paraqet pjesën më të rëndësishme për sa i përket rendit të fjalëve në fjali. Prej këtu fillon përdorimi i termit *universale* dhe sipas tij ekzistojnë të ashtuquajturat *universale statistikore ose absolute* (ku të gjithë gjuhët kanë veçori të caktuar x’) dhe të ashtuquajturat *universale implikative ose relacionale* (nëse gjuha ka x, atëherë do të ketë edhe y’)¹⁸⁵ dhe me këtë u hap rruga për tipologjinë e fjalive, gjegjësisht rendin tipik të fjalëve në fjali të cilat sipas tij janë VSO¹⁸⁶, SVO dhe SOV. Teoria e Greenberg për sa i përket tipologjisë është plotësuar nga Lehman. Në fillim të viteve 70-ta Lehman prezantoi dy tipa fjalish dhe atë VO dhe OV¹⁸⁷ ku mund të shihet se kryefjala sipas tij nuk paraqet njësi thelbësore në tipologjinë e fjalive, por është folja gjymtyra më e rëndësishme në fjali. Prej këtu rrjedh edhe klasifikimi i gjuhëve në të gjithë botën duke u mbështetur në këtë teori, pra nëse një gjuhë është gjuhë VO ose OV, apo SVO ose

¹⁸² Weil, H. ‘The order of words in the ancient languages compared with that of the modern languages’, John Benjamins, 1978, f. 25.

¹⁸³ Po aty f. 29.

¹⁸⁴ Schmidt, P. W. ‘Die Sprachfamilien und Sprachenkreise der Erde’, Heidelberg: Carl Winter, 1926, f. 117.

¹⁸⁵ Greenberg, J. ‘Language Universals’, The Hague: Mouton, 1966, f. 127.

¹⁸⁶ S (Subject) – kryefjalë, V (Verb) – folje, O (Object) – kundrinor.

¹⁸⁷ Lehman, W. P. ‘A structural principle of language and its implications’ Lg, 1973, f. 51.

SOV ose VSO. Në bazë të këtij klasifikimi, si gjuha angleze ashtu edhe gjuha shqipe kanë rend të drejtë SVO¹⁸⁸.

Rendi i fjalëve në fjali kuptohet që mbështetet në teori të ndryshme. Teoria standarde dhe teoria standarde e zgjeruar janë themeli i gjuhësisë moderne dhe karakterizohen nga tre përbërës: 1) përbërësi sintaksor, 2) përbërësi fonologjik dhe 3) përbërësi semantik¹⁸⁹. Këta zhvillime hapën rrugën për analizën e plotë të fjalive duke marr parasysh të gjithë kategoritë e rëndësishme, atë sintaksore, fonologjike dhe semantike. Si rrjedhim, teoria X-bar është ajo që hapi rrugën për analizë të plotë të fjalive, jo vetëm në gjuhën angleze, por në të gjitha gjuhët e botës, përfshirë gjuhën angleze. Skema e pemës (ang. tree diagram) duke u bazuar në teorinë X-bar ishte dhe është një lehtësim shumë i madh për analizën e gjymtyrëve të fjalisë. Teoria X-bar është pjesë e programit ‘Parime dhe parametra’ dhe sintagmat i sheh si ‘projeksion X’ të kokave të tyre dhe ky proces derivimi mund të jepet me anë të një parimi të vetëm dhe kjo teori vlen për të gjitha gjuhët e botës¹⁹⁰. Për ta pasur më të qartë teorinë X-bar, më poshtë është dhënë projeksioni ku edhe analiza e fjalive varet nga një projeksion i tillë.




Figura 1. Skema X-bar¹⁹¹.

Teoria X-bar luan shumë rol të rëndësishëm për gjetjen e roleve sintaksore në fjali. Teoria X-bar mund të aplikohet në të gjitha gjuhët dhe analiza krahasuese hap rrugën për krahasimin e strukturës së sintagmave dhe fjalive të ndryshme.

¹⁸⁸ Andersen, P. K. ‘Word order typology and comparative constructions’, John Benjamins Publishing Company, 1983, f. 30.

¹⁸⁹ Chomsky, N. ‘Syntactic Structures’, Mouton de Gruyter, 2002, f. 18, 49, 61.

¹⁹⁰ Memushaj, R. ‘Gjuhësia gjenerative’, SHBLU, 2008, f. 145.

¹⁹¹ Po aty, f. 145.

Gërshetimi i të gjithë periudhave dhe teorive ka bërë që kategoritë dhe faktorët më të rëndësishëm të merren parasysh gjatë analizës së përbërësve të fjalisë dhe përcaktimit të funksioneve sintaksore. Përderisa në gjuhën shqipe gjuhëtarët më shumë janë përqendruar kryesisht në sqarime teorike për sa i përket rendit të fjalëve në fjali sesa në krijimin e skemave të ndryshme, në gjuhën angleze përcaktimi i roleve sintaksore dhe rendi i fjalëve në fjali mbështetet në masë të madhe në teoritë universale të përmendura më lart.

3.2. Lidhja kryefjalë-kallëzues-kundrinor në fjalitë e thjeshta

Për të krijuar fjali të saktë në aspektin gramatikor, gjymtyrët duhet të respektojnë disa rregulla. Gjymtyrët dhe rregullat e futjes së gjymtyrëve në fjali ka kohë që janë studiuar. Për gjuhë të ndryshme vlejnë rregulla të ndryshme gjuhësore, prandaj edhe këtu përmenden rregullat themelore të lidhjes së gjymtyrëve në fjali. Kur flitet për rendin e fjalëve në një gjuhë realisht mendohet për dy gjymtyrët kryesore (kryefjalën dhe kallëzuesin) dhe gjymtyrën tjetër më të rëndësishme dhe më të përdorur kundrinorin (e drejtë dhe të zhdrejtë), normalisht duke mos lënë asnjë gjymtyrë tjetër pas dore.

Ekzistojnë disa mjete për lidhjen e fjalëve në fjali për të përfutur fjali gramatikusht të saktë. Rendi i fjalëve dhe i gjymtyrëve është një nga mjetet më kryesore, i cili kushtëzohet nga faktorë dhe funksione të ndryshme. Në gjuhën shqipe rendi është kryesisht i lirë dhe zhvendosja bëhet kryesisht për peshën kumtuese, rëndësinë ose shprehjen emocionale. Meqenëse lëvizja e fjalëve në fjali është e lirë në gjuhën shqipe, funksionet sintaksore të gjymtyrëve duhet që të jenë të njëjta pavarësisht nga pozita në të cilën gjenden në fjali. Ky pohim nuk qëndron për gjuhën angleze pasi lëvizja e gjymtyrëve nuk është e lirë, si dhe në rast se bëhet zhvendosja e tyre atëherë mund të ndikojë në ndryshimin e funksioneve sintaksore.

Tema (ajo për të cilën bëhet kumtimi) dhe rema (ajo që kumtohet për temën) kanë rol në gjymtyrëzimin e fjalive dhe, si tema, ashtu edhe rema, mund të përbëhen nga një gjymtyrë e vetme fjalie, por mund të shprehen edhe me tog gjymtyrësh¹⁹². Në rolin e temës dhe remës (të thjeshta ose të zgjeruara) mund të dalin vetëm folja-kallëzues dhe gjymtyrët që lidhen

¹⁹² Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 414.

drejtpërdrejt me të, ndërsa gjymtyrët tjera hyjnë në përbërje të temës ose të remës nëpërmjet gjymtyrëve prej të cilave varen. Në gjuhën shqipe ekziston **rendi i drejtë** i gjymtyrëve (kryefjalë + kallëzues, kallëzues + kundrinor, kallëzues + rrethanor) dhe **rendi i anasjelltë** (kallëzues + kryefjalë, kundrinor + kallëzues etj.), si dhe **rendi neutral** (temë + remë) dhe **rendi emfatik afektiv** (remë + temë)¹⁹³. Ajo çfarë është thënë disa herë deri tani se gjuha shqipe ka kryesisht rend të lirë vërtetohet sipas ndarjes së lartpërmendur. Pozicioni i gjymtyrëve në gjuhën shqipe përveç ndarjes së lartpërmendur bëhet edhe sipas funksionit stilistikor, shprehës emocional (remë + temë) dhe sipas funksionit gramatikor të rendit të fjalëve (i cili është shumë i rëndësishëm për përcaktimin e funksioneve sintaksore të gjymtyrëve dhe ndihmon në dallimin e kryefjalës nga kundrinori i drejtë, kryefjala nga gjymtyra emërore e kallëzuesit, gjymtyra e përcaktuar nga ndajshimi i veçuar¹⁹⁴, etj.).

(91)

- a. *Joni bërtiti./Jon screamed.* (rend i drejtë)
- b. *Bërtiti Joni./*Screamed Jon. → Jon screamed.* (rend i anasjelltë)

Ajo çfarë mund të shihet menjëherë në këtë shembull të thjeshtë është se rendi në gjuhën shqipe mund të jetë i drejtë ose i anasjelltë dhe ndryshimi i rendit mund të bëhet për çështje stilistike ose emfatike. E njëjta nuk vlen për gjuhën angleze për shkak të rendit të fiksuar.

Në krahasim me gjuhën angleze, gjuha shqipe është më e komplikuar për sa i përket rendit të fjalëve në fjali, kryesisht për shkak të rendit të anasjelltë dhe kjo gjë vjen si pasojë e pasurisë gramatikore të gjuhës shqipe (mbaresave rasore), gjegjësisht numrin e madh të rasave. Prandaj, në gjuhën shqipe lidhjet sintaksore në fjali arrihen me anë të tri mjeteve gramatikore: 1) mbaresat rasore, 2) parafjalët dhe 3) rendi i fjalëve (gramatikor dhe stilistikor)¹⁹⁵. Ndryshe nga gjuha shqipe, mungesa e rasave në gjuhën angleze detyron folësin që të përdorë një rend kryesisht të fiksuar të gjymtyrëve (me përjashtime të vogla). Por ajo që nuk është përmendur deri tani për sa i përket rendit është intonacioni. Rendi i gjymtyrëve të fjalisë dhe rendi i pjesëve të thënies, nga njëra anë, dhe intonacioni, nga ana tjetër, janë dy mjetet themelore të formësimit të fjalisë dhe të thënies¹⁹⁶. Intonacioni është shumë i rëndësishëm veçanërisht për theksimin e një gjymtyre në fjali si dhe për fjalitë pyetëse. P.sh.:

¹⁹³ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 414.

¹⁹⁴ Po aty, f. 415.

¹⁹⁵ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 271.

¹⁹⁶ Po aty, f. 271.

(92)

- a. *Erdhi dita./Dita erdhi./The day has come.* (fjali dëftore)
- b. *Erdhi dita?Dita erdhi?/Has the day come?* (fjali pyetëse)

Përderisa në gjuhën shqipe ekziston rend i anasjelltë dhe i drejtë, si dhe përderisa intonacioni luan rol në theksimin (ndryshimin e vendit) e kryefjalës, në gjuhën angleze kemi vetëm rend të drejtë (të fiksuar) dhe intonacioni nuk luan rol për përcaktimin e rendit të gjymtyrëve dhe llojit të fjalisë. Shembujt më lart janë dy shembuj tipik në gjuhën shqipe ku intonacioni është faktor kyç për përcaktimin e llojit të fjalisë. Në gjuhën angleze nuk mund të themi ‘*The day has come?*’ pasi që ka rend të drejtë të një fjalisë dëftore, ndërsa për të pasur fjali pyetëse folja ndihmëse ‘*has*’ duhet të jetë në fillim të fjalisë. Intonacioni në gjuhën angleze nuk luan rol në rendin e gjymtyrëve, por luan rol në llojet e fjalisë, si pyetëse, urdhërore apo thirrmore.

Lidhja e kryefjalës dhe kallëzuesit foljor si në çdo gjuhë ashtu edhe në gjuhën shqipe zë vend kyç për shkak se bëhet fjalë për dy gjymtyrët kryesore. Kryefjala dhe kallëzuesi, ashtu siç kemi përmendur më herët, lidhen dhe përshtaten në vetë dhe numër. Përveç përshtatjes, me rëndësi është rendi i kryefjalës dhe i kallëzuesit. Rendi mund të jetë i drejtë, neutral ose emfatik, por mund të jetë edhe i anasjelltë e neutral kur nuk ka temë dhe të dy kryegjymtyrët përbëjnë remën¹⁹⁷ (kallëzues-kryefjalë). P.sh.:

(93)

- a. *Vajza këndoi./The girl sang.* (rend i drejtë: kryefjalë-kallëzues)
- b. *Këndoi vajza./*Sang the girl.* (rend i anasjelltë: kallëzues-kryefjalë)

Sërish, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për rend të drejtë, të anasjelltë ose emfatik, në gjuhën shqipe lëvizja e gjymtyrëve nuk përbën problem për të pasur një fjali të saktë gramatikore, por në gjuhën angleze përmbysja e rendit të drejtë nuk prodhon fjali të saktë në aspektin gramatikor.

Kryefjala dhe kallëzuesi emëror përbën rend me interes në gjuhën shqipe për shkak se për të pasur kallëzues emëror folja duhet të jetë folje këpujore dhe e njëjta vlen për gjuhën shqipe dhe angleze. Te kjo lidhje rendi në gjuhën shqipe normalisht është i drejtë dhe neutral çdoherë kur kryefjala është tema dhe pjesa emërore është rema, por mund të jetë edhe rend i përmbysur,

¹⁹⁷ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 416.

pra këpujë + pjesë emërore + kryefjalë ose pjesë emërore + këpujë + kryefjalë¹⁹⁸. Kallëzuesi emëror, edhe pse është gjymtyrë e dytë, është diskutuar në këtë pjesë pasi lloji i kallëzuesit (me folje këpujë) na imponon të diskutohet më herët për shkak se qëndron menjëherë pas foljes, por njëkohësisht edhe para por me kusht që të jetë afër foljes.

(94)

- a. *Hekuri ishte i nxehtë./The iron was hot.* (rend i drejtë)
- b. *Ishte i nxehtë hekuri./*Was hot the iron.* (rend i anasjelltë)
- c. *I nxehtë ishte hekuri./*Hot was the iron.* (rend i anasjelltë)

Përderisa në gjuhën shqipe rendi i anasjelltë është i mundur, në gjuhën angleze një gjë e tillë nuk është e mundur pasi kryefjala duhet të jetë në fillim të fjalisë dhe lëvizja e saj në pozicion tjetër e bën fjalinë gramatike të pasaktë. Në të tri rastet fjalia në gjuhën angleze do të përkthehej ‘*The iron was hot.*’ Por duhet theksuar se rendi i anasjelltë normalisht përdoret në vepra letrare kur nevojitet rendi emfatik, ndërsa rendi i drejtë në gjuhën standarde.

Rendi **kryefjalë + kallëzues + përcaktor kallëzuesor** në gjuhën shqipe është i drejtë neutral kur kryefjala është tema e thënies ndërsa rema përbëhet nga grupi i kallëzuesit¹⁹⁹. Duhet theksuar edhe njëherë se përcaktori është një term i diskutueshëm në gjuhën shqipe për ndryshim nga gjuha angleze. Themë kështu për shkak se në gjuhën shqipe ekzistojnë dyshime nëse përcaktori kallëzuesor mund të pranohet si gjymtyrë e veçantë²⁰⁰, ndërsa në gjuhën angleze përcaktori thjeshtë konsiderohet si një plotësor (ang. complement) dhe më pas mund të ketë një rol të caktuar sintaksor (kallëzues emëror [ang. subject complement] ose përcaktor kallëzuesor i kundrinorit/kallëzuesor i kundrinorit [ang. object complement]). Në gjuhën angleze përcaktori konsiderohet pjesë përbërëse e një gjymtyrë/fraze të caktuar ose më saktë pjesë e sintagmës emërore, e jo si gjymtyrë në vete si në gjuhën shqipe.

(95) *Djemtë mbetën të fundit./The boys remained last.*

Nga ky shembull del dallimi i parë në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Përderisa të *fundit* në gjuhën shqipe konsiderohet si një përcaktor kallëzuesor, në gjuhën angleze *last* konsiderohet kallëzues emëror. Kjo ndodh për shkak se folja ‘*remained*’ në gjuhën angleze është folje këpujore dhe ndikon drejtpërdrejt në përcaktimin e këtij funksioni sintaksor. Në gjuhën

¹⁹⁸ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 416.

¹⁹⁹ Po aty, f. 416.

²⁰⁰ Çeliku, M. ‘Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde (Pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura)’, Tiranë, 2007, f. 89.

angleze pjesa pas foljes këpujore konsiderohet plotësor, prandaj *last* përveç se është kallëzues emëror është edhe plotësor. Ajo çfarë na intereson neve këtu është rendi. Në fjalinë e dhënë më sipër mund të shihet se rendi nuk ndryshon në këtë lloj strukture gjymtyrore.

Rendi **kryefjalë + kallëzues + kundrinor i drejtë + përcaktor kallëzuesor** është i drejtë dhe neutral²⁰¹. Në krahasim me situatën më lart ku kishim vetëm kryefjalë, kallëzues dhe përcaktor kallëzuesor, këtu situata ndryshon dhe kemi përputhje si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze.

(96) *Ata e bënë vendin të pabanueshëm./They made the place inhabitable.*

Në të dy shembujt kemi përcaktorë kallëzuesorë pasi që tani logjikisht edhe në gjuhën angleze përcaktori kallëzuesor është i lidhur me kundrinorin *vendin/the place* dhe jo me kryefjalën *ata/they*.

Rendi **kryefjalë + kallëzues + kundrinor i drejtë** mund të ketë rend të drejtë ose të anasjelltë në gjuhën shqipe²⁰².

(97)

- a. *Unë bleva një makinë të re./I bought a new car.* (rend i drejtë)
- b. *Një makinë të re bleva unë./A new car bought I.* (rend i anasjelltë)

Në dy shembujt më sipër mund të shihet se në gjuhën shqipe lëvizja e gjymtyrëve nuk paraqet asnjë problem për shkak të mbaresave rasore dhe rendit të lirë. Por në gjuhën angleze mund të shihet fare lehtë se rendi i anasjelltë krijon një fjali të pasaktë në aspektin gramatikor. Por lëvizja e gjymtyrëve në fjali jo në të gjitha rastet është e mundur në gjuhën angleze. Është kundrinori ai i cili është më problematik për gjetjen e funksioneve sintaksore në gjuhën shqipe, për dallim nga gjuha angleze. Rendi i drejtë ndonjëherë është i detyrueshëm për të bërë dallimin ndërmjet kryefjalës dhe kundrinorit. Me vetë këtë lëvizje të kryefjalës dhe të kundrinorit ndonjëherë krijohet vështirësi për të bërë identifikimin e tyre. Për ta pasur më të qartë këtë pohim japim shembullin e mëposhtëm:

(98)

- a. *Gëzimet kanë larguar mërzitë./Mërzitë kanë larguar gëzimet.*
- b. *The joy has taken away the sadness./The sadness has taken away the joy.*

²⁰¹ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 417.

²⁰² Po aty, f. 417.

Ky shembull është një shembull tipik për të ilustruar vështirësinë e identifikimit të kryefjalës dhe të kallëzuesit. Është rendi i gjymtyrëve ai i cili është kyç për identifikimin e saktë të tyre në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze dhe këtu merret për bazë rendi i drejtë i gjymtyrëve, gjegjësisht kryefjalë-kallëzues-kundrinor i drejtë. Rendi i drejtë është i rëndësishëm për këto lloj fjalish kur kemi emër në rasën emërore ose në kallëzore të cilët formalisht nuk dallojnë. Rastet të tilla kemi kur kundrinori shprehet me emër me nyje joshquese, pa nyjë, me një togfjalësh ose me emër të shquar dhe nuk rimerret me trajtë të shkurtër²⁰³. Ndodh që herë pas here të hasim fjali të tilla dhe duhet rikujtuar se mënyra e vetme për të gjetur funksionet sintaksore mbetet rendi i fjalëve. Pra, në shembullin e mësipërm në rastin e parë fjala *gëzimet* është kryefjalë dhe *mërzitë* kundrinor i drejtë, ndërsa në rastin e dytë kemi situatë të kundërt, gjegjësisht *mërzitë* si kryefjalë dhe *gëzimet* si kundrinor i drejtë dhe të dy fjalitë në fakt kanë rend të drejtë në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze pasi ndryshon edhe kuptimi i tyre, gjegjësisht bëhet fjalë për dy fjali të ndryshme.

Kundrinor i drejtë + kallëzues + kryefjalë mund të ketë rend neutral apo të anasjelltë dhe përbën rend mjaft të shpeshtë në gjuhën shqipe. Kundrinori herë mund të jetë temë, herë mund të jetë remë. Ky rend është i mundur për shkak të pasurisë rasore të gjuhës shqipe dhe rendit të lirë të gjymtyrëve. Fillimisht fjalinë e japim sipas rendit të drejtë sa për krahasim me rendin e anasjelltë:

(99) *Djali bleu një lule./The boy bought a flower.* (rend i drejtë)

Më poshtë fjalia e njëjtë është dhënë me rend të anasjelltë:

(100)

a. *Një lule bleu djali./*A flower bought the boy. → The boy bought a flower.*
(r. i anasjelltë)

b. *Një lule djali bleu./*A flower the boy bought.*

Këtu kemi dy situata të ndryshme kur fjalitë e ngjashme në aspektin gramatikor në gjuhën shqipe përkthehen në gjuhën angleze. Përderisa në rastin e parë në gjuhën shqipe kundrinori i drejtë mund të qëndrojë në pozicion fillestar pa asnjë problem, në gjuhën angleze një gjë e tillë nuk është e mundur për shkak se *një lule* nuk mund të blejë *një djalë*. Prandaj, nëse kërkohet përkthimi i fjalisë së parë atëherë kundrinori në gjuhën angleze shkon pas kallëzuesit duke respektuar rendin e drejtë/të fiksuar. Por një situatë interesante del me shembullin e dytë. Në fjalinë e dytë kryefjala është në rasën emërore dhe si e tillë është e lehtë të kuptohet se bëhet fjalë

²⁰³ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 417.

për fjalën *oficeri*. Por në përkthimin e bërë në gjuhën angleze fjalia ‘*Nothing revealed the officer.*’ ka kuptim të plotë gramatikor por nuk përputhet nga ana kuptimore me përkthimin në gjuhën shqipe për shkak se fjalia e njëjtë në gjuhën shqipe do të ishte ‘*Asgje nuk e zbuloi oficerin.*’. Në këtë rast kemi ndryshim të roleve sintaksore, gjë që nuk përputhet me fjalinë në gjuhën shqipe. Përkthimi i saktë i fjalisë ‘*Asgjë nuk zbuloi oficeri.*’ do të ishte ‘*The officer revealed nothing.*’ dhe me këtë ruhet kuptimi i fjalisë dhe ruajtja e funksioneve sintaksore me anë të respektimit të rendit të drejtë/të fiksuar në gjuhën angleze.

Në shembullin e tretë më lart mund të shohim se në gjuhën shqipe kemi rend **kundrinor i drejtë + kryefjalë + kallëzues** dhe është një rend plotësisht i pranueshëm dhe fjali e saktë në aspektin gramatikor dhe semantik. Këtu luan rol shumë të rëndësishëm intonacioni duke spikatur kundrinorin e drejtë dhe duke e bërë më të lehtë dallimin e kryefjalës dhe të kundrinorit të drejtë.

Rendi **kryefjalë + kallëzues + kundrinor i zhdrejtë** është rend i drejtë neutral në gjuhën shqipe dhe kundrinori i zhdrejtë bart theksin dhe është remë e thënies ose pjesë e saj²⁰⁴. Përderisa në gjuhën shqipe fjalitë me këtë rend janë të shpeshta, në gjuhën angleze rrallëherë mund të hasim fjali e cila përmban vetëm kundrinor të zhdrejtë pa një kundrinor të drejtë dhe arsyeja për këtë është sqaruar në kreun pararendës. Mund të ndodhë që kundrinori i zhdrejtë në gjuhën shqipe të jetë kundrinor i drejtë në gjuhën angleze.

Gj.shqipe/Gj.angleze

(101)

- a. *Unë i shkrova asaj një letër./I wrote her a letter.* (k. zhdrejtë/k. zhdrejtë)
- b. *Djemtë e fituan lojën./The boys won the game.* (k. drejtë/k. drejtë)
- c. *Beni i tha mësueses./Ben told the teacher.* (k. zhdrejtë/k. drejtë)
- d. *Njerëzit iu larguan rrezikut./The people fled the danger.* (k. zhdrejtë/k. drejtë)

Fjalitë më lart ilustronë se si kundrinori i zhdrejtë në gjuhën shqipe mund të jetë kundrinor i drejtë në gjuhën angleze. Si me kundrinorin e drejtë, ashtu edhe kundrinori i zhdrejtë në gjuhën shqipe mund të gjendet në pozita të ndryshme. Ndryshimi i pozicionit të kundrinorit të zhdrejtë vjen si pasojë e rendit neutral ose emfatik. Për ta pasur më të qartë merren shembujt e njëjtë nga më lart.

Rendi **kundrinor i zhdrejtë + kallëzues + kryefjalë**:

²⁰⁴ Akademia e Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 2”, Tiranë, 2002, f. 418.

(102) *Asaj i tha Joni./ *Her told Jon.*

Duhet theksuar se fjali të tilla janë të rralla dhe kryesisht hasen në gjuhën e folur dhe jo të shkruar, ngjashëm si për rendin e mëposhtëm të gjymtyrëve. Me kësi fjalish duhet theksuar se intonacioni luan rol shumë të rëndësishëm pasi që zëri ngrihet në gjymtyrën që theksohet më së shumti, si në rastin e mësipërm ku theksi bie mbi kundrinorin e zhdrejtë. Në gjuhën angleze një fjali e përkthyer me rend të njëjtë si në gjuhën shqipe shihet qartë se është krejtësisht e pasaktë në aspektin gramatikor. Për sa i përket rendit, mund të shihet se shembulli më lart nuk është i saktë në gjuhën angleze pasi që kundrinori i zhdrejtë nuk mund të dalë në pozicion fillestar.

Rendi **kundrinor i zhdrejtë + kryefjalë + kallëzues**:

(103) *Asaj Joni i tha./ *Her Jon told.*

Në bazë të shembujve mund të shihet se lëvizja e kundrinorit të zhdrejtë nuk ndikon në saktësinë e fjalisë në aspektin gramatikor por ndikon vetëm në aspektin e theksimit, pra ku bie intonacioni, por një lëvizje e tillë nuk është e mundur në gjuhën angleze për shkak të kufizimit të sistemit rator. Këtu mund të shihet se nuk mund të përdorim rendin ku kallëzuesi vjen i pari për shkak se rendi i tillë është tipik për fjalitë pyetëse, e jo për fjalitë dëftore, p.sh. *'Asaj Joni i tha?'*. Intonacioni luan rol të rëndësishëm si për rendin kur kundrinori del në fillim të fjalisë, si në rastet kur kemi fjali pyetëse.

Rendi **kryefjalë + kallëzues + kundrinor i zhdrejtë me parafjalë** është i ngjashëm si me kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë. Më saktë, kundrinori mund të ndryshojë pozicion në gjuhën shqipe. P.sh.:

(104) *Dhoma ishte mbushur me tym./ The room was filled with smoke.*

Duhet theksuar se ekziston një dallim për sa i përket përdorimit të termit kundrinor i zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe dhe kundrinor me parafjalë në gjuhën angleze (ang. object of preposition). Dallimi përfundon këtu, pra vetëm te termi e jo te koncepti pasi që flitet për të njëjtën gjë. Duke u nisur nga ky qëndrim, *me tym* dhe *with smoke* janë kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë. Si me kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë, edhe këtu mund të kemi rend të anasjelltë në gjuhën shqipe:

Rendi **kundrinor i zhdrejtë me parafjalë + kallëzues + kryefjalë**:

(105) *Me tym ishte mbushur dhoma./ *With smoke was filled the room.*

Si kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë, ashtu edhe ai me parafjalë në gjuhën angleze nuk mund të qëndrojë në fillim të fjalisë. Është e rëndësishme të theksohet se kundrinori i zhdrejtë

me parafjalë në gjuhën shqipe mund të prapavendoset pas kallëzuesit duke formuar rendin **kallëzues + kundrinor i zhdrejtë me parafjalë + kryefjalë** ose **kallëzues + kryefjalë + kundrinor i zhdrejtë me parafjalë**:

(106)

- a. *Ishte mbushur me tym dhoma./ *Was filled with smoke the room.*
- b. *Ishte mbushur dhoma me tym./ *Was filled the room with smoke.*

Në të dy rastet e mësipërme në gjuhën shqipe lëvizja e gjymtyrëve mund të bëhet për të theksuar diçka si më të rëndësishme dhe ky ndryshim shoqërohet edhe me ndryshim të intonacionit. Në gjuhën angleze asnjëri rend nuk është i mundur dhe fjalitë të cilat fillojnë me kallëzues në fillim janë fjalitë urdhërore kur u mungon kryefjala (kryefjala është e nënkuptuar).

Në rastet kur kemi folje trevalente, atëherë kemi situatë më të komplikuar, gjegjësisht kemi edhe kundrinor të drejtë edhe kundrinor të zhdrejtë. Si rrjedhim, kemi këtë rend të drejtë: **kryefjalë + kallëzues + kundrinor i zhdrejtë + kundrinor i drejtë**:

(107) *Joni i bleu Jonidës një biçikletë./ Jon bought Jonida a bike.*

Ky rend mund të jetë edhe ndryshe dhe konsiderohet rend i drejtë duke lëvizur gjymtyrët e dyta, gjegjësisht kundrinorët të zënë vendin e njëri-tjetrit. Në këtë rast fjalia ka rendin **kryefjalë + kallëzues + kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë**²⁰⁵:

(108) *Joni i bleu një biçikletë Jonidës./ Jon bought a bike to Jonida.*

Përderisa në gjuhën shqipe nuk ka asnjë ndryshim në aspektin e rasës apo mbaresave, në gjuhën angleze shtohet parafjala *to* para kundrinorit të zhdrejtë për shkak të rasës së emrit. Kjo është një situatë e zakonshme në gjuhën angleze pasi njihet si rend i drejtë dhe gramatikor. Më lart janë dhënë shembuj kur kundrinorët (e drejtë dhe të zhdrejtë) mund të paravendosen në fjali duke zënë pozitën fillestare. E njëjta gjë është e mundur edhe në këtë rast. Pra, në gjuhën shqipe mund të kemi edhe rendet si më poshtë varësisht nga gjuha e përdorur, gjuhë standarde ose jo, stil letrar ose jo:

Kundrinor i drejtë + kryefjalë + kallëzues + kundrinor i zhdrejtë:

(109) *Një biçikletë Joni i bleu Jonidës./ *A bike Jon bought Jonida.*

Kundrinor i drejtë + kallëzues + kryefjalë + kundrinor i zhdrejtë:

(110) *Një biçikletë i bleu Joni Jonidës./ *A bike bought Jon Jonida.*

Kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë + kryefjalë + kallëzues:

²⁰⁵ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 273.

(111) *Një biçikletë Jonidës Joni i bleu./*A bike Jonida Jon bought.*

Kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë + kallëzues + kryefjalë:

(112) *Një biçikletë Jonidës i bleu Joni./*A bike Jonida bought Jon.*

Kundrinor i zhdrejtë + kryefjalë + kallëzues + kundrinor i drejtë:

(113) *Jonidës Joni i bleu një biçikletë./Jonida Jon bought a bike.*

Kundrinor i zhdrejtë + kallëzues + kryefjalë + kundrinor i drejtë:

(114) *Jonidës i bleu Joni një biçikletë./**Jonida bought Jon a bike²⁰⁶.*

Kundrinor i zhdrejtë + kundrinor i drejtë + kryefjalë + kallëzues:

(115) *Jonidës një biçikletë Joni i bleu./*Jonida a bike Jon bought.*

Kundrinor i zhdrejtë + kundrinor i drejtë + kallëzues + kryefjalë:

(116) *Jonidës një biçikletë i bleu Joni./*Jonida a bike bought Jon.*

Kallëzues + kryefjalë + kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë:

(117) *I bleu Joni një biçikletë Jonidës./*Bought Jon a bike Jonida.*

Kallëzues + kryefjalë + kundrinor i zhdrejtë + kundrinor i drejtë:

(118) *I bleu Joni Jonidës një biçikletë./*Bought Jon Jonida a bike.*

Kallëzues + kundrinor i zhdrejtë + kryefjalë + kundrinor i drejtë:

(119) *I bleu Jonidës Joni një biçikletë./*Bought Jonida Jon a bike.*

Kallëzues + kundrinor i drejtë + kryefjalë + kundrinor i zhdrejtë:

(120) *I bleu një biçikletë Joni Jonidës./*Bought a bike Jon Jonida.*

Kallëzues + kundrinor i zhdrejtë + kundrinor i drejtë + kryefjalë:

(121) *I bleu Jonidës një biçikletë Joni./*Bought Jonida a bike Jon.*

Kallëzues + kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë + kryefjalë:

(122) *I bleu një biçikletë Jonidës Joni./*Bought a bike Jonida Jon.*

Një lëvizje e lirë e gjymtyrëve në shembujt e mësipërm lejohet nga sistemi rasor i gjuhës shqipe, pavarësisht nëse tingëllojnë mirë ose jo. Normalisht, një lëvizje e tillë kufizohet edhe nga intonacioni. Nëse gjatë ligjërimit nuk përdoret intonacioni i duhur, një rend i përmbysur nuk do të ishte natyror. Intonacioni apo ngritja e zërit në një gjymtyrë të caktuar bëhet me qëllim të theksimit si diçka më të rëndësishme që dëshirojmë ta theksojmë dhe është njëra ndër arsytet për vendosjen e një gjymtyrë në një vend të caktuar, gjegjësisht në pozitë fillestare.

²⁰⁶ **Në këtë shembull bëhet ndryshimi i rolit të kryefjalës dhe të kallëzuesit dhe përkthimi i bërë nuk korrespondon me fjalinë në gjuhën shqipe nga ana kuptimore, edhe pse fjalia në gjuhën angleze është e saktë në aspektin gramatikor.

Për të përmbledhur lidhjen e gjymtyrëve dhe rendin e drejtë²⁰⁷ të kryefjalës, kallëzuesit, kundrinorit dhe kallëzuesorit, rendi i drejtë sipas Çelikut është:

- 1) kryefjalë + kallëzues (*Jonida këndon./Jonida sings.*)
- 2) kallëzues + kundrinor i drejtë (*Jonida këndon një këngë./Jonida sings a song.*)
- 3) kallëzues + kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë (*Jonida i këndon një këngë Jonit./Jonida sings a song to Jon.*)
- 4) folje këpujë + kallëzuesor (*Ajo është e bukur./She is beautiful.*)
- 5) folje këpujë + kundrinor i drejtë + kallëzuesor i kundrinorit (*Ata e zgjedhen Jonin kryetar./They elected Jon president.*)

Rendi i përshkruar në gjuhën shqipe nga Çeliku është i mundur edhe në gjuhën angleze për shkak se bëhet fjalë për rend të drejtë të fjalëve në fjali dhe shembujt kanë pasqyruar se një gjë e tillë është e mundur. Ky rend është i njëjtë me rendin e gjymtyrëve në gjuhën angleze, çka pasqyrohet edhe në gramatikalitetin e fjalive të përkthyer.

Gjuha angleze në krahasim me gjuhën shqipe për sa i përket rendit të kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit është shumë më e thjeshtë, sepse, duke krahasuar gjuhën shqipe me gjuhën angleze nga shembujt e dhënë deri tani, mund të vërehet se vetëm rendi i drejtë i paraqitur më sipër është rend i pranuar në gjuhën angleze, me përjashtim të fjalive urdhërore, fjali të tipit me *Let me/us* etj.

Rregullat e lidhjes së kryefjalës dhe kallëzuesit në gjuhën angleze janë sqaruar më herët. Ato rregulla u përkasin rregullave gramatikore siç është përshtatja e kryefjalës dhe kallëzuesit në vetë dhe numër. Por, lidhja e gjymtyrëve, në veçanti e kryefjalës me kallëzuesin, bazohet në tre parime: 1) parimi i lidhjes gramatikore – që ka të bëjë me formën gramatikore, 2) parimi i lidhjes nocionale dhe 3) parimi i afërsisë²⁰⁸. Parimi i parë është i qartë nga vetë emërtimi i tij. Por ajo çfarë dëshirojmë të sqarojmë për parimin e dytë është se ai vjen në shprehje atëherë kur përshtatja e kryefjalës dhe kallëzuesit varet nga kuptimi dhe jo nga forma (p.sh. emrat përmbledhës, emrat e lëndës). Parimi i tretë është ngushtë i lidhur me parimin e dytë pasi që ai përdoret për t'i ardhur në ndihmë parimit të dytë. Dallimi ndërmjet të parit dhe të dytit është se parimi i dytë merr parasysh kuptimin, ndërsa parimi i tretë edhe kuptimin edhe afërsinë e fjalëve që mund të kenë ndikim në numrin e foljes.

²⁰⁷ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 273.

²⁰⁸ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A Comprehensive Grammar of the English Language”, Longman, 1985, f. 766.

Në gjuhën angleze në fjalitë e thjeshta ekzistojnë shtatë rende të gjymtyrëve. Rendi i drejtë dhe tipat e rendit të drejtë mbështetet nga pjesa dërrmuese e gjuhëtarëve në gjuhën angleze, ashtu siç kemi përmendur më herët. Ky rend normalisht është për fjalitë e thjeshta por i njëjti vlen edhe për fjalitë e përbëra. Ajo çfarë bie në sy në lidhje me rendin e gjymtyrëve është se kryefjala çdoherë është në pozitë fillestare dhe pas kryefjalës qëndron menjëherë kallëzuesi. Kështu, kemi një lidhje të pandarë të kryefjalës dhe të kallëzuesit në gjuhën angleze. Edhe njëherë, në gjuhën angleze ekzistojnë këto rende të drejta të gjymtyrëve kryesore dhe të dyta:

Rendi **kryefjalë + kallëzues**²⁰⁹ në gjuhën angleze formohet me folje jokalimtare. Folja në këtë rend është jokalimtare për të dyja gjuhët, shqipe dhe angleze. Shembujt janë të shumtë për të dyja gjuhët dhe ky rend është rend i drejtë edhe për gjuhën shqipe. Ky është njëkohësisht edhe rendi më i thjeshtë pasi që formohet me kallëzues të shprehur me folje njëvalente. P.sh.:

(123)

- a. *Jon sleeps./ Joni fle.*
- b. *The girl is singing./Vajza po këndon.*

Në gjuhën angleze shumë rrallë mund të kemi rend të anasjelltë ndërmjet kryefjalës dhe kallëzuesit. Rendi i anasjelltë **kallëzues + kryefjalë** në gjuhën angleze ekziston në raste shumë të rralla vetëm kur ky rend është i plotësuar me plotësorë (rrethanor) ose operator, apo me diatezë pësore²¹⁰.

(124)

- a. *In a distant place **his family lies**./Në një vend të largët **familja e tij pushon**.* (rend i drejtë)
- b. *Here comes **my beloved family**./Ja ku vjen **familja ime e dashur**.* (r. i anasjelltë)

Në këtë rast plotësori (rrethanori) del në fillim të fjalisë me qëllim të arritjes së një stili të caktuar. Në rastin e parë kemi një stil i cili përdoret më së shumti në të shkruar apo më saktë stil letrar, ndërsa në rastin e dytë kemi një stil i cili përdoret më shumë në biseda joformale dhe jo në forma të shkruara.

Operatori (në ang. operator) në gjuhën angleze duhet patjetër të përmendet. Në rastet kur kemi operator, atëherë kemi rend të anasjelltë, gjegjësisht **kallëzues + kryefjalë**. P.sh.:

²⁰⁹ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. "A Comprehensive Grammar of the English Language", Longman, 1985, f. 53.

²¹⁰ Po aty, f. 1379-1392.

(125)

- a. *They must leave and so **must you**.*/Ata duhet të largohen dhe kështu **duhet ti**.
- b. *The boys were happy. So **were we**.*/Djemtë ishin të lumtur. Edhe ne/Kështu ishim edhe ne.

Në rastet me operator ndodh që mos kemi strukturë dhe rend të njëjtë. Përderisa rregulla për rendin e anasjelltë të operatorit funksionon pa problem për gjuhën angleze, në gjuhën shqipe nuk mund të kemi një përkthim të përshtatshëm për shembullin e dytë pasi që në gjuhën shqipe format me operator *So was/were...* kanë marrë formë shprehjesh dhe si në shembullin më lart përkthehen *Kështu ishim edhe ne* dhe nuk duhet të thuhet *Edhe unë/ti* etj.

Kallëzuesi emëror (dhe kallëzuesori i kundrinorit) është diskutuar këtu për shkak se kallëzuesi emëror është drejtpërdrejt i lidhur me folje këpujore. Në gjuhën angleze kallëzuesi emëror konsiderohet gjymtyrë e veçantë dhe jo gjymtyrë e lidhur në mënyrë të pandashme në aspektin sintaksor me kallëzuesin. Gjatë analizës sintaksore kallëzuesi emëror analizohet si gjymtyrë e veçantë dhe është kategori në vete.

Rendi **kryefjalë + kallëzues + kallëzues emëror** është rend i drejtë i fiksuar në gjuhën angleze. Për të pasur kallëzues emëror folja duhet patjetër të jetë folje këpujore²¹¹. Shembujt janë të shumtë, si në gjuhën angleze ashtu edhe në gjuhën shqipe. P.sh.:

(126)

- a. *The family is happy.*/Familja është e lumtur.
- b. *All the members of the club were hurt.*/Të gjithë anëtarët e klubit ishin të lënduar.

Në rendin e drejtë kryefjalë + kallëzues + kallëzues emëror në gjuhën angleze paraqitet një situatë ndryshe kur kryefjala shprehet me përemrin *it*. Në rastet e tilla, kryefjala e zhvendosur është më shumë sesa një kryefjalë e zbrazët dhe rezulton me një rend të drejtë por njëkohësisht edhe të anasjelltë. Shembulli më poshtë është dhënë për të qartësuar këtë situatë:

(127) *It is useless to go back.*/Është e padobishme të kthehem.

Në këtë shembull mund të shihet se kryefjala e vërtetë në gjuhën angleze është *'to go back'* (kryefjalë e shprehur me paskajore) dhe në fillim të fjalisë qëndron kryefjala e zbrazët *'it'*. Këto

²¹¹ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. "A Comprehensive Grammar of the English Language", Longman, 1985, f. 56.

janë tipa fjalish ku një zhvendosje e tillë është e domosdoshme për të arritur një stil të caktuar. Përndryshe, në rast se nuk do të kishim një zhvendosje të tillë fjalia do të ishte ‘*To go back is useless*’. Nga ky transformim është e lehtë të kuptohet se kryefjala e vërtetë si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin është ‘*to go back*’. Por në gjuhën shqipe kemi situatë ndryshe ku nuk kemi dy kryefjalë si në gjuhën angleze, por kemi një kryefjalë ‘*të kthehemi*’ e cila njëjtë si në gjuhën angleze ka lëvizur në pozicionin final pas kallëzuesit emëror. Pra, kryefjala e zbrazët *it* në gjuhën angleze paraqitet në rastet kur kryefjala e vërtetë zhvendoset në fund dhe zëvendësohet me përemrin *it*, ndërsa në gjuhën shqipe një gjë e tillë nuk është e mundur për shkak se nuk ekziston formë kanonike e këtillë dhe kryefjala nuk mund të zëvendësohet me përemër. Pra, rendi në fjalitë me këtë përbërje është i drejtë dhe i fiksuar dhe nuk mund të kemi lëvizje të lirë të gjymtyrëve.

Për të pasur fjali me kallëzuesor të kundrinorit në gjuhën angleze duhet patjetër që të kemi edhe kundrinor të drejtë brenda saj. Ky është kusht pasi kallëzuesori i kundrinorit është i lidhur drejtpërdrejt me kundrinorin e drejtë dhe i referohet atij. Rendi i drejtë në gjuhën angleze është **kryefjalë + kallëzues + kundrinor i drejtë + kallëzuesor i kundrinorit**²¹². Si me kallëzuesin emëror, ashtu edhe me kallëzuesorin e kundrinorit kryefjala përveç që mund të jetë një kryefjalë e rregullt, mund të shprehet edhe me përemrin *it* (duke funksionuar si kryefjalë e zbrazët).

(128)

- a. *They called him a traitor./Ata e quajtën atë tradhtar.*
- b. *Anna made her hair curly./Ana i bëri flokët e saj kaçurrele.*

Siç u tha më lart, rendi i njëjtë mund të përdoret edhe në rastet kur kryefjala e vërtetë është zhvendosur në fund:

(129) *It makes her sad to see other people suffering./*Ajo mërzhitet kur sheh njerëz të tjerë duke vuajtur.*

Nga dy shembujt më lart, njëjtë si me kallëzuesin emëror, ashtu edhe me kallëzuesorin e kundrinorit, kemi përputhje ndërmjet gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe në aspektin e roleve sintaksore. Kjo vjen si pasojë e asaj që fjalia mund të përkthehet dhe të ruajë strukturën si në gjuhën angleze. Por në rastin kur kryefjala e vërtetë *to see other people suffering* është zhvendosur në fund dhe rolin e kryefjalës së zbrazët e luan përemri *it* nuk kemi përputhje me

²¹² O'Dwyer, B. T. ‘*Modern English Structures – Form, Function and Position (Second Edition)*’, Broadview Press, 2006, f. 246.

gjuhën shqipe për shkak se përkthimi nuk mund të bëhet fjalë pas fjalë (si pasojë e asaj që në gjuhën shqipe nuk mund të kemi kryefjalë të zbrazët si në gjuhën angleze) dhe në vend të kësaj shkohet me përkthim me përshtatje të kuptimit. Në momentin që vendoset për përkthim me përshtatje, atëherë fjalia në gjuhën shqipe nuk ka strukturën e njëjtë si ajo në gjuhën angleze.

Rendi i radhës më shpesh i hasur në gjuhën angleze është rendi **kryefjalë + kallëzues + kundrinor**. Kur flitet për kundrinorin në këtë rend të drejtë e kemi fjalën për kundrinorin e drejtë. Për të pasur kundrinor folja duhet të jetë kalimtare dhe dyvalente. Kjo rregull vlen për të dyja gjuhët.

(130) *Jonida bleu **biçikletë**./Jonida bought **a bike**.* (kundrinor i drejtë)

Këtu ekziston një dallim shumë i madh kur krahasohet kundrinori në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Kundrinori i drejtë është ai i cili vjen pas kallëzuesit dhe rastet kur kemi kundrinor të zhdrejtë pa pasur një kundrinor të drejtë janë shumë të rralla në gjuhën angleze. Në gjuhën angleze kundrinori i cili qëndron pas kallëzuesit normalisht konsiderohet kundrinor i drejtë dhe në raste shumë të rralla ai mund të jetë kundrinor i zhdrejtë. Për ta pasur më të qartë këtë dallim jepen disa shembuj:

(131)

- a. *I shouted **at her**./Unë i bërtita **asaj**.* (kundrinorë të zhdrejtë në të dy gjuhët)
- b. *Ata u besojnë **thashethemeve të tyre**./They believe **their** *gossips*.* (kund. zhdrejtë/drejtë)

Në rastin e dytë fjala *thashethemeve* në gjuhën shqipe është kundrinor i zhdrejtë, ndërsa në gjuhën angleze është kundrinor i drejtë. E njëjta ndodh edhe duke përkthyer shembullin nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:

(132) *They enjoy **weddings**./Ata kënaqen **me dasma**.* (kund. drejtë/zhdrejtë)

Në rast se fjalia përkthehet fjalë pas fjale, atëherë mund të ruhet edhe funksioni, edhe rendi, si p.sh. *Ata i pëlqejnë dasmat*.

Në fjalitë e thjeshta dëftore përmbyssa e rendit të gjymtyrëve bëhet vetëm nëse kemi diatezë pësore. Shembuj të tillë janë dhënë më herët. Ndryshimi tjetër i rendit të gjymtyrëve është i mundur vetëm në fjalitë e tjera të ndara sipas kuptimit, gjegjësisht fjalitë urdhërore dhe pyetëse të cilat janë dhënë më poshtë.

Ashtu si në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën angleze me folje trevalente formohet fjali e cila mund të përmbajë kundrinor të drejtë dhe të zhdrejtë. Rendi i drejtë në gjuhën angleze është **kryefjalë + kallëzues + kundrinor i zhdrejtë + kundrinor i drejtë**²¹³. Ky rend është i fiksuar pasi sistemi rasor i gjuhës angleze nuk lejon lëvizjen e gjymtyrëve në fjali për shkak se nuk mund të dallohen, gjegjësisht nuk kanë mbaresa rasore. Në gjuhën angleze është i mundur vetëm ndryshimi i vendeve të kundrinorëve, por edhe kjo lëvizje arrihet duke shtuar një parafjalë (*to*), përndryshe lëvizja e tillë do të prodhonte fjali jogramatikore. Me gjithë ndryshimin e vendit të kundrinorëve, kuptimi mbetet i njëjtë.

(133)

- a. *Jonida bought Jon a present./Jonida i bleu Jonit një dhuratë.*
- b. *Jonida bought a present to Jon./Jonida i bleu një dhuratë Jonit.*

Është kjo lëvizja e vetme e gjymtyrëve të dyta (kundrinorëve), e cila mund të bëhet në gjuhën angleze. Asnjë lëvizje tjetër e gjymtyrëve në gjuhën angleze, qoftë kryesore apo të dyta, nuk do të prodhonte një fjali të saktë në aspektin gramatikor dhe semantik. Kjo është vërtetuar edhe nga përkthimi i shembujve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze kur fjalitë përbëhej nga kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë. Asnjë rend tjetër që në gjuhën shqipe është i mundur nuk mund të realizohet në gjuhën angleze, me përjashtim kur kundrinori i drejtë del para kundrinorit të zhdrejtë dhe kundrinori i zhdrejtë merr parafjalë për të krijuar fjali të saktë në aspektin gramatikor.

3.3. Rendi i gjymtyrëve të tjera të dyta

Rendi i gjymtyrëve të tjera të dyta (rendi i kundrinorëve, kallëzuesit emëror dhe kallëzuesorit të kundrinorit u diskutua më lart), shkurtimisht diskutohet këtu. Në gjuhën shqipe si gjymtyrë të dyta përveç kundrinorit (të drejtë dhe të zhdrejtë), kallëzuesit emëror dhe kallëzuesorit të kundrinorit konsiderohen edhe përcaktorët dhe rrethorët. Përcaktori dhe rrethorë janë diskutuar më lart në pjesën ku flitet për gjymtyrët e fjalisë. Në këtë pjesë na intereson vendi dhe rendi i tyre në fjali, si dhe mënyrat se si lidhen e përshtaten me gjymtyrët e

²¹³ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “*A Comprehensive Grammar of the English Language*”, Longman, 1985, f. 53.

tjera në fjali. Në anën tjetër, si gjymtyrë të dyta në gjuhën angleze, përveç kundrinorit të drejtë dhe të zhdrejtë, kallëzuesit emëror dhe kallëzuesorit të kundrinorit, konsiderohet edhe rrethanori²¹⁴. Që këtu del një dallim në gramatikën e gjuhës shqipe dhe atë të gjuhës angleze: përcaktori nuk konsiderohet gjymtyrë e veçantë, por pjesë e një sintagme.

Përcaktori, siç është thënë edhe më herët, përbën një gjymtyrë shumë të gjerë në gjuhën shqipe për shkak se lidhet me të gjitha gjymtyrët e fjalisë, përveç kallëzuesit, dhe kjo është njëra ndër arsyet që disa gjuhëtarë nuk i pranojnë si gjymtyrë të veçanta²¹⁵. Në gjuhën angleze përcaktori (ang. modifier) nuk konsiderohet si gjymtyrë e veçantë. Ai është pjesë e një gjymtyrë të caktuar dhe jo gjymtyrë më vete. Ajo çfarë pohojmë këtu, është shumë e qartë kur fjalia analizohet me anë të diagramit të pemës dhe gjymtyrët analizohen në mënyrë të veçantë duke analizuar përbërësit e tyre. Përcaktori bashkohet me një gjymtyrë të fjalisë me lidhje përshtatjeje, drejtimi ose bashkimi dhe për këtë arsye shembujt me përcaktorë janë të pafund duke pasur parasysh që mund të lidhen me një kokë emërore²¹⁶. Koka emërore në fjali mund të luajë shumë funksione sintaksore: kryefjalë, kundrinor, rrethanor etj. Është kjo njëra ndër arsyet pse përcaktorët janë atë kategori e gjerë në gjuhën shqipe. Për sqarim, këtu jepen disa shembuj me përcaktorë:

(134)



- a. Qytetarët **e dëmtuar** protestuan dje./The **damaged** citizens protested yesterday.
- b. Kafshët **në male** jetojnë jetë **të qetë**./Animals **in mountains** live **a quiet** life.
- c. **Presidenti** Xhonsen jetojnë në një shtëpi **të vogël**./**President** Jonson lives in **a small** house.

Siç u tha më sipër dhe mund të vërtetohet edhe nga shembujt e dhënë, përcaktori në gjuhën angleze normalisht është pjesë e një sintagme. Për më tepër, përcaktori mund të jetë pjesë e një koke që funksionon si kryefjalë ose kundrinor. Ndjejmë se nevojitet të jepet një shembull ilustrues i një sintagme emërore ku mund të shihet roli i përcaktorit në gjuhën angleze dhe të shihet pse i njëjti nuk konsiderohet gjymtyrë e veçantë.

²¹⁴ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. "A Comprehensive Grammar of the English Language", Longman, 1985, f. 66.

²¹⁵ Çeliku, M., "Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)", ILAR, Tiranë, 2012, f. 198.

²¹⁶ Po aty, f. 198.



Ajo çfarë dëshirojmë të tregojmë me këtë analizë këtu, është se edhe ne jemi të mendimit që përcaktorët të mos konsiderohen gjymtyrë të veçanta, pasi roli i tyre sintaksor është i kufizuar për faktin se janë pjesë e një njësie më të madhe, pra sintagmës, prej ku roli sintaksor varet nga sintagma e jo nga përcaktori. Në këtë rast, përcaktori *brown/kafe* është thjeshtë përcaktor i kokës

emërore dhe koka emërore ka funksion sintaksor – kryefjalë. Ky është një tregues i qartë se përcaktori, i cili në këtë rast shprehet nga një mbiemër, nuk ka asnjë funksion të caktuar sintaksor në nivel gjymtyre, por është pjesë e gjymtyrës kryesore si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze. Edhe shembujt e tjerë të dhënë më lart, nëse do të ilustrtoheshin me diagramin e pemës, do të vërtetonin të njëjtën gjë se përcaktori është pjesë e një sintagme e cila ka funksion të caktuar sintaksor. Si rrjedhim, përcaktori mund të gjendet në pozita të ndryshme, varësisht nga sintagma në të cilën është futur, por brenda sintagmës ai nuk mund të lëvizë lirshëm. Shembull i tillë është përcaktori i shprehur me mbiemër ku nuk mund të lëvizë brenda sintagmës pasi që krijon fjali jogramatikore, si p.sh. *The leaves brown/Kafe gjethet*.

Në gjuhën shqipe përcaktori lidhet me përshtatje, me drejtim dhe me bashkim²¹⁷. Por lidhja e përcaktorit kushtëzohet nga sintagma brenda së cilit ndodhet. Në këtë mënyrë rendi i tij është i kufizuar dhe në raste të caktuara mund të lëvizë varësisht nga lloji i përcaktorit. Pjesa më e madhe e përcaktorëve në rast se largohen nga sintagma të cilën e përcaktojnë, mund të humbin kuptimin dhe me këtë humb edhe kuptimi i fjalisë. Ka përcaktorë të cilët brenda një sintagme mund të lëvizin dhe nuk ndikojnë në kuptimin e fjalisë, p.sh. ‘*Është djalë **dreq**./Është dreq **djalë**.*’. Por ka edhe të tillë të cilët me lëvizjen e tyre krejtësisht ndryshojnë strukturën e fjalisë dhe funksionin sintaksor të fjalëve, si p.sh. ‘*U nis me shpejtësi **luani**./**Luani** u nis me shpejtësi.*’. Këtu bëhet fjalë për dy shembuj shumë interesant, sepse në rastin e parë fjala *luan* është përcaktor i shprehur me emër në rrjedhore dhe është i barasvlershëm me mbiemër, ndërsa në rastin e dytë fjala e njëjtë është kryefjalë.

Në gjuhën angleze përcaktorë të një fjale, sintagme apo sifjalie mund të jenë mbiemrat, ndajfoljet, emrat dhe sintagmat parafjalore²¹⁸. Përcaktori në gjuhën angleze gjendet në pozitë të ndërmjetme, më poshtë se specifikuesit dhe më lart se plotësorët²¹⁹. Me fjalë të thjeshta, përcaktori në gjuhën angleze nuk është as në nivelin e specifikuesve, e as në nivelin e plotësorëve. Pozita e përcaktorëve është kryesisht e fiksuar, duke qëndruar afër fjalës për të cilën japin të dhëna plotësuese. Në rastet kur ka më shumë përcaktorë, atëherë rendi i tyre bëhet sipas rregullave gramatikore. Kjo më së shumti vlen për përcaktorët të cilët shprehen me dy ose më shumë mbiemra dhe në rastet e tilla mbiemrat renditen sipas rregullave gramatikore. Në raste të

²¹⁷ Dhima, Th. ‘*Gjuha shqipe - Sintaksa*’, SHBLU, Tiranë, 2008, f. 93.

²¹⁸ O’Dwyer, B. T. ‘*Modern English Structures – Form, Function and Position (Second Edition)*’, Broadview Press, 2006, f. 178.

²¹⁹ O’Grady, W. dhe Achibald, J. ‘*Contemporary Linguistic Analysis – An Introduction*’, Pearson, 2016, f. 166.

rralla mund të ketë lëvizje të përcaktorëve në gjuhën angleze, si p.sh. ‘*The water, **blue and clear**, remained still./The **blue and clear** water remained still.*’. Pozita e përcaktorëve në gjuhën angleze bëhet në bazë të katër ‘zonave’: a) përforcuesit, b) epitetet, c) përshkruesit dhe d) klasifikuesit²²⁰. Kjo lidhet drejtpërdrejt me idenë se pozicioni i përcaktorit varet sipas zonës në të cilën është ajo fjalë. Fjala mund të ketë funksione të ndryshme, varësisht nga zonat e përmendura më lart, prandaj edhe rendi varet sipas tyre. Derisa jemi te përcaktorët, në gjuhën angleze është e rëndësishme të theksohet se mund të bëhet ngatërresë e një përcaktori me emrat e përbërë, si p.sh. ‘*Police officer/White officer*’. Në këtë fjali duhet pasur kujdes ngaqë në rastin e parë bëhet fjalë për singatmë emërore të përbërë nga një emër i përbërë, ndërsa në rastin e dytë, meqenëse *white* është mbiemër, kemi përcaktor + emër. Fjala që përdoret në sintagmë, ka ndikim të drejtpërdrejtë në funksionin e tyre, ndaj duhet analizuar mirë funksioni sintaksor i tyre.

Rrethanori, si gjymtyrë e dytë, është shumë i pranishëm në fjali të shumta. Kjo nuk vlen vetëm për gjuhën shqipe, por edhe për shumë gjuhë të botës, përfshirë gjuhën angleze. Them i kështu, sepse rrethanori ka përdorim të gjerë, pasi edhe llojet e rrethanorit janë të shumta. Kjo është arsyeja përse rrethanori ka përdorim të gjerë. Rrethanorët në gjuhën shqipe janë të domosdoshëm ose fakultativ dhe lidhja gramatikore e bashkimit është lidhja më e zakonshme e tyre.

Në gjuhën shqipe rrethanori vendoset zakonisht pas kallëzuesit (sidomos ai i mënyrës dhe qëllimit), por në rastet kur në fjali ka më shumë rrethanorë, atëherë ata shpërndahen në fjali, ndërsa kur fjalia ka kundrinor të drejtë e të zhdrejtë, rrethanorët vendosen pas këtyre (në periferi)²²¹. Më saktë, rrethanorin mund ta gjejmë në fillim, në mes dhe në fund të fjalisë. Është një gjymtyrë e dytë që lëviz pothuajse lirshëm në fjali. Varësisht nga lloji i rrethanorit ndryshon edhe vendi i tij: 1) Rrethanori i mënyrës qëndron zakonisht pas foljes ose afër saj, 2) Rrethanori i shkakut gjendet zakonisht pas foljes, 3) Rrethanori i qëllimit gjendet para ose pas foljes, 4) Rrethanori i vendit mund të jetë në krye ose në fund të fjalisë, 5) Rrethanori i kohës zakonisht gjendet pas foljes, në fund të fjalisë ose para foljes dhe 6) Rrethanori i sasisë gjenet para ose pas foljes²²². Arsyeja përse rrethanori gjendet para ose pas foljes, në fillim, në mes apo në fund të fjalisë, është se ka shumë tipa rrethanorësh, të cilët mund të përshtaten në fjali të ndryshme me kuptime të ndryshme.

²²⁰ Feist, J. ‘*Premodifiers in English – Their Structure and Significance*’, Cambridge, 2012, f. 250.

²²¹ Çeliku, M., “*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 179-180.

²²² Akademia e Shkencave, “*Gramatika e gjuhës shqipe 2*”, Tiranë, 2002, f. 419-420.

Karakteristikë shumë e rëndësishme është se përkundër rendit kryesisht të fiksuar të gjymtyrëve në gjuhën angleze, rrethanori është gjymtyra e vetme e cila mund të lëvizë në fjali dhe mund të ketë një pozitë periferike²²³, ashtu si në gjuhën shqipe. Kuptohet, kjo nuk vlen për të gjithë llojet e rrethanorëve në gjuhën angleze, pasi ekzistojnë rrethanorë të cilët mund të përdoren vetëm në pozita të caktuara. Më poshtë janë dhënë disa shembuj në të cilat tregohet se në çfarë pozicionesh mund të gjendet rrethanori, gjegjësisht vërtetohet se ai mund të lëvizë lirshëm, dhe shihet nëse një lëvizje e tillë është e mundur në fjalitë e krahasuara.

(135)

- a. *Ai shkoi në shtrat./He went to bed.* (rrethanor i domosdoshëm)
- b. *Mekaniku e riparoj makinën shpejt./The mechanic repaired the car quickly.* (rrethanor fakultativ)

Dy shembujt e dhënë tregojnë se e njëjta rregull vlen si për gjuhën shqipe, ashtu edhe për gjuhën angleze për sa i përket asaj nëse janë të domosdoshëm ose jo. Shembujt e dhënë më poshtë i referohen pozitës së rrethanorit dhe shihet se rrethanori mund të gjendet në pozita të ndryshme.

(136)

- a. *Papritmas u ndjeva keq./Suddenly I felt ill.*
- b. *Ata asnjëherë nuk kanë shkuar në Australi./They have never gone to Australia.*
- c. *Ai flet anglisht rrjedhshëm./He speaks English fluently.*

Tre shembujt e dhënë më lart tregojnë se rrethanori mund të gjendet në të tre pozitat, në fillim, në mes dhe në fund. Madje, këto shembuj vërtetojnë edhe pohimin se e vetmja gjymtyrë që mund të ‘lëvizë më lirshëm’ në gjuhën angleze është rrethanori. Por edhe ky pohim nuk mund të jetë tërësisht i saktë pasi, nëse tentojmë që të lëvizim rrethanorët si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze, do të krijohen fjali të pasakta. Për shembull, nëse në shembullin e parë lëvizim fjalën *ndoshta* në pozitë tjetër, atëherë fjalia si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze, do të ishte e pasaktë. Nuk mund të themi ‘Do të vij në ndoshta.’ ose ‘They will come maybe.’. Por në shembullin e dytë kemi situatë ndryshe në gjuhën shqipe. Fjala *asnjëherë* mund të lëvizë në shumë pozicione të ndryshme brenda fjalisë, ndërsa në gjuhën angleze një gjë e tillë

²²³ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. “A Comprehensive Grammar of the English Language”, Longman, 1985, f. 440.

nuk është e mundur. Në shembullin e tretë mund të kemi vetëm një lëvizje të rrethanorit, duke thënë ‘*Ai flet rrjedhshëm anglisht.*’, por në gjuhën angleze rrethanori i mënyrës qëndron në fund. Nga shembujt e mësipërm dëshirojmë të theksojmë se vendi i rrethanorit është i kushtëzuar nga lloji i rrethanorit. Por, ekzistojnë edhe ca ndajfolje si ‘*honestly*’ ose ‘*however*’ që mund të përdoren në pozita të ndryshme, si p.sh.:

(137)

- a. ***Honestly***, we were late./***Sinqerisht***, ne ishim vonë.
- b. We were late, ***however*** we got the money./Ne ishim vonë, ***megjithatë*** i morëm paratë.
- c. I have three computers. My wife prefers laptops, ***however***./Unë kam tre kompjuterë. Bashkëshortja ime ***megjithatë*** preferon laptopët.

Tre shembujt e mësipërm u dhanë për të vërtetuar se ndajfolja *however* mund të gjendet në tre pozita të ndryshme në gjuhën angleze. Por me këtë ndajfolje paraqitet problemi se kemi fjali jo të thjeshta dhe në rastet e tilla pozita e ndajfoljes analizohet sipas fjalisë së cilës i përket. Kjo edhe njëherë tregon se ndajfoljet/rrethanorët në gjuhën angleze janë të vetmet fjalë/gjymtyrë që mund të gjenden në pozita të ndryshme, ndërsa gjymtyrët tjera janë kryesisht të fiksuara.

3.4. Rendi i fjalëve në fjalitë sipas kumtimit

Deri këtu pjesa më e madhe e fjalive të cilat janë dhënë si shembuj, kanë qenë kryesisht fjali dëftore. Rendi i gjymtyrëve mund të ndryshojë varësisht nga tipi i fjalisë. Kur ndryshon rendi i gjymtyrëve, normalisht ndryshon edhe intonacioni, dhe theksi vendoset në atë pjesë që theksohet më së shumti, gjegjësisht gjymtyra që bart kuptimin ose vlerën kuptimore. Këtu duhet bërë edhe një ndarje e rëndësishme për sa i përket vendit dhe rendit të fjalëve në fjali, gjegjësisht në fjalitë e thjeshta dhe të përbëra.

Në fjalitë e thjeshta, varësisht nga kumtimi dhe përbërësit, ndryshon edhe rendi i gjymtyrëve. Fjalitë dëftore pohore dhe mohore kanë rend të lirë, por edhe të anasjelltë, siç është vërtetuar në shembujt ku tregojnë lëvizjen e gjymtyrëve. Por, një fjali urdhërore bën që rendi të ndryshojë, dhe ky ndryshim është më i dukshëm në gjuhën angleze në rastet kur kemi fjali mohore, si p.sh.:

(138)

- a. (You) *Don't break the door./ (Ti) Mos e thyej derën.*
- b. *Don't (you) do it!/Mos e bëj!*
- c. *Don't you dare!/Mos guxo!*

Kryefjala, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze, mund të mos jetë e pranishme. Në fakt, fjalia e parë është një lloj fjalie në gjuhën angleze ku mund të mos kemi kryefjalë, sepse ajo është e nënkuptuar nga folja, gjë që tregon se kemi një ndryshim nga shembujt e diskutuar më parë. Por, në rast se krahasojmë shembullin e parë dhe të dytë më lart, del që kryefjala *you* mund të dalë në dy pozicione të ndryshme, para dhe pas foljes. Në rastin e tretë mund të shihet se kryefjala, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe, mund të mos jetë e pranishme dhe sërish të jetë e nënkuptuar. Dy fjalitë e shënuara më poshtë tregojnë një dallim shumë interesant në gjuhën angleze ku koha e ndryshme e foljes ndikon në tipin e fjalisë.

(139)

- a. *Didn't you do it?/A nuk e bëre ti atë?*
- b. *Don't (you) do it!/Mos e bëj!*

Në pamje të parë, si në fjalinë pyetëse, ashtu edhe në atë urdhërore kemi rend të njëjtë gjymtyrësh, *didn't* dhe *don't*, por kemi kohë të ndryshme. Në raste të tilla intonacioni dhe koha janë vendimtare për dallimin e fjalisë urdhërore nga ajo pyetëse. Një tip fjalish urdhërore që duhet të jepet këtu, është fjalia me pjesëzën e lejimit *le*²²⁴. Edhe në gjuhën angleze kemi fjali të tilla dhe rendi i kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit është i njëjtë.

(140) *Le të japë edhe ai ndihmë!/Let him give a hand too!*

Për sa u përket fjalive pyetëse në gjuhën shqipe, kryesore për dallimin e tyre është intonacioni dhe rendi i gjymtyrëve²²⁵. Pra, intonacioni është më i rëndësishëm sesa rendi i gjymtyrëve. Ky pohim vlen për gjuhën shqipe, por jo për gjuhën angleze. Kjo vërtetohet me një shembull të thjeshtë:

(141) *Ai luan sonte?/*He plays tonight? → Does he play tonight?*

Rendi i fjalëve në fjalinë në gjuhën shqipe është rendi i drejtë i një fjalie dëftore (kryefjalë + kallëzues + rrethanor), edhe pse është një pyetje. Për ta kthyer një fjali dëftore në pyetje në gjuhën shqipe mjafton intonacioni. Që këtu shihet rëndësia e madhe që ka intonacioni në fjalitë

²²⁴ Çeliku, M., “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 286.

²²⁵ Po aty, f. 284.

(142)

- Did they eat?/A hëngrën ata?*
- When will they be here?/Kur do të jenë këtu?*
- How will he pass the exam?/Si do ta kalojë ai provimin?*

Në të tre fjalitë pyetëse mund të shihet se kallëzuesi del përpara kryefjalës në të dy gjuhët, ose fjalja fillon me përemër, ndajfolje pyetëse ose pjesëz pyetëse.

(143) *What a dress! / Çfarë fustani!* (fjali thirrmore)

(144)

- 109

Fjalja dëshirore në gjuhën shqipe konsiderohet kategori e veçantë, por në gjuhën angleze nuk konsiderohet kategori e veçantë. Në gjuhën angleze kur i dëshirohet dikujt diçka përdoret mënyra lidhore e foljes²²⁹. Përkthimi i tyre është mjaft problematik, për shkak se normalisht bëhet fjalë për shprehje, dhe përkthimi i drejtpërdrejtë është i vështirë dhe në raste të caktuara i pamundur. Si rrjedhim, përkthimi me parafrzim bën që struktura, gjegjësisht rendi i fjalëve, të jetë krejtësisht e ndryshme.

(145)

- a. *I wish you the best!/Të uroj gjitha të mirat!* (strukturë e njëjtë – kryefjalë-kallëzues)
- b. *Rroftë mbreti!/Long live the king!* (strukturë e njëjtë, rend i anasjelltë–kallëzues-kryefjalë)
- c. *Break a leg!/Paç fat!* (strukturë e njëjtë – përkthim me parafrzim)
- d. *Të trashëgohen!* (përkthim i pamundur-duhet përkthim me parafrzim)

Dy shembujt e parë përputhen me njëri-tjetrin për sa i përket strukturës. Në shembullin e tretë kemi strukturë të njëjtë, por jo fjalë të njëjta, pasi është shprehje idiomatike e përkthyer dhe rastësisht ka strukturë të njëjtë. Në rastin e fundit shprehja ‘*Të trashëgohen!*’ nuk ka një përkthim adekuat, por duhet të gjendet një përkthim sa më i përafërt që do i përafrohej kuptimit të urimit ‘*Të trashëgohen!*’.

Si pikë e fundit është modaliteti i fjalive, pra, ndarja në fjali pohuese dhe mohuese. Në gjuhën shqipe fjalitë mohuese kanë strukturë të llojllojshme, pasi përdoren disa fjalë mohuese, si pjesëza mohuese, përemra e ndajfolje²³⁰. Në krahasim me gjuhën shqipe, ku pjesëzat mohuese qëndrojnë zakonisht në fillim të fjalisë ose para foljes, gjuha angleze është shumë më e thjeshtë, sepse fjalët mohuese qëndrojnë normalisht menjëherë pas foljes kryesore ose asaj ndihmëse (në rastet kur kallëzuesi shprehet me folje ndihmëse dhe kryesore), ose në raste të caktuara përdoren ndajfolje për fjali mohuese (*never*) dhe për pjesën dërrmuese të fjalive vlen rendi i drejtë i gjymtyrëve.

(146)

- a. *Unë **nuk** komunikoj me ekipin./I do **not** communicate with the team.*
- b. *Sot **nuk** erdhi **askush**./Today nobody came.*

²²⁹ Gudmanian, A. ‘*Guide to Successful English Grammar*’, NK Publishers, 2013, f. 116.

²³⁰ Çeliku, M., “*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 289.

Fjalja e parë në gjuhën shqipe për nga struktura është e njëjtë me atë në gjuhën angleze. Por në fjalinë e dytë kemi folje negative në gjuhën shqipe (*nuk erdhi*), ndërsa pozitive në gjuhën angleze (*came*). Kjo vjen si pasojë e asaj që rolin e negativit e merr përemri (*nobody*) dhe në gjuhën angleze nuk përdoret negacioni i dyfishtë (themi: *I did not see anybody.*, ose *I saw nobody.* por jo *I did not see nobody.*), ndërsa në gjuhën shqipe negacioni i dyfishtë është i domosdoshëm në kësi rastesh nëse përkthehet fjalia siç është përkthyer më lart. Por në rast se përkthehet si ‘*Sot nuk erdhi njeri.*’, atëherë nuk është patjetër të kemi negacion të dyfishtë. Rendi i gjymtyrëve në këto shembuj është i njëjtë.

3.5. Rendi i fjalëve në fjalitë sipas pranisë apo mungesës së gjymtyrëve

Shpesh ndodh që në gjuhën shqipe të hasim fjali të tipit ‘*Shi./Gjëmon./Ikim./Krisi*’, por një gjë e tillë nuk është aq e shpeshtë në gjuhën angleze, posaçërisht kur flasim për fjali ku përbërësi i vetëm është folje. Në gjuhën shqipe fjalitë e tilla janë të shumëllojshme për shkak të sistemit rasor dhe eptimit foljor. Në anën tjetër, sistemi rasor e bën të domosdoshme që fjalitë në gjuhën angleze të kenë një kryefjalë, pavarësisht pozitës (në fillim të fjalisë apo e zhvendosur në fund) apo fjalës me të cilën është shprehur (emër, përemër apo tjetër). Për shembull, fjalia ‘*Krisi.*’ në gjuhën shqipe përbëhet nga një përbërës, por në gjuhën angleze e njëjta përbëhet nga dy përbërës, pra ‘*It cracked.*’. Por kjo nuk do të thotë se nuk ka raste të ngjashme, për shembull: ‘*Çfarë sheh? Dritë./What do you see? Light.*’. Fjalitë e tilla në gjuhën angleze quhen fjali eliptike, gjegjëse me fjalitë e paplota eliptike në gjuhën shqipe. Shembuj ka plot, varësisht nga lloji i fjalive dhe qëllimi për të cilin përdoren. Mund të jenë përgjigje e një pyetjeje, pjesë dialogu ose edhe fjali thirrmore.

Kur flasim për praninë apo mungesën e gjymtyrëve, ideja është nëse fjalia ka vetëm një përbërës apo më shumë se një përbërës, si dhe çfarë roli sintaksor kanë ata përbërës në fjali. Në gjuhën shqipe ndarja kryesore për sa u përket përbërësve të fjalisë (nuk thuhet gjymtyrë pasi jo çdoherë mund të jetë gjymtyrë kryesore një përbërës) ekzistojnë fjali njëkryepërbërëse (emërore [përshkruese, treguese apo emërtuese] ose foljore [vetore ose pavetore]) dhe dykryepërbërëse²³¹.

²³¹ Çeliku, M. “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 293.

Për sa u përket fjalive dykryepërbërëse, shembujt janë të shumtë dhe të gjitha fjalitë e dhëna si shembuj deri këtu konsiderohen fjali të plota.

Në anën tjetër, fjalitë e paplota janë një kategori e veçantë në gjuhën shqipe dhe ky lloj fjalish ekziston edhe në gjuhën angleze. Në fakt, në gjuhën angleze përdoret termi fjali të çrregullta dhe ka disa tipa fjalish të tilla, përfshirë fjalitë e paplota (ose në anglisht që quhen eliptike). Këtu realisht nuk flitet për numër përbërësish, por për kuptimin që del nga fjalia. Fjalitë eliptike mund të kenë më shumë përbërës apo edhe një përbërës.

(147)

- a. *Më mirë një mik sesa armik./Better a friend than an enemy.*
- b. *Çfarë pret? Asgjë./What are you waiting? Nothing.*

Të dy shembujt më lart tregojnë se si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze mund të kemi fjali të paplota (eliptike) me një apo me më shumë përbërës. Për më tepër, ekzistojnë lloje fjalish të paplota ku kryefjala ose kallëzuesi të mund të largohet dhe sërish fjalia të ketë kuptim, gjegjësisht gjymtyra të jetë e nënkuptuar. Për shembull:

(148)

- a. *(We will) See you tomorrow./(Ne do) Takohemi nesër.*
- b. *(Are you) Happy?/(A je) E lumtur?*

Fjalitë e paplota si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze janë të llojeve të ndryshme dhe shembujt e dhënë më lart përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të situatave të ndryshme ku përbërës të caktuar mund të largohen nga fjalia dhe ajo sërish të ketë kuptim, pavarësisht mungesës së tyre. Mungesën e gjymtyrëve në këto raste e zëvendëson përdorimi i elementeve të tjerë si situata ligjërimore, konteksti ose përvoja njohëse e folësve të gjuhës.

Për ta përmbledhur, në fjalitë eliptike mund të mungojë si kryefjala ashtu edhe kallëzuesi (folja kryesore ose ndihmëse), por jo edhe kundrinori. P.sh.:

(149)

- a. *[I] Hope to meet you again./(Unë) Shpresoj të të takoj sërish.*
- b. *(There are) Too many mistakes./(Ka) Shumë gabime.*
- c. *(Are you) Listening to me?/(A) Më dëgjon?*
- d. *See you soon./Shihemi.*

Në fjalinë e parë mund të shihet se kryefjala mungon në të dy gjuhët, por fjalia ka kuptim të plotë. Në fjalinë e dytë në gjuhën angleze mungon kryefjala e zbrazët dhe kallëzuesi, ndërsa në

gjuhën shqipe është fjali pa kryefjalë. Në fjalinë e tretë mungon kryefjala në të dy gjuhët. Situatë më ndryshe nga tre fjalitë e para është fjalia e fundit ku përveç mungesës së kryefjalës në të dy gjuhët mungon edhe kundrinori në gjuhën shqipe. Në këtë rast, mungesa e kundrinorit ka ndikim të drejtpërdrejtë në fjali sepse përemri 'you' i cili është kundrinor në gjuhën angleze mund të ketë kuptimin e 'ty' ose 'juve' por që zakonisht në bazë të konotacionit përdoret për numrin njëjës. Në anën tjetër, me fjalinë e paplotë 'Shihemi' mund të kuptojmë se në bazë të konotacionit dhe të foljes bëhet fjalë për numrin shumës. Si rrjedhim, mungesa e gjymtyrëve në raste të caktuara mund të ndikojë drejtpërdrejt në kuptimin e fjalive të paplota dhe në rastet e tilla gjymtyrët duhet të përkthehen dhe të jenë pjesë e fjalisë së përkthyer.

3.6. Semantika në lidhjen e kryefjalës-kallëzuesit-kundrinorit

Për të pasur një fjali të saktë, fjalia nuk duhet të jetë e saktë vetëm në aspektin gramatikor (morfologjik e sintaksor), por edhe në atë semantik. Për shembull, fjalia 'Djali e theu dritaren./The boy broke the window.' me fjalinë 'Dritarja e theu djalin./The window broke the boy.' kanë strukturë të njëjtë sintaksore (kryefjalë-kallëzues-kundrinor), por e para është e saktë, ndërsa e dyta nuk është e saktë në aspektin semantik. Këtu duhet të shihet se kush është vepruesi dhe kush është pësuesi, apo kush është tema e kush është rema. Nuk mjafton vetëm struktura sipërfaqësore sintaksore e fjalisë për të pasur fjali gramatikisht të saktë. Semantika dhe roli semantik është përmendur edhe më herët dhe është vërtetuar se është një pjesë e rëndësishme në formimin e fjalive të sakta. Kjo nuk vlen vetëm për gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, por për çdo gjuhë të botës. Pavarësisht rendit të gjymtyrëve, kur fjalia e njëjtë përkthehet edhe në gjuhë të tjera, kuptimi i fjalisë duhet patjetër të mbetet i njëjti. Përndryshe, mosplotësimi i kushtit që fjalia të jetë e saktë edhe në aspektin semantik, rezulton me fjali të pasaktë.

Rolet semantike, si vepruesi, pësuesi, qëllimi, lokacioni etj., edhe pse nuk mund të lidhen në mënyrë absolute me funksionet gramatikore, luajnë rol të caktuar në konstrukte të caktuara gramatikore²³². Rolet semantike të vepruesit, pësuesit, lokacionit ose instrumentit luajnë rol të rëndësishëm në gjuhën shqipe, por vendi i fjalëve në fjali në gjuhën angleze është i përcaktuar,

²³² Jong-Bok, K. dhe Sells, P. 'English Syntax: An Introduction', Center for the study of language and information, 2008, f. 43-44.

gjegjësisht sipas modeleve që janë përshkruar më herët. Pavarësisht nëse lidhja bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, megjithatë ekziston një farë lidhjeje midis rendit të fjalëve dhe rolit semantik, siç demonstrohet në raste të caktuara me folje kalimtare. Përderisa rendi i fjalëve për gjuhë të caktuara varet nga faktorët e caktuar semantikë dhe pragmatikë, në gjuhën angleze fjalitë radhiten sipas rendit të fjalëve dhe parafjalëve, me ndryshime morfologjike vetëm të përemrave (*I/me, he/his*, etj.)²³³.

Përveç këtyre, kuptimi i fjalës është shumë i rëndësishëm për sa u përket emrave përmbledhës²³⁴ dhe është i vetmi rol që merret parasysh për të vendosur nëse folja me një emër përmbledhës do të përdoret në njëjës, në shumës apo edhe në njëjës, edhe në shumës. Emrat përmbledhës janë të bollshëm dhe shembuj të tillë në anglishte janë emrat *government/qeveri, team/ekip, family/familje, people/njerëz, police/policia* etj. Më poshtë janë dhënë disa shembuj ku roli i semantikës është kyç për përcaktimin e numrit të foljes, gjegjësisht ndikon drejtpërdrejt në lidhjen e kryefjalës dhe kallëzuesit:

(150)

- a. *The jury has delivered its verdict./Juria e ka marr vendimin e saj.*
- b. *The jury have not reached a verdict because they are still inside./Juria nuk e ka marr vendimin për shkak se ende është brenda.*

Në këta shembuj mund të shihet se në të dy rastet kemi të njëjtin emër përmbledhës në gjuhën angleze dhe folja del edhe në njëjës edhe në shumës, ndërsa në gjuhën shqipe vetëm në njëjës. Kjo ndodh për shkak se në rastet kur individët veprojnë bashkë, si grup, emri përmbledhës normalisht është në njëjës, ndërsa në rastet kur individët veprojnë në mënyrë individuale, emri përmbledhës është në shumës. Megjithëse ky është një dallim i dukshëm midis gjuhës angleze dhe shqipes, ndodh edhe ndërmjet anglishtes së Britanisë dhe Amerikës. Në gjuhën angleze në Amerikë emrat përmbledhës në përgjithësi marrin folje në numrin njëjës²³⁵ e kjo ndodh veçanërisht për ekipet sportive, institucionet apo firmat, ndërsa në gjuhën angleze të përdorur në Britani marrin folje në numrin shumës, si më poshtë.

(151)

- a. *My family is here./Familja ime është këtu.*

²³³ Chang, N. dhe Lakoff, G. 'Semantic role marking: A preliminary report', Fall, 1997, f. 3.

²³⁴ Depraetere, I. 'On Verbal Concord with Collective Nouns in British English', HAL, 2011, f. 88.

²³⁵ Einsohn, A. dhe Schwartz, M. 'The Copyeditor's Handbook: A guide for Book Publishing and Corporate Communications', University of California Press, Fourth Edition, 2019, f. 343.

- b. *Chelsea **were** Premier League Champions last year./Çelsi **ishte** kampioni i Premier Ligës vitin e kaluar. (British Mirror)*
- c. *How Manchester United **Sees** Digital As the Key To Future Commercial Success /Si e **sheh** Mançester Junajtedi Digjitalizimin si çelës të suksesit tregtar të ardhshëm. (American Forbes)*

Edhe në këto dy shembuj në gjuhën angleze mund të kemi raste të ndryshme, por në gjuhën shqipe tendenca është që emrat përmbledhës të përdoren me folje në numrin njëjës pasi emrat përmbledhës kryesisht merren si një tërësi, gjegjësisht një gjë, e jo shumë gjëra. Por ka emra përmbledhës që detyrimisht përdoren në shumës, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe, sepse për nga vetë forma janë në shumës.

(152)

- a. *The people **were** happy./Njerëzit **ishin** të lumtur.*
- b. *Cattle **eat** grass./Bagëtia **hanë** bar.*

Shembuj të tillë janë më të paktë në numër, pasi edhe numri i emrave përmbledhës që përdoren vetëm në shumës, është më i vogël, dhe këtu roli i semantikës është i qartë dhe kushtëzon përdorimin e foljes vetëm në numrin shumës. Në shembullin e parë më lart duhet të theksohet se emri ‘people’ konsiderohet si emër përmbledhës, ndërsa në gjuhën shqipe nuk konsiderohet emër përmbledhës. Në fjalinë e dytë emri ‘cattle’ është emër përmbledhës njëjtë si në shqip ‘bagëtia’, por në këtë rast kemi mospërputhje të numrit të foljes.

Me interes është edhe roli i semantikës për sa u përket homonimeve.

(153)

- a. *The tree **barks** are thick./Lëvozhgët e pemëve janë të trasha.*
- b. *The dog **barks** tonight./Qeni **leh** sonte.*
- c. *Investors **eye** shares of hotels.(Reuters)/Intestitorët **synojnë** aksionet e hoteleve.*

Këtu kyç është roli sintaksor, gjegjësisht rendi i fjalëve në fjali, por në shikim të parë mund të bëhet ngatërresë e roleve sintaksore dhe normalisht që edhe semantika merret parasysh në përcaktimin e roleve sintaksore dhe shihet se, edhe pse një fjalë mund të jetë e njëjtë (homonim), ajo mund të ketë kuptime të ndryshme, role të ndryshme sintaksore dhe si rezultat fjalia përmban gjymtyrë të ndryshme (rrethanor dhe kallëzues emëror). Shembull ku mund të bëhet ngatërresë e lehtë në gjetjen e kallëzuesit është fjalia e fundit më lart ku fjala ‘eye’ mund të jetë emër ‘sy’, por

edhe folje ‘shoh/synoj’, pasi në pamje të parë mund të duket se ‘eye’ është pjesë e sintagmës emërore ‘investors eye/syri i investitorëve’. Analiza semantike këtu ndihmon në gjetjen e kallëzuesit dhe analizën e duhur të fjalisë.

3.7. Roli i leksikonit dhe i përkthimit në strukturën e fjalisë

Leksikoni është pjesë e rëndësishme jo vetëm për një gjuhë, por është shumë më i rëndësishëm kur krahasohen dy gjuhë, gjegjësisht kur përkthehet nga njëra në tjetrën. Pasuria gjuhësore ose një fjalor i pasur lejon përkthim më të lehtë dhe deri diku përshtatje më të mirë të strukturës së fjalisë. Shembujt e dhënë më poshtë pasqyrojnë më mirë atë çfarë dëshirojmë të themi këtu.

(154)

- a. *The **feedback** was not enough./Rezultati/Reagimi/Reaksioni/Prapaveprimi nuk ishte i mjaftueshëm.*
- b. *Multitasking is a skill./Ekzekutimi i më shumë detyrave është aftësi.*
- c. *Njerka është njerke./A **step-mother** is a step-mother.*
- d. *Vjehrra është këtu./The **mother-in-law** is here.*

Duke u bazuar vetëm në shembujt e mësipërm e që, pa dyshim, shembujt të tillë ka plot, mund të shohim se leksikoni është shumë i rëndësishëm kur përkthehet nga njëra gjuhë në tjetrën. Shembujt më sipër janë dhënë qëllimisht duke përzgjedhur fjalë ku në një gjuhë emri përbëhet nga një fjalë (emër i thjeshtë), ndërsa në gjuhën tjetër përkthehet si sintagmë emërore (emër i përbërë). Lidhja e kryefjalës dhe kallëzuesit nuk është problematike në këto raste për shkak se numri i kryefjalës përcakton numrin e kallëzuesit, përshtatja bëhet me mjete gramatikore. Por ka raste të ndryshme në anglishte kur kryefjala është në shumës, por kallëzuesi në njëjës, si më poshtë:

(155)

- a. ***Measles** is a virus./Fruthi është virus.*
- b. ***Maths** is a hard subject./Matematika është lëndë e vështirë.*

Ashtu siç ka edhe raste ku kryefjala në njërën gjuhë është në njëjës, ndërsa në tjetrën në shumës dhe në raste të tilla kallëzuesi përshtatet me numrin e kryefjalës në varësi të përkthimit.

(156) *The proceedings were published yesterday./Përmbledhja e punimeve ishte publikuar dje. //Punimet janë publikuar dje.*

Në shembullin e fundit nuk mund të themi ‘*Punimet janë publikuar dje.*’ për shkak se ‘*proceedings*’ nuk e ka fjalën për punime, por për një përmbledhje punimesh - revistë. Ky është një shembull që pasqyron se mungesa e terminologjisë në raste të caktuara mund të ndikojë edhe në strukturën e fjalisë, pra në numrin e kallëzuesit. Shembujt e tjerë janë pasqyrë e asaj se mungesa e terminologjisë mund të ndikojë te kryefjala, ose edhe kundrinori apo ndonjë gjymtyrë tjetër dhe nëse bëhet analizë sintaksore me diagramin e pemës do të kemi strukturë të ndryshme në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe.

Çështja e përkthimit paraqet pjesën e fundit më të rëndësishme të këtij disertacioni. Çështjet e përkthimit dhe ndryshimet që mund të ndryshojë fjalë ka një kohë të gjatë që studiohen. Chesterman bën një kategorizim prej dhjetë tipash përkthimesh dhe ndryshimesh që rezultojnë nga përkthimi, por neve na interesojnë tre nga ato që lidhen drejtpërdrejt me qëllimin e studimit: 1) ndryshimi i strukturës së sintagmës, 2) ndryshimi i strukturës së sifjalisë dhe 3) ndryshimi i strukturës së fjalisë²³⁶. Me këtë kategorizim nënkuptojmë se përkthimi i një teksti mund të pësojë ndryshime sintaksore në të tre nivelet. Në të vërtetë, në shembujt e dhënë deri këtu është vërejtur ndryshim strukturor dhe kjo e përmbledh në aspektin teorik atë që e kemi vërtetuar deri tani në aspektin praktik me shembujt e dhënë. Për më tepër, analiza e veprës në kreun vijues, ku bëhet fjalë për përkthim letrar, nxjerr në pah ndryshimet e mundshme strukturore, si të sintagmave, ashtu edhe të sifjalive e fjalive. Përkthimi letrar në raste të caktuara është i ndikuar edhe nga parafrazimi, prandaj mund të kemi ndryshim të strukturës së fjalisë. Ashtu siç ishte rasti më sipër me shprehjet, struktura e shprehjes mund të ndryshojë si në nivel të sintagmës, ashtu edhe në nivel të fjalisë. Madje, sipas Nuhiut, interferencat gjuhësore ekzistojnë më së shumti në gjuhën e folur ku përveç transferit të kodit ekziston edhe transferi i plotë i strukturës së një gjuhe në tjetrën²³⁷, duke ndikuar drejtpërdrejt në rendin e fjalëve në fjali dhe duke rezultuar me një fjali jo dhe aq natyrore. Për shembull:

(157) *Europe is inhabited by 741 million people./Evropa banohet nga 741 milion njerëz.*

²³⁶ Chesterman, A. ‘*Memes of Translation – The Spread of Ideas in Translation Theory*’, John Benjamins Publishing Company, 1997, f. 94.

²³⁷ Nuhiu, V. ‘*Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*’, Prishtinë, 2012, f. 289.

Në gjuhën e folur strukturat mund krejtësisht të barten në gjuhën marrëse dhe një fjali e tillë edhe pse do të ishte e kuptueshme, ajo nuk do ishte natyrore për shkak të ndryshimit të strukturës. Në këtë rast fjalia në gjuhën shqipe për të tingëlluar më mirë duhet të kthehet në diatezën veprorë dhe të thuhet *‘741 milion njerëz banojnë në Evropë.’* ose të rifrazohet në *‘Evropa ka 741 milion banorë.’*. Kjo fjali kështu fiton rendin e duhur dhe është e saktë si në aspektin sintaksor, ashtu edhe në aspektin semantik.

Edhe pse ndikimet e transferimit të strukturës mund të jenë më të dukshme më shumë në gjuhën e folur atëherë kur folësit kanë qenë për kohë të gjatë të ndikuar nga gjuha e huaj, një gjë e tillë me siguri nuk është aq e dukshme në gjuhën e shkruar dhe përkthimi nuk do të rezultonte me transfer aq flagrant të strukturës nga njëra gjuhë në tjetrën. Themi flagrant pasi që shembulli më lart tregon se bartja e strukturës nga gjuha angleze në gjuhën shqipe krijon një fjali e cila nuk tingëllon mirë dhe përkthyesi duhet të jetë shumë i vëmendshëm gjatë përkthimit. Ideja është përkthyesi jo duhet domosdoshmërisht të tentojë të ruaj strukturën nga gjuha e parë. Ajo çfarë duhet të bëjë është përshtatja sa më e mirë e përkthimit me qëllim që të ruhet struktura normale e gjuhës marrëse dhe rendi i duhur i gjymtyrëve.

3.8 Shprehjet frazeologjike në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze dhe ndikimi i tyre mbi strukturën e fjalisë

Shprehjet idiomatike/frazeologjike janë një kategori e veçantë dhe mjaft problematike kur vjen puna të përkthimi i tyre. Si nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, vështirësi mund të hasen edhe nga përkthimi i shprehjeve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze. Madje, në raste të caktuara, siç kemi vërejtur më herët, mund të ndodhë që të mos mundemi të kemi një përkthim të ndonjë shprehjeje të caktuar, por përkthimi i tyre bëhet me anë të parafrazimit, duke gjetur një shprehje sa më të përafërt në gjuhën marrëse. Në raste të tilla, struktura e fjalisë mund të ndodhë që të jetë pjesërisht ose krejtësisht e ndryshme me strukturën e fjalisë në gjuhën nga bëhet përkthimi.

Shprehje idiomatike me strukturë të njëjtë:

(158)

- a. *Ai vrau dy zogj me një gurë./He killed two birds with a stone.*
- b. *He is a two-faced person!/Ai është person dyfytresh.*

c. *Don't be a fool!/Mos u bë budalla!*

Shprehje idiomatike me strukturë të përafërt ku njëra pjesë përkthehet njëlloj, ndërsa tjetra jo, e ku një pjesë e ligjëratës në njëren gjuhë zëvendësohet me një pjesë tjetër të ligjëratës:

(159)

- a. *Ngrije zërin!/Speak up!*
- b. *Take him down!/Hiqe qafe!*
- c. *Cover me./ Më ruaj.*
- d. *He is safe and sound./Ai është mirë.*
- e. *He is old school./Ai është i gjeneratës së vjetër.*

Shprehje idiomatike me strukturë tërësisht të ndryshme ku nevojitet parafrazim i plotë për të ruajtur kuptimin e shprehjes:

(160)

- a. *It takes two for a tango./Duhet dy persona për t'u marrë vesh./Tangoja kërcëhet me dy veta.*
- b. *We will keep our fingers crossed./Ju urojmë fat!*

Kategorizimi i mësipërm është bërë vetëm për sa i përket strukturës së fjalisë, gjegjësisht përputhjes apo mospërputhjes së gjymtyrëve kur shprehja përkthehet nga njëra gjuhë në tjetrën. Sipas Thomait, ekziston larmi në marrëdhëniet sintaksore që vendosin gjymtyrët me njëra-tjetrën dhe në këtë mënyrë ekzistojnë marrëdhënie përcaktore, objektore e rrethanore²³⁸. Edhe nga shembujt e mësipërm mund të shihet se mund të kemi bartje të shprehjeve nga njëra gjuhë në tjetrën dhe atë në pozita të ndryshme. Në kategorinë e parë dhe të dytë ku shprehjet mund të kenë strukturë të njëjtë ose të përafërt, mund të bëjmë një analizë sintaksore, duke nxjerrë të përafërtat dhe dallimet ndërmjet dy gjuhëve. Por, në kategorinë e fundit kemi strukturë tërësisht të ndryshme nga njëra gjuhë në tjetrën. Parafrazimi i plotë në këtë rast bën që struktura e fjalisë të jetë e ndryshme dhe gjatë analizës sintaksore nuk kemi përputhje të pjesëve të ligjëratës ose edhe të gjymtyrëve.

²³⁸ Thomai, J. 'Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe', Tiranë, 1999, 55-57.

KREU IV

RENDI I GJYMTYRËVE TË FJALIVE NË VEPRËN ‘AVENTURAT E SHERLOK HOLMSIT’ E PËRKTHYER NGA GJUHA ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE

4.1 Hyrje

Në kreun III është vërejtur se rendi i fjalëve në fjali mund të ndryshojë në raste të caktuara kur ballafaqohemi me përkthimin e fjalive nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Shembujt e dhënë në mënyrë individuale dhe të grumbulluar nga burime të ndryshme si ueb faqe interneti, agjenci lajmesh ose në rrjetet sociale në kreun II dhe III kanë vërtetuar një gjë të tillë, edhe pse shumica e fjalive kanë pasur rendin e njëjtë. Në kreun IV analizohet rendi i fjalëve në fjalitë e përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe nga vepra ‘*Aventurat e Sherlock Holmsit*’. Fjalitë e analizuar janë dhënë në Shtojcën A të ndara sipas tre tabelave përkatëse. Tabelat janë ndarë sipas përbërësve të fjalive, gjegjësisht gjymtyrëve. Në tabelën nr. 1 janë dhënë fjalitë që në gjuhën angleze kanë rendin kryefjalë + kallëzues + kundrinor (i drejtë ose i zhdrejtë, ose fjali me dy kundrinorë), në tabelën nr. 2 rendi kryefjalë + kallëzues + gjymtyrë tjetër e dytë (kryesisht jemi përqendruar te kallëzuesi emëror, kallëzuesori i kundrinorit dhe rrethanori) dhe në tabelën nr. 3 janë dhënë fjalitë me një kryepërbërës, me dy kryepërbërës ose të paplota. Fjalive që do të analizohen në këtë kapitull u jemi referuar në bazë të numrave të shënuar në tabelat përkatëse në Shtojcën A.

Analiza sintaksore e fjalive në gjuhën angleze, gjegjësisht përcaktimi i funksioneve sintaksore, në raste të rralla është bërë edhe me ndihmën e mjetit VISL (*Visual Interactive Syntax Learning*), i cili është një aplikacion eksperimental që jo çdoherë ka gjetur në mënyrë të saktë funksionet sintaksore, por i jemi referuar në raste të caktuara për të testuar saktësinë e aplikacionit për sa u përket funksioneve sintaksore të gjymtyrëve në gjuhën angleze. Gjatë analizës është vërejtur se në mjaft raste aplikacioni nuk ka qenë i saktë veçanërisht me kundrinorin e zhdrejtë me ose pa parafjalë të cilin në raste të caktuara e ka konsideruar rrethanor.

4.2. Analizë e fjalive me rendin kryefjalë – kallëzues – kundrinor (i drejtë/i zhdrejtë)

Në fillim i referohemi tabelës nr. 1 në Shtojcën A e cila ka të bëjë me analizën e fjalive me rend kryefjalë – kallëzues – kundrinor (i drejtë apo i zhdrejtë). Nga numri i përgjithshëm i fjalive të analizuara ato që përmbanin edhe kundrinor ishin 226 të tilla. Nga ky numër, 95 fjali të analizuara kishin rend të njëjtë. Për fillim, duhet të theksohet se në një numër shumë të madh fjalish nga këto fjali (tabela nr. 1) kryefjala nuk ka qenë e shprehur dhe ajo është kuptuar nga veta e foljes. Rastet e tilla janë përsëritur në mënyrë të vazhdueshme kur kryefjala është shprehur me përemra vetorë. Duke u nisur nga ky fakt, ne i kemi konsideruar si fjali me rend të njëjtë në rastet kur dy gjymtyrët e tjera (kallëzuesi dhe kundrinori) kanë ruajtur rendin e njëjtë në të dyja gjuhët.

Fjalitë e analizuara në pjesën dërrmuese kanë qenë fjali dëftore, por ka pasur edhe fjali pyetëse dhe thirrmore. Fjalitë kanë qenë fjali të thjeshta, por edhe fjali të përbëra me bashkërenditje apo me nënrenditje. Pavarësisht nga tipi i fjalive, analiza është përqendruar kryesisht në lidhjen, apo rendin, e kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit. Fjalitë e thjeshta, apo edhe të përbëra, të cilat në mënyrë plotësuese kanë pasur gjymtyrë tjetër përveç tre gjymtyrëve të përmendura janë futur në të njëjtën kategori për shkak se të njëjtat kanë pasur së paku një kundrinor. Fjalitë të cilat nuk kanë pasur kundrinor, janë shënuar në tabelën nr. 2 në shtojcën e njëjtë.




Figura 1. Fjali ku mungon kryefjala.

Kryefjala në gjuhën shqipe në shumë raste nuk është shkruar për shkak se ajo kuptohet nga veta e foljes dhe rastet e tilla janë të shumta në këtë vepër të analizuar. Rastet e tilla janë të shumta në tabelën nr. 1 (si fj. 5, 6, 7, 8, 9 dhe shumë të tjera), pavarësisht nëse gjenden në fillim të fjalisë, në sifjali apo në fjali të përbërë me bashkërenditje apo nënrenditje. Numri i fjalive mund të shihet se është mjaft i madh, përkatësisht në 126 fjali kryefjala ose ka munguar (është kuptuar nga veta e foljes), ose është përdorur trajtë të shkurtër për të shënuar kundrinorin pa pasur kryefjalë në fjali, ose duke pasur vetëm kryefjalë logjike.

Rendi në pjesën dërmuese të këtyre fjalive është ruajtur, por ndonjëherë ka pasur raste kur përkthyesi për të arritur një stil letrar dhe gjuhë më stilistike ka ndikuar në strukturën e fjalisë në mënyra të ndryshme, posaçërisht me anë të parafrazimit. Ndonjëherë ka pasur raste kur janë përdorur edhe shprehje të caktuara idiomatike të cilat kanë rezultuar me strukturë të njëjtë (si fjalia 175) ose me ndryshim të plotë të strukturës (si fjalia 35, 83, 130). Më poshtë jepen disa nga ndryshimet e vogla strukturore, por që nuk kanë ndikuar në rendin e kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit.

Në fjalinë (28) *‘Holmes took his hunting whip and we went to the same street **as that morning.**’*/Holmsi nxori kamzhikun e tij të gjuetisë dhe shkuam në të njëjtën rrugë **që e vizituam**

në mëngjes’, përkundër rendit të njëjtë, është përdorur strukturë e ndryshme në fund të fjalisë ku në gjuhën angleze nuk është përdorur folje (*‘as that morning’*), ndërsa në gjuhën shqipe ka shtim të foljes (*‘që e vizituam në mëngjes’*) për t’iu referuar një veprimi të mëhershëm. Normalisht, shtimi i kësaj foljeje në fjalinë e përkthyer është bërë me qëllim plotësimin e kuptimit, por një gjë e tillë nuk ka qenë e domosdoshme për shkak se fjalia do të kuptohej nga konteksti, ose duke u mbështetur në kuptimin e tërë fjalisë ose paragrafit. Një dallim është vërejtur në fjalinë (33) *‘The other managed to escape back down the hole, despite the policeman grabbing him by his jacket./Tjetri arriti të arratisë nga vrima në tokë, edhe pse polici e kishte kapur nga xhaketa’* ku rendi nuk është prekur përkundër përdorimit të parafjalëve të ndryshme. Por në këtë rast përdorimi i parafjalës *‘nga’* në vend të *‘prapa’* (që në gj. angleze është *‘back’*) ka bërë që të humbet deri diku kuptimi i fjalisë, sepse logjikisht nuk mund të thuhet *‘Tjetri arriti të arratisë nga vrima në tokë.’*, e që në gj. angleze e ka kuptimin e kundërt, pra, të dalë nga toka (*‘... managed to escape back down the hole...’*). Këtu përkthimi me parafrazim ndoshta do të kishte prekur strukturën e fjalisë, por mbase do të ruante kuptimin e së njëjtës. Qëllimi i përkthimit me parafrazim është ruajtja e kuptimit të fjalisë së përkthyer. Ndryshimi i strukturës së fjalive në raste të tilla bëhet me qëllim që të ruhet kuptimi, që njëkohësisht është qëllimi kryesor kur përkthehet një fjali.

Gjatë analizës së tekstit është hasur në raste kur kryefjala është shprehur me pjesë të ndryshme të ligjëratës, por që sërish nuk kanë ndikuar në rendin e gjymtyrëve. Rast i tillë është fjalia (44) ku është përdorur përemri vetor *‘ai’* në vend të *‘ky burrë/this man’*. Kjo paraqet një dallim ndërmjet dy gjuhëve, por ky dallim nuk ka prekur rendin e gjymtyrëve. Në një rast të caktuar është vënë re mungesa e përemrit lidhor në gjuhën angleze. Realisht, përemri lidhor *‘that’* në gjuhën angleze është jo çdoherë i domosdoshëm dhe mund të mos përdoret në rastet kur ai kuptohet nga vetë fjalia. Shembull i tillë është fjalia (51) *‘No, because he said (that) he was innocent./Jo, sepse ai tha që ishte i pafajshëm.’*. Në gjuhën angleze nuk ka përemër lidhor, por në gjuhën shqipe ai detyrimisht është shtuar pasi që fjalia do të humbte kuptimin. Përkundër shtimit të këtij përemri lidhor, rendi i fjalisë ka mbetur i njëjtë në të dyja gjuhët. Gjatë përkthimit parapëlqehet që të mos lihen fjalë pa përkthyer, pasi ato në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo mund të ndikojnë në humbjen e kuptimit të fjalisë. Rast tjetër ku nuk është marrë parasysh përemri lidhor i ndjekur nga një folje, është fjalia (104), por edhe këtu kemi rend të njëjtë.

Ndonjëherë përkthyesit e veprave janë më të lirë me përzgjedhjen e fjalëve, por me kusht të ruhet kuptimi i fjalisë. Një rast i tillë kur nuk është përdorur folja e njëjtë, është fjalia (53) ‘*He took his shotgun and **went** to the pool to hunt rabbits./Ai kishte marrë pushkën dhe **ishte nisur** drejt liqenit për të gjuajtur lepuj.*’ ku folja ‘*ishte nisur*’ është përdorur në vend të foljes ‘*went*’. Përkundër përdorimit të një foljeje të ndryshme, rendi ka mbetur i njëjtë dhe në fjalinë e dytë kemi rrethanor. Rastet kur rendi ndryshon është kur një folje jokalimtare zëvendësohet me një folje kalimtare dhe anasjelltas. Rast tjetër është edhe fjalia (169) ‘*At that moment we heard a short man **asking the same thing** at Breckinridge’s stall./Atë çast dëgjuam një burrë të shkurtër që **bënte të njëjtën pyetje** tek tezga e Bekinrixhit.*’ ku janë përdorur fjalë jo të njëjta si në gjuhën angleze, por që nuk kanë ndikuar në rendin dhe funksionet sintaksore. Kjo fjali është futur në këtë kategori pasi është fjali e përbërë me bashkërenditje dhe pjesa e parë ka kundrinor si gjymtyrë të dytë në gjuhën angleze. Në gjuhën shqipe është fjali e përbërë me nënrenditje përcaktore. Por në raste të tjera ndodh krejtësisht e kundërta. Përdorimi i foljeve të ndryshme ndikon në strukturën e fjalisë, siç u tha pak më herët. Kështu, kallëzuesi në një gjuhë mund të marrë një gjymtyrë ndryshe ose mund të mos marrë një të tillë, ose, nëse jo gjymtyrë, atëherë mund të ndryshojë strukturën e fjalisë. Shembull i tillë është fjalia (80) ‘*First, the father had a meeting at the pool and it **wasn’t** with his son, as he didn’t know when we has returning, and second, the father shouted ‘Cooee’ before he knew his son had returned./E para, babai kishte takim pranë liqenit dhe **nuk e kishte** me djalin e tij, pasi nuk e dinte se ai po kthehej, dhe e dyta, babai ka bërëtitur Kuuiii para se ta dinte që djali i tij ishte kthyer.*’ ku përdorimi i foljeve ‘*kam*’ dhe ‘*jam*’ në vend të njëra-tjetrës ka ndikim. Më saktë, folja ‘*jam*’ është folje këpujore dhe si e tillë pas saj normalisht vjen kallëzuesi emëror. Pas foljes ‘*kam*’ normalisht vjen kundrinor me parafjalë (në këtë rast ‘*me djalin e tij*’). Në veprën e analizuar është vërejtur ndryshim jo vetëm i emrave dhe i foljeve, pra përdorim i fjalëve të ndryshme në fjalitë e përkthyer, por ka ndodhur edhe ndryshim nga një pjesë e ligjëratës në një pjesë tjetër të ligjëratës. Më saktë, këtu ka ndikuar folja e cila në gjuhën angleze nuk lejon mohim të dyfishtë, ndërsa në gjuhën shqipe një gjë e tillë është e mundur. Bëhet fjalë për fjalinë (139) ‘*And this man didn’t place **an** advertisement?/Po ky burri nuk ka vënë asnjë shpallje?*’ ku nyja ‘*an*’ në gjuhën angleze është përkthyer si përemër ‘*asnjë*’ në gjuhën shqipe. Edhe pse kemi ndryshim nga një nyje joshquese në një përemër të pacaktuar, rendi mbetet i njëjtë.

Kundrinorin në gjuhën shqipe e gjejmë në pozicione të ndryshme, por jo në gjuhën angleze, së paku duke iu referuar rendit të drejtë dhe të fiksuar. Në raste të rralla, për të arritur një stil letrar, pra për arsye stilistike, ndodh që edhe në gjuhën angleze të kemi lëvizje të kundrinorit dhe ai të vendoset në fillim të fjalisë, si në fjalinë (127) ‘*That I refused./Atë e refuzova.*’. Ky është një ndër rastet e rralla të zhvendosjes së kundrinorit para kallëzuesit. Sa i përket gjuhës shqipe, një lëvizje e tillë është krejtësisht e pranueshme dhe e saktë në aspektin gramatikor dhe rendi i anasjelltë përputhet në të dy rastet.

Fjalia (61) ‘*But if he had the imagination to invent that his father spoke of a rat before dying, why didn’t he have it to invent a motive for the argument?/Po nëse do të kishte imagjinatën për të sajuar se babai i kishte folur për një mi para se të vdiste, pse nuk e pati edhe për të sajuar ndonjë motiv për grindjen?*’ nxjerr në pah një element të rëndësishëm pas analizës së fjalive. Këtu flitet për përcaktorin i cili me mungesën apo praninë e tij nuk ndikon në rendin e gjymtyrëve. Por, mungesa e tij ndikon në kuptimin e fjalisë, sepse në këtë rast heqja e përcaktorit ‘his’ nga emri ‘father’ (‘...that his father spoke...’) dhe përdorimi vetëm i emrit ‘babai’ (‘...se babai i kishte folur’) e bën të paqartë se kujt babai i referohemi. Pra, ‘babai’ mund të jetë i kujtdo personi të përmendur më herët, në moment apo më vonë në fjali. I njëjti rast me fjalën ‘babai’ përsëritet edhe në fjalinë (57). Përcaktori preferohet që mos hiqet gjatë përkthimit për shkak se ka rol përcaktues, ndryshe nga kryefjala e cila mund të kuptohet nga folja.

Më lart u përmend se përkthyesi në raste të caktuara ka përdorur fjalë të ndryshme për kallëzuesin (folje të ndryshme). Raste të ngjashme ka pasur edhe me emrat, si në fjalinë (62) ‘*I deduce that the young man is telling the truth./Mendoj se i riu po thotë të vërtetën.*’. Në këtë rast kemi përdorimin e pjesëve të ndryshme të ligjëratës, gjegjësisht është shndërruar sintagma emërore në mbiemër të emërzuar. Në këtë fjali sintagma emërore ‘the young man’ është përkthyer si mbiemër i emërzuar ‘i riu’. Meqë të dy janë në numrin njëjës, kjo ka bërë që të mos ketë ndryshim të strukturës apo rendit të fjalisë. Në raste të tjera në fjalitë e përkthyer janë shtuar edhe fjalë të cilat nuk kanë qenë në fjalinë në gjuhën angleze, si në fjalinë (122) ‘*After a while I bumped into McCarthy in London./Pas një kohe, rastësisht takova Mekarthin në Londër.*’. Përkundër shtimit të ndajfoljes ‘rastësisht’ për të cilën lirisht mund të themi se nuk ka pasur nevojë, fjalia nuk ka pësuar ndryshim të rendit të gjymtyrëve.

Trajta e shkurtër e përemrave vetorë luan rol shumë të rëndësishëm në gjuhën shqipe sepse është rimarrëse e kundrinorit. Në fjalinë (64) ‘*We have known each other since we were*

children./E njohim njëri-tjetrin që kur jemi fëmijë.’ apo (120) trajta e shkurtër ‘e’ shpreh kundrinorin. Me këtë kemi një rend të ndryshuar të fjalive pasi që në gjuhën angleze fjalia fillon me kryefjalë, ndërsa në gjuhën shqipe me kallëzues dhe kryefjala është e nënkuptuar. Gjatë analizës janë vërejtur edhe raste me mospërputhje të vetave si në fjalinë (124) ‘*They came with me and I couldn’t get rid of him./Ata erdhën me mua dhe nuk mund t’i hiqja dot qafe.*’). Ky ndryshim i vetës së trajtës së shkurtër nuk ndikon në rendin e gjymtyrëve, por padyshim që ndryshon kuptimin e fjalisë. Ky ndryshim rrjedh nga përkthimi i gabuar dhe fjalia është dashur të përkthehet ‘*Ata erdhën me mua dhe nuk mund ta hiqja dot qafe.*’. Në rastin kur trajta e shkurtër shpreh kundrinorin, rendi i gjymtyrëve është çdoherë i ndryshëm nëse përdoret vetëm trajta e shkurtër dhe nëse nuk shkruhet përemri i plotë që shpreh kundrinorin, p.sh., si në fjalinë (78) ‘*She left **him** and is saying their wedding wasn’t legal./Ajo e ka lënë duke thënë se martesa e tyre nuk ishte e ligjshme.*’ dhe të tjera të shënuara më poshtë. Në rastet kur përdoret kundrinori i zhdrejtë me parafralë zakonisht kemi rend të njëjtë dhe kundrinori vendoset pas kallëzuesit, si në fjalinë (77) ‘*He was with **her** during these three days in Bristol./Ai ka qenë me të këto tri ditë në Bristol.*’. Përkundër rendit kryesisht të lirë në gjuhën shqipe, ndryshimi i vendit të kundrinorit do të humbte rendin e drejtë në gjuhën shqipe dhe fjalia në raste të caktuara nuk do të tingëllonte mirë. Përderisa jemi te trajta e shkurtër, një shembull interesant është fjalia (107). Ajo çfarë ra në sy është se trajta e shkurtër dhe forma vetore e foljes jo çdoherë janë tregues të saktë të vetës. Bëhet fjalë për fjalinë ‘*Now I know who it is./Tani e di kush është.*’. Përderisa në fjalinë në gjuhën angleze është shumë e qartë kryefjala ‘*I/Unë*’, në gjuhën shqipe mund të na paraqitet problem. Imagjinoni situatën: ‘*Tani **unë/ti** e di kush është.*’. Pra, trajta e shkurtër dhe folja jo çdoherë kanë shënjesë ekskluziv të vetave dhe mungesa e kryefjalës mund të ndikojë në kuptimin e fjalisë.

Rendi i gjymtyrëve nuk mund të ruhet në mënyrë të patjetërsueshme në gjuhën shqipe në të gjitha rastet. Përmendim vetëm gjuhën shqipe pasi në gjuhën angleze rendi normalisht është i fiksuar, ndërsa në gjuhën shqipe lëvizja e gjymtyrëve mund të bëhet për shkak të rendit të anasjellë, rendit emfatik apo arsye stilistike. Në vepra letrare ndryshimi i vendit të gjymtyrëve mund të jetë më i dukshëm sesa në përkthimet e teksteve teknike dhe kjo mund të shihet në numrin e fjalive që rezulton se është më i madh sesa i atyre me rend të njëjtë. Pas analizës së bërë rezulton se 131 fjali nga tabela nr. 1 kanë rend apo strukturë të ndryshme (të kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit) në të dyja gjuhët, në dallim nga 95 fjali të cilat kanë rezultuar me

rend të njëjtë të gjymtyrëve. Shembull tipik është fjalia (17) ‘A young man opened the door./Derën e hapi një djalë i ri.’, si edhe (27), (35) dhe shumë të tjera të përmendura më poshtë. Në anën tjetër, në tekstet teknike përkthyesit janë më shumë të përqendruar në ruajtjen e kuptimit dhe nuk luajnë me lëvizjen e fjalëve në fjali pasi vetë natyra e teksteve teknike është e tillë që nuk e lejon aq shumë lëvizjen e gjymtyrëve. Shembuj të tillë janë dhënë në shtojcën B, si fjalia ‘Çiftet me disavantazh më të lartë është parashikuar se performojnë me më pak efikasitet gjatë PCR-së./ Pairs with higher penalty are predicted to perform less efficiently during the PCR’, apo ‘Në përgjithësi, efikasiteti i ARNi-së në qeliza dihet se është i varur nga sekuenca e regjionit të rrënjës dhe vetëm përafërsisht 30% e siARN-ve të rëndomtë ËSHTË raportuar se tregon ARNi shumë efikas në linjat e kultivuara të gjitarëve./In general, RNAi efficiency in the cells is known to depend on the sequence of the stem region, and only approximately 30% of random siRNAs HAVE been reported to show highly effective RNAi in cultured mammalian cells.’ Pra, mund të shihet se tendenca për të ndryshuar rendin e gjymtyrëve mund të shkaktojë humbjen e kuptimit për shkak se proceset në fjali janë të dhënë njëri pas tjetrit ose në mënyrë kronologjike.




Figura 2. Struktura/rendi në fjalitë me kryefjalë – kallëzues – kundrinor.

Ndryshimi i parë që bie në sy në tekstin e përkthyer, është mungesa e kryefjalës në mënyrë të vazhdueshme, sepse kryefjala kuptohet nga veta e foljes ose bëhet fjalë për kryefjalë logjike. Situatat ku kryefjala kuptohet nga veta e foljes nuk paraqesin vështirësi për analizën e tekstit apo edhe për kuptimin e tij. Por, ndonjëherë ndodh që gjinia mund të mos kuptohet kur nuk kemi

kryefjalë të shprehur në gjuhën shqipe, si në fjalinë (46) ‘*That morning **he** said to his maid that **he** had a meeting at three, but **we** don’t know with whom.*./Atë mëngjes i kishte thënë shërbyeses se kishte një takim në orën tre, mirëpo nuk e dimë me kë.’. Në gjuhën angleze është e qartë se flitet për person të gjinisë mashkullore, sepse kryefjala është shprehur me përemrin vetor ‘*he*’, ndërsa në gjuhën shqipe nuk mund të kuptohet gjinia: ‘*Atë mëngjes i kishte thënë shërbyeses se kishte një ...*’. Pra, pyetja që shtrohet këtu është se kush i kishte thënë, ai apo ajo? Prandaj, mungesa e kryefjalës apo kundrinorit lë hapësirë për interpretime të ndryshme. Fjali e tillë ku ka paqartësi është fjalia (67) ‘*No, he didn’t want **it** either.*./Jo, **as** ai nuk do e donte.’, në të cilën mungesa e kundrinorit, në rast se fjalia do të analizohej veças e jo si pjesë e tekstit, do ta bënte të paqartë kuptimin e saj. Në gjuhën angleze fjalia është ‘*No, he didn’t want it either.*’, ndërsa në gjuhën shqipe ‘*Jo, as ai nuk do e donte.*’ Pra, përveç lëvizjes së pjesëzës, si ndryshim strukturor i domosdoshëm, mungon kundrinori ‘*atë*’. Duke e analizuar të shkëputur nga konteksti fjalinë në gjuhën shqipe, për ne është e paqartë se çfarë nuk do të donte ai. Ashtu si mungesa e kryefjalës, siç u tha më lart, mund të ndikojë në kuptimin e fjalisë, situatë të ngjashme kemi edhe me kundrinorin. Në fjalinë (47) ‘*A gamekeeper saw **him** walking alone and shortly after **he** saw McCarthy’s son, James, following him with a shotgun.*./Një rojtar **e** kishte parë duke ecur vetëm dhe pak më vonë kishte parë djalin e Mekarthit, Xhemsin, duke e ndjekur me një pushkë.’ mund të shohim se kundrinori në gjuhën angleze është krejtësisht i qartë (pra, dihet gjinia), ndërsa në gjuhën shqipe nuk mund ta gjejmë gjininë vetëm nëpërmjet trajtës së shkurtër. Lënia anash e kundrinorit mund të krijojë paqartësi në tekst. E njëjta situatë përsëritet edhe në fjalitë (48 dhe 158). Mënyra e vetme për të gjetur se kujt i referohet trajta e shkurtër është konteksti, pra, të dihet se për çfarë flitet në tekst dhe të ruhet lidhshmëria logjike e fjalive. Kësi rastesh normalisht paraqiten kur kundrinori shprehet nga një përemër e jo nga një emër. Kur kundrinori shprehet me emër, nuk paraqiten raste të tilla për shkak se emrat nuk mund të lihen anësh gjatë përkthimit.

Ka pasur raste të caktuara ku është vërejtur ndryshimi i vendit të kryefjalës dhe kallëzuesit në tekstin e analizuar, si në fjalitë (96, 103, 108, 144, 145, 157, 188, 193 dhe 206), e ku si shembull referues marrim fjalinë (96) ‘*And the murderer?’ Lestrade asked*’ dhe ‘*Po vrasësi?’ pyeti Lestradi*’. Ky ndryshim realisht është i domosdoshëm në gjuhën shqipe, sepse përndryshe imagjinoni fjalinë ‘*Po vrasësi?’ Lestradi pyeti.*’. Rendi i anasjellë i kryefjalës dhe kallëzuesit është i domosdoshëm në këtë fjali.

Dallimi i dytë më i madh dhe më i dukshëm për sa i përket lidhjes kryefjalë – kallëzues – kundrinor në këtë analizë ka qenë lëvizja e kundrinorit i cili zakonisht është shprehur me trajtë të shkurtër të përemrave vetorë. Në raste të rralla ka pasur situata ku përveç trajtës së shkurtër është shkruar përemri i plotë. Më poshtë janë dhënë dallimet më të dukshme që kanë të bëjnë me rendin e lartpërmendur në tabelën nr. 1 në Shtojcën A.

Në fillim të analizës është vërejtur një fjali (fjalja 2) e cila nuk është e zakonshme në gjuhën angleze. Në këtë fjali mungon kundrinori i zhdrejtë ‘us’, ndërsa në gjuhën shqipe është dhënë me trajtë të shkurtër. Në gjuhën angleze është krejtësisht normale të kemi fjali me rendin kryefjalë – kallëzues – kundrinor të drejtë, ndërsa kundrinori i zhdrejtë normalisht shkruhet kur është i nevojshëm, dhe nuk presim që të kuptohet nga konteksti. Fjalja ‘*Mr. Wilson showed the newspaper advertisement ...*’ është përkthyer ‘*Z. Uilson na tregoi një shpallje në gazetë ...*’. Pra, trajta e shkurtër qëndron për përemrin vetor në rasën dhanore ‘*neve na*’ e që në fjalinë në gjuhën angleze do të duhej të ishte ‘*Mr. Wilson showed us the newspaper advertisement...*’. Përveç kësaj, në këtë fjali nuk përdoret njëjtë trajta e shquar dhe e pashquar (*the newspaper advertisement/një shpallje në gazetë*). Gjatë përkthimit është e pëlqyeshme që të ruhet në maksimum struktura dhe kuptimi i fjalive, prandaj edhe këtu do të ishte mirë që të ruhej trajta e njëjtë si në gjuhën angleze për shkak se ndryshimi i trajtës ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në kuptim. Rast tjetër interesant ku kemi bashkim të trajtave të shkurtra është fjalja (11) ‘*I placed an advertisement and I chose him because he seemed smart and didn’t cost me much, as he was ready to work for half-wages while he was learning the trade.*’/Vura një shpallje dhe e zgjedha atë, pasi *m’u duk* i zgjuar dhe *nuk kërkonte shumë*, pasi ishte i gatshëm të punonte për gjysmën e pagës ndërkohë që mësonte zanatin’. Madje, në këtë fjali përveç mungesës së pritshme të kryefjalës përdoret edhe trajta e shkurtër për kundrinorin dhe vështirësi tjetër për përcaktimin e roleve sintaksore luan edhe mospërputhja e diatezave të foljes (veprore në gjuhën angleze dhe pësore në gjuhën shqipe). Të gjitha këto ndryshime e bëjnë të qartë strukturën e ndryshuar të fjalisë (11). Në të njëjtën fjali, e cila është fjali e përbërë me bashkërenditje, në pjesën ‘*and didn’t cost me much*’ mund të shohim se ‘*me*’ është kundrinor i zhdrejtë në gjuhën angleze, ndërsa në gjuhën shqipe nuk kemi aspak kundrinor ‘*dhe nuk kërkonte shumë*’. Mungesa e kundrinorit e bën të paqartë se kujt i është drejtuar fjalja dhe ia humb kuptimin asaj. Njëjtë, edhe fjalja (24) ka të bëjë me ndryshimin e vendit të kundrinorit të shprehur me trajtë të shkurtër.

Në dy raste në tekst, në fjalinë (37) ‘*When I heard that the employee was working for half-wages, I knew he had **a good reason**.*’/Kur dëgjova se punëtori i tij punonte për gjysmë rroge, e dija se kishte **arsye të forta**.’ kemi vërejtur ndryshim të numrit të emrit (kundrinorit): ‘half-wages – gjysmë rrogë’ dhe ‘a good reason – arsyë të forta’. Pra, në të dy rastet kemi ndryshim të numrit të emrit. Edhe pse këto emra janë emra të numërueshëm në të dyja gjuhët, përkthimi i bërë ka prekur numrin e tyre dhe normalisht që ndikon edhe në kuptimin e fjalisë, sepse ‘half-wages’ në gjuhën angleze ka kuptimin e më shumë gjysmë rrogave, ndërsa në shqip lë përshtypje se bëhet fjalë për vetëm një gjysmë rrogë. E njëjta gjë është edhe për ‘a good reason’ e cila ndikon në atë se a bëhet fjalë për një arsye apo për shumë arsye. Këto ndryshime si pasojë e përkthimit ndikojnë drejtpërdrejt në kuptimin e fjalisë. Përkthim më i mirë mund të ishte nëse thuhej ‘gjysmë rroga’ dhe ‘një arsye të fortë’ dhe në këtë mënyrë do të ishte ruajtur kuptimi i fjalisë. Zëvendësim tjetër i panevojshëm i kundrinorit është bërë edhe në fjalinë (42) ‘*He had bought **it** with the fortune that he had made in Australia.*’/Ai i kishte blerë **ato toka** me pasurinë e fituar në Australi.’ ku nga një përemër vetor ‘it’ kundrinori në gjuhën shqipe është përkthyer ‘ato toka’. Përveç ndryshimit nga një përemër në një emër, këtu nuk përputhet edhe numri i kundrinorit, por kjo mospërputhje këtu nuk ndikon në pjesën tjetër të fjalisë, gjegjësisht rendin e gjymtyrëve.

Mospërputhje tjetër e numrit të kryefjalës dhe kallëzuesit është vërejtur në fjalinë (88). Si pasojë e ndryshimit të panevojshëm të numrit të emrit nga ‘the trial’ në ‘gjurmët’, kemi edhe ndryshim të numrit të foljes me të cilën shprehet kallëzuesi. Po ashtu, në fjalinë (153) kemi mospërputhje të numrit të foljes: ‘... the owner of the goose and the hat comes this afternoon...’, ‘pronari i patës dhe kapelës të vijnë’. Këtu realisht kemi të bëjmë me gabim në gjuhën shqipe pasi nuk bëhet fjalë për dy palë, por bëhet fjalë për një person i cili ka në pronë dy gjëra, dhe si rrjedhim nuk mund të kemi folje në numrin shumës. Ose më saktë, kryefjala përbëhet nga sintagmë emërore me kokë emër në numrin njëjës ‘the owner’ dhe ‘pronari’, ndërsa pjesa tjetër shërben si përcaktor i kryefjalës, që nuk duhet të ketë ndikim në numrin e foljes. Situatë e ngjashme sërish paraqitet në fjalinë (162) ‘*There **he found out** that the geese had been bought in Covent Garden market from a certain Breckinridge.*’/Atje **gjetëm** se patat i kishin blerë në tregun e Kovent Gardenit nga njëfarë Brekinrixhi.’. Në këtë fjali mungon kryefjala dhe kallëzuesi nuk është në të njëjtin numër në të dyja fjalitë. Kjo vjen si pasojë e drejtpërdrejtë e përkthimit të gabuar, sepse ‘there’ është rrethanor dhe jo kryefjalë. Kryefjalë është përemri vetor ‘he’, i cili

lidhet me folje në njëjës, ndërsa në gjuhën shqipe fjalia fillon ‘Atje gjetëm ...’ - sikur kryefjalë të ishte përemri ‘ne’, që në fakt nuk është. Numri i foljes nuk përputhet edhe në fjalinë (201). Këtu ballafaqohemi me një situatë mjaft interesante brenda sifjalisë ‘it was only 10 kms away’ apo ‘ishin vetëm 10 kilometra më larg’ për shkak të përkthimit të gabuar. Folja nuk përshtatet me pjesën që ndjek, pra me kallëzuesin emëror, por me kryefjalën. Ashtu si në gjuhën angleze, edhe në gjuhën shqipe fjalia duhet të jetë ‘**Ishte** vetëm 10 km larg.’. Në gjuhën angleze në asnjë mënyrë nuk mund të kemi folje në numrin shumës e të themi ‘it were only 10 kms away’. Ndryshimi më evident për sa i përket lidhjes së kryefjalës dhe kallëzuesit është vërejtur në fjalinë (218) ‘Everybody had a different opinion until Holmes pointed to the centre of the circle./Të gjithë kishin mendime të ndryshme, derisa Holmsi tregoi në qendër të rrethit.’ ku nuk kemi përputhje të numrit të foljes. Për ta pasur më të qartë japim vetëm kryefjalën, kallëzuesin dhe kundrinorin në të dy gjuhët: ‘Everybody had a different opinion, ...’, apo ‘Të gjithë kishin mendime të ndryshme, ...’. Ky ndryshim shpjegohet me atë që ‘everybody’ është përemër i pacaktuar dhe në gjuhën angleze është në numrin njëjës, gjegjësisht foljen e kërkon në numrin njëjës, ndërsa në gjuhën shqipe po i njëjti përemër ‘të gjithë’ kërkon folje në numrin shumës. Ky ndryshim në të njëjtën kohë ka ndikuar edhe te kundrinori, ku kundrinori në gjuhën angleze është i shprehur me emër në numrin njëjës, ndërsa në gjuhën shqipe është imponuar emër në numrin shumës sepse nuk mund të thuhet ‘Të gjithë kishin mendim të ndryshëm’.



Figura 3. Lëvizja e kundrinorit në fjalitë në gjuhën shqipe.

Rastet e fjalive ku kundrinori i drejtë apo i zhdrejtë në gjuhën shqipe gjendet në pozicione të ndryshme nga gjuha angleze, është shprehur me trajtë të shkurtër, apo mungon krejtësisht, janë të shumta. Të tilla janë fjalia (8) ‘*Each week he paid **me** the four pounds and **he** then only passed by once a week and even stopped going, but I didn’t dare to miss a day./Çdo javë ai **më** paguante nga katër paundë dhe pastaj vinte aty vetëm një herë në javë dhe pastaj nuk vinte më, por unë nuk guxoja të mungoja asnjë ditë.*’ dhe fjalitë (10, 14, 17 dhe shumë fjali të tjera deri në fjalinë 211). Pra, 54 fjali kanë ndryshime strukturore që lidhen me ndryshime që kanë të bëjnë me kundrinorin.

Në gjuhë ndodhin ndryshime të detyrueshme. Një ndryshim i tillë është kur në gjuhën angleze kemi kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë, ndërsa në gjuhën shqipe me parafjalë. Kjo ndodh për shkak të lëvizjes së gjymtyrëve si në fjalinë (10): ‘*I asked my employee for advice ...*’ – ‘*Kërkova këshillë nga punëtori im*’. Pra, përveç mungesës së kryefjalës, gjë që është më se e zakonshme, këtu kemi gjymtyrë të dyta në pozita të ndryshme. Kundrinor pa parafjalë do të kishim vetëm në rast se emri do të ishte në rasën dhanore, por, meqenëse është përdorur një parafjalë, atëherë fjalia në gjuhën shqipe nuk do të tingëllonte mirë, nëse do të ishte ‘*Kërkova nga punëtori im këshillë...*’ sepse fjalia nuk përfundon aty. Edhe në gjuhën angleze do të mund të kishim fjali me kundrinor pa parafjalë nëse fjalia do të ishte ‘*I asked my employee **an** advice ...*’. Madje, ky është rendi i drejtë në gjuhën angleze kur fjalia përbëhet nga dy kundrinorë dhe kundrinori i zhdrejtë qëndron para kundrinorit të drejtë. Si mundësi tjetër për të bërë përkthim më të mirë do të ishte fjalia ‘*I kërkova një këshillë punëtorit tim*’. Kjo fjali do të ishte si përkthim më i pranueshëm dhe fjalia do të ruante rendin e një fjalie tipike në gjuhën shqipe. Fjali tjetër ku kemi kundrinor të zhdrejtë me parafjalë në gjuhën angleze ‘*with us*’ ndërsa pa parafjalë në gjuhën shqipe të shprehur me trajtë të shkurtër është fjalia (92). Një ndryshim i imponuar është vërejtur në fjalinë (86) ku folja jokaltare ‘*frowned*’ në gjuhën angleze nuk ka asnjë fjalë shoqëruese, por në gjuhën shqipe kemi folje kalimtare dhe duhet patjetër të shoqërohet nga një fjalë. Në fjalinë (111) ‘*Yes, the lodge-keeper brought **it to me**./Po, kujdestari ma solli.*’ kemi situatë interesante. Përderisa në gjuhën angleze kemi dy kundrinorë (të drejtë dhe të zhdrejtë), në gjuhën shqipe kemi njëjtë dy kundrinorë por të shprehur me trajtë të bashkuar (*më + e = ma*). Raste të ngjashme si ky i fundit janë edhe fjalitë (117, 119, 145). Në një rast tjetër kemi shtim të një kundrinori në gjuhën shqipe të shprehur me trajtë të shkurtër, edhe pse në gjuhën angleze nuk ka kundrinor. Bëhet fjalë për fjalinë (123) – ‘*He **threatened** to go to the police if I didn’t help*

him and his son, as they were in a miserable situation./Ai më kërcënoi se do të shkonte në polici po të mos e ndihmoja atë dhe djalin e tij, pasi ishin në gjendje të mjeruar.'. Në gjuhën angleze kuptimi i fjalisë është se ai është kërcënuar se do të shkonte, e jo se e ka kërcënuar dikë se do të shkonte. Pra, shtimi i kundrinorit ndikon drejtpërdrejt në strukturën, rendin dhe kuptimin e fjalisë. Ky ndryshim vjen sepse *është kërcënuar* është në joveprore dhe si e tillë në gjuhën shqipe ka nevojë për kundrinorin, ndaj shtohet trajta e shkurtër e cila e referon kundrinorin tek kryefjala e nënkuptuar (unë).

Përshtatja e përkthimit në raste të caktuara ka ndryshuar edhe funksionin sintaksor të gjymtyrëve. Bëhet fjalë për fjalinë (6) ku kemi dallim për sa u përket funksioneve sintaksore. Fjala *'As my business usually received clients in the afternoon, my employee could take care of things in the morning, so I accepted'* është përkthyer në *'Meqë në biznesin tim klientët zakonisht vijnë pasditeve, punëtori im mund të kujdesej për gjërat në mëngjes, ndaj pranova'*. Këtu në pamje të parë mund të shihet se kryefjala në gjuhën angleze është *'my business'*, ndërsa në gjuhën shqipe *'klientët'*. Përveç kësaj, *'në biznesin tim'* nga kryefjalë në gjuhën angleze është shndërruar në rrethanor në gjuhën shqipe. Përkundër ndryshimit strukturor, në këtë fjali është ruajtur kuptimi. Ndryshimi i roleve sintaksore për shkak të përkthimit është vërejtur edhe në fjali të tjera. E tillë është fjalia (52) *'He declared he'd been in Bristol for three days and had arrived that morning but his father wasn't home./Tha se kishte qenë në Bristol për tri ditë dhe se ishte kthyer atë mëngjes, mirëpo nuk e kishte gjetur babain në shtëpi.'* ku njëra fjalë është kryefjalë në gjuhën angleze dhe kundrinor në gjuhën shqipe. Pra, me të analizuar pjesën *'...but his father wasn't home'* dhe *'...mirëpo nuk e kishte gjetur babain në shtëpi'* mund të shohim se kemi ndryshim të funksioneve sintaksore. Madje, në gjuhën shqipe kryefjala është *'ai'*, e një gjë e tillë nuk është e njëjtë në fjalinë në gjuhën angleze. Në fjalinë (80) *'First, the father had a meeting at the pool and it wasn't with his son, as he didn't know when we has returning, and second, the father shouted 'Cooee' before he knew his son had returned./E para, babai kishte takim pranë liqenit dhe nuk e kishte me djalin e tij, pasi nuk e dinte se ai po kthehej, dhe e dyta, babai ka bërëtitur Kuuiii para se ta dinte që djali i tij ishte kthyer.'* njëjtë kemi ndryshim të funksioneve sintaksore për shkak të foljes. Përdorimi i foljes këpujore, si në gjuhën angleze, edhe në gjuhën shqipe pasohet nga një kallëzues emëror ose në raste të tjera rrethanor. Por përdorimi i një foljeje tjetër në gjuhën shqipe në vend të foljes këpujore rezulton me gjymtyrë që ka funksion tjetër sintaksor, gjegjësisht kundrinor. Në fjalinë (165), në gjuhën angleze kemi kallëzues emëror për

shkak të foljes këpujore *'I bet that the goose I ate was **a country-bread**'*, ndërsa në gjuhën shqipe kemi po kallëzues emëror por të shoqëruar me rrethanor vendi *'Kam vënë bast se pata që hëngru ishte e rritur në fshat'*. Ndryshim të funksioneve sintaksore kemi vërejtur edhe në fjalinë (185) *'You could see that his thumb had been cut off and he had bled **a lot**./Mund ta shihja se gishti i madh ishte këputur dhe ai kishte patur shumë gjakderdhje.'* ku rrethanori *'... he had bled **a lot**.'* është kundrinor në gjuhën shqipe *'...ai kishte pasur shumë gjakderdhje'*. Këtu ky ndryshim është i domosdoshëm, sepse në gjuhën shqipe nuk mund të kemi përkthim tekstual, ose fjalë pas fjalë. Në rast se do të ishte përkthim tekstual, atëherë fjalia do të ishte *'... ai kishte derdhur shumë gjak'* – fjali që tingëllon mirë në gjuhën shqipe, por që njëkohësisht do të kishte konotacion tjetër – *'do të kishte vrarë'*. Përkthim më i mirë do të ishte nëse do të thuhej *'kishte humbur shumë gjak'* dhe me këtë do të ruhej më shumë kuptimi i fjalisë së përkthyer.

Në fjalinë (192) kemi ndryshim strukturor, gjegjësisht ndryshim të tipit të gjymtyrëve, ku kundrinori *'I work **for myself** ...'* është shndërruar në kallëzues emëror *'Jam i vetë-punësuar ...'* në gjuhën shqipe. Ngjashëm, edhe në fjalinë (195) kemi ndryshim të funksionit sintaksor të gjymtyrëve, gjegjësisht nga kallëzues emëror *'... it was **only a matter of seeing a hydraulic press** ...'* në kundrinor *'... unë do ta kontrolloja një shtypës hidraulik ...'*. Në fjalinë (196) sërish kemi ndryshim të funksioneve sintaksore, rrethanor në gjuhën angleze *'I had to go **by train** ...'* dhe kundrinor të drejtë në gjuhën shqipe *'U desh të marr trenin ...'*. Ky ndryshim vjen drejtpërdrejt nga përdorimi i një foljeje tjetër, pra nga *'go/shkoj'* në *'marr'*. Sërish duhet theksuar se folje të ndryshme marrin gjymtyrë të ndryshme, prandaj edhe këtu na paraqitet një dallim strukturor.

Gjatë analizës së tekstit janë vërejtur ndryshime strukturore më të theksuara, që drejtpërdrejt kanë ndikuar në rendin e gjymtyrëve në fjali. Për shembull, fjalia (16) *'"I'll smoke a few pipes in order to think," and sitting in the armchair, he lit his pipe and closed his eyes./"Do ta tymos llullën disa herë që të mendoj" tha ai duke u ulur në kolltuk, ndezi llullën dhe mbylli sytë.'* ka strukturë të ndryshuar në pjesë të caktuara për shkak të përshtatjes së përkthimit. Përshtatja mund të ndodhë për shkak se përkthyesi dëshiron të gjejë shprehje më e përshtatshme në aspektin stilistik. Por përdorimi i shprehjeve ndikon drejtpërdrejt në përbërësit e fjalisë. Shembull i një ndryshimi strukturor është edhe fjalia (22) *'I confess that I still didn't know **what was behind the business** with the redhead, despite having seen and heard the same as Sherlock Holmes./E pranoj se ende nuk e dija si ishte puna me flokëkuqin, edhe pse kisha parë dhe dëgjuar të njëjtat gjëra si Sherlock Holmsi.'* me shprehjen *'...what was behind the*

business’ e përkthyer në ‘...si ishte puna me flokëkuqin...’. Pra, siç mund të shihet, kemi ndryshim rrënjësor pas përkthimit të bërë, edhe pse ideja është e qartë, por fjalët e përdorura nuk janë të njëjta. Shembuj të tjerë kemi fjalitë (35, 38, 106, 179), ku kemi shprehje ose strukturë tërësisht të ndryshme. Në anën tjetër, shprehje të caktuara rezultojnë me ndryshim rrënjësor të strukturës së fjalisë dhe rendit, siç janë fjalitë (83) dhe (130). Në këto fjali nuk mund të gjejmë asgjë të përbashkët, por të gjitha janë ndryshuar tërësisht, ashtu si në fjalitë (115, 132), ose deri diku edhe në fjalinë (125). Fjalia (23) përbën një ndryshim strukturor për shkak të foljes, ose më saktësisht për shkak të foljes ‘wear/vesh’. Për ta pasur më të qartë duhet analizuar fjalia e përkthyer: ‘The other **was wearing** a luxury suit and hat.’, ‘Tjetri **kishte veshur** kostum luksoz dhe **kishte vënë** kapele.’ Nga një folje kemi ndryshim strukturor me dy folje. Ky është një ndryshim i patjetërsueshëm sepse foljen ‘wear’ nuk mund ta përdorim për të dy kundrinorët e dhënë në gjuhën angleze, sepse nuk mund të themi ‘kishte veshur kostum dhe kapele’, ngaqë në gjuhën shqipe nuk themi ‘vesh kapele’. Fjalia (41) ‘He told **me** that in Boscombe Valley lived Mr. Turner, who **owned** most of the land there./Ai **më** tha se në Luginën Boskomb jetonte z. Tërner që **ishte** pronar i pjesës më të madhe të tokave atje.’ nxjerr në pah një ndryshim sintaksor, ose më saktë, ndryshim të funksionit sintaksor. Ky ndryshim vjen si pasojë e përdorimit të dy foljeve të ndryshme, por që kuptimin e kanë të përafërt: ‘who owned **most of the land there**’, ‘që ishte **pronar** i pjesës më të madhe të tokave atje.’. Ndryshimi evident këtu është se në gjuhën angleze kemi kundrinor, ndërsa në gjuhën shqipe kallëzues emëror. Edhe pse ideja është e përafërt, ndryshimi i foljes nga një folje e plotë në folje këpujore rezulton me ndryshim të funksioneve sintaksore.

Ndryshime më të thella strukturore janë vënë re në disa raste në tekst. Shembull i tillë është fjalia (82) ‘And **don’t you think it’s odd** that if McCarthy owed **him** so much, that he **strongly supported his son marrying Turner’s daughter**, who’s the heiress, knowing that Turner was against it?/Dhe a **nuk ju duket e çuditshme** që nëse Mekarthi i kishte aq shumë borxhe, që ai **dëshironte aq shumë që djali i tij të martohej me vajzën e Tërnerit**, e cila është trashëgimtare, duke e ditur se Tërneri ishte kundër saj?’ ku kemi ndryshim të strukturës për shkak të përshtatjes së foljes ‘owed’. Kjo ka bërë që përshtatja e përkthimit bashkë me lënien anësh të kundrinorit ‘him’ të ndryshojnë strukturën dhe rendin e fjalisë. Fjalia (84) ‘**At the farm** Holmes asked the maid to show **him** the boots that McCarthy was wearing **the day of his death**, and also a pair of his son’s./**Kur arritëm në fermë**, Holmsi i kërkoi shërbyeses të **na** tregonte çizmet që Mekarthi

kishte patur të veshura **ditën kur vdiq**, si dhe një palë të djalit të tij.’ në anën tjetër përbën një shembull se si mund të ketë shumë ndryshime strukturore, përfshirë funksionet sintaksore. Në këtë fjali rrethanori në gjuhën angleze është shndërruar në sifjali në gjuhën shqipe, kundrinori ‘*him*’ që është në njëjës në gjuhën angleze del si trajtë e shquar e përemrit ‘*ne*’ në rasën dhanore, si dhe kemi ndryshim nga sintagmë emërore në gjuhën angleze në sifjali në gjuhën shqipe. Fjali tjetër me ndryshim strukturor të theksuar është fjalia (101) ‘*I asked for **it** last night, **telegraphing** Bristol./Këtë e kam kërkuar mbrëmë, kur dërgova **telegraf** në Bristol.*’ ku brenda sifjalisë folja ‘*telegraphing*’ e ndjekur nga kundrinori ‘*Bristol*’ është shndërruar në ‘*dërgova telegraf në Bristol*’. Në pamje të parë mund të shihet se kemi ndryshim strukturor, si dhe të funksioneve sintaksore brenda sifjalisë, ku kundrinori ‘*Bristol*’ tani është rrethanor ‘*në Bristol*’. Në fjalinë (105) ‘*And this person lived in the area, because you can **only** reach **the pool** via the farm or the estate./Ky njeri jeton këtu afër, sepse **në liqen** mund të vish **vetëm** nga ferma apo vila.*’ nga kundrinori ‘*the pool*’ kemi rrethanor ‘*në liqen*’. Madje, përveç ndryshimit të funksioneve sintaksore kemi vërejtur edhe lëvizjen e tyre dhe fjalia nuk ka rend të njëjtë. Në fjalinë (184) kemi kuptim të njëjtë, përkundër mungesës së përcaktorit dhe trajtave të shkurtra. Ndryshim strukturor më i theksuar është hasur në fjalinë (199) ku kundrinori është në pozita të ndryshme dhe sintagma foljore ‘*see*’ është shndërruar në sintagmë mbiemërore ‘*qartë*’. Fjali tjetër e cila paraqet ndryshim rrënjësor të strukturës është fjalia (212) për shkak se në gjuhën angleze kemi rend kryefjalë – kallëzues – kundrinor ‘*He won’t say anything.*’, ndërsa në gjuhën shqipe kemi vetëm kryefjalë dhe kallëzues ‘*Ai nuk do të flasë*’. Ky ndryshim strukture vjen si pasojë e përshtatjes së përkthimit dhe folja ‘*nuk do të flasë*’ është përdorur në vend të foljes ‘*thotë*’. Në rast se do të përdorej folja ‘*thotë*’, atëherë situata do të ishte ndryshe për shkak se ajo është folje kalimtare dhe do të kërkonte të plotësohej në këtë rast me një kundrinor. Fjalia (213) ‘*I couldn’t see either **the house or the garden**./Pash se as shtëpia, as oborri, nuk ishin **aty**.*’ paraqet një rast tipik ku kemi ndryshim më evident të strukturës, pjesëve të ligjëratës dhe funksioneve sintaksore. Shtimi i një foljeje në gjuhën shqipe ‘*ishin*’ për të përshtatur përkthimin rezulton me ndryshimin e funksioneve sintaksore (nga kundrinor në gjuhën angleze në rrethanor në gjuhën shqipe) – ‘*I couldn’t see either the house or the garden*’, ‘*Pash se as shtëpia, as oborri, nuk ishin aty*’. E ngjashme si kjo fjali me strukturë të thellë të ndryshuar është edhe fjalia (215). Por në shembuj të tjerë, si fjalitë (25) dhe (39), edhe pse kemi ndryshim të foljes, nuk kemi ndryshim të rendit.

Rendi do të ndryshonte vetëm nëse ndryshon lloji i foljes, pra, nga këpujore në folje të plotë, ose nga kalimtare në folje jokalimtare, ose, nëse do të ndryshonte valenca e saj.

Përveç përdorimit të foljeve të ndryshme, në tekst ka pasur raste edhe me ndryshimin e pjesëve të ligjëratës. Në fjalinë (50) '*And I think it's significant that the young man wasn't surprised to be arrested./Mendoj se është shumë e rëndësishme që i riu nuk u befasua që e arrestuan.*' sintagma emërore '*the young man*' është përkthyer në mbiemër të emëruar. Gjithsesi, ky ndryshim i pjesës së ligjëratës nuk ka ndryshuar rendin e gjymtyrëve dhe funksionet sintaksore. Në një rast tjetër kemi ndryshim nga mbiemër në ndajfolje. Ky ndryshim është vërejtur në fjalinë (56) ku mbiemri '*usual*' është kthyer në ndajfoljen '*zakonisht*'. Fjali ku ka ndryshim të pjesëve të ligjëratës është edhe fjalia (66) ku mbiemri '*it's very probable*' është shndërruar në shprehjen foljore '*ka shumë të ngjarë*'. Në fjalinë (73) si pasojë e ndryshimit të pjesës së ligjëratës në sifjali, emri '*blow*' është përkthyer si folje '*kishin goditur*'.

Ndryshim sintaksor kemi edhe në fjalinë (142) '*These grey hairs reveal his advanced age, and the dust that you see isn't from the street but from fluff from a house./Këto flokë të thinjur na tregojnë se ka moshë të shtyrë dhe pluhuri që sheh, nuk është nga rruga por nga pendla në shtëpi.*' ku kundrinori i shprehur me sintagmë emërore në gjuhën angleze është kundrinor i shprehur me sifjali në gjuhën shqipe '*his advanced age*' dhe '*se ka moshë të shtyrë*'. Ky dallim është tregues i qartë se brenda kësaj fjalie ka ndryshim rrënjësor të strukturës. Ndryshim i të njëjtit lloj paraqitet në fjalinë (170) ku në përkthim rrethanori '*Back in Baker Street*' jepet me sifjali '*Pasi u kthyem në rrugën Bejker*'. Në aspektin sintaksor, ose nëse bëhet analizë me anë të diagramit të pemës, normalisht që këtu kemi dallim në strukturën e fjalisë. Në fjalinë (179) '*I chose a white one with a black fringe on its tail feathers and I put the stone into its gullet./Zgjodha një patë të bardhë me shirit të zi tek puplat e bishtit dhe e bëra ta gëlltiste gurin.*' në sintagmën emërore kemi zëvendësim të numërorit ('*I chose a white one ...*') me kokë emërore ('*Zgjodha një patë të bardhë ...*'). Në fjalinë (194) sërish paraqiten tipa të ndryshëm sintagmash, nga sintagmë foljore në gjuhën angleze '*... and told him to explain.*' në sintagmë emërore në gjuhën shqipe '*... dhe i kërkova të më jepte shpjegime*'. Ky ndryshim në këtë fjali ndikon në rendin e gjymtyrëve për shkak të kundrinorit. Edhe në fjalinë (204) kemi ndryshim strukturor të thellë, nga sifjali e varur '*I, not wanting to lose my fifty pounds, told ...*' në gjuhën angleze, në sifjali kryesore '*Unë nuk doja të humbas pesëdhjetë paundet e mi, ...*' në gjuhën shqipe. Pra, ky ndryshim ndikon drejtpërdrejt në llojin e sifjalisë. Ngjashëm, edhe fjalia (207) ka

strukturë të ndryshuar për shkak të ndikimit të përkthimit, gjegjësisht përkthyesit. Më saktë, sifjalia ‘... **which led us** down some corridors and stairs.’ është tkurrur deri në atë masë sa që përdoret një parafjalë ‘...**nëpër** disa korridore dhe shkallë’ për të ruajtur kuptimin. Përkthim ndryshe mund të ishte nëse do të përdorej shprehja ‘që na çonte nëpër disa ...’ me qëllim që të ruhet kuptimi i fjalisë.

Ndryshim i pjesëve të ligjëratës është vërejtur edhe në fjalinë (209) ‘**Just then the colonel saw me** and, **overcome** by fury, he closed the door and started the machine./**Kur koloneli më pa, u tërbua** nga zemërimi, e mbylli derën dhe e ndezi makinën.’ ku mbiemri ‘**overcome**²³⁹’ është përkthyer në folje ‘u tërbua’. Këtu nuk duhet të krijohet ideja se ‘**overcome**’ është folje, sepse ajo kuptohet nga fjalia dhe e ka kuptimin ‘**i marrë/tërhequr** nga zemërimi’ ose ngjashëm. Në fakt, në gjuhën angleze ka raste kur një fjalë me formë të njëjtë mund të jetë emër dhe folje (p.sh.: *bank* – *bankë/breg*; *left-e* *majtë/iku*) ose emër dhe mbiemër (p.sh.: *firm* – *firmë/i fortë*; *round* – *rundë/rrethor*). Ndryshimi i mbiemrit me folje krijon strukturë të ndryshme të fjalisë, gjegjësisht krijon sifjali ‘**Kur koloneli më pa, u tërbua nga zemërimi, ...**’. Ndryshimi i mbiemrit ‘*fast*’ me emrin me parafjalë ‘*me shpejtësi*’ është vënë re në fjalinë (225), ku kemi edhe ndryshim të strukturës për shkak të këtij ndryshimi dhe për shkak të shtimit të foljes ‘*ecte*’ në gjuhën shqipe. Ky ndryshim ka rezultuar edhe me mospërputhjen e strukturës së fjalisë, pra në njërën gjuhë kemi sintagmë parafjalore ‘*with large boxes*’, ndërsa në tjetrën sifjalinë ‘*që kishin kuti të mëdha*’.

Ajo çfarë është përmendur më së shumti në kreun III është lëvizja e lirë e gjymtyrëve në gjuhën shqipe. Qëndrimi i njëjtë vërtetohet pas analizës së tekstit, gjegjësisht duke marrë si shembull fjalinë (17) ‘*A young man opened the door./Derën e hapi një djalë i ri.*’. Pra, përderisa në gjuhën angleze ruhet rendi i drejtë kryefjalë – kallëzues – kundrinor, në gjuhën shqipe kemi kundrinor – kallëzues – kryefjalë. Përkundër ndryshimit të vendeve, funksionet sintaksore janë të njëjta. Kjo lëvizje e gjymtyrëve në gjuhën shqipe është e mundur për shkak të rasave dhe rendit të lirë. Shembuj të tillë ka edhe në fjali të tjera, si edhe fjalia (21). Fjali tjetër ku kemi ndryshim minimal të strukturës është fjalia (151) ‘*Ryder called the police and Horner was arrested, although he resisted and **insisted** he was innocent./Rajderi thirri policinë dhe Hornerin e arrestuan, edhe pse kishte rezistuar **duke thënë** se ishte i pafajshëm.*’. Ky ndryshim nuk ka rezultuar me ndërrim të funksioneve sintaksore. Por në fjalinë tjetër (152) kemi lëvizje brenda

²³⁹ Fjala ‘*overcome*’ që në gjuhën angleze normalisht është folje, por në formën e njëjtë mund të funksionojë edhe si mbiemër sipas fjalorit ‘*Merriam Webster*’ dhe në këtë fjali është mbiemër dhe jo folje.

sifjalisë dhe me këtë kemi lëvizje të sintagmave (sintagma emërore e sifjalisë ka lëvizur nga pozita fillestare në gjuhën angleze në pozitë fundore në gjuhën shqipe). Rast i ngjashëm si ky i fundit është edhe fjalia (164) ku kemi rend të ndryshuar, por pa ndryshim të funksioneve sintaksore.

Në disa raste fjalitë përveç kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit kanë pasur edhe rrethanorë. Rrethanori, siç është përmendur në kreun III, është gjymtyra e cila më së shumti lëviz në fjali. Dhe ky pohim nuk përbën përjashtim as këtu. Fjali të tilla janë fjalia (12) '*Of course, he **also** has his defects: **he** loves photography and spends hours in the basement developing photos./Sigurisht, dhe ai kishte të metat e tij: i pëlqen shumë fotografia dhe kalon orë të tëra në bodrum duke zhvilluar foto.*' si dhe fjalitë (20, 21, 27 dhe disa të tjera deri në fjalinë 226). Përparësia e rrethanorit është se normalisht nuk imponon ndryshim të vendit të gjymtyrëve të tjera, pra kryefjalës, kallëzuesit apo kundrinorit. Gjatë analizës së fjalive në gjuhën angleze mund të ketë situata shumë të rralla ku kryefjala mund të shprehet me ndajfolje, prandaj edhe duhet të analizohet mirë nëse në ndonjë rast ndajfolja në gjuhën angleze luan rolin e kryefjalës ose normalisht të rrethanorit. Në fjalinë (137) '*The man left the hat and the goose **in his escape**./Burri kishte lënë **pas** kapelën dhe patën.*' zëvendësimi i rrethanorit '*in his escape*' me '*pas*' në gjuhën shqipe e bën fjalinë të mos ketë kuptim të njëjtë, përkundër asaj që është fjali e saktë në aspektin gramatikor dhe semantik. Nuk mundet që rrethanori '*in his escape*' të jetë i barasvlershëm me '*pas*'. Si zakonisht, rrethanori ndodhet në pozita të ndryshme dhe nuk gjendet në fund në të dy rastet. Fjali tjetër që lidhet me rrethanorin është fjalia (140) '*We can **only** get clues from his hat./Mund të nxjerrim të dhëna nga kapelja e tij.*' ku nuk është përkthyer rrethanori '*only*' në gjuhën shqipe. Mungesa e një fjale ndikon drejtpërdrejt në rendin e gjymtyrëve kur i kemi parasysh tipat e fjalive në gjuhën angleze. Përkthimi ndonjëherë ka bërë që rrethanori, përveç ndryshimit të vendit, të shndërrohet në gjymtyrë kryesore. Kuptohet, ky ndryshim është bërë si pasojë e përkthimit, e jo se diçka e tillë është e mundur në këtë fjali specifike (148). Me shndërrimin e rrethanorit në gjuhën angleze ('*in the newspapers*') në kryefjalë në gjuhën shqipe ('*gazetat*'), është e qartë se është prekur i gjithë rendi i fjalisë dhe nuk mund të flitet për fjali me strukturë të njëjtë, por për një fjali me kuptim të përafërt. Lëvizja e ndajfoljes, e rrethanorit, është vënë re në fjalinë (226). Duke u bazuar edhe nga shembujt në kreun III, edhe këtu mund të vërejmë se ndajfolja në gjuhën shqipe mund të lëvizë më lirë sesa në gjuhën angleze. Ndajfolja '*probably*' e ka shumë më të vështirë ose të pamundur të lëvizë aq

lirë në fjali në gjuhën angleze sesa ndajfolja *'me siguri'* në gjuhën shqipe. Ndajfoljet në gjuhën angleze lëvizin në fjali sipas disa rregullave të caktuara. Madje, për ndajfolje të caktuara si *'yet, however, so far,'* etj. ekzistojnë rregulla të caktuara gramatikore dhe ato nuk mund të lëvizin lirshëm në fjali.

Një rast me interes në këtë vepër është fjalia (139) *'And this man didn't place an advertisement?/Po ky burri nuk ka vënë asnjë shpallje?'*. Kjo fjali është analizuar për dy arsye. E para, se në gjuhën angleze *'an'* është nyje, ndërsa në gjuhën shqipe është përkthyer *'asnjë'*, pra, përemër i pacaktuar. Arsyeja e dytë lidhet drejtpërdrejt me të parën, pra, foljen mohore. Përderisa në gjuhën shqipe mund të kemi mohim të dyfishtë, një gjë e tillë nuk është e mundur në gjuhën angleze. Prandaj edhe kemi ndryshim të nyjës nga *'an'* në gjuhën angleze në përemër të pacaktuar *'asnjë'* në gjuhën shqipe. Pra, fjalia *'... didn't place an advertisement.'* nuk mund të jetë *'...didn't place no advertisement.'*. Si përkthim më i mirë do të ishte nëse në gjuhën shqipe thuhej *'...nuk ka vënë shpallje'* dhe me këtë ruhet si struktura ashtu edhe kuptimi i fjalisë.

Fjalia e përkthyer (171) *'The man looked out of frightened eyes./Burri e pa me sy të frikësuar.'* na bën të mendojmë se fjalia në gjuhën angleze ka kundrinor të drejtë, por nuk është ashtu. Po të analizojmë fjalinë *'The man looked out of frightened eyes.'*, ne e kuptojmë se në gjuhën angleze nuk ka kundrinor të drejtë, por kundrinor të zhdrejtë me parafjalë për shkak se kemi edhe lokucion foljor. Në gjuhën shqipe fjalia e përkthyer na lë përshtypje tjetër: *'Burri e pa me sy të frikësuar.'*. Këtu parashtrihet dilema se kë ka parë me sy të frikësuar burri. Fjalia e përkthyer shihet qartë se nuk ka kuptim të njëjtë.

Mospërputhje e vetës së kryefjalës për shkak të përkthimit është vërejtur në fjalinë (172), pra *'You didn't mind accusing Horner'* – veta e dytë dhe *'Nuk i erdhi keq ta akuzojë Hornerin'* – veta e tretë. Ndryshimi i vetës ndikon drejtpërdrejt në kuptimin e fjalisë, madje për më tepër, nuk dihet se kujt nuk i erdhi keq, atij apo asaj. Në gjuhën shqipe ka dy mjete që shënojnë vetë dhe këtu ndryshon veta e kundrinorit dhe veta e kryefjalës. Prandaj, gjatë përkthimit duhet të ruhen vetat ngaqë ndikojnë drejtpërdrejt në kuptim dhe një përkthim më i mirë mund të ishte *'Ty nuk do të pengonte të akuzohej Horneri'*. Fjali tjetër ku kemi mospërputhje të vetës është fjalia (185) ku në gjuhën angleze kemi vetën e dytë *'You could see ...'*, ndërsa në gjuhën shqipe vetën e parë *'Mund ta shihja'* e cila kuptohet nga folja.

Përdorimi i diatezës pësore është vërtetuar në kreun III se ndikon në ndryshimin e rendit të gjymtyrëve dhe ndryshimin e funksioneve sintaksore, por jo edhe të kuptimit. Fjalia (173) e

ilustron këtë: *You knew that plumber had been involved in something similar before and that he would be suspected immediately, so you broke the grate and asked Horner to fix it.*/ Ti e dije se hidrauliku ishte përfshirë në diçka të ngjashme më parë dhe se menjëherë **do të dyshonin** tek ai, prandaj e theve tubin dhe kërkove që Horneri ta ndreqte. Pra, në fjalinë në gjuhën angleze kemi diatezë pësore ‘*would be suspected*’, në gjuhën shqipe kemi diatezë veprorë ‘*do të dyshonin*’. Me këtë ndryshim kryefjala bëhet agjent, ndërsa kundrinori kryefjalë.

4.3. Analizë e fjalive me rendin kryefjalë – kallëzues – gjymtyrë tjetër e dytë (kallëzues emëror, kallëzuesor i kundrinorit, rrethanor)

Fjalitë nga (1) deri në fjalinë (226) nga Shtojca A, tabela nr. 1 përbëheshin nga kryefjala, kallëzuesi dhe së paku nga një kundrinor. Ndarja e fjalive në këtë kategori dhe me këtë rend ka qenë qëllimi kryesor i këtij disertacioni për të gjetur ngjashmëritë dhe dallimet në strukturën e fjalisë dhe rendin e gjymtyrëve. Më poshtë, duke iu referuar tabelës nr. 2 në Shtojcën A janë analizuar fjalitë nga vepra ‘*Aventurat e Sherlock Holmsit*’, por me rend kryefjalë – kallëzues dhe gjymtyrë tjetër e dytë (kallëzues emëror, kallëzuesor i kundrinorit ose rrethanor). Ndarja e këtyre gjymtyrëve të dyta është bërë për të parë nëse në përkthim ka pasur vetëm ndryshim të rendit të tyre, apo nëse përkthimi ka ndikuar edhe në ndryshimin e funksioneve sintaksore, duke fituar ndoshta një gjymtyrë tjetër, të themi kundrinor. Në tabelën nr. 2 nga numri i përgjithshëm i 191 fjalive, 72 fjali kanë strukturë të njëjtë si në gjuhën angleze edhe në shqipe dhe 119 fjali kanë strukturë të ndryshme.

**STRUKTURË/REND I NJËJTË OSE I NDRYSHËM
NË FJALITË ME KRYEFJALË - KALLËZUES -
GJYMTYRË TJETËR E DYTË**




Figura 4. Struktura/rendi në fjalitë me kryefjalë – kallëzues – gjymtyrë tjetër e dytë
(kallëzues emëror, kallëzuesor i kundrinorit, rrethanor)

Në tekst janë vërejtur disa fjali të cilat kanë pasur strukturë krejtësisht të njëjtë në të dyja gjuhët, si p.sh. fjalia (2) *‘One of them happened last year./Një prej tyre ndodhi vitin e kaluar.’*. Por, rastet e tilla kanë qenë më të pakta sesa fjalitë të cilat kanë pasur ndryshime të caktuara strukturore, apo ndryshim rrënjësor të strukturës dhe rendit të gjymtyrëve. Si dallim i parë që është vërejtur, është mungesa e kryefjalës. Mungesa e saj kryesisht nuk ka ndikuar në rendin e gjymtyrëve të tjera. Prandaj, fjalitë ku rendi është ruajtur, pavarësisht mungesës së kryefjalës, i konsiderojmë si fjali të cilat kanë rend të njëjtë të gjymtyrëve, sepse realisht pjesa nga kallëzuesi e më tutje mbetet e njëjtë. Fjalitë të cilat kanë ndryshime të strukturës ose të rendit, konsiderohen si fjali me strukturë jo të njëjtë.

Kryefjala, e cila nuk është shprehur në gjuhën shqipe, kryesisht ka qenë e shprehur me përemra vetorë ose është kuptuar nga veta e foljes. Në gjuhën angleze, duke iu referuar rregullave gramatikore, fjalia duhet patjetër të ketë kryefjalë. Ka pasur raste me kryefjalë të zbrazët që është shprehur me përmrin *‘it’* ose *‘there’*, e që në gjuhën shqipe fjalia përkatëse e përkthyer detyrimisht fillon me folje.



Figura 5. Fjali ku mungon kryefjala.

Fjalitë ku kryefjala mungon ose kuptohet nga veta e foljes dhe fjalia përmban një gjymtyrë tjetër përveç kryefjalës si kallëzues, kallëzues emëror, kallëzuesor të kundrinorit ose kundrinor janë: fjalia 1 (*‘When I go **over my notes** for Sherlock Holmes’ investigations between 1882 and 1890, I see so many strange and interesting cases that it becomes difficult to choose one to write down./Kur rilexoj shënimet e mia për hetimet e Sherlock Holmsit ndërmjet viteve 1882 dhe 1890, shoh shumë raste interesante dhe të çuditshme, saqë është e vështirë të zgjedh ndonjërin për ta shkruar.’*), 3, 6, 7 dhe shumë fjali të tjera deri në fjalinë 190 të cilat janë dhënë në tabelën 2 në Shtojcën A. Në total në tabelën nr. 2 janë analizuar 191 fjali, dhe prej tyre në 106 fjali kryefjala ka qenë e pranishme apo e shprehur në të dyja gjuhët, ndërsa në 85 fjali kryefjala ka munguar dhe fjalia ka filluar drejtpërdrejt me kallëzues, pasi kryefjala është kuptuar nga veta e foljes.

Numri i madh i fjalive ku ka munguar kryefjala, si në tabelën nr. 1 ashtu edhe në tabelën nr. 2, por që normalisht është e kuptuar nga veta e foljes ndodh për shkak se në gjuhën angleze kryefjala është e domosdoshme, por në gjuhën shqipe, edhe sikur të mungojë, ajo nënkuptohet. Vetë zgjedhimi i foljeve e pasqyron një gjë të tillë dhe përdorimi i shpeshtë i kryefjalës, zakonisht të shprehur me përemra vetorë, do ta bënte tekstin monoton, duke pasur përsëritje të vazhdueshme të përemrave vetorë.

Gjatë analizës së tekstit është vërejtur se përkundër ndryshimit të foljes (nga pohore në mohore), rendi i gjymtyrëve mund të mbetet i njëjtë. Shembulli i tillë është fjalia (95) ‘*It was McCarthy and he remembered my face./Ishte Mekarthi dhe ai nuk e harroi fytyrën time.*’, Ndryshimi i foljes nga pohore në mohore, ose anasjelltas, normalisht nuk prek funksionet sintaksore të fjalëve që gjenden pas foljes. Në rast se përdoret tip tjetër foljesh, të themi këpujore, atëherë është e pritshme që të kemi funksione tjera sintaksore.

Një ndryshim tjetër strukturor, por jo i rendit të gjymtyrëve, është vërejtur me përdorimin e rasës gjinore në fjalinë (150) ‘*We went to Sherlock Holmes’ house./Shkuam në shtëpinë e Sherlok Holmsit.*’. Edhe pse fjalët janë në pozicione të ndryshme brenda një sintagme, funksioni sintaksor i tyre nuk ndryshon për shkak se ato konsiderohen si një tërësi e plotë dhe jo e ndarë, pra sintagmë e cila merr funksion sintaksor si e plotë dhe jo si e ndarë, duke u mbështetur në kokën e saj.

Dallimi i parë për sa i përket funksioneve sintaksore të gjymtyrëve paraqitet që në fjalinë (1) ‘*When I go over my notes for Sherlock Holmes’ investigations between 1882 and 1890, I see so many strange and interesting cases that it becomes difficult to choose one to write down./Kur rilexoj shënimet e mia për hetimet e Sherlock Holmsit ndërmjet viteve 1882 dhe 1890, shoh shumë raste interesante dhe të çuditshme, saqë është e vështirë të zgjedh ndonjërin për ta shkruar.*’. Në këtë fjali kemi dy tipa të ndryshëm foljesh, lokucion foljor/idiomë në gjuhën angleze ‘*go over*’ dhe folje të plotë në gjuhën shqipe ‘*rilexoj*’. Dallim tjetër në strukturën e së njëjtës fjali por pa ndryshim të rendit është përkthimi i foljes ‘*becomes*’ nga gjuha angleze në ‘*është*’ në gjuhën shqipe. Meqenëse të dyja foljet janë folje këpujore, kjo nuk ndikon në ndryshimin e strukturës, gjegjësisht rendit të gjymtyrëve. Por në fjalinë (7) ‘*And so it was until this morning, when I saw the office was closed and a sign saying: “The Red-Headed League has been dissolved.”/Dhe kështu vazhdoi deri këtë mëngjes, kur pashë që zyra ishte mbyllur dhe kishte një shenjë që thoshte “Lidhja e Flokëkuqëve është shuar”.*’ kemi një ndryshim strukturor ku kemi ndryshim të gjymtyrëve.

Përdorimi i trajtës së shkurtër ‘*e*’ në një fjali normalisht na bën të mendojmë se në gjuhën angleze ka kundrinor, por, nëse e analizojmë fjalinë (7) në tabelën 3 ‘*Now the barmaid has found out./Tani kamerierja e ka zbuluar..*’ e kemi të qartë se këtu nuk ka kundrinor. Në anën tjetër, fjalia (37) ‘*The lantern light flashed on a revolver, but Holmes’ whip caught the young man’s hand and the weapon fell./Drita e fenerit ra mbi një pistoletë, mirëpo kamzhiku i Holmsit u*

mbështoll rreth dorës së djalit dhe arma i ra nga dora.’ në vete përmban dy gjymtyrë të ndryshme për të njëjtat fjalë: kundrinor në gjuhën angleze ‘*the young man’s hand*’ dhe rrethanor në gjuhën shqipe ‘*rreth dorës së djalit*’. Arsye për këtë ndryshim është përdorimi i foljeve të ndryshme, gjegjësisht ndryshimi i foljes nga ‘*caught/kapi*’ në ‘*u mbështoll*’ dhe kjo ka ndikuar në ndryshimin e funksioneve të gjymtyrëve. Edhe në fjalinë (46) ‘*Both were widowers and **were retired**./Që të dy ishin vejanë dhe **kishin dalë në pension**.*’ është vërejtur ndryshim i funksioneve sintaksore ku në ‘... *were retired*’ kemi kallëzues emëror, ndërsa në shqip ‘... *kishin dalë në pension*.’ kemi shprehje foljore. Në fjalinë (66) ‘*The odd thing was the mention of the rat, as nobody is **delirious** after a hit./Gjëja e çuditshme ishte përmendja e miut, pasi askush nuk bie **në delir** pas goditjes.*’ për shkak të ndryshimit të foljes pas përkthimit të bërë fitohen dy gjymtyrë të ndryshme, ku ‘*delirious*’ është kallëzues emëror, ndërsa ‘*në delir*’ rrethanor. Po të përdorej folja e njëjtë, por edhe të gjendej një mbiemër me kuptimin e fjalës ‘*delirious*’, atëherë do të mund të kishim strukturë të njëjtë. Mungesa e mbiemrit të përshtatshëm për fjalën ‘*delirious*’ ka detyruar ndryshimin e foljes dhe ndryshimin e llojit të gjymtyrës. Fjali tjetër ku kemi ndryshim të foljes është fjalia (75) ‘*Let’s see, here **are** three different trails made by the same feet, which are young McCarthy’s: twice walking and once running, because you can hardly see the heel./Pa të shohim, këtu **kemi** tre lloje gjurmësh të ndryshme nga të njëjtat këmbë, që janë të Mekarthit të ri: dy herë ecën dhe një herë vrapon, pasi mezi ia dallon thembrën.*’. Ky dallim, pikë së pari, vjen për shkak të ndryshimit të foljes gjatë përkthimit. Folja ‘*are*’ është folje këpujore, ndërsa folja ‘*kemi*’ jo. Përveç ndryshimit të foljes, këtu kemi mospërputhje të vetës, për shkak se në gjuhën angleze përdoret kryefjalë e zbrazët, ndërsa në gjuhën shqipe nga folja kuptohet veta e kryefjalës. Shembull tjetër si fjalia (75) është edhe fjalia (93) ku ndryshimi i foljes ndikon në funksionin sintaksor të gjymtyrës pas foljes, prej ku ‘*I wasn’t **lucky** at all*’ ka rend kryefjalë – kallëzues – kallëzues emëror, ndërsa ‘*nuk pata fare **fat***’ ka rend kallëzues – kundrinor. Ndajfolja në të dy rastet ndodhet në pozicione të ndryshme, por ajo nuk përbën arsye për ndryshimin e funksioneve sintaksore. Si përkthim më i mirë do të ishte nëse do të përdorej shprehja ‘*nuk isha me fat*’ dhe do të kishte një formë fjalie që i ngjan rendit normal të gjuhës shqipe. Njëjtë, edhe në fjalinë (181) përsëritet rast i tillë ku folja e ndryshme merr gjymtyrë të ndryshme, gjegjësisht folja këpujore ka marrë kallëzues emëror ‘*there aren’t **any villages***’ dhe folja ‘*kam*’ ka marrë kundrinor ‘*ku nuk ka **fshatra***’.

Tjetër rast ku kemi dallim në gjymtyrë është fjalia (83) ‘*He’s tall, left-handed, **has a slight limp in his right leg**, smokes cigars, and uses a cigar holder.*./Ai është i gjatë, majtak, **çalon pak në këmbën e djathtë**, pi cigare dhe përdor pipë për cigaren.’ ku ‘*has a slight limp*’ është përkthyer ‘*çalon pak*’ dhe me këtë kemi ndryshim të funksioneve sintaksore të gjymtyrëve, gjegjësisht kallëzues-kundrinor në gjuhën angleze dhe kallëzues-rrethanor në gjuhën shqipe. Ky dallim strukturor vjen për shkak të përdorimit të foljes ‘*çalon*’ në vend të foljes ‘*has*’ që në shqip është ‘*ka*’. Në fjalinë (156) ‘*He picked me up at the station and I got **into a horse-drawn carriage**.*./Ai më priti në stacion dhe u nisa **me karrocën me kuaj**.’ na paraqiten sërish dy gjymtyrë të ndryshme, gjegjësisht rrethanor në gjuhën angleze ‘*into a horse-drawn carriage*’ dhe kundrinor i zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe ‘*me karrocën me kuaj*’. Ky dallim vjen si pasojë e shprehjes foljore në gjuhën angleze ‘*got into*’ e cila kërkon rrethanor, ndërsa folja ‘*nisa*’ mund të shoqërohet me rrethanor ose me kundrinor. Si përkthim më i përshtatshëm do të ishte ‘*Ai më mori nga stacioni dhe u futa në karrocën e tij me kuaj*.’ Me këtë përkthim do të ruhej si struktura, ashtu edhe kuptimi.

Në tekstin e analizuar ka pasur raste me ndryshime brenda elementeve të sintagmës. Shembull i tillë është fjalia (4) ‘*The only requirement was to have **this hair colour**.*./E vetmja kërkesë ishte që të kishte **flokë në atë ngjyrë**.’ ku përkthimi ka rezultuar me një ndryshim të vogël brenda strukturës së sintagmës, por që nuk ka pasur ndikim në ndryshimin e tipit të sintagmës apo funksionit sintaksor. Bëhet fjalë për ‘*this hair colour*’ dhe ‘*flokë në atë ngjyrë*’ ku të dy kokat janë emra, por te njëra ‘*colour*’ dhe te tjetra ‘*flokë*’. Përkthimi më i përshtatshëm do të ishte ‘*këtë ngjyrë flokësh*’ dhe kështu do të ruhej në tërësi struktura e sintagmës emërore dhe do të kishim koka të njëjta të sintagmës. Edhe në fjalinë (6) ka një ndryshim të vendit të fjalëve brenda sintagmës emërore ‘*many redhead candidates*’ dhe ‘*shumë flokëkuqë kandidatë*’. Në këto dy sintagma emërore mund të shihet se si në rastin e mëparshëm, kokat janë të ndryshme, pra ‘*candidates*’ dhe ‘*flokëkuqë*’. Me këtë kuptohet se përkthimi është i gabuar dhe përkthim më i mirë do të ishte ‘*shumë kandidatë flokëkuqë*’ dhe kështu do të ruhej struktura dhe kuptimi, që janë prekur si pasojë e përkthimit. Në anën tjetër, sintagma emërore me të cilën shprehet kryefjala në fjalinë (22) ‘*The game will be more exciting, seeing as you’re betting 30,000 pounds.*./ Kjo lojë do të jetë më interesante, duke pasur parasysh se ti po vë bast 30,000 paundë.’ nuk është me strukturë të njëjtë për shkak se në gjuhën shqipe është shtuar përcaktori ‘*kjo*’, ndërsa në gjuhën angleze nuk kemi përcaktorin ‘*this*’, por kemi një shqese ‘*the*’ e që në shqip

do të duhej të ishte ‘loja’ e jo ‘kjo lojë’. Ky ndryshim ndikon në kuptimin e kryefjalës, sepse bën shtimin e panevojshëm të përcaktorit të kryefjala në gjuhën shqipe. Në fjalinë (35) ‘*When he was out, he helped pull his colleague, a short redhead, up./Pasi u ngjit, ai ndihmoi të ngrihej edhe kolegun e tij, një burrë të shkurtër me flokë të kuqe*’ kemi sintagmë emërore ‘short redhead’ në gjuhën angleze dhe ‘burrë të shkurtër me flokë të kuqe’ në gjuhën shqipe. Këtu struktura e sintagmës është e ndryshme, pra koka të ndryshme, por që mbeten sintagma emërore të dyja e që nuk ndikojnë në funksionet sintaksore dhe si rezultat drejtpërdrejt në kuptim. Ngjashëm, edhe në fjalinë (50) është vërejtur ndryshim në strukturën e sintagmës emërore, ku në gjuhën angleze është ‘the young man’ ndërsa në gjuhën shqipe është përdorur mbiemri i emërzuar ‘të riun’. Sidoqoftë, ky ndryshim nuk ndikon në gjymtyrën me të cilën lidhet folja, pra kallëzuesin emëror dhe nuk ndryshon kuptimin. Por ndryshe nga fjalia (50) është fjalia (101) ‘*And Turner died shortly afterwards, so the two young people could live happily together, without knowing about the dark pasts of their fathers./Tërneri vdiq pak më vonë, ndaj dy të rinjtë patën mundësinë të jetojnë të lumtur bashkë, pa mësuar për të kaluarat e errëta të baballarëve të tyre.*’ ku sintagma emërore në gjuhën angleze ka kokë një emër ‘the two young people’, ndërsa ajo në gjuhën shqipe një mbiemër të emërzuar ‘dy të rinjtë’ dhe strukturë të ndryshme për shkak të përdorimit të një foljeje tjetër e cila merr gjymtyrë të ndryshme. Përderisa në gjuhën angleze folja lidhet me rrethanorin ‘happily’, në gjuhën shqipe folja lidhet me kundrinorin ‘mundësinë’. Fjali tjetër ku struktura është ndjeshëm e ndryshuar brenda sintagmës është fjalia (78). Këtu përveç mungesës së kryefjalës ndryshon edhe lloji i sintagmës, pra sintagmë emërore në gjuhën angleze ‘a square tipped toe’ dhe sintagmë parafjalore në gjuhën shqipe ‘nga maja në formë katrore’. Në fjalinë (98) ‘*I had already hidden in the forest, but I returned for my dropped cape./Isha fshehur në pyll, por u ktheva të marr pelerinën që më kishte rënë.*’ kemi sintagma të ndryshme për shkak të përkthimit të bërë dhe sintagma parafjalore në gjuhën angleze ‘for my dropped cape’ është dhënë me sintagmën emërore ‘pelerinën’ të shoqëruar nga sifjalia ‘që më kishte rënë’. Shembull tjetër ku kryefjala përbëhet nga sintagma emërore është fjalia (91). Dallimi i vetëm në këtë fjalë është se sintagma në gjuhën angleze ka emër brenda vetes ‘the young man’, ndërsa në gjuhën shqipe ka mbiemër të emërzuar ‘i riu’. Gjithsesi, ky ndryshim brenda sintagmës nuk ka ndikuar në pjesën tjetër të fjalisë, apo të rendit të gjymtyrëve. Rast tjetër ku kryefjala nuk shprehet me emër në të dy gjuhët është fjalia (117) ‘*It was bred in London./Pata është rritur në Londër.*’. Në gjuhën angleze kryefjala shprehet me përemrin ‘it’ që

është përemër vetor i cili përdoret për kafshë apo insekte, kurse në gjuhën shqipe është përdorur emri ‘*pata*’. Ky ndryshim i kryefjalës është bërë si pasojë e përkthimit dhe përshtatjes së tekstit. Fjala, si në shumë raste të tjera, mund të fillonte drejtpërdrejt me kallëzuesin dhe në këtë mënyrë nuk do të kishte pasur nevojë që të shtohet emër. Në gjuhën shqipe përemrat vetorë ‘*ai*’ dhe ‘*ajo*’ realisht nuk pëlqehet të përdoren për kafshë, zogj ose insekte, meqë në shumë raste nuk mund të dallojmë gjininë dhe mënyra më e pranuar për fjali të tilla është që të bjerë kryefjala dhe fjalia të fillojë me folje si ‘*ka*’, ‘*është*’, ‘*ishte*’ etj.




Figura 6. Pozita e kryefjalës dhe kallëzuesit në fjali me rend kryefjalë – kallëzues – kallëzues emëror/kallëzuesor i kundrinorit/rrethanor.

Ndryshimi i vendit të kryefjalës dhe kallëzuesit ishte rast i vërejtur herë pas here edhe në tabelën nr. 1. Edhe këtu ka pasur disa raste ku kryefjala nga pozicioni në fillim të fjalisë ose para kallëzuesit në gjuhën angleze, është gjetur pas kallëzuesit në gjuhën shqipe. Rast të tillë kemi në fjalinë (15) ‘“*Third right, then fourth left,*” **he** answered without hesitation./“*Kthesa e tretë djathtas dhe pastaj e katërta majtas*” u përgjigj **ai** pa ngurrim.’ ku ky ndryshim është bërë për shkak se në gjuhën shqipe ligjërata e drejtë jepet në këtë formë dhe është strukturë normale, ndryshe nga gjuha angleze ku kryefjala duhet të jetë para. Raste të tjera të ngjashme me rend të anasjelltë paraqiten në fjalinë (24) ‘“*He’s a murderer, a thief, a fraudster and forger,*” **the**

policeman said./'*Është një vrrarës, hajdut, mashtrues dhe falsifikator*' **tha polici.**' dhe fjalitë (34, 38 dhe disa të tjera deri në fjalinë 161), pra 17 fjali nga totali prej 191 fjalish.

Një rast unik i cili është vënë re gjatë analizës së tekstit është ndryshimi i pozitës së kryefjalës në gjuhën angleze, gjë që paraqet një rast më të rrallë. Më saktë, kryefjala qëndron pas kallëzuesit në fjalinë (103) '*On a chair were a worn out black hat and some forceps./Mbi një karrige ishte një kapele e zezë e vjetëruar dhe disa pinca.*'. Në fakt, rendi është ruajtur në të dy fjalitë, por kjo fjali është përjashtim nga rregulla se në gjuhën angleze kryefjala qëndron në fillim të fjalisë, gjegjësisht para foljes. Në gjuhën angleze ekzistojnë raste kur kryefjala shprehet me një ndajfolje, por në këtë rast kemi sintagmë parafjalore dhe ajo nuk mund të konsiderohet kryefjalë, por thjeshtë rrethanor. Përveç këtij ndryshimi, ndryshimi i dytë është se nuk kemi përputhje të numrit të foljes. Edhe këtu mund të shihet ndikimi i kryefjalës mbi foljen, pavarësisht pse ka lëvizur në fund. Kryefjala e shprehur me sintagmë bashkërenditëse kërkon folje në numrin shumës, ndërsa në gjuhën shqipe folja mund të dalë në njëjës ose në shumës kur kryefjalët homogjene ndodhen pas saj, sepse, nëse kryefjala do të ishte në fillim të fjalisë, atëherë situata do të ishte ndryshe dhe folja do të duhej patjetër të ishte në shumës, ashtu si në gjuhën angleze, sepse nuk do kishte përshtatje të numrit të kryefjalës dhe kallëzuesit.

Një fjali tjetër ku kemi ndryshim strukturor është fjalia (127). Në fjalinë '*The game's over, Ryder*' dhe '*Loja mbaroi, Rajder.*' nuk kemi strukturë të njëjtë për shkak se në gjuhën angleze kemi rend kryefjalë - kallëzues - kallëzues emëror, nëse analizohet vetëm aspekti sintaksor, duke mos e marrë parasysh aspektin semantik, ndërsa në gjuhën shqipe kemi kryefjalë - kallëzues. Nëse do të përkthehej fjalë pas fjale, fjalia do të ishte '*Loja është e përfunduar.*', por kjo fjali nuk është tipike dhe nuk tingëllon mirë në gjuhën shqipe, si dhe '*e përfunduar*' mund të ketë konotacion tjetër negativ. Rast të ngjashëm me kallëzues të përbërë foljor kemi edhe në fjalinë (129) '*The man fell to the floor and begged./Burri ra në dysheme duke u lutur.*'. Por në këtë fjali kemi ndryshim strukturor sepse kallëzuesi i përbërë foljor nuk përkthehet si i tillë, por ndahet duke krijuar një strukturë tjetër që nuk është e njëjtë me atë në gjuhën angleze.




Figura 7. Pozita e rrethanorit në fjali me rend kryefjalë – kallëzues – kallëzues emëror/kallëzuesor i kundrinorit/rrethanor.

Ndryshimi i rendit të gjymtyrëve kryesisht i referohet më së shumti lëvizjes së rrethanorit brenda fjalisë. Rast tipik i tillë është fjalia (17) ‘*Let’s go **now** to hear a music concert./Tani të shkojmë të dëgjojmë ndonjë koncert.*’, por që në pjesën më të madhe të fjalive lëvizja e rrethanorit nuk ndikon në lëvizjen e gjymtyrëve të tjera. Por në fjalinë (31) ‘*I kept my pistol **cocked** and Holmes turned off the lantern./Unë e mbajtja **gati** pistoletën time dhe Holmsi fiku fenerin.*’ kemi lëvizje të kallëzuesorit të kundrinorit ‘*cocked*’ dhe ‘*gati*’. Kjo lëvizje realisht ka qenë e panevojshme sepse, edhe po të ishte në vendin e njëjtë si në gjuhën angleze, fjalia sërish do të kishte kuptim të plotë. Sikur të thuash ‘*Unë e mbajta **gati** pistoletën time dhe ...*’ dhe ‘*Unë e mbajta pistoletën time **gati** dhe ...*’, është e njëjta gjë dhe nuk ndikon në strukturën semantike të fjalisë. Prandaj konsiderojmë se kjo lëvizje ka qenë e panevojshme. Ngjashëm, edhe në fjalitë (33, 43, 49, 130) rrethanori gjendet në pozita të ndryshme, por brenda këtyre fjalive ka ndryshime strukturore më të thella që janë sqaruar më poshtë. Shembuj të tjerë ku rrethanori është në pozita të ndryshme por që nuk ka ndikuar në rendin apo funksionet sintaksore të gjymtyrëve tjera, janë edhe fjalia (17) ‘*Let’s go **now** to hear a music concert./Tani të shkojmë të dëgjojmë ndonjë koncert.*’ dhe fjalitë (33, 43, 47 dhe disa të tjera deri në fjalinë 191). Megjithatë

rrethanori lëviz më lirshëm në fjali, analiza e fjalive nga anglishtja në shqipe tregon një përqindje jo dhe aq të madhe dhe ndoshta të pritur.



Figura 8. Lëvizja e kundrinorit në fjali me gjymtyrë tjetër të dytë.

Përveç rrethanorit, edhe kundrinori ka pasur raste që ka dalë në pozicione të ndryshme, si p.sh. në fjalinë (28) ‘“*Now we must turn the lantern off and wait **for them** in the dark,*” Holmes said./“Tani duhet të fikim fenerin dhe t’i presim në errësirë,” tha Holmsi.’ dhe fjalitë (36, 99, 110 dhe disa fjali deri në fjalinë 172). Në fjalinë (125) ‘*And it turned out to be **very special**, because it laid this brilliant blue egg./Doli se ishte **një patë shumë speciale**, sepse na bëri një vezë blu të shndritshme.*’ struktura është pakëz më e komplikuar, për shkak se në gjuhën angleze ‘it’ është kryefjalë, ndërsa në gjuhën shqipe ‘it’ është zëvendësuar me emrin ‘*një patë*’, por që ka funksion tjetër – kallëzues emëror. Ndryshimi i rendit të gjymtyrëve këtu ka bërë që të ndryshojë edhe funksioni sintaksor. Ky ndryshim vjen për shkak se përkthyesi ka bërë parafrazim për të ruajtur kuptimin, por një gjë e tillë ka qenë e panevojshme për shkak se kuptohet nga konteksti i fjalisë. Përderisa këtu jemi shkurtimisht te kundrinori, duhet përmendur edhe fjalia (171) ‘*I perched on the windowsill while she pleaded **with the ruffian** to let me go./Unë u përkula mbi parvazin e dritares, ndërkohë që ajo e luste **rrugaçin** të më linte të largohesha.*’ ku në gjuhën angleze kemi kundrinor me parafjalë ‘*with the ruffian*’, ndërsa në gjuhën shqipe pa parafjalë ‘*rrugaçin*’. Këtu ndikim ka folja pasi që në gjuhën angleze folja ‘*plead*’ shoqërohet nga parafjala

‘with’ dhe automatikisht merr kundrinor me parafjalë. Në fjalinë e fundit (191) ‘Now you will see, Mr. Know it All./Tani shihni **këtu**, z. Di-Gjithçka.’ në gjuhën angleze ka vetëm një rrethanor ‘now’, ndërsa në gjuhën shqipe dy rrethanorë: ‘tani’ dhe ‘këtu’. Shtimi i rrethanorit të dytë është bërë pa arsye dhe ky shtim ndikon në strukturën e fjalisë, duke pasur numër jo të njëjtë rrethanorësh në fjali. Më mirë do të ishte sikur fjalia të ishte ‘Tani do të shihni...’ dhe kështu do të ruhej struktura e njëjtë në të dy gjuhët.

Në fjalinë (82) ‘**The grass was growing underneath**, so it had only been there for a few days./**Poshtë po rritej bari**, pra ka qenë aty vetëm për pak ditë.’ në gjuhën shqipe përveç lëvizjes së rrethanorit kemi edhe lëvizje të kryefjalës: ‘The grass was growing underneath, ...’ dhe ‘Poshtë po rritej bari ...’. Me gjithë ndryshimin e vendit të gjymtyrëve kuptimi mbetet i njëjti. Sikur në gjuhën shqipe të kishim ‘Bari po rritej poshtë ...’ do të kishim rend të njëjtë si në gjuhën angleze dhe kuptimi do të ishte sërish i njëjtë. Pra, rendi ndryshon sepse kryefjala *bari* është remë e fjalisë e cila motivon më tej lidhjen logjike me sifjalinë tjetër dhe në këtë mënyrë ajo del pas kallëzuesit. Gjithashtu, ka pasur raste kur në fjalinë e përkthyer në gjuhën shqipe është shtuar rrethanori, duke mos ekzistuar në fjalinë në gjuhën angleze, si në fjalinë (119) ‘Are you convinced?/A u binde **tani**?’. Në anën tjetër, rrethanori është larguar nga fjalia e përkthyer (135) ‘I returned to my sister’s house and she told me there were two geese with the same fringe **on the tailfeather**, but that she had sold them all in Covent Garden./U ktheva në shtëpinë e motrës dhe ajo më tha se kishte dy pata me atë lloj shiriti, mirëpo ajo i kishte shitur të gjitha në Kovent Garden.’ dhe mungesa e tij nuk mund të shpjegohet ndryshe përveç se përkthyesi nuk ka mundur ta përshtatë rrethanorin në fjali ashtu siç duhet.

Lëvizja e sifjalive nuk është tipike gjatë përkthimit, por në fjalinë (5) ‘The League’s founder was a millionaire redhead who, **when he died**, wanted to share his money among men with this hair colour in return for a simple job./Themeluesi i Lidhjes ishte një flokëkuq milioner që donte t’i shpërndante paratë tek njerëzit me këtë ngjyrë flokësh **pasi të vdiste**, në këmbim të një vendi pune.’ ka ndodhur një lëvizje e tillë në gjuhën shqipe me qëllim që fjalia të ketë rend të drejtë. Lëvizja e kësaj sifjalie është e detyrueshme në këtë rast sepse është me marrëdhënie paskohësie dhe nëse do të ishte në vendin e njëjtë si në gjuhën angleze fjalia nuk do të tingëllonte mirë. Situatë e njëjtë është edhe në rast se *when he died* lëviz në fund si në fjalinë e përkthyer në gjuhën shqipe. Por edhe brenda sifjalive mund të ndodhë që të ketë ndryshim strukturor, si në fjalinë (27) ‘We’re in the basement of one of the main London banks, **whose director is Mr.**

Merryweather./Jemi në podrumin e një prej bankave kryesore të Londrës, që ka për drejtor z. Merriuedhër.’ ku nuk është përdorur folja e njëjtë (folja këpujore ‘*jam*’ në gjuhën angleze dhe ‘*kam*’ në gjuhën shqipe).

Në disa raste ka pasur fjali me kryefjalë të zbrazët në gjuhën angleze kur kryefjala është shprehur me ‘*there*’ ose ‘*it*’. Rast i tillë është fjalia (6) “*In the street mentioned in the advertisement **there** were many redheaded candidates for the post, but none with the deep red colour of my hair,*” said Wilson./ “Në rrugën e përmendur në shpallje **kishte** shumë flokëkuqë kandidatë për punën, por asnjëri nuk e kishte këtë ngjyrë të kuqe të thellë si unë” tha Uilsoni.’ ku ‘*there*’ është kryefjalë në gjuhën angleze, ndërsa në gjuhën shqipe fjalia fillon me kallëzuesin ‘*kishte*’. Rast tjetër me ‘*there*’ kemi në fjalinë (19) ‘*When I arrived that night at Baker Street **there were** two men with Holmes.*’/Atë natë, kur arrita në Rrugën Bejkër, **gjeta** Holmsin me dy burra.’, por këtu kemi ndryshim strukturor. Në këtë fjali nuk përputhet numri i foljes dhe rendi i gjymtyrëve, pra përbën një fjali me strukturë thellësisht të ndryshuar. Rast tjetër kemi fjalinë (65) ‘*That’s right./Ashtu është.*’ ku në gjuhën angleze kemi kryefjalë, ndërsa në gjuhën shqipe jo, për shkak se kryefjala në gjuhën angleze është kryefjalë e zbrazët e shprehur me ‘*that*’, ndërsa në shqipe fjalia fillon me ndajfoljen ‘*ashtu*’. Ngjashëm, edhe në fjalinë (68) kemi kryefjalë të zbrazët në gjuhën angleze ‘***There** are two key points.*’, ndërsa në gjuhën shqipe fjalia fillon me kallëzues ‘***Kemi** dy pika kryesore*’. Kjo fjali ndryshon edhe për nga kuptimi, sepse në gjuhën angleze ideja qëndron në atë se tregohet diçka në përgjithësi ‘*Ekzistojnë dy ...*’ ose ‘*Janë dy ...*’, ndërsa në gjuhën shqipe fjalia është e tillë sikur i drejtohet vetes, pra ‘*Ne kemi ...*’. Kjo fjali, me një fjalë, ndryshon atë se kujt i drejtohet. Në vend të kundrinorit ‘*dy pika*’ si përkthim më i përshtatshëm do të mund të ishte ‘*dy çështje*’. Them i kështu, sepse fjalia duhet fillimisht të analizohet edhe në aspektin semantik, ngaqë jo çdoherë duhet të shkohet me përkthim fjalë për fjalë. Përdorimi i kryefjalës së zbrazët në të shumtën e rasteve nuk ndikon në ndryshimin e kuptimit apo numrit të foljes në gjuhën shqipe. Rast të tillë kemi në fjalitë (72, 138) ku numri i foljes është i njëjtë në të dyja gjuhët, përkundër mungesës së kryefjalës në gjuhën shqipe, sepse fjalia fillon drejtpërdrejt me kallëzues.

Ndryshim tjetër strukturor dhe dallim për nga funksioni sintaksor i gjymtyrëve është paraqitur edhe në fjalinë (90) ‘***It** might not come to that./Ndoshta nuk vjen puna deri aty.*’. Ky dallim vjen si pasojë e përdorimit të kryefjalës së zbrazët ‘*it*’. Madje, fjalisë së përkthyer i është shtuar një emër ‘*puna*’ e cila në gjuhën shqipe është kryefjalë. Pra, qëllimi për të qartësuar fjalinë

ka bërë ndryshim rrënjësor të strukturës së fjalisë. Përkthyesi në këtë rast ka qenë i detyruar të përdorë përkthim me parafrazim dhe kryefjalë të vërtetë për të përshtatur përkthimin.

Lidhja e kryefjalës me kallëzuesin në pjesën më të madhe të rasteve është përshtatur në të dyja gjuhët në vetë dhe numër. Në tekstin e analizuar është gjetur një rast interesant ku numri i foljes nuk mund të jetë i njëjtë në të dyja gjuhët. Në fjalinë (41) '*Four pounds a week was a small expense as they were going to rob thousands of pounds.*/Katër paundë në javë **ishin** shpenzim i vogël pasi do të vidhnin mijëra paundë.' kryefjala '*four pounds a week*' lidhet me kallëzues në numrin njëjës ('*was a small expense ...*'), ndërsa në gjuhën shqipe kryefjala '*katër paundë në javë*' lidhet me kallëzues në numrin shumës ('**ishin** shpenzim i vogël ...'). Ky ndryshim shpjegohet me faktin se, edhe pse emri '*paundë*' është emër i numërueshëm, në gjuhën angleze të Britanisë kërkon folje në numrin njëjës dhe jo në shumës si në gjuhën shqipe, sepse konsiderohet si një tërësi. Në gjuhën shqipe, kur emri është në shumës, edhe folja është në shumës. Ky rast paraqet një ndryshim që nuk është bërë vetëm për shkak të përkthimit, por është një ndryshim i domosdoshëm. Por, duhet pasur parasysh se e njëjta fjalë mund të dalë edhe ndryshe, si në '*40 pounds are enough.*/40 funte janë të mjaftueshme.' Në këtë rast folja në të dyja rastet është në numrin shumës, sepse emri '*pounds*' nuk merret si njësi, por si shumë parash. Me emër të numërueshëm i cili normalisht përdoret në numrin njëjës është fjala '*proof*' në fjalinë (54) '*If he'd been surprised, I would have suspected him because he knows the **proof** goes against him.*/Po të ishte befasuar, **mendoj** se do të kisha dyshuar për të, pasi ai e di se **provat** i **ka** kundër.'. Në gjuhën shqipe ajo fjalë është përkthyer '*provat*'. Prej këtij paraqitet problemi i lidhjes së kryefjalës dhe kallëzuesit pasi që nuk kemi përputhje të numrit të foljes në të dy gjuhët. Fjala '*proof*' në gjuhën angleze normalisht merr folje në njëjës si në rastin e fjalisë (54), ndërsa në gjuhën shqipe fjala '*provat*'. Në gjuhën shqipe *provat* është kundrinor i drejtë dhe folja është në njëjës **ai ka**. Pra, është ndryshuar edhe folja dhe fjalia për këtë arsye del në këtë formë.

Përdorimi i një foljeje tjetër në vend të foljes së njëjtë gjatë përkthimit ka bërë që të kemi ndryshim të numrit të foljes dhe nga pohore në gjuhën angleze dhe në mohore në gjuhën shqipe. Bëhet fjalë për fjalinë (95) '*It was McCarthy and he **remembered** my face.*/Ishte Mekarthi dhe ai **nuk e harroi** fytyrën time.'. Sikur folja '*remembered*' të përkthehej '*mbajti mend*', atëherë fjalia do të kishte qenë pohore. Gjithsesi, ky ndryshim nuk ka pasur ndikim në funksionin sintaksor të '*my face/fytyrën time*' që është kundrinor. Por, si përkthim më i saktë mund të ishte fjalia '*Ishte Mekarthi dhe ai e mbajti mend fytyrën time*'. Në këtë mënyrë do të ruhej struktura e njëjtë si në

gjuhën angleze ashtu edhe në gjuhën shqipe. Fjali tjetër ku ka ndryshim të vogël duke shtuar pjesëzën dyshuese *mos* është vërejtur në fjalinë (184) ‘*Is he a very tall, thin German?/A mos është një gjerman i gjatë, i hollë?*’. Përdorimi i kësaj pjesëze e bën pyetjen vërtetuese në gjuhën shqipe, ndryshe nga gjuha angleze.

Rasti i fundit ku numri i foljes nuk është i njëjtë është në fjalinë (188) ku fjalia në gjuhën angleze ‘*And so they were.*’ është përkthyer në ‘*Dhe ashtu ishte.*’. Për shkak të parafrazimit dhe mungesës së kryefjalës, këtu, përveç mospërputhjes së numrit të foljes në të dyja gjuhët, kemi edhe ndryshim të kuptimit, për shkak se në gjuhën angleze fjalia e ka kuptimin e pohimit të një veprimi të mëhershëm që e kanë bërë shumë persona, ndërsa në gjuhën shqipe kuptimi i fjalisë lidhet me ndonjë punë, send apo karakteristikë, por jo me njerëz. Ky përkthim është bërë duke gjetur shprehjen më të përshtatshme, por për ta ruajtur edhe më shumë kuptimin atëherë mund të jepej një variant tjetër që do të përsëriste veprimin e shprehur në fjalinë paraprijëse.

Ndryshime strukturore më të mëdha janë vërejtur gjatë analizimit të fjalive të paraqitura në tabelën nr. 2. E tillë është fjalia (7) ‘*And so it was **until this morning**, when **I** saw the office was closed and **a sign saying**: “The Red-Headed League has been dissolved.”/Dhe kështu vazhdoi **deri këtë mëngjes**, kur pashë që zyra ishte mbyllur dhe **kishte një shenjë që thoshte** “Lidhja e Flokëkuqëve është shuar”.*’ ku në gjuhën angleze kemi kryefjalë dhe kallëzues ‘*a sign (was) saying*’ (ku folja ndihmëse mund të bjerë) dhe në shqipe kallëzues e kundrinor ‘*kishte një shenjë që thoshte*’. Pra, këtu përveç mungesës së kryefjalës, kemi ndryshim të funksioneve sintaksore ku ‘*sign*’ është kryefjalë, ndërsa ‘*shenjë*’ në gjuhën shqipe është kundrinor. Këtu nuk kemi të bëjmë me diatezë pësore që të arsyetohej një ndryshim i këtillë, por thjeshtë përkthimi ka bërë që të rezultojë me strukturë të ndryshuar. Fjalja tjetër që përmban strukturë jo të njëjtë në të dyja gjuhët është fjalia (8) ‘“*How long had this employee, Spaulding, been with you when he suggested you to join the League?*” asked Holmes./“*Sa kohë kishte me ty punëtori yt, Spolding, kur të sugjeroi të bëhesh pjesë e Lidhjes?*” pyeti Holmsi.’. Në këtë fjali nuk është përdorur folja e njëjtë gjatë përkthimit (‘*been*’ – ‘*ishte*’), gjë që ka rezultuar edhe me mospërputhjen e rendit të gjymtyrëve. Pavarësisht ndryshimit strukturor këtu është e rëndësishme ruajtja e kuptimit të fjalisë. Ndryshim i theksuar i tërë strukturës së fjalisë është vërejtur në fjalinë (9) ‘“***I thought so!***” exclaimed Holmes./“***Ma mori mendja!***” thirri Holms i emocionuar.’ për shkak se kemi shprehje idiomatike. Shprehjet idiomatike në të shumtën e rasteve kanë strukturë tërësisht të ndryshuar për shkak se nuk përkthehen fjalë për fjalë.

Ndryshim brenda sifjalisë është vërejtur në fjalinë (14) ‘*Of all the old brick houses, Sherlock Holmes stopped in front of the one **that advertised** Wilson’s business and he knocked.*’/Nga të gjitha shtëpitë me tulla të vjetra, Sherlock Holmsi u ndal para njëres **që kishte shenjën e biznesit të Uilsonit dhe trokiti.**’ ku përshtatja e përkthimit ka bërë që të mos kemi funksione sintaksore të njëjta në të dyja gjuhët – ‘*one that advertised*’ dhe ‘*njëres që kishte shenjën e biznesit*’. Pra, mund të shihet qartë se brenda sifjalisë kemi strukturë tërësisht të ndryshme si dhe kuptim të ndryshuar, pasi ‘*advertised Wilson’s business*’ dhe ‘*kishte shenjën e biznesit të Uilsonit*’ nuk janë të barasvlershme. Është dashur të ruhet kuptimi duke thënë ‘... reklamonte biznesin e Uilsonit’. Tjetër fjali me strukturë tërësisht të ndryshuar është fjalia (20) ‘*One I **recognized** as Jones, the policeman.*’/Njëri prej tyre **ishte** Xhonsi, polici.’ ku përshtatja e përkthimit ka ndryshuar foljen dhe përdorimi i një foljeje tjetër çon në një rend të ndryshëm fjalësh, çka nuk lë hapësirë për të gjetur diçka të përbashkët në të dyja gjuhët. Përshtatja e përkthimit ka rezultuar në raste të caktuara me ndryshim të fjalisë, gjegjësisht numrit të foljeve. Në fjalinë (30) në gjuhën angleze fjalia ka dy folje (‘*turn*’ dhe ‘*surround*’), ndërsa në gjuhën shqipe tre folje (‘*ndez*’, ‘*drejtoj*’ dhe ‘*rrethojini*’) – ‘*When I turn the lantern on the thieves, surround them.*’/Kur ta ndez fenerin dhe t’ua drejtoj hajdutëve, rrethojini’. Pra, këtu kemi tipa të ndryshëm fjalish për shkak të shprehjes foljore në gjuhën angleze, e cila ka kuptimin se drita i drejtohet dikujt, ndërsa në gjuhën shqipe është i nevojshëm shtimi i foljes për të pasur fjali kuptimplotë. Përveç numrit të foljeve, kundrinori ‘*them*’ në gjuhën angleze kuptohet nga trajta e shkurtër e ndërshtënë në foljen në mënyrën urdhërore “*rrethojini*” në gjuhën shqipe. Me interes në këtë disertacion janë edhe fjalitë ku në gjuhën angleze përdoren shprehjet foljore. Fjali e tillë është fjalia (131) ku në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe kemi strukturë të njëjtë të foljes ‘*run away*’ dhe ‘*largohem*’. Por mund të ndodhë që me shprehjet foljore të kemi ndryshim strukturor, si p.sh. në fjalinë (133) ‘*My sister **came out** at that moment and as I turned around, the goose **escaped** and went with the others.*’/Motra **doli në oborr** në atë kohë dhe duke u kthyer, pata më **shpëtoi nga duart** dhe u bashkua me të tjerat.’ ku në gjuhën angleze kemi shprehje foljore si në fjalinë e mëparshme, por jo në gjuhën shqipe. Në gjuhën shqipe folja ‘*doli*’ është e shoqëruar me rrethanorin ‘*në oborr*’. Këto dy shembuj mjaftojnë për të thënë se nuk mund të kemi një rregull universal që do të vlente për shprehjet foljore në kuptimin që mund të plotësohen ose mos plotësohen me gjymtyrë tjetër të dytë.

Tjetër shembull me ndryshim të madh strukturor dhe rendit të fjalëve është fjalia (53) ku në gjuhën angleze ‘*That was a confession.*’ kemi kryefjalë – kallëzues – kallëzues emëror, ndërsa në gjuhën shqipe ‘*Pra, qenka rrëfyer.*’ kemi lidhëzorin ‘*pra*’ dhe vetëm kallëzues ‘*qenka rrëfyer*’. Nëse do të tentohej që të përshtatej fjalia me përkthim fjalë për fjalë, rezultati në gjuhën shqipe nuk do të ishte i pranueshëm për shkak se fjalia do të ishte: ‘*Ai ishte një rrëfim.*’ Por, meqenëse kryefjala ‘*that*’ në gjuhën shqipe zakonisht nuk shkruhet (por në raste të caktuara edhe mund të shkruhet si në ‘*That is my pen./Ai është stilolapsi im.*’), atëherë mundësia tjetër deri diku e pranueshme do të ishte ‘*Ishte një rrëfim.*’, pasi nuk e ka stilin letrar si fjalia e përkthyer në tekst. Në fjalinë (105) ‘*In the early morning, as he was returning home, he saw a man **staggering** in the street with a goose on his shoulder./Herët në mëngjes, ndërsa kthehej në shtëpi, ai kishte parë një burrë **që i merreshin këmbët** nëpër rrugë, me një patë mbi sup.*’ është vërejtur një ndryshim për shkak se folja ‘*staggering*’ duke mos mundur të përshtatet me përkthimin, është plotësuar me fjalë të tjera duke e zgjeruar kuptimin e saj, por njëkohësisht duke shtuar një emër dhe është përkthyer ‘*që i merreshin këmbët*’. Pra, ky parafrazim ndikon drejtpërdrejt në strukturën e fjalisë.

Në fjalinë (111) ‘***Just then** Peterson arrived running./Pitersoni erdhi duke vrapuar.*’ në fjalinë e përkthyer nuk është marrë parasysh rrethanori dhe nuk është pjesë e fjalisë së përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo bën që të kemi rend të ndryshuar, sepse fjalia nuk fillon me gjymtyrën e njëjtë në të dy gjuhët, pra me rrethanor. Një fjali pyetëse e cila nuk ka strukturë të njëjtë në të dyja gjuhët është fjalia (112) ‘*It’s not the countess, blue carbuncle, is it?/A nuk është guri i çmuar i konteshës?*’. Në këtë fjali, në gjuhën angleze fillohet me përemrin ‘*it*’, ndërsa në gjuhën shqipe fillohet me pjesëzën pyetëse ‘*a*’. Përveç kësaj, në gjuhën angleze ky është një tip i veçantë fjalish pyetëse që njihen si ‘tag questions’. Fjalia do të mund të ishte përshtatur për të pasur strukturë të ngjashme edhe në gjuhën shqipe, por me anë të parafrazimit është ndryshuar struktura e fjalisë pyetëse. Ngjashëm, fjali pyetëse të ndryshuar kemi edhe në fjalinë (119) për shkak se nuk është bërë përkthim fjalë për fjalë, por është bërë përkthim me përshtatje me qëllim që fjalia të ruajë kuptimin. Pra, fjalia pyetëse ‘*Are you convinced?*’ nëse do të ishte përkthyer fjalë për fjalë për të ruajtur strukturën do të ishte ‘*A je i bindur?*’, ndërsa në tekst është ‘*A u binde tani?*’. Ndajfolja ‘*tani*’ në fjalinë e përkthyer është shtuar pa pasur nevojë. Parafrazimi është përdorur edhe në fjalinë (176) ku struktura nuk është as përafërsisht e njëjtë, sepse janë përdorur dy shprehje ‘*was almost dawn – po lindte dita e re*’ dhe ‘*came round – erdha në vete*’. Në rast se

këto pjesë analizohen me diagramin e pemës, do të kishim ndryshime strukturore të mëdha dhe gjymtyrë me funksione të ndryshme që nuk janë të njëjta në të dyja gjuhët.

Në fjalinë (139) '*At the end of the day, it wasn't the police who hired me./Në fund të fundit, mua nuk më ka angazhuar policia.*' ballafaqohemi me dallime më të thella për shkak se në fillim kemi një shprehje idiomatike që ka strukturë të ndryshme në të dyja gjuhët, pastaj në gjuhën angleze kemi kryefjalë të zbrazët '*it*' me kallëzues me folje këpujore dhe pastaj kallëzues emëror, ndërsa në gjuhën shqipe kemi rend të përmbysur duke dalë kundrinori në fillim, pastaj kallëzuesi (ku nga folje këpujore në gjuhën angleze kemi folje të thjeshtë në gjuhën shqipe) dhe në fund kryefjala. Dallimet janë të shumta kur krahasohen të dyja fjalitë, qoftë në strukturë apo rend, por në fund të fundit kuptimi është i njëjtë përkundër rendit jo të njëjtë.

Shprehje frazeologjike është vërejtur edhe në fjalinë (67) '*The sad thing is he's in love with Miss Turner, but a few years ago, while she was at boarding school, he took a fancy to a barmaid from Bristol and married her./Gjëja e trishtuar është se ai ka rënë në dashuri me znj. Tërner, mirëpo disa vite më parë kur ajo ishte në shkollë, atij i kishte rënë në kokë për një kamariere nga Bristol dhe u martua me të.*'. Siç është pohuar edhe më herët, shprehjet gjatë përkthimit normalisht ndryshojnë për nga struktura, siç është rasti me '*took a fancy*' dhe '*i kishte rënë në kokë*'. Po të analizohen me diagramin e pemës këto dy shprehje do të shohim se kemi folje të ndryshme dhe sintagmë emërore '*fancy*' dhe parafjalore '*në kokë*'. Shprehje idiomatike është përdorur edhe në fjalinë (130) dhe normalisht shprehjet nuk kanë strukturë të njëjtë në të dyja gjuhët, me përjashtime të vogla të përmendura në kreun III.

Fjalia (48) '*The girl ran home and just after telling her parents, young McCarthy arrived with his right arm bloodstained, asking for help as he had found his father dead./Vajza kishte vrapuar për në shtëpi dhe menjëherë pasi u kishte treguar prindërve, Mekarthi i ri kishte ardhur aty me krahun e djathtë të mbuluar nga gjaku, duke kërkuar ndihmë, pasi e kishte gjetur babain e tij të vdekur.*' është shembull tjetër tipik ku kemi strukturë thellësisht të ndryshuar. Në fillim, rrethanori '*home*' në gjuhën angleze është i shprehur me sintagmë emërore, ndërsa në gjuhën shqipe me sintagmë parafjalore '*për në shtëpi*'; mungesa e përcaktorit në gjuhën shqipe nga sintagma emërore '*her parents*' e bën të paqartë se prindërve të kujt u ka treguar ajo, përkundër asaj që fjalia e pavarur deri diku e jep një informacion të tillë; dallimi i tretë dhe më i madh është se, nëse e marrim sifjalinë dhe e analizojmë ndaras, atëherë '*Young McCarthy arrived with his right arm bloodstained*' ka rend kryefjalë – kallëzues – kundrinor – kallëzuesor i kundrinorit,

ndërsa në gjuhën shqipe ‘*Mekarthi i ri kishte ardhur aty me krahun e djathtë të mbuluar nga gjaku*’ ka rend kryefjalë – kallëzues – rrethanor – kundrinor – përcaktor. Edhe në fjalinë (49) ka ndryshim strukturor ku ndikim ka pasur diateza e foljes: ‘*the victim had received blows to the head*’, ‘*viktimën e kishin goditur në kokë*’. Në pamje të parë mund të shihet se emri ‘*victim*’ është kryefjalë, nëse analizohet si fjali në vete, ndërsa ‘*viktimën*’ është kundrinor. Njëjtë, në fjalinë (143) diateza pësore në gjuhën shqipe rezulton me ndryshim strukturor të fjalisë (është shtuar edhe një folje për të përshtatur përkthimin), kur krahasohet me atë në gjuhën angleze. Diateza pësore është përdorur edhe në fjalinë (168) në gjuhën shqipe për të parafrazuar përkthimin ku në gjuhën angleze ka përemër vetvetor. Pra, për fjalinë ‘*I threw myself*’ në gjuhën shqipe kemi ‘*U hodha*’ dhe kryefjala kuptohet nga veta e foljes. Ky përkthim shihet se ka ndikuar pa asnjë dyshim në strukturën e fjalisë, por ky ndryshim, apo përdorimi i pësorës është në fakt i domosdoshëm për të pasur fjali të saktë në aspektin gramatikor dhe semantik në gjuhën shqipe. Parafrazim, madje më i theksuar, është përdorur edhe në fjalinë (174) ‘*I got up and started running, but **I felt faint** and noticed that he had cut off my thumb and **I was bleeding a lot***./U ngrita në këmbë dhe nisa të vrapoj, **mirëpo m’u turbullua mendja** dhe vura re se ai më kishte prerë gishtin e madh dhe **po më rridhte shumë gjak**.’ ku në dy raste ka krijuar strukturë të ndryshme nga ajo e gjuhës angleze. Përderisa në njërin rast ‘*felt faint*’ do mundej të ruhet struktura dhe fjalia të përkthehej fjalë pas fjale, në rastin tjetër ‘*I was bleeding a lot*’ nuk mund të ruhet struktura dhe bëhet parafrazim i fjalisë me të cilin fitohet strukturë e ndryshme, si në këtë rast me ‘*m’u turbullua mendja*’ dhe ‘*po më rridhte shumë gjak*’.

Fjalia (60) është një shembull tjetër ku kemi dallim strukturor për shkak se ‘*Here she is now!*’ dhe ‘*Ja ku është!*’ tregon në pamje të parë se nuk kanë shumë të përbashkëta. Problemi më i madh me këtë fjali është se mungesa e kryefjalës lë hapësirë për disa interpretime të kësaj fjalie. Çështja është kush është, ai apo ajo. Pra, fillimisht nuk dihet kujt i referohemi (si pasojë e mungesës së kryefjalës) dhe rrethanori ‘*now*’ i cili mungon në gjuhën shqipe, përbën problemin e dytë, për shkak se fjalia mund të ishte më e qartë, si p.sh.: ‘*Ja ku është tani!*’. Pra, lënia anësh e fjalëve nga gjuha angleze në fjalitë e përkthyer në gjuhën shqipe rezulton me fjali jo krejtësisht të qarta. Në fjalinë (63) ballafaqohemi ngjashëm me strukturë krejtësisht të ndryshuar për shkak të përshtatjes së përkthimit. Së pari, në gjuhën angleze në pjesën ‘*this has made **him worse** ...*’ kemi kryefjalë, kallëzues, kundrinor dhe kallëzuesor të kundrinorit, ndërsa në gjuhën shqipe ‘*kjo ngjarje ia ka rënduar shëndetin ...*’ kemi kryefjalë, kundrinor të zhdrejtë, kallëzues dhe

kundrinor të drejtë. Përkthim më i përshtatshëm këtu do të ishte ‘*kjo e ka përkeqësuar atë*’ dhe në këtë mënyrë do të ruhej edhe struktura, edhe kuptimi. Fjalja tjetër në radhë (64) ka strukturë krejtësisht të ndryshuar dhe nuk kanë pika të përbashkëta për nga aspekti sintaksor, përkundër asaj që kuptimi është ruajtur. Parafrazimi i fjalisë së përkthyer ruan kuptimin, por jo rendin dhe strukturën. Përkthimi me parafrazim është vënë re edhe në fjalinë (94) ku kemi strukturë krejtësisht të ndryshuar, qoftë në aspekt të pjesëve të ligjëratës, sintagmës apo gjymtyrëve. Edhe në fjalinë (134) ‘*The surprise was that when we opened the goose, the carbuncle wasn’t there./Për befasinë time, kur e hapëm patën, guri nuk ishte aty.*’ kemi strukturë krejtësisht të ndryshme në fillim të fjalisë për shkak se ‘*the surprise*’ është kryefjalë, ndërsa ‘*për befasinë time*’ është shprehje e cila nuk mund të luajë rolin e kryefjalës. Ky ndryshim vjen nga përkthimi i fjalisë, pasi, nëse do të ishte përkthyer njëjtë siç është fjalja në gjuhën angleze, atëherë do të ishte ‘*befasia*’ dhe në këtë mënyrë do të kishim kryefjalë si në gjuhën angleze. Në fjalinë (169) ‘*Someone pulled me at my hand and I saw the woman from earlier, who urged me to run./Dikush më tërhoqi nga dora dhe pashë gruan që e kisha takuar më herët, e cila më tha të vrapoj.*’ përkthimi me parafrazim ka krijuar sifjali në vend të një rrethanori. Jo se nuk ka qenë e mundur që fjalja të përshtatet dhe të ketë strukturë të njëjtë në të dyja gjuhët, por qëllimi për të pasur një stil letrar, ndikon në raste të caktuara duke krijuar struktura të ndryshme, si në këtë rast.

Në fjalinë (32) ‘*The wait in the dark seemed eternal./Pritja në errësirë na u duk e pafund.*’ është vërejtur një ndryshim interesant kur krahasohen të dyja gjuhët. Në fjalinë në gjuhën angleze nuk ka kundrinor, ndërsa në gjuhën shqipe është shtuar trajtë e shkurtër. Fjalja (33) ngjashëm ka strukturë rrënjësisht të ndryshuar pas përkthimit të bërë dhe nuk përputhet struktura e të dyja gjuhëve, por kuptimi është i përafërt. Në rast se do të bënim analizë me anë të diagramit të pemës, në këtë fjali do të kishim strukturë shumë të ndryshme. Edhe në fjalinë (38) ‘“*There is no escape, John Clay,*” *Holmes exclaimed./“Nuk ke nga shpëton, Xhon Klej” thirri Holmsi.*’ na përsëritet rasti ku përkthimi i bërë rezulton me strukturë tërësisht ndryshe nga gjuha angleze në të cilën nuk kemi përputhje të kryefjalës dhe emri ‘*no escape*’ është shndërruar në folje ‘*shpëton*’. Njëjtë, tentimi për ta përshtatur sa më mirë përkthimin ka bërë që të kemi strukturë shumë të ndryshme në fjalinë (42) ku folja ‘*call*’ është përkthyer në ‘*bëra*’, emri ‘*state*’ në foljen ‘*dukeshin*’ dhe emri ‘*knees*’ që është në shumës në emrin ‘*pjesa e gjurit*’ që është në njëjës. Të gjithë këto ndryshime drejtpërdrejt kanë ndikuar edhe në mospërputhjen e funksioneve sintaksore të fjalëve, kur krahasohen të dyja fjalitë. Kjo nuk do të thotë se fjalitë nuk janë të

sakta. Fjalitë janë plotësisht të sakta, por rendi nuk është ruajtur pas përkthimit të bërë dhe pjesët e ligjëratës kanë marrë funksione të ndryshme sintaksore. Edhe në fjalinë (43) kemi përkthim ndryshe të foljes nga ‘*be*’ në ‘*ndodhte*’, por përkundër kësaj gjymtyra që i vjen pas është në të dyja gjuhët rrethanor. Një dallim tjetër është se rrethanori tjetër ‘*today*’ dhe ‘*sot*’ nuk gjenden në vendin e njëjtë.

Përdorimi i një foljeje tjetër në vend të foljes këpujore rezulton me gjymtyrë me funksion tjetër sintaksor. I tillë është rasti me fjalinë (107) ‘*In the lining of the hat are the initials ‘H.B’ and on the leg of the goose was a card that said, ‘For Henry Baker’, but there are so many of them in London that Peterson didn’t know what to do and he brought them to me.*’/Në astarin e kapales janë inicialet ‘H.B’ dhe në këmbën e patës kishte një kartolinë që thoshte ‘Për Henri Bejkerin’, mirëpo ka aq shumë me këtë emër në Londër saqë Pitersoni nuk dinte çfarë të bënte dhe m’i solli mua.’ ku nuk është rast i vetëm kur është bërë zëvendësimi i foljes ‘*jam*’ me foljen ‘*kam*’. Pra, ‘... was a card ...’ dhe ‘... kishte një kartolinë ...’ nuk janë të njëjta, sepse në rastin e parë kemi kallëzues emëror, ndërsa në të dytin kundrinor. Shembull i ngjashëm është edhe fjalia (151) ku kemi gjymtyrë të ndryshme në të dyja gjuhët si pasojë e përdorimit të një foljeje tjetër në gjuhën shqipe (‘*veshur*’) në vend të foljes këpujore në gjuhën angleze (‘*was*’). Rast tjetër që përsëritet për shkak të foljes këpujore dhe një tjetre, është fjalia (165). Në gjuhën angleze kemi kryefjalë, kallëzues dhe kallëzues emëror të ‘*there were remains of metal*’, ndërsa në gjuhën shqipe kallëzues dhe kundrinor të ‘*pashë mbeturina metali*’.

Fjali e cila në pamje të parë duket e thjeshtë dhe jo shumë ndryshe nga gjuha angleze, është fjalia (81) ‘*I won’t be long.*’/Nuk vonohem.’. Përveç mungesës së kryefjalës, e cila nuk paraqet ndonjë ndryshim domethënës për pjesën e mbetur, problem paraqet folja. Në gjuhën angleze në ‘*I won’t be long.*’ kemi kryefjalë, kallëzues dhe rrethanor kohe, ndërsa në gjuhën shqipe në ‘Nuk vonohem.’ kemi vetëm kallëzues. Ky dallim është për shkak se në gjuhën shqipe folja ‘*vonohem*’ tregon kohën, ndërsa në gjuhën angleze folja duhet patjetër të marrë një plotësor i cili ka funksionin e rrethanorit. Një fjali tjetër ku kemi një pjesë të ligjëratës të shndërruar në një tjetër pjesë të ligjëratës është fjalia (87) ‘*The print of his right foot was always less clear, and he’s left-handed because the blow came from the left.*’/Gjurma e këmbës së djathtë ishte gjithnjë më pak e qartë dhe është majtak sepse ka goditur nga ana e majtë.’. Emri ‘*the blow*’ është përkthyer në foljen ‘*ka goditur*’. Ndryshimi i një pjese të ligjëratës rezulton me ndryshim strukturor, sepse, po ta analizonim veças fjalinë pas lidhëzës, ‘*the blow*’ në anglishte është kryefjalë, ndërsa ‘*ka*

goditur’ në shqipe është kallëzues. Kjo ndikon drejtpërdrejt edhe në kuptimin e fjalisë, pra, nuk ruhet kuptimi i plotë për shkak se në gjuhën angleze ‘*goditja*’ ka ardhur nga ana e majtë por nuk thuhet se nga kush, ndërsa në gjuhën shqipe veta e foljes lë të nënkuptohet se ‘*ai*’ kishte goditur nga ana e majtë. Me një fjalë, këtu përveç ndryshimit strukturor kemi edhe ndryshim semantik. Pas përkthimit të fjalisë (183) ‘*They’re money counterfeiters on a large scale./Janë falsifikatorë të mëdhenj të parave.*’ sintagma parafrallore ‘*on a large scale*’ që njëkohësisht është rrethanor në gjuhën shqipe rezulton të jetë sintagmë mbiemërore ‘*të mëdhenj*’ dhe që luan rolin e përcaktorit në fjali. Një ndryshim, sado i vogël që mund të duket në pamje të parë, rezulton në ndryshim strukturor më të thellë.

Rend dhe strukturë krejtësisht të ndryshuar mund të vërehet edhe në fjalinë (104) ‘“*Behind this simple hat there’s a terrible story, isn’t there?*” *I said to him./“Kjo kapele ka një histori të tmerrshme, apo jo?” e pyeta.*’ për shkak të përshtatjes së përkthimit dhe mospërkthimit të ndajfoljes. Përveç kësaj, edhe kundrinori ‘*him*’ nuk është shkruar në gjuhën shqipe për shkak se kuptohet nga veta e foljes se kujt i është drejtuar me atë pyetje. Në fjalinë (121) ‘*Walking away, my friend confessed, laughing, that the best way of getting information was with a bet./Duke u larguar, miku im më tregoi duke qeshur se mënyra më e mirë për të nxjerrë informacion është përmes bastit.*’ folja jokalmtare ‘*confessed*’ nuk është shoqëruar nga një gjymtyrë tjetër, ndërsa në gjuhën shqipe folja kalimtare ‘*tregoi*’ kërkon një gjymtyrë tjetër, që në këtë rast është kundrinori i shprehur me trajtë të shkurtër. Kjo folje mund të përkthehet edhe ‘*pranoi*’ ose ‘*u rrëfye*’ dhe në këtë mënyrë do të kishin folje jokalmtare si në gjuhën angleze. Po ashtu, në fjalinë (132) kemi rast me folje jokalmtare ‘*was smoking*’ dhe kalimtare ‘*pirë duhan*’. Mund të shihet qartë se në gjuhën shqipe kemi një gjymtyrë plotësuese për dallim nga gjuha angleze dhe shtimi i gjymtyrës, në këtë rast i kundrinorit, është i domosdoshëm, sepse folja nuk mund të jetë e pashoqëruar nga një gjymtyrë tjetër. Në fund, lidhëza ndodh që në gjuhën shqipe të mos jetë në të njëjtin vend si në gjuhën angleze. Një shembull i tillë është paraqitur në fjalinë (77), por lëvizja e lidhëzës nuk ka ndikuar në ndryshimin e strukturës apo funksioneve sintaksore të gjymtyrëve. Madje, edhe sikur të ishte në vendin e njëjtë si në gjuhën angleze, sërish rendi do të jetë i njëjtë në të dyja gjuhët.

4.4. Analizë e fjalive me një kryepërbërës, dy kryepërbërës ose të paplota

Në tabelën nr. 3 në shtojcën A janë pasqyruar fjalitë me një kryepërbërës, të paplotat ose ato me vetëm kryefjalë dhe kallëzues. Ky kategorizim është bërë me qëllim që të shihet numri i fjalive me një kryepërbërës apo fjali me folje jokalimtare që nuk kërkojnë një gjymtyrë tjetër të dytë. Si në dy tabelat e para, edhe tabela nr. 3, është analizuar për të parë nëse ka dallim në strukturën e këtyre fjalive. Nga 23 fjali, 13 kanë pasur strukturë të njëjtë ose pothuajse të njëjtë në të dyja gjuhët, ndërsa 10 fjali kanë pasur dallime strukturore.




Figura 9. Struktura/rendi në fjali me një kryepërbërës, dy kryepërbërës ose fjali të paplota

Në dallim nga fjalitë e analizuar në dy tabelat e para të cilat ishin të shumta në numër, në tekst është vërejtur një numër shumë i vogël fjalish të cilat kanë një kryepërbërës, vetëm dy kryepërbërësit (kryefjalën dhe kallëzuesin) ose të paplota. Në fillim, fjalia (2) në gjuhën angleze është një fjali e paplotë për shkak se i mungon kallëzuesi. Por, ajo çfarë është vërejtur pas përkthimit të së njëjtës fjali është përdorimi i foljes 'ka'. Me vetë faktin që fjalia në gjuhën shqipe përmban folje, ajo konsiderohet fjali e plotë. Fjalia, nëse nuk do të përdorej folja, do të ishte e paplotë edhe në gjuhën shqipe, por për të përshtatur përkthimin më mirë përkthyesi ka vendosur që të shtojë një folje pa prishur kuptimin e fjalisë. Në gjuhën angleze ka disa fjali që

përkundër strukturës së plotë janë, në fakt, shprehje të cilat kanë kuptim të veçantë. Shembull i tillë është fjalia (3) ku *‘That’s it.’* në gjuhën shqipe është përkthyer *‘Kaq.’* Përderisa në gjuhën angleze fjalia është e plotë, në gjuhën shqipe kemi fjali të paplotë. Në gjuhën angleze në fjalinë (4) *“‘And I you,’ Holmes replied./“Dhe unë të përgëzoj ty” ia priti Holmsi.* është vërejtur një fjali e paplotë që nuk është tipike në gjuhën angleze: *‘And I you’, replied Holmes.*. Nëse fjalia do të përkthehej fjalë për fjalë, do të ishte *‘Dhe unë ty.’*, që në fakt nuk do të ishte një fjali dhe aq e qartë, përkundër asaj që konteksti deri diku mund të ndihmojë në kuptimin e saj. Vendimi për ta përkthyer fjalinë në gjuhën shqipe si *“‘Dhe unë të përgëzoj ty’, ia priti Holmsi’* krijon fjali të plotë me kryefjalë, kallëzues dhe kundrinor brenda saj. Fjali e ngjashme ku është shtuar folje pas përkthimit të bërë, është fjalia (5) *“‘Back in Baker Street,’ Holmes explained to me./“Pasi u kthyem në Rrugën Bejkër,” Holmsi ma shpjegoi.* dhe me shtimin e foljes këtu rezulton se është sifjali.

Në fjalinë (6) *‘They argued and he left, but about 150 meters away he heard a terrible cry and he returned./Ishin grindur dhe ai ishte larguar, por pasi kishte ecur për 150 metra kishte dëgjuar një ulërimë të tmerrshme dhe ishte kthyer.’* në të cilën kemi sifjali me dy kryepërbërës, kemi ndryshim më të theksuar të strukturës për shkak se fillimisht *‘he left’* është përkthyer *‘ai ishte larguar’*, pastaj, në sifjalinë tjetër në gjuhën shqipe është shtuar folja *‘kishte ecur’* pa e pasur atë në gjuhën angleze. Shtimi i foljes ndryshon strukturën e fjalisë, sepse nga një rrethanor *‘about 150 meters away’* shndërrohet në sifjali kohore *‘pasi kishte ecur për 150 metra’*. Fjali tjetër me dy kryepërbërës është fjalia (7) *‘Now the barmaid has found out./Tani kamerierja e ka zbuluar.’*, por në gjuhën shqipe kemi në mënyrë plotësuese një trajtë të shkurtër të përemrit vector në rasën kallëzore. Kjo trajtë e shkurtër shërben për të shprehur kundrinorin. Në gjuhën angleze fjalia *‘Now the barmaid has found out.’* nuk përmban kundrinor, që do i referohej asaj që është zbuluar, ndërsa në gjuhën shqipe në fjalinë e përkthyer *‘Tani kamerierja e ka zbuluar.’* tregon se ajo *‘atë e’* ka zbuluar. Rast tjetër me fjali me dy kryepërbërës i ngjashëm me fjalinë (7) është fjalia (14). Edhe këtu, trajta e shkurtër është shtuar pa pasur nevojë duke sjellë ndryshimin e kuptimit të fjalisë. Nga *‘Some ruffians approached’* duhej të ishte *‘Disa rrugeçër ishin afruar’* dhe jo *‘Disa rrugeçër i ishin afruar.’* Pra, në fjalinë që duhej të ishte pa trajtë të shkurtër, fjalia do të ishte e përgjithshme dhe do të tregonte se ata janë afruar diku, ndërsa fjalia e përkthyer në vepër tregon se ata i janë afruar dikujt, e jo diku.

Në fjalinë (15) '*Both the man and the muggers panicked and ran off./Edhe burri, edhe grabitësit ishin trembur dhe kishin ikur me vrap.*' ka dallim për sa i përket numrit të gjymtyrëve. Folja e thjeshtë jokalimtare '*panicked*' dhe shprehja foljore '*ran off*' në gjuhën angleze nuk janë plotësuar me gjymtyrë tjetër, ndërsa të njëjtat në gjuhën shqipe si '*ishin trembur*' dhe '*kishin ikur*' janë plotësuar me rrethanorin '*me vrap*', pra '*ishin trembur*' dhe '*kishin ikur **me vrap***'.

Edhe në fjalitë me dy gjymtyrë kryesore ka ndodhur të ketë lëvizje të kryefjalës në gjuhën shqipe dhe me këtë kemi rend të anasjelltë, si në fjalinë (17). Përderisa në gjuhën angleze kemi '*he replied*', e njëjta në gjuhën shqipe është përkthyer '*u përgjigj ai*'. Kjo lëvizje e kryefjalës nuk është vërejtur vetëm në tabelën e tretë të Shtojcës A, por edhe në të parën dhe të dytën. Lëvizja kryesisht ka ndodhur kur kryefjala dhe kallëzuesi qëndrojnë pas një pjese të thënë ose të deklaruar të futur në thonjëza, apo që njihet edhe si ligjëratë e drejtë. Por lëvizja e kryefjalës, siç është dëshmuar edhe më herët, paraqitet edhe në fjalinë (21) '***A**_door opened and **a woman** with a lamp came out./U hap **një derë** dhe **jashtë saj** doli **një grua** me një fener.*' brenda sifjalisë me dy kryepërbërës. Këtu, përveç lëvizjes së kryefjalës pas foljes, mund të shihet se është përdorur diateza pësore në gjuhën shqipe në njërën nga foljet. Me përdorimin e diatezës pësore dihet që kryefjala dhe kundrinori ndryshojnë rolet. Në fjalinë e përbërë me bashkërenditje kemi në dy raste kryefjalë dhe kallëzues në gjuhën angleze '*A door opened and a woman with a lamp came out.*'. Në të dy rastet emrat në gjuhën angleze janë kryefjalë dhe ky pohim nuk është i diskutueshëm për shkak të rregullës themelore se në gjuhën angleze kryefjala qëndron para foljes.

Në tabelën nr. 3 si pjesë e fjalive të cilat kanë strukturë të njëjtë kryesisht gjenden shprehjet ose fjalitë e paplota. Duke u nisur nga vetë fakti se bëhet fjalë për fjali me numër minimal përbërësish, edhe mundësitë për të pasur dallime janë më të vogla, me përjashtim të fjalive thirrmore ose shprehjeve.

Së fundi, nga shembujt e dhënë në të tre pjesët e kreut IV kishte raste ku dallimet kryesisht kanë rezultuar për shkak të përkthimit. Përdorimi i foljeve të tjera ka qenë arsyeja e dytë më e madhe pse fjalitë nuk kanë pasur strukturë apo rend të njëjtë në të dyja gjuhët. Por ka pasur edhe raste kur parafrazimi apo ndryshimet strukturore kanë qenë të imponuara për shkak të krijimit të fjalive kuptimplota. Të gjitha bashkë kanë kontribuar për të pasur ndryshime strukturore.

KREU V

ANALIZË E PYETËSORIT ME FJALI TË PËRKTHYERA NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHËN ANGLEZE DHE ANASJELLTAS

5.1 Hyrje

Kreu V mbështetet në shtojcën B ku është dhënë pyetësi i realizuar me 115 pjesëmarrës. Nga 115 pjesëmarrës, 91 janë studentë universitarë të gjuhës angleze dhe të shkencave sociale dhe 24 profesorë universitarë me njohje të mirë të gjuhës angleze ose mësimdhënës të gjuhës angleze në shkolla fillore dhe të mesme. Pyetësi ka gjithsej 21 pyetje dhe është ndarë në katër pjesë. Në pjesën e parë pjesëmarrësit është dashur të gjejnë përgjigjen e saktë në 6 pyetje që lidhen me emra përmbledhës, emra të numërueshëm dhe përemra të pacaktuar. Në pjesën e dytë janë dhënë fjali nga vepra ‘*Aventurat e Sherlok Holmsit*’, ku pjesëmarrësit kanë pasur të dhënë fjalinë në gjuhën angleze ose në gjuhën shqipe dhe duhet të gjejnë numrin e foljes. Në pjesën e tretë të pyetësit ka pasur fjali nga libri universitar i shkencave natyrore ‘*Environmental Biotechnology*’ i cili është i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Në këtë pjesë studentëve u janë dhënë fjali vetëm në gjuhën angleze dhe është dashur të gjejnë numrin e foljes, ose në rastet e tjera kanë pasur fjali në gjuhën angleze dhe është dashur të gjejnë përkthimin e saktë nga opsionet e dhëna në gjuhën shqipe që lidhen me funksionin dhe rendin. Pjesa e fundit e pyetësit është mbështetur në fjali nga një libër tjetër universitar i shkencave të mjekësisë ‘*siRNA Design*’. Edhe këtu, si në pjesën e mëparshme, pjesëmarrësit duhet të gjejnë numrin e saktë të foljeve ose përkthimin e saktë në bazë të fjalive të dhëna që ka të bëjë me funksionet sintaksore dhe rendin e fjalëve në fjali. Në rastet e kryefjalës së zbrazët është analizuar edhe roli i kundrinorit mbi numrin e foljes pasi që kryefjala në rastet e tilla nuk ndikon në numrin e foljes në gjuhën angleze. Ndarja e pyetësit në katër pjesë është bërë me qëllim, dhe ngaqë fjalitë nuk janë të fushave të njëjta.

Fjalitë e dhëna në pyetësor janë përzgjedhur gjatë analizës së tekstit pasi është vërejtur se janë hasur disa dallime të qarta ndërmjet dy fjalive. Numri i foljes normalisht që varet nga numri i kryefjalës, por në raste të caktuara ka pasur ndikim fjala vijuese pas kallëzuesit (që në raste ka mundur të jetë kallëzues emëror ose kundrinor) që ka pasur ndikim për një përgjigje ndryshe. Më saktë, kreu V është ndarë në katër pjesë për të bërë diferencimin e shembujve. Prapëseprapë, qëllimi i katër pjesëve është i njëjtë, pra, të gjenden ngjashmëritë dhe dallimet kur përdoren emra përmbledhës, përemra të pacaktuar, ose kur një kryefjalë mund të marrë folje ose në numrin njëjës, ose në numrin shumës, ose në të dy numrat. Qëllimi dytësor i këtij pyetësi ka qenë të shihet niveli i njohjes së gjuhës angleze, pse jo edhe gjuhës shqipe, nga studentët dhe mësimdhënësit.

5.2 Analizë e fjalive me emra përmbledhës dhe përemra të pacaktuar të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas

Në shtojcën B (pjesa 1) janë dhënë fjali më të përgjithshme sesa në tre pjesët e tjera. Bëhet fjalë për fjali me emra përmbledhës dhe një përemër të pacaktuar. Në këtë pjesë fjalitë nuk janë nga ndonjë vepër letrare, ose nga fushat teknike a mjekësore, dhe konsiderohen fjali më të lehta për të gjetur përgjigjen e saktë. Fjalitë lidhen me problematikat e hasura gjatë analizës së fjalive në pjesën teorike të këtij disertacioni.

Në pyetjen e parë pjesëmarrësit kanë pasur si mundësi zgjedhjeje dy numra foljesh, në njëjës dhe në shumës, gjegjësisht: *'The team HAS/HAVE won five of the last ten games'*. Këtu bëhet fjalë për emrin përmbledhës *'team'* apo *'ekip'*. Në bazë të rezultatit të pyetësorit rezulton që 48 studentë kanë zgjedhur *'has'* dhe 43 *'have'*. Në anën tjetër, 20 mësimdhënës kanë zgjedhur *'has'* dhe 4 *'have'*. Për lehtësi studimi dhe analizë të figurave, përgjigjet e sakta janë nënvizuar në të gjitha figurat e dhëna në vijim. Të intervistuarit nuk i kanë pasur përgjigjet e sakta gjatë plotësimit të pyetësorit. Në çdo figurë janë inkorporuar nga dy figura me qëllim të krahasimit të rezultateve. Figura e parë me simbolin (S) tregon se është plotësuar nga ana e studentëve, ndërsa me simbolin (M) nga ana e mësimdhënësve.





Figura 1. Fjali dëftore me emër përmbledhës me folje në numrin njëjës.

Përgjigjja e saktë në këtë fjali është '*has*', për shkak se emri përmbledhës '*team*' apo '*ekip*' konsiderohet si një gjë e vetme, si unitet, si një gjë e pandashme që fiton diçka. Me këtë emër përmbledhës në këtë fjali nuk merren parasysh individët, prandaj edhe folja duhet të jetë në numrin njëjës. Në bazë të përqindjeve mund të shihet se shumica e mësimeve kanë qenë të

saktë në përgjigjen e tyre, por jo shumica e studentëve. Përqindja përafërsisht mesatare tregon se studentët nuk e bëjnë qartë dallimin kur flitet për një tërësi, ose për diçka të përbërë nga më shumë pjesë përbërëse, në këtë rast individë.

Fjala e dytë është jo shumë ndryshe nga fjalia e parë në fig. 1 dhe kjo fjali është dhënë qëllimisht në pyetësor. Qëllimi i pyetjes së dytë është se i njëjti emër përmbledhës mund të marrë edhe folje në numrin shumës, në këtë rast ‘*have*’. Bëhet fjalë sërish për emrin ‘*team*’ apo ‘*ekip*’, por në konotacion tjetër. Kur në fjali përdoret një emër përmbledhës, është shumë e rëndësishme të bëhet dallimi nëse flitet për individë apo një tërësi, pasi kjo përcakton numrin e foljes në fjali. 55 studentë dhe 12 mësimdhënës në këtë fjali kanë zgjedhur numrin njëjës të foljes (‘*has*’), ndërsa 36 studentë dhe 12 mësimdhënës kanë zgjedhur ‘*have*’.






Figura 2. Fjali dëftore me emër përmblendhës me folje në numrin shumës.

Ajo çfarë bie në sy këtu janë mospërputhjet e përqindjeve. Përderisa përgjigjet e gabuara janë të pritshme nga studentët, këtu habit përqindja e përgjigjeve të dhëna nga ana e mësimeve. Në fjalinë në fig. 2 emri përmblendhës ‘*team*’ ndryshon nga i njëjti emër në fig. 1 për shkak se këtu bëhet fjalë për pjesëtarët e ekipit, pra individët e jo për ekipin si një tërësi. Pra, anëtarët e ekipit e ‘*kanë*’ humbur besimin te trajneri. Në rast se fjalia do të ishte në gjuhën shqipe me emrin ‘*ekipi*’, atëherë situata do të ishte ndryshe pasi në gjuhën shqipe do të ishte përdorur folje në numrin njëjës. Kjo mospërputhje me siguri ndikohet edhe nga ideja se, po të ishte fjalia në gjuhën shqipe, situata do të ishte ndryshe, gjë që ka pasqyruar edhe dallimin më të madh të përqindjes.

Fjalia e tretë është dhënë sërish vetëm në gjuhën angleze, për të mos pasur ndikim njëra gjuhë në tjetrën, gjegjësisht përkthimi. Në këtë fjalë është dhënë një emër i numërueshëm, por që në gjuhën angleze mund të krijojë vështirësi me përdorimin e saktë të numrit të foljes, gjë që ndikon drejtpërdrejt në lidhjen kryefjalë – kallëzues. Nga numri i studentëve, 55 kanë zgjedhur ‘*is*’ dhe 36 ‘*are*’. Në anën tjetër, 20 mësimeve kanë zgjedhur ‘*is*’ dhe 4 ‘*are*’.





Figura 3. Fjali me emër të numërueshëm në gjuhën angleze.

Këtu, me përjashtim të 40% të studentëve të cilët kanë zgjedhur përgjigjen e gabuar, numri tjetër i mbetur, si dhe shumica e mësimeve të kanë gjetur saktë, pra 'is'. Këtu, me këtë emër të numërueshëm i cili është në numrin shumës për shkak se flasim për një njësi kohore, nuk mund të përdoret folje në numrin shumës dhe si këto raste janë edhe fjalitë me kryefjalë emra të

cilët tregojnë distancë, periudhë kohore, sasi ose para. Shembuj të ngjashëm janë dhënë në këtë pyetësor në pyetjen e katërt të pjesës së parë dhe pyetjen e parë dhe të tretë të pjesës së dytë.

Fjalitë e katërt dhe e pestë (fig. 4 dhe fig. 5) janë dhënë në gjuhën shqipe me qëllim që të intervistuarit ta kenë më të lehtë gjetjen e formave të sakta. Në të dyja fjalitë është dhënë emri ‘*minuta*’, por në kontekste të ndryshme. Varësisht nga konteksti, përgjigjja mund të jetë e ndryshme. Në fjalinë e katërt ‘*Pesë minuta _____ kohë e gjatë për të pritur. (është/janë)*’, 64 studentë kanë zgjedhur foljen ‘*është*’ dhe 27 ‘*janë*’, ndërsa 20 mësimdhënës kanë zgjedhur ‘*është*’ dhe 4 ‘*janë*’. Figura 4 ilustron përqindjet e përgjigjeve.




Figura 4. Fjali me emër të numërueshëm në gjuhën shqipe dhe folje në numrin njëjës.

Paraqitja vizuale e përgjigjeve me anë të diagrameve në fig. 4 tregon se përgjigjet kanë qenë të përafërta si te studentët, ashtu edhe te mësimdhënësit. Përgjigjja e saktë në këtë fjali është folja në numrin njëjës ‘*është*’, gjë që është për zgjedhur nga shumica e të intervistuarve, ndërsa një numër më i vogël ka dhënë përgjigje të gabuar.

Ashtu si në gjuhën angleze, ku një emër përmbledhës mund të marrë folje ose në numrin njëjës, ose në numrin shumës, edhe në fjalinë e pestë (fig. 5) kemi një rast të ngjashëm në gjuhën shqipe. Bëhet fjalë sërish për emrin e numërueshëm ‘*minuta*’, por këtë radhë duhet të ndiqet nga një folje në numrin shumës. Në fjalinë ‘*Nëse pesë minuta _____ shumë, atëherë mos pritni të humbni peshë. (është/janë)*’, 79 studentë kanë zgjedhur ‘*është*’ dhe 12 ‘*janë*’, si dhe 23 mësimdhënësit ‘*është*’ dhe 1 ka zgjedhur ‘*janë*’.





Figura 5. Fjali me emër të numërueshëm në gjuhën shqipe dhe folje në numrin shumës.

Fjalja e pestë paraqet një rast më të komplikuar në gjuhën shqipe. Themi kështu për shkak se normalisht me emrin e numërueshëm në shumës '*minuta*' dhe kallëzuesin emëror '*shumë*' duhet të kemi folje në numrin shumës '*janë*'. Ajo çfarë bie në sy është se pjesa dërrmuese e studentëve dhe mësimdhënësve kanë zgjedhur foljen në numrin njëjës '*është*'. Edhe pse në pamje të parë kjo mund të duket si një përgjigje e saktë, problemi qëndron te kallëzuesi emëror i cili tregon se diçka është '*shumë*' e jo një gjë apo një tërësi. Për ta thjeshtësuar, imagjinoi fjalinë: '*Pesë minuta është/janë shumë.*' Në këtë rast, me siguri, të intervistuarit do ta kishin më të lehtë gjetjen e dallimit dhe do të vërenin se folja normalisht duhet të jetë në numrin shumës për të pasur përshtatje të kryefjalës dhe kallëzuesit.

Fjalja e fundit në pjesën e parë të pyetësorit është dhënë vetëm në gjuhën angleze, sërish me qëllim që të mos ndikohen të intervistuarit nga përkthimi. Në këtë fjali është përdorur një përemër i pacaktuar '*everyone*' apo '*secili*', i cili për të intervistuarit mund të krijojë vështirësi nëse duhet të përdoret me folje në numrin njëjës apo në shumës. Përemri '*everyone*', ashtu si në gjuhën shqipe, kërkon folje në njëjës, pra '*everyone has*' ose '*secili ka*'. Problemi paraqitet atëherë kur ky përemër konsiderohet si shumë individë të një grupi dhe bëhet ngatërresa me përemrin vetor '*ata/ato*' i cili kërkon folje në numrin shumës.

6. Everyone _____ their own opinions!
(has/have) (S)



6. Everyone _____ their own opinions! (has/have)
(M)




Figura 6. Fjali me përemër të pacaktuar me folje në numrin njëjës.

Përderisa 20 nga 24 mësimdhënës kanë përzgjedhur opsionin e saktë '*has*', përqindja nuk është e njëjtë me studentët. Pra, mund të shihet se përafërsisht gjysma e studentëve kanë zgjedhur opsionin e gabuar '*have*', ose më saktë 43 studentë. Këtu kundrinori, megjithëse është në numrin shumës, nuk ka asnjë ndikim mbi foljen. Është rregull gramatikore se kryefjala është faktori i cili ndikon në numrin e kallëzuesit, e jo kundrinori. Sikur ky përemër të përdorej në një

fjali, të themi me rrethanor, si në *'Everyone is/are here.'*, atëherë jemi të sigurt se përqindja te studentët do të ishte shumë më ndryshe dhe do të kishin zgjedhur saktë *'is'*.


5.3 Analizë e fjalive nga vepra *'Aventurat e Sherlock Holmsit'* të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe

Fjalitë në pjesën 5.2 më lart janë fjali të cilat mund të hasen në komunikim të përditshëm. Ndarja e pyetësorit në katër pjesë është bërë me qëllim të diferencimit të fjalive, gjegjësisht se cilës fushe i përket. Në këtë pjesë janë përzgjedhur me kujdes disa fjali nga vepra e analizuar në kreun e katërt *'Aventurat e Sherlock Holmsit'*. Kjo gjë nuk është përsëritje e kreut IV, sepse këtu nuk bëhet analizë e fjalive të përkthyer, por analizë e përgjigjeve nga ana e studentëve dhe mësimeve, si dhe gjetja e arsyeve përse kanë zgjedhur një përgjigje të caktuar.

Janë përzgjedhur me kujdes pesë fjali (tre në gjuhën angleze dhe dy në gjuhën shqipe), por fjalitë këtu janë dhënë vetëm në një gjuhë, ose në gjuhën angleze ose në gjuhën shqipe pa e pasur përkthimin e fjalisë përkatëse. Përkthimi është fakt se mund të ndikojë në zgjedhjen e përgjigjes, prandaj këtu punën kryesore e ka bërë studenti/mësimdhënësi pa pasur fjalinë e përkthyer për ta ndihmuar, apo edhe për ta ngatërruar që të zgjedhë përgjigjen e gabuar.

Në fjalinë e parë kryefjala është emri i numërueshëm në numrin shumës *'pounds'* apo *'funte'*. Pjesëmarrësit kanë pasur si opsion foljen këpujore në numrin njëjës *'was'* ose në shumës *'were'*. Nga 115 pjesëmarrës në pyetësor, përgjigjet ishin si në vijim:

1. Four pounds a week ____ a small expense as they were going to rob thousands of pounds. (was/were) - (S)



1. Four pounds a week ____ a small expense as they were going to rob thousands of pounds. (was/were) - (M)





Figura 7. Fjali në gjuhën angleze me emër të numërueshëm në shumës me folje në njëjës.

Në fjalinë e parë mund të shihet qartë se shumica e studentëve kanë dhënë përgjigje të gabuar, 29 'was' dhe 62 'were'. Në anën tjetër, ka pasur edhe disa mësimdhënës, më saktë 8 të cilët kanë zgjedhur përgjigjen e gabuar nga 16 të cilët kanë zgjedhur atë të saktën 'was'. Kjo fjali është e ngjashme me fjalinë në fig. 3, ku jepen fjaltë të cilat tregojnë kohën apo paratë që e marrin foljen në numrin njëjës, edhe pse kryefjala mund të jetë formalisht në numrin shumës. Pra, kur

emri merret si një e tërë, edhe pse është në shumës, ai merr folje në numrin njëjës. Ky është një shembull tipik i mospërshtatjes së numrit të kryefjalës me kallëzuesin.

Fjala e dytë ‘*On a chair ___ a worn out black hat and some forceps. (was/were)*’ është shembull mjaft me interes për shkak të tipit të kryefjalës në gjuhën angleze. Vazhdimisht kemi thënë se kryefjala në gjuhën angleze qëndron në fillim dhe se rendi në gjuhën angleze është i fiksuar, me përjashtime shumë të vogla. Një përjashtim na paraqitet këtu, ku rrethanori ka dalë në fillim të fjalisë dhe kryefjala në fund të saj. Kjo lëvizje e gjymtyrëve në gjuhën angleze (më saktësisht e kryefjalës) ndikon në numrin e foljes, pavarësisht se kryefjala ka dalë në fund. Në këtë rast si përgjigje e saktë është folja në numrin shumës ‘*were*’, ngaqë kryefjala është e përbërë (nga dy gjëra) të lidhura me lidhëzën bashkërenditëse ‘*dhe*’ dhe kërkon folje në numrin shumës. Kjo lëvizje e gjymtyrëve ka qenë faktori kyç që ka ndikuar në përqindjen e madhe të përgjigjes së gabuar, si nga studentët, ashtu edhe nga mësimdhënësit. Të intervistuarit mund të jenë nisur nga ideja se ‘*on a chair*’ mund të ketë dalë në fillim të fjalisë dhe kryefjala duhej të ishte kryefjalë e zbrazëte shprehur me ‘*there (was/were)*’ dhe fjalia në atë rast do të ishte ‘*There was a worn out black hat and some forceps.*’. Por, siç u tha më lart, këtu kemi lëvizje të kryefjalës dhe një gjë e tillë nuk është e mundur. Përgjigje të gabuar ‘*was*’ kanë dhënë 68 studentë dhe 14 mësimdhënë, ndërsa të saktë ‘*were*’ 23 studentë dhe 10 mësimdhënë.







Figura 8. Fjali në gjuhën angleze me rend të anasjelltë.

Pra, ishte rendi i anasjelltë faktori i cili ka ndikuar në këtë përqindje më të lartë të përgjigjes së gabuar. Sikur fjalia të ishte me rend të drejtë, atëherë, me siguri, përqindja do të ishte ndryshe dhe do ta kishin më të lehtë për të përzgjedhur përgjigjen e saktë *'were'*.

Fjalia e radhës është fjalia e përkthyer në gjuhën shqipe nga fjalia e dhënë më lart në Fig. 7: *'Katër paundë në javë ___ shpenzim i vogël pasi do të vidhnin mijëra paundë. (ishte/ishin)'*. Përderisa për fjalinë e njëjtë në gjuhën angleze (fig. 7) përdoret folje në numrin njëjës, në fjalinë e përkthyer në veprën *'Aventurat e Sherlok Holmsit'* është përkthyer me folje në numrin shumës. Edhe ne jemi të mendimit se folja duhet të jetë në numrin shumës për shkak se kemi emër të numërueshëm. Dallimi i vetëm është se në gjuhën angleze *para* (*'money'*) konsiderohet si një tërësi, ndërsa monedhat si me rastin e fjalës *'pound'* ose *'funte'* mund të marrin folje ose në numrin njëjës, ose në numrin shumës, varësisht nëse flitet për një tërësi ose jo. Në bazë të rezultateve shumica e studentëve dhe mësimdhënësve kanë dhënë përgjigjen e saktë *'ishin'*, gjegjësisht 57 studentë dhe 15 mësimdhënës, ndërsa 34 studentë dhe 9 mësimdhënës kanë zgjedhur opsionin *'ishte'*.

3. Katër paundë në javë ___ shpenzim i vogël pasi do të vidhnin mijëra paundë. (ishte/ishin) - (S)



3. Katër paundë në javë ___ shpenzim i vogël pasi do të vidhnin mijëra paundë. (ishte/ishin) - (M)




Figura 9. Fjali në gjuhën shqipe me emër të numërueshëm në shumës me folje në shumës.

Për dallim nga fig. 7 ku studentët nuk e kanë gjetur opsionin e saktë në gjuhën angleze, në gjuhën shqipe e kanë pasur shumë më të lehtë dhe përqindja prej 63% tregon se shumica e kanë të qartë lidhjen kryefjalë – kallëzues dhe përshtatjen e numrit të foljes.

Në fjalinë e katërt është dhënë përkthimi i fjalisë së fig. 8 e cila është: ‘Mbi një karrige ___ një kapele e zezë e vjetëruar dhe disa pinca. (ishte/ishin)’. Edhe këtu, ngjashëm si me fig. 9 ku studentët dhe mësimdhënësit e kanë më të lehtë të gjejnë përgjigjen në gjuhën amtare, përqindja

tregon se shumica kanë përdorur foljen ‘*ishte*’. Arsyeja për këtë është dhënë në kreun IV ku ndikimi i kryefjalës me kokë emër në numrin njëjës ka bërë që folja të jetë në numrin njëjës. Në bazë të përgjigjeve, shumica kanë zgjedhur përgjigjen ‘*ishte*’ (77 mësimdhënës/14 studentë) dhe më pak kanë dhënë përgjigje ‘*ishin*’ (14 studentë/10 mësimdhënës). Por ajo çfarë është e rëndësishme këtu është se të dy foljet janë të mundshme dhe nuk mund të flasim për përgjigje të saktë ose të gabuar.





Figura 10. Fjali në gjuhën shqipe me rend të anasjelltë

Këtu habit përqindja pothuajse mesatare e përgjigjeve të mësimdhënësve në krahasim me përgjigjen e studentëve. Ndikim, me siguri, ka pasur lëvizja e gjymtyrëve dhe me siguri nuk e

kanë analizuar më thellë efektin e lëvizjes së gjymtyrëve mbi numrin e foljes. Sikur fjalia 4 në fig.10 të kishte rend të drejtë, atëherë folja logjikisht do të duhej të jetë në numrin shumës.

Fjalia e fundit në pjesën e dytë është fjali me emrin e panumërueshëm në gjuhën angleze ‘news’ apo ‘lajm(e)’. Përderisa në gjuhën angleze ‘news’ ka formën e njëjtë për një apo shumë lajme, në gjuhën shqipe emri ‘lajm’ ka edhe shumësin ‘lajme’. Fjalia e nxjerrë nga vepra ‘Aventurat e Sherlok Holmsit’ për të analizuar përgjigjet është: ‘The news ___ not good. (is/are)’. Me emrin e panumërueshëm ‘news’ në gjuhën angleze lidhet folje në numrin njëjës. Në versionin në gjuhën angleze folja e përdorur është ‘is’. Në bazë të pyetësorit, shumica e studentëve kanë dhënë përgjigje të gabuar (21 për ‘is’/70 për ‘are’), ndërsa mësimdhënësit kanë qenë pak më të saktë (15 për ‘is’/9 për ‘are’), por jo mjaftueshëm. Forma e emrit e cila në pamje të parë duket si emër në shumës për shkak të mbaresës ‘s’ ka bërë studentët të mendojnë se drejtpërdrejt merr folje në shumës. Emrat si ‘news’ apo ‘information’ çdoherë marrin folje në numrin njëjës dhe përdorimi i saktë i tyre është deri diku tregues se sa dikush e njeh gjuhën angleze në të vërtetë.






Figura 11. Fjali me emër të panumërueshëm në gjuhën angleze.


Shembujt e përzgjedhur deri këtu kanë qenë të përgjithshëm, të cilët mund të hasen në komunikim të përditshëm dhe në gjuhën letrare. Shembujt në pjesën vijuese janë fjali të një natyre tjetër, pra, të shkencave natyrore, dhe janë dhënë për të parë nëse të intervistuarit janë në gjendje të gjejnë përgjigjet e sakta nga fjali disi më të vështira për shkak të terminologjisë dhe fjalorit më të vështirë.

5.4 Analizë e fjalive nga libri ‘*Environmental Biotechnology*’ të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe

Fjalitë në këtë pjesë janë marrë nga teksti universitar ‘*Environmental Biotechnology*’ i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Në këtë tekst janë hasur disa raste me kryefjalë homogjene, kryefjalë në njëjës dhe kallëzues emëror në shumës, fjalë të cilat mund të ngatërrohen (nga që kanë formë të njëjtë si emër, ashtu edhe si folje) dhe kryefjalë të zbrazët në gjuhën angleze. Fjalitë në këtë pjesë kanë qenë të ndryshme, gjegjësisht në disa raste të intervistuarit e kanë pasur fjalinë e përkthyer në gjuhën shqipe, ndërsa në raste të tjera e kanë pasur vetëm fjalinë në gjuhën angleze dhe duhet të zgjedhin përgjigjen e duhur.

Në fjalinë e parë është dhënë përkthimi në gjuhën shqipe ('*Shkathhtësia dhe përshtatja e bakteres **bazohet** në ekzistencën e plazmideve katabolike.*') dhe të intervistuarit është dashur të gjejnë numrin e saktë të foljes (*The versatility and adaptability is/are based on the existence of catabolic plasmids.*). Bëhet fjalë për kryefjalë homogjene dhe kallëzues emëror në numrin shumës. Në pamje të parë shihet se në gjuhën shqipe folja është në numrin njëjës, por në tekstin në gjuhën angleze, përveç rregullës ku kryefjala homogjene merr folje në numrin shumës, teksti kuptohet që ka qenë i redaktuar për gabime gramatikore dhe folja është në numrin shumës 'are'. Pra, këtu kemi një dallim për sa i përket numrit të foljes. Në gjuhën shqipe është përdorur folje në numrin njëjës në versionin e përkthyer, ngaqë të dy emrat e kryefjalës homogjene janë në numrin njëjës. Sikur emrat të ishin në shumës, atëherë edhe folja do të ishte në shumës. Por, nuk mund të themi se, edhe sikur folja në gjuhën shqipe të ishte në numrin shumës, do të ishte gabim. Faktikisht, në gjuhën shqipe të dy format janë të mundshme për dallim nga gjuha angleze, por ne për bazë kemi marrë tekstin e përkthyer.

1. The versatility and adaptability of bacteria _____ based on the existence of catabolic plasmids. (is/are) - (S)







Figura 12. Fjali me kryefjalë të përbërë dhe folje në numrin shumës në gjuhën angleze.

Në bazë të rezultateve mund të shihet një përqindje pothuajse e njëjëtë ndërmjet studentëve dhe mësimeve, por kanë dhënë përgjigje të gabuar. Përgjigje të saktë nga studentët kanë dhënë vetëm 31 nga 91 dhe 9 nga 24 mësimeve. Ndikimi i fjalisë në gjuhën shqipe, me siguri, ka pasur efekt të pakundërshtueshëm në vendimin e tyre për të përzgjedhur folje në numrin njëjës, sepse shqip më e natyrshme do të ishte të thuhej *‘Shkathtësia dhe përshtatja e bakteres bazohet në ekzistencën ...’*.

Fjalja e dytë është shembull i një fjalie jotipike në gjuhën angleze me të cilën mund të ballafaqohemi. Në fjalinë me kryefjalë në numrin njëjës dhe kallëzues emëror i shprehur nga një sintagmë emërore me kokë një emër në numrin shumës, folja është në numrin shumës. Këtu, të intervistuarit e kanë pasur më të lehtë të gjejnë përgjigjen e saktë në gjuhën angleze, krahasuar me fjalinë e përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe, ku kryefjala është vënë në numrin shumës për t’u përshtatur me kallëzuesin emëror në numrin shumës. Pra, fjalia *‘Arsyet në njërin anë ishin kushtet specifike të çdo lokacioni të deponisë, p.sh., klima, mbulesa e sipërfaqes, përbërja e mbetjeve dhe efektet frenuese’* në gjuhën angleze është *‘One reason was the specific conditions of each landfill site, e.g., the climate, the surface cover, the waste composition, and inhibition effects.’*. Dallimi i qartë i kryefjalës dhe kallëzuesit e ka bërë më të lehtë për të intervistuarit të gjejnë përgjigjen e saktë *‘was’* dhe të mos përdorin foljen *‘were’*.

2. One reason ____ the specific conditions of each landfill site, e.G., The climate, the surface cover, the waste composition, and inhibition effects. (was/were) - (S)



2. One reason ____ the specific conditions of each landfill site, e.G., The climate, the surface cover, the waste composition, and inhibition effects. (was/were) - (M)





Figura 13. Fjali me kryefjalë në njëjës dhe kallëzues emëror në shumës.


Në bazë të rezultateve, 68 studentë kanë zgjedhur 'was' dhe 23 'were'. Në anën tjetër, 14 mësimdhënës kanë dhënë përgjigjen e saktë 'was' dhe 10 të gabuar 'were'. Këtu na shqetëson fakti që studentët kanë qenë më të saktë në përgjigjet e tyre sesa mësimdhënësit, por, meqenëse pothuajse më shumë se gjysma e mësimdhënësve të intervistuar nuk janë mësimdhënës të gjuhës angleze, kjo ka bërë që të ketë gabime në përgjigjet e tyre, megjithatë nuk mund të justifikohet në asnjë mënyrë.

Gjatë përkthimit nga një gjuhë në një gjuhë tjetër mund të ndodhë që një emër ose folje të ketë formën e njëjtë dhe mbaresat e njëjta. Kjo, në raste të rralla, mund të ndikojë në identifikimin e gabuar të pjesëve të ligjëratës, madje edhe të funksioneve sintaksore. Fjalja e mëposhtme është shembull tipik se si përkthyesi mund të bëjë një gabim të tillë: ‘*According to German standards for COD in the leachate, **the estimation results** in a period of 80-360 years, with a mean of 140 years, until the limiting concentration of 200 mg O₂ L⁻¹ is reached*’. Të intervistuarve u janë dhënë dy mundësi: ‘Në bazë të standardeve gjermane për COD, REZULTATET E VLERËSIMEVE NË/VLERËSIMI REZULTON ME një periudhë prej 80–360 viteve, me mesatare prej 140 vitesh, derisa të arrihet përqendrimi limitues prej 200 mg O₂ L⁻¹’:
a) ‘... rezultatet e vlerësimeve në një periudhë ...’ dhe b) ‘vlerësimi rezulton me një periudhë’. Për të gjetur përgjigjen e saktë kuptohet që duhet të analizohet mirë fjalia. Tendenca për të shpejtuar ka qenë faktor në përzgjedhjen jo të saktë nga ana e studentëve, ndërsa mësimdhënësit në këtë rast kanë qenë më të saktë.

3. 'According to German standards for COD in the leachate, the estimation results in a period of 80–360 years, with a mean of 140 years, until the limiting concentration of 200 mg O₂ L⁻¹ is reached' - (S)



3. 'According to German standards for COD in the leachate, the estimation results in a period of 80–360 years, with a mean of 140 years, until the limiting concentration of 200 mg O₂ L⁻¹ is reached' - (M)




■ rezultatet e vlerësimeve në ■ vlerësimi rezulton me

Figura 14. Përkthim i varur nga identifikimi i saktë i pjesëve të ligjëratës.

Në bazë të përqindjeve, 45 studentë kanë zgjedhur mundësinë e parë përballë 46 studentëve të cilët kanë zgjedhur përgjigjen e saktë, ndërsa në përqindjen e mësimdhënësve shihet se pjesa më e madhe kanë dhënë përgjigje të saktë 'vlerësimi rezulton me ...'. Konteksti në këtë fjali luan rol të rëndësishëm për të gjetur përgjigjen e saktë, kështu që ai ka qenë një faktor kyç. Themi kështu, sepse në bazë të kontekstit mund të shihet se për cilën pjesë të ligjëratës bëhet fjalë dhe çfarë funksioni sintaksor ka.

Fjali e ngjashme me fjalinë në fig. 14 është edhe fjalia e radhës, ku përkthyesi mund të ngatërrojë një fjalë, duke e konsideruar si kryefjalë të shprehur me kokë emërore ose kallëzues të shprehur me folje. Për fjalinë 'pH increases from buffer level controlled by VFA to one more characteristics of the bicarbonate system' të intervistuarve u janë dhënë dy mundësi: 'pH RRITET/RRITJET nga niveli i buferit të kontrolluar nga VFA në një karakteristikë tjetër të sistemit të biokarbonatit.': a) 'pH rritet nga niveli i buferit...' dhe b) 'pH rritjet nga niveli i buferit...'. Shumica e të intervistuarve kanë vërejtur se opsioni i dytë nuk përmban në vete folje/kallëzues dhe është opsion i gabuar. Zgjedhjen e saktë 'rritet' e kanë dhënë 69 nga 91 studentë dhe 19 nga 24 mësimdhënës.

4. pH increases from buffer level controlled by VFA to one more characteristics of the bicarbonate system. (pH rritet/pH rritjet) - (S)



4. pH increases from buffer level controlled by VFA to one more characteristics of the bicarbonate system. (pH rritet/pH rritjet) - (M)





Figura 15. Identifikimi i saktë i gjymtyrës varet nga struktura dhe konteksti i fjalisë.

Përqindja e lartë e përgjigjes së saktë ‘rritet’ nga të dy palët e të intervistuarve tregon se kanë qenë të vëmendshëm dhe se e kanë vërejtur se duhet të zgjedhin foljen dhe jo emrin për shkak se pa folje fjalia nuk do të kishte kallëzues dhe nuk do të ishte fjali e saktë në aspektin gramatikor.

Në pyetjen e fundit është zgjedhur një fjali me kryefjalën ‘there’ në gjuhën angleze. Kjo konsiderohet kryefjalë e zbrazët dhe përdorimi i saj është përmendur në kreun paraprak. Qëllimi

pse është dhënë kjo fjali me këtë lloj kryefjale në pyetësor, është lidhja e kryefjalës dhe kallëzuesit. Në fjalinë ***‘There are also a series of internal factors directly related to the way microorganisms develop and work.’***, të intervistuarit kanë pasur dy mundësi: a) *‘Ekziston edhe një seri faktorësh të brendshëm që janë drejtpërdrejt të lidhur me mënyrën e zhvillimit dhe funksionimit të mikroorganizmave’* dhe b) *‘Ekzistojnë edhe një seri faktorësh të brendshëm që janë drejtpërdrejt të lidhur me mënyrën e zhvillimit dhe funksionimit të mikroorganizmave.’*. Fjala në tekstin e përkthyer, që konsiderohet edhe përgjigje e saktë, është *‘ekziston’*. Për ta thjeshtuar arsyen pse *‘ekziston’* është përgjigje e duhur dhe jo *‘ekzistojnë’*, e krahasojmë me mundësinë e përdorimit të foljeve *‘ka’* dhe *‘kanë’*. Emri *‘seri’* kërkon folje në numrin njëjës, për shkak se në trajtën e pashquar si në njëjës ashtu edhe në shumës ka formën e njëjtë dhe vetëm në trajtën e shquar në shumës themi *‘seritë’* dhe mund të themi *‘Ka një seri ...’*, por jo *‘Kanë një seri ...’*. Si rrjedhim, folja *‘ekziston’* është dhënë si opsion i saktë vetëm nga 34 studentë për dallim nga 57 të cilët kanë zgjedhur opsionin *‘ekzistojnë’*. Në anën tjetër, edhe te mësimdhënësit është vërejtur se vetëm 8 kanë zgjedhur opsionin *‘ekziston’*, kurse 16 janë vendosur për opsionin *‘ekzistojnë’*.






Figura 16. Kryefjalë e zbrazët në gjuhën angleze.


Përqindja e madhe e të intervistuarve që kanë dhënë përgjigjen e gabuar, me siguri, është ndikuar nga fjalia në gjuhën angleze dhe kanë përzgjedhur drejtpërdrejt foljen në numrin shumës, pa e analizuar mirë fjalinë dhe emrin ‘series’. Por, ndodh që fjala e njëjtë ‘seri’ në trajtën e pashquar të marrë folje në numrin shumës, si në shembullin ‘*Ekzistojnë seri faktorësh që ndikojnë në këtë fenomen.*’. Dallimi në krahasim me fjalinë në fig. 16 është se këtu nuk kemi theksim të trajtës së pashquar, siç është në rastin kur thuhet ‘*një seri*’. Përdorimi i nyjës ‘një’ na detyron që të përdorim foljen në numrin njëjës. Faktor tjetër plotësues është edhe ajo se ‘seri’ mund të konsiderohet si një njësi dhe jo si diçka e ndarë në shumë pjesë. Kur diçka konsiderohet si një njësi, atëherë edhe foljen e kërkon në numrin njëjës.

5.5 Analizë e fjalive nga libri ‘*siRNA Design*’ të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe

Pjesa e fundit e këtij kreu përmban pesë fjali të përzgjedhura nga teksti universitar ‘*siRNA Design*’, i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Ky tekst i përket fushës së biologjisë dhe mjekësisë, por fjalitë e përzgjedhura në pyetësor janë të ngjashme si në pjesën 5.4, me

dallime të caktuara. Në këtë pjesë të intervistuarit është dashur të gjejnë përgjigjen e saktë të gjuhës angleze kur fillimisht u është dhënë fjalia e përkthyer në gjuhën shqipe. Qëllimi i kësaj pjese ka qenë të shihet nëse fjalia e përkthyer ka ndikim në përgjigjen e tyre, gjegjësisht nëse janë përqendruar vetëm në fjalinë në gjuhën angleze, apo ndikim ka pasur fjalia e përkthyer në gjuhën shqipe.

Në pyetjen e parë *‘Ekziston një numër i veglave statistikore të cilat mund të jenë të dobishme për vlerësimin e performancës së algoritmeve të rreshtuara më lart.’* të intervistuarit kanë pasur dy zgjedhje: a) *‘There is a number of statistical tools which can be helpful for evaluating the performance of the algorithms listed above.’* dhe b) *‘There are a number of statistical tools which can be helpful for evaluating the performance of the algorithms listed above.’*. Në versionin e redaktuar në gjuhën angleze përdoret folja në numrin shumës, përkundër asaj që pas foljes kemi emër në numrin njëjës *‘number’*. Por ky emër është kokë e sintagmës emërore që njëkohësisht ka sintagmë parafjalore (dhe brenda sintagmës parafjalore ka emër në numrin shumës *‘tools’*). Është ndikimi i emrit *‘tools’*, i cili është në shumës, që bën që në gjuhën angleze folja të jetë në numrin shumës, duke qenë se në këtë rast folja nuk varet nga kryefjala, ngaqë ajo është kryefjalë e zbrazët dhe numri i foljes varet nga fjala që vjen pas foljes – kundrinori. Situata ndryshon në gjuhën shqipe ku emri *‘numër’* na detyron të kemi kallëzues të shprehur me folje në numrin njëjës *‘ekziston’* dhe jo në numrin shumës.



1. Ekziston një numër i veglave statistikore të cilat mund të jenë të dobishme për vlerësimin e performancës së algoritmeve të rreshtuara më lart. - (M)




Figura 17. Fjali me kryefjalë të zbrazët në gjuhën angleze – mospërputhje e numrit.

Sipas përqindjeve, rezulton që 65 studentë kanë zgjedhur përgjigje të gabuar në krahasim me 26 studentë të cilët kanë zgjedhur përgjigjen e saktë *'there are'*. Në anën tjetër, 15 mësime dhënë kanë dhënë përgjigje të gabuar dhe 9 të saktë. Në fakt, kjo përqindje ka qenë e pritshme për shkak se kjo fjali mund të gjendet edhe me folje në numrin njëjës, por dallimi qëndron në atë se me folje në numrin njëjës specifikohet një grup i caktuar, ndërsa me folje në numrin shumës specifikohen përbërësit e një grupi. Prandaj, këtu përgjigja e saktë, pa asnjë dyshim, është *'there are'*. Sa për krahasim, nëse analizohet fjalia në fig. 16, mund të shihet se kemi një situatë të ngjashme, por me një dallim të vogël. Në fig. 16, emri *'series'* është emër i numërueshëm dhe në përkthim është *'seri'*, pra një seri. Situata e ngjashme është edhe në fig. 17 ku emri *'numër'* është në njëjës. Dallimi i vetëm është se emri *'series'* ka formë të njëjtë si për numrin njëjës ashtu edhe numrin shumës. Me foljen *ekziston* në gjuhën shqipe, ajo që ndjek është kryefjala e jo kundrinori. Po ta kthejmë emrin në trajtë të shquar, ai del në rasën emërore *'Ekziston numri, seria etj'*. Përveç kësaj, këtu si përkthim më i përshtatshëm në vend të fjalës *'veglave'* do të ishte përdorimi i fjalës *'mjeteve'*, por ky ndryshim nuk do të ndikonte në strukturën e fjalisë.

Në fjalinë e radhës të analizuar nga të intervistuarit kemi kryefjalë të shoqëruar nga përcaktori. Sërish, të intervistuarve u është dhënë fjalia në gjuhën shqipe *'Çiftet me disavantazh më të lartë është parashikuar se performojnë me më pak efikasitet gjatë PCR-së.'* dhe ata duhet

të gjejnë versionin e saktë në gjuhën angleze nga dy mundësi: a) *'Pairs with higher penalty is predicted to perform less efficiently during the PCR'* dhe b) *'Pairs with higher penalty are predicted to perform less efficiently during the PCR'*. Përgjigja e saktë është e dyta, për shkak se kryefjala me përcaktor përbëhet nga një emër në shumës dhe e gjitha mund të zëvendësohet me përemrin vetor *'They/Ata'*. Kjo e bën shumë të qartë fjalinë dhe përzgjedhjen e versionit të duhur, pra *'...are predicted...'*. Shumica e të intervistuarve kanë dhënë përgjigje të saktë në këtë fjali: 47 nga 91 studentë dhe 17 nga 24 mësime.






Figura 18. Kryefjalë me përcaktor.

Në këtë pyetje ka qenë e pritshme që mësimdhënësit të jenë më të saktë, ashtu si në të gjitha pyetjet, po të krahasohen përqindjet me studentët, kështu që edhe këtu pritshmëritë tona janë vërtetuar.

Fjalja e tretë është një fjali kushtore e cila është dhënë qëllimisht për shkak të gjatësisë së saj për të parë nëse të intervistuarit kanë qenë të vëmendshëm në përgjigjen e tyre. Në fjalinë e përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe ‘*Veç kësaj, edhe nëse frekuencat e plotësimit të farave janë të ulëta, nuk është e qartë se cili nga transkriptet e targetuara në të vërtetë është shuar.*’ të intervistuarit duhet të zgjedhin midis foljes në numrin njëjës ose në numrin shumës: a) ‘*Further, even if seed complement frequencies are low, it is not clear which of the targeted transcripts is really silenced*’ dhe b) ‘*Further, even if seed complement frequencies are low, it is not clear which of the targeted transcripts are really silenced*’. Kjo fjali është shumë e thjeshtë dhe e lehtë për të gjetur përgjigjen e saktë, por gjatë leximit të saj të intervistuarit ose e kanë humbur lidhjen logjike, ose automatikisht kanë marr si përgjigje të saktë versionin i cili është dhënë në fjalinë në gjuhën shqipe. Gjatë përkthimit të fjalive, ndonjëherë ndodh që të përdoret përshtatje dhe të mos përkthehet fjalë për fjalë. Rast i tillë është kjo fjali ku në gjuhën shqipe është përdorur folja në numrin njëjës, sepse nuk dihet se ‘cili’ është shuar, ndërsa në gjuhën angleze ndikim në numrin e foljes ka emri ‘*transcripts*’ i cili drejtpërdrejt kërkon folje në numrin shumës ‘*are*’. Përemri në gjuhën angleze nuk ka mundësi të ndikojë në numrin e foljes, siç kemi rastin në gjuhën shqipe.

3. Veç kësaj, edhe nëse frekuencat e plotësimit të farave janë të ulëta, nuk është e qartë se cili nga transkriptet e targetuara në të vërtetë është shuar. -
(S)



3. Veç kësaj, edhe nëse frekuencat e plotësimit të farave janë të ulëta, nuk është e qartë se cili nga transkriptet e targetuara në të vërtetë është shuar. -
(M)





Figura 19. Fjali kushtore.

Në bazë të përgjigjeve mund të shihet se më shumë studentë, gjegjësisht 63 prej tyre kanë dhënë përgjigje të gabuar 'is' dhe 28 të saktë 'are'. Mësimdhënësit kanë dhënë në përqindje përgjigje më të sakta, ku 13 kanë gjetur përgjigjen e saktë dhe 11 kanë dhënë përgjigje të gabuar. Përqindja më e madhe e gabimit të studentëve nuk ka si të shpjegohet ndryshe përveç se

përgjigjja e tyre është mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë në fjalinë në gjuhën shqipe dhe nuk janë përqendruar të analizojnë fjalinë në gjuhën angleze.

Në fjalinë e parafundit të intervistuarve u është dhënë fjalia në gjuhën angleze dhe dy përkthime të ndryshme. Bëhet fjalë për fjalinë ‘*Therefore, it is useful for constructing relatively **large numbers** of shRNA expression plasmids.*’ dhe përkthimet a) ‘Si rrjedhim, kjo është e dobishme për ndërtimin e **një numri** relativisht **të madh** të plazmideve të shprehjes së shARN-së.’ dhe b) ‘Si rrjedhim, kjo është e dobishme për ndërtimin e **numrave** relativisht **të mëdhenj** të plazmideve të shprehjes së shARN-së.’. Shprehjet ‘*large numbers*’ janë relativisht të rralla në gjuhën angleze, ashtu si edhe në gjuhën shqipe. Zakonisht përdoret shprehja ‘*number/numër*’ në numrin njëjës edhe kur flitet për shumë gjëra, si p.sh. ‘*një numër i madh fjalish/lojërash/opsionesh,*’ ose ‘*a large number of sentences/games/options*’. Por në tekstin e redaktuar në gjuhën angleze është përdorur ‘*numbers*’, ndërsa në gjuhën shqipe fjalia e përkthyer është përshtatur duke u përdorur ‘*një numri*’. Me një fjalë këtu kemi mospërputhje të numrit të emrit në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe dhe qëllimi ka qenë të shihet nëse ka ndikuar fjalia në gjuhën angleze në përgjigjet e të intervistuarve, ashtu siç ishte rasti me fjalitë në fig. 17 dhe fig. 19.







Figura 20. Fjali me shprehje të tipit ‘një numri’.

Përgjigjet në këtë pyetje na tregojnë një mospërputhje ndërmjet përgjigjeve të studentëve dhe mësimdhënësve. Shumica e studentëve (61 nga 91 studentë) kanë dhënë përgjigje të gabuar ‘numrave’, pjesa më e madhe e mësimdhënësve kanë dhënë përgjigje të saktë ‘një numri’, respektivisht 17 prej tyre nga totali 24. Kjo tregon se studentët kanë shkuar në përzgjedhje të drejtpërdrejtë pa e analizuar fjalinë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe duke mos e vënë re se përdorimi i emrit ‘numrave’, fjalinë në gjuhën shqipe e bën të mos tingëllojë bukur, për shkak të përdorimit edhe të mbiemrit ‘të mëdhenj’. Në raste të tilla ndikon në përshtatjen e fjalisë së përkthyer gjuha në të cilën përkthehet, ngaqë fjalia duhet t’i ngjajë një fjalie në gjuhën shqipe dhe të mos përdoret çdoherë dhe detyrimisht numri i njëjtë i emrave ose i foljeve si në rastet e mëhershme.

Edhe në fjalinë e fundit të këtij pyetësori është vërejtur përqendrimi i dobët i studentëve, në krahasim me përgjigjet e mësimdhënësve për shkak të gjatësisë së fjalisë. Përshtatja e përkthimit edhe këtu ka ndikuar që studentët të mbështeten në fjalinë e përkthyer dhe të zgjedhin numrin e foljes që është përdorur në fjalinë në gjuhën shqipe, pa e vërejtur se një gjë e tillë nuk është e mundur në gjuhën angleze. Kryefjala në shumës kërkon folje në numrin shumës. Këtu dallim paraqet folja ‘është raportuar’, e cila zakonisht në gjuhën shqipe përdoret në njëjës dhe forma në shumës ‘janë raportuar’ është më e rrallë. Në fjalinë ‘Në përgjithësi, efikasiteti i ARNi-së në qeliza dihet se është i varur nga sekuenca e regjionit të rrënjës dhe vetëm përafërsisht 30% e

siARN-ve të rëndomtë është raportuar se tregon ARNi shumë efikas në linjat e kultivuara të gjitarëve.’ të intervistuarit duhet të zgjedhin ndërmjet dy mundësive: a) ‘In general, RNAi efficiency in the cells is known to depend on the sequence of the stem region, and only approximately 30% of random siRNAs **HAS** been reported to show highly effective RNAi in cultured mammalian cells’ dhe b) ‘In general, RNAi efficiency in the cells is known to depend on the sequence of the stem region, and only approximately 30% of random siRNAs **HAVE** been reported to show highly effective RNAi in cultured mammalian cells.’.

5. Në përgjithësi, efikasiteti i ARNi-së në qeliza dihet se është i varur nga sekuenca e regjionit të rrënjës dhe vetëm përafërsisht 30% e siARN-ve të rëndomtë ËSHTË raportuar se tregon ARNi shumë efikas në linjat e kultivuara të gjitarëve. - (S)



■ 30% of random siRNAs HAS been reported to show highly effective RNAi ■ 30% of random siRNAs HAVE been reported to show highly effective RNAi

5. Në përgjithësi, efikasiteti i ARNi-së në qeliza dihet se është i varur nga sekuenca e regjionit të rrënjës dhe vetëm përafërsisht 30% e siARN-ve të rëndomtë ËSHTË raportuar se tregon ARNi shumë efikas në linjat e kultivuara të gjitarëve. - (M)




Figura 21. Përshtatja e numrit midis kryefjalës dhe kallëzuesit.

Si në fjalinë e parafundit, edhe në fjalinë e fundit, vërehet se studentët nuk i kanë kushtuar shumë rëndësi fjalisë në gjuhën angleze dhe, për gjetjen e përgjigjes së saktë, janë mbështetur vetëm në fjalinë në gjuhën shqipe. Kjo ka bërë që të pasqyrohet drejtpërdrejt me përqindje më të madhe të përgjigjeve të gabuara të tyre (61 kanë dhënë përgjigjen e gabuar ‘has’ dhe 30 kanë dhënë ‘have’) në krahasim me përgjigjet e mësimdhënësve ku pjesa më e madhe kanë dhënë përgjigje të saktë (15 kanë dhënë ‘have’ dhe 9 kanë dhënë ‘has’). Për këtë fjali në gjuhën shqipe është bërë përshtatje e saj duke thënë se një përqindje e caktuar (ose më saktë 30%) ‘është raportuar’ dhe jo ‘janë raportuar’. Në versionin e redaktuar në gjuhën angleze është marrë parasysh lidhja e kryefjalës dhe kallëzuesit për sa i përket numrit të foljes, prandaj edhe si përgjigje e saktë është ‘have been reported’.

Si rrjedhim, duke pasur parasysh se në disa pyetje të pyetësorit përgjigjet nuk kanë qenë në një vijë me pritshmëritë tona, duhet theksuar edhe njëherë se studentët universitarë nuk kanë qenë të ndarë në bazë të niveleve të njohjes së gjuhës angleze, pasi një ndarje e tillë nuk është aplikuar në universitetet ku është realizuar ky pyetësor. Në anën tjetër, në grupin e mësimdhënësve, përveç atyre të gjuhës angleze, këtë pyetësor e kanë plotësuar edhe profesorë universitarë të fushave të tjera, por me njohje të mirë të gjuhës angleze, meqenëse njohja e gjuhës së huaj është kusht për ligjërime. Tjetër faktor i pakontestueshëm ka qenë edhe fjalia në të cilën të intervistuarit janë mbështetur. Në rastet kur ata e kanë pasur fjalinë e përkthyer, të njëjtit

kanë zgjedhur opsionin siç ka qenë në fjalinë e parë, pa e analizuar më thellë kuptimin e fjalisë së përkthyer, ose, nëse fjalia e përkthyer ka strukturë që i përngjan gjuhës përkatëse. Më qartë, ndikimi i një gjuhe në tjetrën ka bërë që të intervistuarit në raste të caktuara të zgjedhin numrin e foljes siç ka qenë në fjalinë e parë. Fushat e ndryshme nga të cilat vijnë fjalitë kanë pasur ndikim shtesë mbi përgjigjet e të intervistuarve. Në fjalitë e gjata dhe më të komplikuara është vërejtur se të intervistuarit (më së shumti studentët) janë përqendruar vetëm në pjesën ku janë shënuar dallimet dhe nuk kanë bërë analizë më të thellë të fjalisë nëse përgjigjja e tyre ka logjikë ose nëse përputhet ose jo. Këto kanë qenë arsyet që përqindjet jo çdoherë kanë qenë të pritshme, prandaj edhe rezultatet kanë qenë në raste të caktuara të ndryshme dhe jashtë pritshmërive reale.

KREU VI

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

6.1 Përfundime të përgjithshme

Çështjet e diskutuara në këtë disertacion, si në pjesën teorike, ashtu edhe në pjesën praktike, nxjerrin në pah ngjashmëritë dhe dallimet sintaksore ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze. Dallimet sintaksore në raste të caktuara kanë qenë minimale, ndërsa në raste të tjera kanë qenë më të theksuara. Metodologjia dhe mjetet që janë përdorur në këtë disertacion paraqesin dy shtyllat kryesore, përveç pyetjeve studimore dhe hipotezave, pasi që ia kanë arritur qëllimit kryesor të përcaktuar që në fillim, krahasimin e strukturave të fjalive në gjuhën angleze me ato në gjuhën shqipe, kryesisht të lidhjes kryefjalë-kallëzues-kundrinor. Fokusi ynë ka qenë struktura e fjalive dhe rendi i gjymtyrëve në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nga përqsja e dy gjuhëve është vënë re se ka pasur mjaft raste ku fjalitë kanë strukturë/rend të njëjtë, por edhe strukturë/rend të ndryshëm. Duke u mbështetur në analizën e fjalive të teksteve ‘*Aventurat e Sherlock Holmsit*’, ‘*siRNA Design*’, ‘*Environmental Biotechnology*’ dhe fjalive të përzgjedhura nga burime të ndryshme, del se funksionet sintaksore të pjesëve të ligjëratës dhe rendi i gjymtyrëve në fjalitë në tekstet e analizuara dëshmojnë vërtetimin e hipotezave të këtij disertacioni.

Hipoteza e parë e këtij disertacioni ‘*Ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime gramatikore - sintaksore midis gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe për sa i përket strukturës së fjalisë së thjeshtë*’ është vërtetuar plotësisht duke iu referuar shembujve në krerët III, IV dhe V. Në bazë të tabelave 1, 2 dhe 3 në Shtojcën A mund të shihet se ka pasur fjali si me strukturë të njëjtë, ashtu edhe me strukturë të ndryshme. Më saktë, në tabelën 1, 95 fjali kanë pasur strukturë të njëjtë dhe 131 të ndryshme, në tabelën 2, 72 fjali kanë pasur strukturë të njëjtë dhe 119 të ndryshme dhe në tabelën 3, 13 fjali kanë pasur strukturë të njëjtë dhe 10 të ndryshme. Kjo dëshmon se përqindja

ka qenë përafërsisht e ngjashme në të treja tabelat në të cilat janë dhënë fjali me gjymtyrë të dyta të ndryshme.

Si dallime më të theksuara për sa i përket strukturës së fjalive të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në tekstin ‘*Aventurat e Sherlock Holmsit*’ janë:

- Kryefjala kur në anglishte është shprehur me përemër vetor, në shumë raste nuk është shkruar në gjuhën shqipe, sepse është kuptuar nga veta e foljes. Për dallim nga gjuha shqipe, kryefjala në gjuhën angleze, në bazë të tipologjisë së fjalive, është e domosdoshme dhe pavarësisht faktit se përemri vetor përsëritet, ai është i domosdoshëm të shkruhet. Raste tipike që vërtetojnë këtë pohim, janë përdorimi i kryefjalës së zbrazët të shprehur me ‘*there*’ ose ‘*it*’, të cilat janë përdorur për të plotësuar fjalitë kur nuk ka pasur një kryefjalë të vërtetë. Për të përshtatur fjalinë, përkthyesi ndonjëherë ka përdorur kryefjalë të vërtetë në gjuhën shqipe, duke ndikuar drejtpërdrejt në ndryshimin e strukturës dhe kuptimit të fjalisë.

- Trajta e shkurtër e përemrave vetorë përbën faktorin e dytë më të rëndësishëm në analizën e tekstit kur flasim për dallime strukturore. Trajta e shkurtër është përdorur në shqipe për të shprehur kundrinorin, por ka pasur disa raste kur përdorimi vetëm i trajtës së shkurtër dhe jo i përemrit të plotë në fjali ka ndikuar në humbjen e kuptimit të fjalisë së përkthyer. Madje, ka pasur edhe raste ku kryefjala në njërin anë nuk është shkruar dhe është kuptuar nga veta e foljes dhe kundrinori në anën tjetër është shprehur vetëm me trajtë të shkurtër dhe kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në kuptimin e fjalisë si në shembullin ‘*Now I know who it is./Tani e di kush është.*’

- Dallimi i tretë në tekstin e analizuar ka qenë mospërshtatja e kryefjalës dhe kallëzuesit, gjegjësisht numrit të emrit dhe të foljes. Pjesa dërmuese ku është identifikuar mospërshtatja e numrit të kryefjalës dhe kallëzuesit rezulton nga përkthimi i gabuar. Ka pasur vetëm dy raste ku numri i foljes është i ndryshëm (ndryshim i domosdoshëm) dhe atë për shkak të përemrit të pacaktuar (‘*Everybody **had** a different opinion until Holmes pointed to the centre of the circle./Të gjithë **kishin** mendime të ndryshme, derisa Holmsi tregoi në qendër të rrethit.*’) ku në gjuhën angleze folja është në njëjës dhe në gjuhën shqipe në shumës dhe kjo drejtpërdrejt ka ndikuar edhe në numrin e emrit me të cilin shprehet kundrinori i cili qëndron pas kallëzuesit në të dy fjalitë, si dhe emrit të numërueshëm, i cili, në gjuhën angleze të përdorur në Britani, merr folje në numrin njëjës dhe jo në shumës si në gjuhën shqipe (‘*Four pounds a week **was** a small expense as they were going to rob thousands of pounds./Katër paundë në javë **ishin** shpenzim i vogël pasi do të vidhnin mijëra paundë.*’).

- Është vërejtur se në raste të caktuara është përdorur folje e rregullt në vend të një foljeje këpujore dhe e kundërta, ose kalimtare në vend të një jokalimtareje dhe e kundërta. Në raste të tilla, siç është theksuar në kreun IV, struktura e fjalisë është prekur në mënyrë rrënjësore, duke ndikuar edhe në rendin e gjymtyrëve. Ky pohim rrjedh nga fakti se pas një foljeje këpujore vjen kallëzuesi emëror, ndërsa pas një foljeje të rregullt nuk kemi kallëzues emëror, por gjymtyrë tjetër të dytë.

Hipoteza e dytë është drejtpërdrejt e lidhur me titullin e disertacionit: *‘Ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime në rendin dhe lidhjen e kryefjalës-kallëzuesit-kundrinorit në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze’*. Kjo hipotezë është lënë qëllimisht e dyta sepse është vazhdimësi e pasqyrimin të ngjashmërive ose ndryshimeve strukturore të fjalive, gjegjësisht e hipotezës së parë. Duke u mbështetur në tekstin e përkthyer *‘Aventurat e Sherlock Holmsit’* mund të shihet se në të treja tabelat në shtojcën A ka raste ku ka pasur rend të njëjtë dhe rend të ndryshëm të kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit. Duke u mbështetur në përqindjet e rezultateve në kreun IV, mund të shohim se pak më shumë fjali kanë pasur rend të ndryshëm sesa ato që kanë pasur rend të njëjtë.

Rendi ruhet:

- Edhe në rastet kur mungon kryefjala, sepse ndryshon vetëm tipi i fjalisë dhe jo rendi i gjymtyrëve. Kjo sqarohet me atë se mungesa e kryefjalës nuk ndikon në pozitën e gjymtyrëve të dyta.

- Edhe pse trajta e shkurtër në gjuhën shqipe ka pozicion të ngulitur, ajo nuk ndikon në rendin e kundrinorit të shprehur me emër ose përemër.

Rendi nuk ruhet për shkak se.

- Nga totali i 417 fjalive në tabelën 1 dhe 2 në shtojcën A, rend të njëjtë kanë 167 fjali dhe 250 kanë rend të ndryshëm.

- Rendi i fjalive pyetëse dhe urdhërore është i ndryshëm nga rendi i fjalive dëftore.

- Në gjuhën angleze kundrinori, sipas rregullave, qëndron pas kallëzuesit, ndërsa në gjuhën shqipe kundrinorin mund ta gjejmë në pozicione të ndryshme për shkak të rendit kryesisht të lirë dhe mbaresave rasore. Kundrinori në tabelën 1 dhe 2 në shtojcën A ka qenë në pozicion të njëjtë në të dyja gjuhët në 349 raste dhe në pozicione të ndryshme në 68 raste. Me gjithë pohimin se lëvizja e gjymtyrëve në gjuhën shqipe është kryesisht e lirë, në fjalitë e përkthyer në gjuhën shqipe në veprën *‘Aventurat e Sherlock Holmsit’* kryesisht është ruajtur rend i njëjtë si në gjuhën

angleze. Gjithsesi, numri prej 68 rastesh me lëvizje të kundrinorit (normalisht të shprehur edhe me trajta të shkurtra) është tregues se ka dallime në rendin e gjymtyrëve.

- Përkthimi i ndryshëm i foljeve ka rezultuar me rend të ndryshëm të gjymtyrëve. Në disa raste është vërejtur se ndryshimi i foljes rezulton me gjymtyrë të ndryshme, ose më saktë, funksione të ndryshme sintaksore. Por, ka pasur edhe raste kur ka pasur lëvizje të vendit të gjymtyrëve në gjuhën shqipe pa ndryshuar funksionet sintaksore. Në raste të tilla, edhe përkundër lëvizjes së gjymtyrëve, kuptimi është ruajtur. Në përgjithësi, ndryshimet në fjalitë e përkthyer zakonisht bëhen për shkak të përshtatjes së kuptimit të fjalive dhe kjo përshtatje mund të ndikojë drejtpërdrejt në një pjesë të strukturës, gjithë strukturën ose edhe rendin e gjymtyrëve në fjali. Madje, në raste të caktuara ka ndikuar edhe në funksionin sintaksor të fjalëve. Por, nëse ruhet funksioni sintaksor, atëherë ruhet edhe kuptimi, si në fjalinë 139 në tabelën 2 (*'At the end of the day, it wasn't the police who hired me./Në fund të fundit, mua nuk më ka angazhuar policia.'*).

Hipoteza e tretë është e ngjashme me hipotezën e dytë, por dallon se nuk merr parasysh rendin e kundrinorit, por të gjymtyrëve të tjera të dyta që vijnë pas kryefjalës dhe kallëzuesit. Pra, në bazë të shembujve në kreun III dhe përqindjeve të shembujve të analizuar në tabelën 1, 2 dhe 3 në shtojcën A, mund të vijmë në përfundim se hipoteza *'Ekzistojnë disa dallime në rendin e gjymtyrëve në fjalitë e thjeshta në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze'* është e plotësisht e vërtetuar. Kjo hipotezë është vërtetuar, sepse, duke u mbështetur kryesisht në tabelën 2 të shtojcës A, mund të shohim se struktura/rendi i gjymtyrëve ka qenë i njëjtë në 72 fjali, ndërsa i ndryshëm në 119 fjali. Por, me më interes është rrethanori dhe pozicioni i rrethanorit në fjali. Është fakt i pamohueshëm se rrethanori është gjymtyra e cila lëviz më së shumti në fjali, por në tabelën 2 mund të shohim se rrethanori ka lëvizur vetëm në 18 fjali, ndërsa në 173 fjali ka qenë në vend të njëjtë në të dyja gjuhët. Në tabelën 2, përveç rrethanorit, janë analizuar edhe gjymtyrët e tjera të dyta, të cilat kanë ndikuar në përqindjen më të lartë të dallimeve strukturore ose të rendit të tyre në fjali. Kjo hipotezë mbështetet edhe në fjalitë e analizuar në tabelën 3, në shtojcën A, ku 13 fjali kanë pasur strukturë/rend të njëjtë dhe 10 strukturë/rend të ndryshëm. Shembujt ku ka pasur ndryshim të tipave të fjalive (nga fjali të paplota në fjali të plota), paraqesin raste domethënëse ku përkthimi me parafrazim është i domosdoshëm për të pasur fjali kuptimplotë.

E gjithë analiza e fjalive dhe e rendit të gjymtyrëve është mbështetur në fjalitë e përkthyer si nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, ashtu edhe anasjelltas. Hipoteza e katërt nuk është dhënë rastësisht në këtë disertacion, por është shumë e rëndësishme. Interferenca gjuhësore është analizuar në mënyrë plotësuese për të parë nëse ka ndikuar në strukturën ose rendin e gjymtyrëve në fjali. Hipoteza e katërt ‘*Gjuha angleze në raste të caktuara mund të ndikojë në rendin e gjymtyrëve apo në strukturën e fjalisë së përkthyer në gjuhën shqipe*’ është vërtetuar pjesërisht, duke u mbështetur në kreun IV dhe V të këtij disertacioni. Përderisa në veprën letrare të përkthyer ‘*Aventurat e Sherlock Holmsit*’ është vërejtur se përkthyesi në raste të caktuara ka vendosur të lëvizë gjymtyrët (kryesisht kryefjalën dhe kallëzuesin në vend të njëri-tjetrit, dhe kundrinorin e rrethanorin), në fjalitë e marra nga tekstet universitare, të analizuar në shtojcën B, lëvizja e gjymtyrëve është më e vështirë për shkak se ndikon në kuptimin e fjalisë dhe në raste të caktuara proceset e shpjeguara janë dhënë në mënyrë kronologjike. Në bazë të pyetësorit të analizuar në kreun V mund të shihet se në raste të caktuar të intervistuarit kanë qenë të ndikuar nga njëra gjuhë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë rrethuar përgjigjen siç u është dhënë shembulli në gjuhën angleze ose në gjuhën shqipe, pa e analizuar fjalinë nëse një zgjedhje e tillë është e pranueshme (si në fig. 17 dhe 19 në kreun V). Rastet e interferencës gjuhësore në fjalitë e analizuar nuk kanë qenë aq të shpeshta saqë të konsiderojmë se interferenca gjuhësore ka luajtur rol kyç në përkthim, por, padyshim, ka raste që edhe ka ndikuar.

Përderisa jemi te përkthimi dhe interferenca gjuhësore, hipoteza e fundit është e lidhur me hipotezën e katërt: ‘*Leksikoni, në rast të mungesës së terminologjisë përkatëse, mund të ketë ndikim në lidhjen e kryefjalës, kallëzuesit dhe gjymtyrëve të tjera*’. Në bazë të fjalive të analizuar në krerët III, IV dhe V mund të vijmë në përfundim se leksikoni nuk ka pasur ndikim në lidhjen ose në rendin e gjymtyrëve të fjalive, me përjashtim të shprehjeve frazeologjike dhe ato që pësojnë ndryshim të plotë strukturor. Nga analiza e fjalive të dhëna të teksteve është vërejtur vetëm një rast (‘*delirious*’ – ‘*në delir*’) ku mungesa e terminologjisë ka ndikuar në funksionin sintaksor dhe me këtë drejtpërdrejt në rendin e gjymtyrëve. Por, duke u mbështetur vetëm në një rast të tillë, nuk mund të thuhet se leksikoni luan rol në lidhjen e gjymtyrëve apo rendin e tyre në fjali. Ngjashëm, edhe në fjalitë e dhëna në pyetësor (shtojca B) mund të shihet se gjatë përkthimit është bërë përpjekje që patjetër të ruhet rendi i gjymtyrëve me qëllim që të ruhet edhe kuptimi i fjalisë. Në fjalitë ku është përdorur terminologji shkencore, duhet patjetër të ruhet rendi për shkak se në fjalitë e tilla përshkruhen procese natyrore apo shkencore që janë të lidhura

me njëra-tjetrën, ose që rrjedhin njëra pas tjetrës. Me këtë, ruajtja e rendit të gjymtyrëve është e domosdoshme për të ruajtur kuptimin e fjalisë.

Pyetëtori dhe përfundimet që rrjedhin nga analiza e pyetëtorit, janë mjaft domethënëse për të përcaktuar njohjen e gjuhës angleze, por në raste të caktuara edhe të gjuhës shqipe. Pas analizës së pyetëtorit dhe përgjigjeve të dhëna nga ana e studentëve dhe mësimdhënësve mund të thuhet se në disa raste të caktuara përgjigjet e studentëve kanë qenë të gabuara me një përqindje mjaft të lartë. Arsyeja e parë për përgjigjet e gabuara lidhet me faktin se fjalitë e përzgjedhura në pyetësor kanë qenë të një niveli të lartë vështirësie. Përzgjedhja e tyre është bërë me qëllim, sepse fjalitë e thjeshta nuk do nxirrnin përgjigjet e pyetjeve studimore të këtij disertacioni. Shqetësuese është se në disa fjali mësimdhënësit kanë dhënë po ashtu përgjigje të gabuara. Përqindjet e larta të përgjigjeve të gabuara në këto raste tregojnë për njohjen jo dhe aq të mirë të gjuhës angleze nga ana e mësimdhënësve. Ato deri diku mund të arsyetohen, sepse jo të gjithë mësimdhënësit e intervistuar ishin mësimdhënës të gjuhës angleze, por kanë qenë edhe profesorë të shkencave sociale.

6.2 Sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme

Në fillim të këtij disertacioni është theksuar se në gjuhën shqipe ekzistojnë teori të ndryshme për konceptet *togfjalësh*, *sintagmë*, *frazë* apo *përbërës sintaksor*. Duke pasur parasysh se në gjuhën angleze konceptet dhe nocionet janë përkufizuar me kohë, do të ishte e pëlqyeshme që edhe në gjuhën shqipe të bëhej një unifikim i terminologjisë dhe të përdorej një nocion i vetëm nga gjuhëtarët shqiptarë, siç përdoret nocioni *frazë* në gjuhën angleze. Nocion më i përshtatshëm, i cili do të përshtatej edhe me gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera, do të ishte nocioni *frazë*, dhe me këtë gjuhëtarët do ta kishin të qartë që në fillim për çfarë bëhet fjalë kur krahasohet gjuha shqipe me gjuhën angleze. Nga gjuhëtarët shqiptarë do të duhej të pranohej, edhe përdorimi i termit *sifjali*. Duke qenë se në gjuhën angleze kemi *fjali* (ang. sentence) dhe *fjali të varur* (ang. clause), pse të mos përdoret edhe në gjuhën shqipe një nocion i unifikuar. Konsiderojmë se përdorimi i këtij nocioni do të thjeshtonte terminologjinë e gjuhës shqipe dhe do të kontribuonte në unifikimin e termave gramatikorë.

Kryefjala është vërejtur se në shumë raste nuk është shkruar në gjuhën shqipe. Kjo kryesisht ka ndodhur në fjalitë ku kryefjala është shprehur me përemër dhe përdorimi i vazhdueshëm i kryefjalës krijon fjali monotone në gjuhën shqipe, ngaqë veta e foljes tregon kryefjalën. Por, një gjë e tillë nuk është e mundur në gjuhën angleze për shkak të tipologjisë së fjalive dhe rregullës sipas së cilës kryefjala duhet patjetër të jetë pjesë e fjalisë, me përjashtim të fjalive urdhërore apo thirrmore. Gjithsesi, në rastet ku kryefjala është e shprehur me emër në gjuhën shqipe, atëherë ajo duhet patjetër të shkruhet. Ngjashëm si me kryefjalën, edhe kundrinori kur është i shprehur me përemër vetor nuk është shkruar dhe është përdorur trajtë e shkurtër. Në rastet e tilla kundrinori i shprehur me trajtë të shkurtër në gjuhën shqipe normalisht qëndron para kallëzuesit, ndryshe nga gjuha angleze. Po të shkruhej kundrinori i plotë, atëherë rendi do të ishte i njëjtë si në gjuhën angleze. Në rastet ku kundrinori nuk krijon fjali monotone, atëherë sugjerohet që të shkruhet i plotë dhe të mos përdoret trajtë e shkurtër, sepse kjo ndikon drejtpërdrejt në rendin e gjymtyrëve në fjali, gjegjësisht lidhjen kryefjalë – kallëzues – kundrinor. Shembull tipik i një ngatërrese të tillë do të ishte fjalia *‘I saw him./E pash.’* Në bazë të kësaj fjalie e kuptojmë kryefjalën, por jo edhe kundrinorin pasi nuk e dimë se kë apo çfarë ka parë dikush.

Rendi i gjymtyrëve dhe ruajtja e rendit të njëjtë është i rëndësishëm në fjalitë e përkthyer. Ndryshimi i rendit do të ishte e logjikshme të ndodhë në rastet kur kemi stil letrar, ose përkthim të ndonjë veprë letrare. Gjithsesi, stili i përkthyesit mund të ndikojë rendin e gjymtyrëve, por nuk duhet që preferenca e përkthyesve të jetë faktor në përcaktimin e rendit të gjymtyrëve. Rendi i drejtë duhet të ruhet si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe. Ata duhet të mbështeten në rregullat sintaksore të rendit të fjalëve në fjali dhe të mos përmbysin rendin e drejtë të gjymtyrëve pa pasur nevojë. Përkthyesi, për të përshtatur sa më mirë tekstin, në raste të caktuara mund të ndikojë duke përdorur fjalë të ndryshme nga gjuha origjinale prej së cilës bëhet përkthimi. Sugjerohet që përkthyesi të mos bëjë përkthim ndryshe të fjalëve sepse kjo mund të ndikojë në strukturën, rendin dhe kuptimin e fjalisë. Raste të tilla janë vërejtur në tekstin e përkthyer *‘Aventurat e Sherlock Holmsit’* dhe të gjitha rastet kanë rezultuar për shkak të preferencës së përkthyesit dhe jo si ndryshim i domosdoshëm i fjalive të përkthyer. Në rast të mungesës së një termi përkatës, përkthimi me parafrazim do të ishte i pranueshëm, por në rastet kur ka term përkatës, atëherë nuk ka pse të bëhet përkthim ndryshe i fjalëve.

Qëllimi më i rëndësishëm i përkthimit është të përcillet kuptimi dhe jo ruajtja e rendit të gjymtyrëve apo strukturës së fjalisë. Në rastet e teksteve letrare rëndësi shumë më të madhe ka kuptimi sesa ruajtja e rendit të gjymtyrëve, prandaj edhe përkthimi me parafrazim do të ishte i pranueshëm në raste të caktuara. Në fjalitë me terminologji shkencore pëlqehet që të mos bëhet ndryshim i rendit të gjymtyrëve, ngaqë mund të ndikojë drejtpërdrejt në kuptimin e fjalisë së përkthyer, duke ndikuar në përshkrimin e dukurive të caktuara të përshkruara në fjalitë përkatëse. Por, në rastet kur nuk ekziston terminologji përkatëse, atëherë përkthimi me parafrazim normalisht që është i lejuar.

Së fundi, në bazë të analizës së përgjigjeve të pyetësorit janë vërejtur përgjigje të gabuara të studentëve dhe mësimdhënësve, deri diku shqetësuese. Përgjigjet e tyre të gabuara në disa raste janë tregues se niveli i njohjes së gjuhës angleze nuk është i kënaqshëm, prandaj edhe sugjerohet që të përforcojnë sa më shumë njohjen e gjuhës angleze.

6.3 Kufizimet e studimit

Të gjithë studimet kanë kufizimet e tyre. Ky studim ka pasur për qëllim nxjerrjen në pah të dallimeve strukturore të fjalive dhe rendin e kryefjalës, kallëzuesit dhe kundrinorit. Janë marrë parasysh mjaft aspekte teorike, si dhe fjali të analizuar në pjesën praktike.

Një ndër kufizimet e këtij studimi është se nuk është marrë parasysh tipologjia e rendit të fjalëve në fjali edhe në gjuhë të tjera, si p.sh., gjuhën gjermane. Zgjerimi i këtij disertacioni edhe me një krahasim teorik dhe praktik plotësues do të ishte me shumë interes për rendin kryefjalë – kallëzues – kundrinor.

Kufizim tjetër është se përfundimet e dhëna mbështeten në analizën e fjalive në pjesën teorike dhe praktike. Për të zgjeruar këtë disertacion dhe për të ardhur në përfundime ende më relevante do të ishte e pëlqyeshme të merren shembuj të fushave të ndryshme dhe të nxirren përfundime shtesë në bazë të fjalive të ndara sipas fushave përkatëse.

Krahasimi i gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur përbën një fushë me shumë interes për gjuhëtarët. Prandaj, analizimi i rendit të gjymtyrëve në gjuhën e folur dhe të shkruar në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze do të ishte me shumë interes për këtë studim dhe do të nxirrte ngjashmëri dhe dallime plotësuese relevante për këtë studim.

BIBLIOGRAFIA

- Aarts, B. “*English syntax and argumentation – Second edition*”, Palgrave Macmillan, London, 2001
- Aarts, B. “*Oxford Modern English Grammar*”, Oxford University Press, 2011
- Akademia e Shkencave, “*Gramatika e gjuhës shqipe 1*”, Tiranë, 2002
- Akademia e Shkencave, “*Gramatika e gjuhës shqipe 2*”, Tiranë, 2002
- Alexeyeva, I. ‘*Theoretical English Grammar Course*’, NK Publishers, 2007
- Altenberg, E. P. dhe Vago, R. M. ‘*English Grammar: Understanding the Basics*’, Cambridge University Press, 2010
- Andersen, P. K. ‘*Word order typology and comparative constructions*’, John Benjamins Publishing Company, 1983
- Azemi, B., dhe Bujari, R. “*Bazat e kërkimit në edukim*”, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2013
- Baugh, C. A. dhe Cable, Th. “*A History of the English Language*”, Routledge, 2012
- Bolshakov, I. dhe Gelbukh A. ‘*Computational Linguistics – Models, Resources, Applications*’, CIENCIA DE LA COMPUTACION, 2004
- Brinton, L. J. ‘*The Structure of Modern English – A Linguistic Introduction*’, John Benjamins Publishing Company, 2000
- Chang, N. dhe Lakoff, G. ‘*Semantic role marking: A preliminary report*’, Fall, 1997
- Chesterman, A. ‘*Memes of Translation – The Spread of Ideas in Translation Theory*’, John Benjamins Publishing Company, 1997
- Chomsky, N. ‘*Syntactic Structures*’, Mouton de Gruyter, 2002
- Çeliku, M. ‘*Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde (Pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura)*’, ILAR, Tiranë, 2007
- Çeliku, M., “*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*”, ILAR, Tiranë, 2012
- Demiraj, Sh. “*Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë, 1972
- Depraetere, I. ‘*On Verbal Concord with Collective Nouns in British English*’, HAL, 2011

- Domi, M. “*Vepra I – Studime sintaksore*”, Kristalina KH, Tiranë, 2013
- Domi, M. “*Sintaksa (për shkollat pedagogjike)*”, Tiranë, 1964
- Domi, M. “*Sintaksa e gjuhës shqipe II*” konspekt-leksione, Tiranë, 1969
- Downing, A. dhe Locke, Ph. ‘*English Grammar – A University Course Second Edition*’, Routledge, 2006
- Dhima, Th., “*Disa veçori të frazës shqipe në këndvështrimin e gjuhësisë së sotme*”, Seminari i Albanologjisë, Ohër, 2007
- Dhima, Th., “*Gjuha shqipe - Sintaksa*”, SHBLU, Tiranë, 2005
- Eastwood, J. ‘*Oxford Guide to English Grammar*’, Oxford University Press, 1994
- Einsohn, A. dhe Schwartz, M. ‘*The Copyeditor’s Handbook: A guide for Book Publishing and Corporate Communications*’, University of California Press, Fourth Edition, 2019
- Feist, J. ‘*Premodifiers in English – Their Structure and Significance*’, Cambridge, 2012
- Floqi S. “*Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*”, Studime Filologjike 1
- Floqi, S. ‘*Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme*’, Studime Filologjike – Nr.2, 1969
- Freeborn, D. “*From Old English to Standard English – A course Book in Language Variation Across Time (Third Edition)*”, Macmillan, 1992
- Graffi, G. “*Sintaksa – Strukturat e ligjërit*”, Dituria, 2003
- Greenbaum, S. dhe Nelson, G. “*An introduction to English grammar – Second Edition*”, Longman, London, 2002
- Greenbaum, S. “*English Grammar*”, Oxford University Press, 1996
- Greenberg, J. ‘*Language Universals*’, The Hague: Mouton, 1966
- Gudmanian, A. ‘*Guide to Successful English Grammar*’, NK Publishers, 2013
- Haebler, C. ‘*Eine albanische Wortstellungsregel*’, Munchener Studien zur Sprachwissenschaft, Heft 11, 1957
- Hannay, M. ‘*English Existentials in Functional Grammar*’, Walter De Gruyter Incorporated, 1985
- Hannay, M. dhe Vester, E. ‘*Working with Functional Grammar: Descriptive and Computational Applications*’, Foris Publications, 1990
- Hickey, R. “*Studying the History of English*”, www.uni-due.de/SHE/, 2017
- Huddleston, R. ‘*Introduction to the Grammar of English*’, Cambridge University Press, 1984

- Iriskulov, A. T. '*Theoretical Grammar of English*', Tashkent, 2006
- Jespersen, O. '*Analytic Syntax*', University of Chicago Press, 1984
- Jong-Bok, K. dhe Sells, P. '*English Syntax: An Introduction*', Center for the study of language and information, 2008
- Konrad, D. C. dhe Adelman, P. B. '*The Grammar Handbook*', Good Year Books by Pearson Learning, 2000
- Kuçi, S. "*Studimet mbi strukturën e shqipes në BRSS (Monografi)*", Allcoa Impex, Prishtinë, 2013
- Kulikov, L. Malchukov, A. dhe De Swart, P. '*Case, Valency and Transitivity*', John Benjamins Publishing Company, 2006
- Lehman, W. P. '*A structural principle of language and its implications*' Lg, 1973
- McArthur, B. Th. "*The Oxford Companion to the English Language*", Oxford University Press, 2005
- Memushaj, R. "*Gjuhësia gjenerative*", SHBLU, 2008
- Memushaj, R. "*Tri koncepte themelore të sintaksës moderne*", Studime Filologjike, 2008
- Morley, G. D. '*Syntax in Functional Grammar – An Introduction to Lexicogrammar in systemic linguistics*', Continuum, 2000
- Nuhui, V. '*Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*', ASHAK, Prishtinë, 2013
- O'Dwyer, B. T. '*Modern English Structures – Form, Function and Position (Second Edition)*', Broadview Press, 2006
- O'Grady, W. dhe Achibald, J. '*Contemporary Linguistic Analysis – An Introduction*', Pearson, 2016
- O'Grady, W., Dobrovolsky, M. dhe Katamba, F. "*Contemporary linguistics by Murray W. R.*", Longman, London 1997
- Përnaska, R. '*Një rast i veçantë i rendit të gjymtyrëve në fjalinë e përbërë në gjuhën shqipe*', Studime Filologjike – Nr. 1, 1979
- Quirk, R. dhe Greenbaum S. "*A University Grammar of English*", Longman, 1976
- Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G. dhe Svartvik, J. "*A Comprehensive Grammar of the English Language*", Longman, 1985
- Rushi, Th. '*Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe*', Studime Filologjike – Nr. 4, 1984

- Schmidt, P. W. '*Die Sprachfamilien und Sprachenkreise der Erde*', Heidelberg: Carl Winter, 1926
- Song, J. J. '*Word Order*', Cambridge University Press, 2012
- Tesniere, L. '*Elements de syntaxe structurale*', Paris: Klincksiek, 1959
- Topalli, K. "*Gramatikë historike e gjuhës shqipe*", Qendra e Studimeve Albanologjike – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2011
- Totoni, M. "*Fraza me nënrenditje*", SHBLU, Tiranë, 2000
- Thomai, J. '*Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*', Tiranë, 1999
- Van Gelderen, E. '*An Introduction to the Grammar of English – Revised Edition*', John Benjamins Publishing Company, 2010
- Weil, H. '*The order of words in the ancient languages compared with that of the modern languages*', John Benjamins, 1978
- Wekker, H. '*Topics in English Linguistics 22*', Mouton de Gruyter, 1997
- Wekker, H. dhe Haegeman, L. "*A modern course in English syntax*", Routledge, London, 1985

SHTOJCA A

FJALITË E ANALIZUARA NGA VEPRA ‘AVENTURAT E SHERLOK HOLMSIT’

Tabela 1. Fjali me kryefjalë, kallëzues dhe kundrinor në veprën ‘Aventurat e Sherlock Holmsit’.

	Kryefjalë – Kallëzues – Kundrinor	Strukturë e njëjtë (rend i njëjtë dhe përshtatje numri, vete, gjinie)	Strukturë jo e njëjtë (mospërshtatje rendi, numri, vete e gjinie)
1	<i>“Mr. Wilson,” said Holmes to the man, “let me introduce you to Dr. Watson, my colleague and assistant. Please, start your story again.”</i> <i>“Z. Uilson” i tha Holmsi atij burrit “më lejoni t’ju prezantoj me Dr. Uotsonin, kolegun dhe asistentin tim. Ju lutem, fillojeni historinë nga e para”.</i>	✓	
2	<i>Mr. Wilson showed the newspaper advertisement where a post was offered in the Red-Headed League for four pounds a week.</i> <i>Z. Uilson <u>na</u> tregoi një shpallje në gazetë që ofronte punë pranë Lidhjes së Flokëkuqëve për katër paund në javë.</i>		✓
3	<i>Wilson, the owner of a pawnbroker’s in Coburg Place, had heard this through his employee Spaulding, who encouraged him to take part.</i> <i>Uilsoni, pronari i një shitoreje pengjesh në Sheshin Koburg kishte dëgjuar</i>	✓	

	<i>për këtë nga punëtori i tij Spolding, që e kishte nxitur të merrte pjesë.</i>		
4	<i>Spaulding pushed his way through and I went into the office. Spoldingu e çau rrugën ndërmjet tyre dhe unë hyra brenda në zyrë.</i>	✓	
5	<i>Duncan Ross, the redhead who was making the selection, was surprised by my hair and explained to me that I would work from ten until two copying out the Encyclopaedia Britannica and that I couldn't miss a day. Dankan Rosi, flokëkuqi që bënte përzgjedhjen, u befasua nga flokët e mi dhe më shpjegoi se do të punoja nga ora dhjetë deri në dy për të kopjuar Enciklopedinë Britanike dhe se nuk duhej të mungoja asnjë ditë.</i>	✓	
6	<i>As my business usually received clients in the afternoon, my employee could take care of things in the morning, so I accepted. Meqë në biznesin tim klientët zakonisht vijnë pasditeve, punëtori im mund të kujdesej për gjërat në mëngjes, ndaj pranova.</i>		✓
7	<i>The next day I started working and Mr. Ross passed by sometimes to check I was at my desk. Ditën tjetër ia nisa punës dhe z. Ros kalonte ndonjëherë për të kontrolluar nëse isha në tryezën time.</i>	✓	
8	<i>Each week he paid me the four pounds and he then only passed by once a week and even stopped going, but I didn't dare to miss a day. Çdo javë ai më paguante nga katër paundë dhe pastaj vinte aty vetëm një herë në javë dhe pastaj nuk vinte më, por unë nuk guxoja të mungoja asnjë ditë.</i>		✓
9	<i>I asked the doorman, but he had never heard of the League nor of Ross. E pyeta portierin, por ai nuk kishte dëgjuar as për Lidhjen, as për Rosin.</i>		✓
10	<i>I asked my employee for advice and he told me to wait for news, but the pay is so good that I don't want to lose it, so I came here. Kërkova këshillë nga punëtori im dhe ai më tha të prisja për ndonjë lajm, por paga është aq e mirë sa nuk dua ta humb, ndaj erdha këtu.</i>		✓
11	<i>I placed an advertisement and I chose him because he seemed smart and didn't cost me much, as he was ready to work for half-wages while he was learning the trade. Vura një shpallje dhe e zgjedha atë, pasi m'u duk i zgjuar dhe nuk kërkonte shumë, pasi ishte i gatshëm të punonte për gjysmën e pagës ndërkohë që mësonte zanatin.</i>		✓
12	<i>Of course, he also has his defects: he loves photography and spends hours in the basement developing photos. Sigurisht, dhe ai kishte të metat e tij: i pëlqen shumë fotografia dhe kalon orë të tëra në bodrum duke zhvilluar foto.</i>		✓
13	<i>What does this Spaulding look like? Si duket Spoldingu?</i>	✓	
14	<i>I hope to give you the solution on Monday. Shpresoj që zgjidhjen t'ua sjell të hënën.</i>		✓
15	<i>I said to Holmes that it was all a bit odd. I thash Holmsit se kjo dukej disi e çuditshme.</i>	✓	
16	<i>"I'll smoke a few pipes in order to think," and sitting in the armchair, he lit his pipe and closed his eyes.</i>		✓

	<i>"Do ta tymos llullën disa herë që të mendoj" tha ai duke u ulur në kolltuk, ndezi llullën dhe mbylli sytë.</i>		
17	<i>A young man opened the door. Derën e hapi një djalë i ri.</i>		✓
18	<i>Excuse me, I just wanted to ask you how to get to the Strand. Më falni, desha t'ju pyes si të shkoj deri në Strand.</i>	✓	
19	<i>"A smart fellow," said Holmes when we left, "the fourth smartest fellow in London." "Djalë i zgjuar" tha Holmsi kur u larguam, "personi i katërt më i zgjuar në Londër".</i>	✓	
20	<i>Let's see, we've got here a shop, the branch of City Bank, a restaurant and a tavern. Të shohim pra, këtu kemi një shitore, degën e Bankës Citi, një restorant dhe një tavernë.</i>		✓
21	<i>After the concert, Holmes said to me, "A big crime is being plotted. I will need your help tonight. Can you come at ten with your pistol?" Pas koncertit, Holmsi më tha, 'Po planifikohet një krim i madh. Sonte më duhet ndihma jote. A mund të vish tek unë në orën dhjetë, merre dhe pistoletën?</i>		✓
22	<i>I confess that I still didn't know what was behind the business with the redhead, despite having seen and heard the same as Sherlock Holmes. E pranoj se ende nuk e dija si ishte puna me flokëkuqin, edhe pse kisha parë dhe dëgjuar të njëjtat gjëra si Sherlok Holmsi.</i>		✓
23	<i>The other was wearing a luxury suit and hat. Tjetri kishte veshur kostum luksoz dhe kishte vënë kapele.</i>		✓
24	<i>Allow me to introduce Mr. Merryweather. Më lejoni t'ju prezantoj me z. Merriuedhër.</i>		✓
25	<i>Let's hope this excursion proves useful. Të shpresojmë se ky ekskursion do të jetë i frytshëm.</i>		✓
26	<i>Mr. Jones might get his man. Z. Xhons mund të kapë njeriun e tij.</i>	✓	
27	<i>I have been chasing him for years. Kam vite që e ndjek.</i>		✓
28	<i>Holmes took his hunting whip and we went to the same street as that morning. Holmsi nxori kamzhikun e tij të gjuetisë dhe shkuam në të njëjtën rrugë që e vizituam në mëngjes.</i>	✓	
29	<i>Mr. Merryweather led us through a side door and after going down to several corridors we arrived, using a lantern, at a basement room full of boxes. Z. Merriuedhër na çoi nga një derë anësore dhe pasi kaluam nëpër disa korridore, me një fener në dorë arritëm në një podrum plot kuti.</i>		✓
30	<i>Holmes examined the cracks between the paving slabs with his magnifying glass. Holmsi i shikoi me vëmendje me një lupë të plasariturat midis pllakave.</i>		✓
31	<i>He will tell you why the thieves are interested in the basement.</i>		✓

	<i>Ai do t'ju tregojë pse hajdutët kanë interesim për këtë podrum.</i>		
32	<i>These boxes contain the gold that we got from the Bank of France. Këto kuti kanë arin që kemi marrë nga Banka e Francës.</i>	✓	
33	<i>The other managed to escape back down the hole, despite the policeman grabbing him by his jacket. Tjetri arriti të arratiset nga vrima në tokë, edhe pse polici e kishte kapur nga xhaketa.</i>	✓	
34	<i>Three policemen are waiting for your friend at the other exit. Tre policë po e presin shokun tënd në daljen tjetër.</i>	✓	
35	<i>You have worked everything out. I kuptove të gjitha.</i>		✓
36	<i>"I congratulate you," he said. "Të përgëzoj," tha ai.</i>		✓
37	<i>When I heard that the employee was working for half-wages, I knew he had a good reason. Kur dëgjova se punëtori i tij punonte për gjysëm rroge, e dija se kishte arsye të forta.</i>		✓
38	<i>And what's more, he spent a lot of time in the basement. Për më tepër, ai kalonte shumë kohë në podrum.</i>		✓
39	<i>II - My wife and I were having breakfast when I received a telegram from Sherlock Holmes to go with him to Boscombe Valley to solve a case. Gruaja ime dhe unë po hanim mëngjes kur mora një telegram nga Sherlock Holmsi që më kërkonte ta shoqëroja në Luginën Boskomb për të zgjidhur një rast.</i>		✓
40	<i>They think it's a murder case and all the clues point to the son of the victim, but precisely because it seems so simple, it becomes a difficult case. Ata mendojnë se është rast vrasjeje dhe të gjitha të dhënat të çojnë tek djali i viktimës, mirëpo pikërisht pse duket kaq e thjeshtë, është bërë një rast i vështirë.</i>	✓	
41	<i>He told me that in Boscombe Valley lived Mr. Turner, who owned most of the land there. Ai më tha se në Luginën Boskomb jetonte z. Tërner që ishte pronar i pjesës më të madhe të tokave atje.</i>		✓
42	<i>He had bought it with the fortune that he had made in Australia. Ai i kishte blerë ato toka me pasurinë e fituar në Australi.</i>		✓
43	<i>On one of his farms lived Mr. McCarthy, whom he'd met in the Australian colonies. Në njërën prej fermave të tij jetonte z. Mekarhi, me të cilin ishin takuar në kolonitë australiane.</i>	✓	
44	<i>This man had a son and Turner had a daughter. Ai kishte një djalë dhe Tërner kishte një vajzë.</i>	✓	
45	<i>"On Monday," Holmes continued, McCarthy left his house at about three and walked to Boscombe pool. "Të hënën," vijoi Holmsi, Mekarhi u largua nga shtëpia rreth orës tre dhe shkoi të ecë pranë liqenit Boskomb.</i>		

46	That morning <u>he</u> said to his maid that <u>he</u> had a meeting at three, but <u>we</u> don't know with whom. Atë mëngjes i kishte thënë shërbyeses se kishte një takim në orën tre, mirëpo nuk e dimë me kë.		✓
47	A gamekeeper <u>saw</u> him walking alone and shortly after <u>he</u> saw McCarthy's son, James, following him with a shotgun. Një rojtar e kishte parë duke ecur vetëm dhe pak më vonë kishte parë djalin e Mekarhit, Xhemsin, duke e ndjekur me një pushkë.		✓
48	The daughter of the Valley lodge-keeper saw <u>them</u> arguing next to the pool and saw how the son raised his hand to his father. Vajza e kujdestarit të Luginës i kishte parë duke u grindur pranë liqenit dhe kishte parë se si djali kishte ngritur dorën kundër babait të tij.		✓
49	Moreover, Turner's daughter believes he's innocent and has hired Lestrade, from Scotland Yard, who has called me. Aq më tepër, vajza e Tërnerit beson se ai është i pafajshëm dhe ka punësuar Lestradin nga Skotland Jard, i cili më ka telefonuar.	✓	
50	<u>And I</u> think it's significant that the young man wasn't surprised to be arrested. Mendoj se është shumë e rëndësishme që i riu nuk u befasua që e arrestuan.		✓
51	No, because he said he was innocent. Jo, sepse ai tha që ishte i pafajshëm.	✓	
52	He declared he'd been in Bristol for three days and had arrived that morning but <u>his father wasn't home</u> . Tha se kishte qenë në Bristol për tri ditë dhe se ishte kthyer atë mëngjes, mirëpo nuk e kishte gjetur babain në shtëpi.		✓
53	He took his shotgun and <u>went</u> to the pool to hunt rabbits. Ai kishte marrë pushkën dhe ishte nisur drejt liqenit për të gjuajtur lepuj.	✓	
54	On the way he saw the gamekeeper, but he assures he <u>wasn't following</u> his father. Rrugës kishte parë rojtarin, por ai tha se nuk kishte qenë në ndjekje të babait.		✓
55	In fact, he didn't even know that he was going in the same direction. Në fakt, as e kishte ditur se po ecte në të njëjtin drejtim.	✓	
56	About 90 meters from the pool, <u>he</u> heard the call Cooee which was the <u>usual</u> call between his father and him, so <u>he</u> ran and he found <u>him</u> near the pool. Rreth 90 metra larg liqenit kishte dëgjuar klithjen Kuuuu që zakonisht ishte si një thirrje mes tij dhe babait të tij, ndaj kishte vrapuar dhe e kishte gjetur pranë liqenit.		✓
57	His father <u>angrily</u> asked him what he was doing there. Babai e kishte pyetur me zemërim se çfarë bënte aty.		✓
58	He dropped the shotgun and took <u>him</u> in his arms, but he died just after saying something about a rat. E kishte hedhur pushkën dhe e kishte marrë në krahë, mirëpo ai kishte vdekur sakaq duke thënë diçka për një mi.		✓

59	<i>The young man saw a grey article of clothing on the ground when he was running to his father, but he didn't see it again later when he went to get help.</i> <i>Djali i ri kishte parë një pelerinë ngjyrë hiri në tokë kur kishte vrapuar drejt babait, por nuk e kishte parë më vonë pasi ishte kthyer për të kërkuar ndihmë.</i>	✓	
60	<i>He won't tell and the dying man's strange words are suspicious.</i> <i>Nuk do të tregojë dhe fjalët e burrit që po vdiste janë të dyshimta.</i>	✓	
61	<i>But if he had the imagination to invent that <u>his</u> father spoke of a rat before dying, why didn't he have it to invent a motive for the argument?</i> <i>Po nëse do të kishte imagjinatën për të sajuar se babai i kishte folur për një mi para se të vdiste, pse nuk e pati edhe për të sajuar ndonjë motiv për grindjen?</i>	✓	
62	<i>I deduce that the young man is telling the truth.</i> <i>Mendoj se i riu po thotë të vërtetën.</i>	✓	
63	<i>With quick feminine intuition she knew who was Sherlock Holmes and she said to him: "I know James didn't do <u>it</u>!"</i> <i>Me intuitën e saj të hollë femërore e kuptoi cili ishte Sherlok Holmsi dhe iu drejtua atij: "E di që Xhejmsi nuk e ka bërë!"</i>		✓
64	<i>We have known each other since we were children.</i> <i>E njohim njëri-tjetrin që kur jemi fëmijë.</i>	✓	
65	<i>Do you think he's innocent?</i> <i>A mendoni se është i pafajshëm?</i>	✓	
66	<i>I think it's very probable.</i> <i>Mendoj se ka shumë të ngjarë.</i>		✓
67	<i>No, he didn't want <u>it</u> either.</i> <i>Jo, <u>as</u> ai nuk do e donte.</i>		✓
68	<i>Can I visit your father tomorrow?</i> <i>A mund ta vizitoj babain tuaj nesër?</i>	✓	
69	<i>The doctor won't let <u>you</u>.</i> <i>Doktori nuk do t'ju lejojë.</i>		✓
70	<i>Please, tell James that I know he's innocent.</i> <i>Ju lutemi, thuajini Xhejmsit se unë e di që ai është i pafajshëm.</i>	✓	
71	<i>Holmes left with Lestrade to visit James in prison.</i> <i>Holmsi u largua me Lestradin për ta vizituar Xhejmsin në burg.</i>	✓	
72	<i>Meanwhile, I, as a doctor, could analyse the mortal wound.</i> <i>Ndërkohë, unë si mjek mund të analizoja plagën vdekjeprurëse.</i>	✓	
73	<i>From the police report I deduced that <u>the blow had come</u> from behind.</i> <i>Nga raporti i policisë kuptova se <u>e kishin goditur</u> nga pas.</i>		✓
74	<i>This favoured the accused, although his father could have turned round before being hit.</i> <i>Kjo favorizonte të akuzuarin, edhe pse babai i tij mund të ishte kthyer para se të goditej.</i>	✓	
75	<i>When Holmes arrived, he told me: "<u>I</u> don't think the son knows who did <u>it</u> either."</i> <i>Kur Holmsi u kthye, ai më tregoi: "Nuk mendoj se djali e di kush e ka</i>		✓

	<i>bërë.</i>		
76	Not even his father knew, as he would have thrown him out of the house. <i>As babai i tij nuk e ka ditur, pasi do ta kishte nxjerrë jashtë shtëpisë.</i>	✓	
77	He was <u>with her</u> during these three days in Bristol. <i>Ai ka qenë me të këto tri ditë në Bristol.</i>	✓	
78	She left <u>him</u> and is saying their wedding wasn't legal. <i>Ajo e ka lënë duke thënë se martesa e tyre nuk ishte e ligjshme.</i>		✓
79	So, who killed the father? <i>Pra, kush e vrau babain?</i>	✓	
80	First, the father had a meeting at the pool and it <u>wasn't</u> with his son, as he didn't know <u>when</u> we has returning, and second, the father shouted 'Cooee' before he knew his son had returned. <i>E para, babai kishte takim pranë liqenit dhe nuk e kishte me djalin e tij, pasi nuk e dinte se ai po kthehej, dhe e dyta, babai ka bërëtitur Kuuii para se ta dinte që djali i tij ishte kthyer.</i>		✓
81	I've found out that Mr. Turner didn't charge McCarthy for living on the farm and that he helped him a lot. <i>Kam zbuluar se z. Tërner nuk i ka marrë qira Mekarthis për fermën dhe se e ka ndihmuar shumë.</i>	✓	
82	And <u>don't you think it's odd</u> that if McCarthy owed <u>him</u> so much, that he <u>strongly supported his son marrying Turner's daughter</u> , who's the heiress, knowing that Turner was against it? <i>Dhe a nuk ju duket e çuditshme që nëse Mekarthis i kishte aq shumë borxhe, që ai dëshironte aq shumë që djali i tij të martohej me vajzën e Tërnerit, e cila është trashëgimtare, duke e ditur se Tërneri ishte kundër saj?</i>		✓
83	Here we go with the deductions! <i>Ja ku po vrasim mendjen!</i>		✓
84	At the <u>farm</u> Holmes asked the maid to show <u>him</u> the boots that McCarthy was wearing <u>the day of his death</u> , and also a pair of his son's. <i>Kur arritëm në fermë, Holmsi i kërkoi shërbyeses të na tregonte çizmet që Mekarthis kishte patur të veshura ditën kur vdiq, si dhe një palë të djalit të tij.</i>		✓
85	He measured <u>them</u> in several parts and then <u>we</u> all took the path to the pool. <i>Ai i mati në disa pjesë dhe pastaj të gjithë morëm rrugën për tek liqeni.</i>		✓
86	He hunched his shoulders, stretched his neck, <u>frowned</u> and his eyes shone when looking <u>at something</u> . <i>Ai përkulte supet, zgjaste qafën, rrudhte ballin dhe sytë i ndriçonin kur shihte diçka.</i>		✓
87	That confirms his story. <i>Kjo konfirmon historinë e tij.</i>	✓	
88	<u>The trial</u> led Holmes to an enormous beech tree. <i>Gjurmët e çuan Holmsin tek një pemë e madhe ahu.</i>		✓
89	He saw a stone, examined it and kept it. <i>Pa një gur, e ekzaminoi dhe e mbajti.</i>		✓

90	The footprints led <u>him</u> down a forest track to the road. Gjurmët e këmbëve <u>e</u> çuan nëpër një shteg pylli tek rruga.		✓
91	I suppose that grey house is the lodgekeeper's. Besoj se shtëpia e hirtë është e kujdestarit.	✓	
92	Ten minutes later he <u>met up with us</u> . Dhjetë minuta më vonë ai <u>na gjeti</u> .		✓
93	He took out the stone. Ai nxorri gurin.	✓	
94	The murder was committed with this. Vrasja është bërë me këtë.	✓	
95	Its shape fits with the wounds. Forma e tij përputhet me plagët.	✓	
96	"And the murderer?" <u>Lestrade</u> asked. "Po vrasësi?" pyeti <u>Lestradi</u> .		✓
97	I have given <u>you</u> your chance. <u>Ta</u> kam dhënë mundësinë.		✓
98	"And the rat?" I asked. "Po miu?" e pyeta.	✓	
99	He brought it. Ai e solli atë.	✓	
100	Holmes took out a map of the Australian colony of Victoria. Holmes nxori një hartë të kolonisë australiane të Viktorias.	✓	
101	I asked for <u>it</u> last night, <u>telegraphing</u> Bristol. <u>Këtë</u> e kam kërkuar mbrëmë, kur dërgova <u>telegraf</u> në Bristol.		✓
102	If I cover <u>this</u> with my hand, what can you read? Po <u>ta</u> mbuloj me dorë, a mund të lexosh?		✓
103	"And now?" <u>he</u> said, removing his hand. "Po tani?" <u>tha ai</u> duke hequr dorën.		✓
104	He was trying to say the name of his murderer, so-and-so from Ballarat, <u>which is</u> the mining town that experienced gold fever in Australia. Është përpjekur të thotë emrin e vrasësit të tij, filan fisteku nga Balarmiu, një qytezë minatorësh që përjetoi ethet e arit në Australi.	✓	
105	And this person lived in the area, because you can <u>only</u> reach <u>the pool</u> via the farm or the estate. Ky njeri jeton këtu afër, sepse <u>në liqen</u> mund të vish <u>vetëm</u> nga ferma apo vila.		✓
106	I knew he had a limp. E di që çalon.		✓
107	Now I know who it is. Tani e di kush është.	✓	
108	"Mr. Turner!" the waiter said. "Z. Tërner!" tha kamarieri.		✓
109	He had strong arms denoting energy, but his face was pale and exhausted. Ai kishte krahë të fuqishëm që tregonin energji, mirëpo fytyrën e kishte të zbehtë dhe të lodhur.		
110	Did you get my note?	✓	

	A e more shënimin tim?		
111	Yes, the lodge-keeper brought <u>it to me</u> . Po, kujdestari ma solli.		✓
112	I know about him. E di për Mekarthin.	✓	
113	God have mercy on me! Zoti pastë mëshirë për mua!	✓	
114	I would have <u>never</u> allowed <u>them</u> to sentence my boy. Kurrë nuk do të kisha lejuar ta dënojnë djalin.		✓
115	I don't have long to live, you understand? E kuptoni besoj se nuk do të jetoj dhe shumë gjatë?		✓
116	Holmes took a pen and paper. Holmsi nxori laps dhe letër.	✓	
117	Tell <u>us</u> the truth and I'll write it down <u>for you</u> to sign. Na trego të vërtetën, unë do ta shkruaj dhe ti do ta nënshkruash.		✓
118	I won't present this confession unless it's necessary. Nuk do ta paraqes këtë dëshmi derisa të jetë e nevojshme.	✓	
119	One time we killed several soldiers, but although I aimed my pistol at the wagon driver, I didn't shoot <u>him</u> . Një herë vramë disa ushtarë, por edhe pse e kisha drejtuar armën time nga shoferi i vagonit, nuk gjuajta.		✓
120	We fled with the gold and returned to England. U larguam me arin dhe u kthyem në Angli.	✓	
121	I split from my friends, bought an estate and wanted to lead a respectable life. Unë u ndava nga shokët e mi, bleva një pronë dhe doja të bëja jetë si njeri i respektuar.	✓	
122	After a while I bumped into McCarthy in London. Pas një kohe, rastësisht takova Mekarthin në Londër.	✓	
123	He <u>threatened</u> to go to the police if I didn't help him and his son, as they were in a miserable situation. Ai më kërcënoi se do të shkonte në polici po të mos e ndihmoja atë dhe djalin e tij, pasi ishin në gjendje të mjeruar.		✓
124	They came with me and I couldn't get rid of him. Ata erdhën me mua dhe nuk mund t'i hiqja dot qafe.	✓	
125	He asked me for every whim he had, and more so when my daughter grew up, as I feared she would find out about my past. Ai më kërkonte çfarë t'i tekej dhe aq më tepër kur vajza ime u rrit, ngaqë kisha frikë mos zbulonte të kaluarën time.		✓
126	I gave <u>him</u> everything: land, a house, money, until he asked for my daughter. I dhashë gjithçka: tokë, shtëpi, para, derisa më kërkoi vajzën.		✓
127	That I refused. Atë e refuzova.	✓	
128	McCarthy threatened <u>me</u> , I challenged <u>him</u> and we arranged to meet at the pool.		✓

	Mekarthi <u>më</u> kërcënoi, unë <u>e</u> sfidova dhe e lamë të takohemi te liqeni.		
129	When I arrived, I saw him with his son and I waited behind a tree. Kur arrita, pashë se ishte me djalin e tij dhe prita pas një peme.		✓
130	As I heard him telling his son to marry my daughter, it made me mad. Sapo e dëgjova që po i thoshte djalit të martohej me vajzën time, më hipi gjaku.		✓
131	Mr. Holmes, I couldn't stand my daughter suffering as I had. Z. Holms, nuk mund të duroja që vajza ime të vuante si unë.		✓
132	I hit him and his scream made his son return. E godita dhe djali u kthye nga klithja e tij.		✓
133	Do you know Peterson, the commissionaire? A e njeh Pitersonin, komisionerin?	✓	
134	He found it. Ai e ka gjetur.		✓
135	He brought it to me on Christmas morning, with a goose, which he'll be eating now. Ma solli mëngjesin e Krishtlindjeve me një patë, të cilën do ta hamë tani.		✓
136	One of them knocked his hatt off and the man raised his cane to defend himself and, by accident, broke the shop window behind him. Njëri prej tyre ia rrëzoi kapelën dhe burri kishte ngritur shkopin për t'u mbrojtur dhe pa dashje kishte thyer dritaren e shitores prapa vetes.	✓	
137	The man left the hat and the goose in his escape. Burri kishte lënë pas kapelën dhe patën.		✓
138	Today he took the goose, as it was going to go off. Sot ai e mori patën, pasi po prishej.	✓	
139	And this man didn't place an advertisement? Po ky burri nuk ka vënë asnjë shpallje?	✓	
140	We can only get clues from his hat. Mund të nxjerrim të dhëna nga kapelja e tij.		✓
141	You're joking with me. Po bën shaka me mua.	✓	
142	These grey hairs reveal his advanced age, and the dust that you see isn't from the street but from fluff from a house. Këto flokë të thinjur na tregojnë se ka moshë të shtyrë dhe pluhuri që sheh nuk është nga rruga por nga pendla në shtëpi.		
143	The dust and the sweat stains make me think that he hardly leaves his house and he gets tired and sweats when he walks. Pluhuri dhe njollat e djersës më bëjnë të mendoj se ai del nga shtëpia rrallëherë dhe lodhet e djersitet kur ecën.		✓
144	"The goose sir!" he exclaimed. "Pata zotëri!" thirri ai.		✓
145	Look what my wife found inside it. Shiko çfarë gjeti brenda gruaja ime.		✓
146	And he revealed a precious stone. Dhe ai na tregoi një gur të çmuar.	✓	

147	<i>"Exactly," said Holmes. "Pikërisht," tha Holmsi.</i>	✓	
148	<i>In the newspapers they're talking about the robbery that took place on the 22nd. Gazetat po flasin për grabitjen që u bë më 22.</i>		✓
149	<i>The plumber, John Horner, was accused of stealing it from the countess's jewelry box after he'd fixed a grate in her room at the Cosmopolitan hotel. Hidrauliku, Xhon Horner, u akuzua se ka vjedhur nga kutia e xhevahireve të konteshës pasi kishte rregulluar një tub në dhomën e saj në hotelin Kozmopolitan.</i>	✓	
150	<i>James Ryder, duty manager at the hotel, declared that he was with him while he was repairing the grate, but he had to go out and when he returned, Horner had gone and the jewelry box had been forced open. Xhejms Rajder, menaxheri i hotelit, ka deklaruar se kishte qenë me të ndërsa hidrauliku rregullonte tubin, mirëpo i ishte dashur të dilte dhe kur ishte kthyer, Horneri ishte larguar dhe kutia e xhevahireve ishte hapur me zor.</i>	✓	
151	<i>Ryder called the police and Horner was arrested, although he resisted and insisted he was innocent. Rajderi thirri policinë dhe Hornerin e arrestuan, edhe pse kishte rezistuar duke thënë se ishte i pafajshëm.</i>	✓	
152	<i>Now we have to work out how the carbuncle got into the goose. Tani na duhet të zbulojmë se si përfundoi brenda patës guri i çmuar.</i>		✓
153	<i>First, I'll put an advertisement in the newspaper so the owner of the goose and the hat comes this afternoon for them. Së pari, do të vë një lajmërim në gazetë që pronari i patës dhe kapelës të vijin këtë pasdite për t'i marrë.</i>		✓
